

**PROCESI I PRIVATIZIMIT NË REPUBLIKËN E
KOSOVËS,MODELET,ZBATIMI DHE NDIKIMI I TIJ NË
ZHVILLIMIN EKONOMIK**

Mr.Sc. Bajram Fejzullahu

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakulteti
Ekonomik, me profil Menaxhment, për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc.Dr. Aleksandër Biberaj

Tiranë,mars 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se disertacioni, të cilin e kam punuar dhe e kam dorëzuar për vlerësim tek mentori, e përgatita në mënyrë të pavarur dhe se ai është tërësisht disertacion imi autorial. Më tutje, deklaroj se disertacioni në fjalë nuk është i publikuar e as i përdorur për qëllime të kryerjes së obligimeve mësimore në këtë apo ndonjë institucion tjetër të arësimit të lartë.

Në fund, deklaroj se në përgatitjen e disertacionit kam respektuar rregullat etike dhe standardet e punës shkencore e akademike të UET.

Bajram Fejzullahu

.

ABSTRAKTI

Me qëllim të konstituimit si shtet, para Kosovës u parashtrua kërkesa që të bëjë definimin pronës të cilën e posedonte. Kjo kërkonte që prona shoqërore (term kryesisht i njohur vetëm për pronën në ish Jugosllavi) të ketë titullarin e saj. Kjo mund të bëhej vetëm përmes procesit të privatizimit. Pasi që shikuar nga shumë aspekte Kosova ishte rast “sui generis”, këtë fat e kishte edhe procesi i privatizimit. Përmes këtij punimi konsideroj që do të përmbushet qëllimi i përcaktuar i cili nuk ka të bëjë jo vetëm me përshkrimin e të ndodhurave gjatë procesit mirëpo për edhe për vazhdimin e tij të propozohen metoda dhe përmylljen e suksesshme të procesit të privatizimit dhe përmbushjen e objektivave që do të konsistojnë në përmirsimin e asaj që mund të

Gjatë realizimit të këtij punimi do të dëshmohet se procesi i privatizimit në Kosovë nuk ishte në harmoni me kërkesat e popullatës dhe kohës. Modelet e përzgjedhura vetëm krijuan huti edhe më të madhe. Të paktë mund të jenë ata që do të arrijnë të kuptojnë se a është fjala për proces të privatizimit apo proces të qira dhënies. Rezultatet e hulumtimit do të dëshmojnë se procesi i privatizimit në Republikën e Kosovës nuk përmbushi (deri tani) objektivat e parashtruara.

Shumë u fol e pak u shkrua deri tani për këtë proces. Procesi i privatizimit në Republikën e Kosovës ndodhi në kohë dhe hapësirë të caktuar. Fillimisht ishte i panjohur dhe i imponuar. Faktori vendor, për mungesë të njohurive të caktuara ose për mos njohje të faktorëve të tjerë, që nga fillimi mbeti jashtë loje.

Meqë ky proces është në vazhdim, nuk pretendoj të vë pikë të procesit. Ky punim do të kontriboj në atë se si të vazhdohet procesi. Do të jetë në shërbim të atyre që kanë mundësi për zbatimin (implementimin) e tij me qëllim që pasojat negative të jenë sa më të pakta. Propozimet dhe metodat që do të jepen, do të shërbejnë si model i vazhdimit të mëtejshëm të procesit, kushtimisht nëse nuk do të jetë ende vonë.

ABSTRACT

To consolidate as a country, Kosovo had to define the notion of its property. This demanded that socially owned enterprises (a notion familiar only for property in former Yugoslavia) be owned privately. This was possible only through the process of privatization. Kosovo is a special case in many ways, *sui generis*, and it was a special case regarding privatization too. This work aims not only to describe the events throughout this process but it also suggests methods to be used to successfully finalize the process of privatization.

Through this work it will be shown that the process of privatization was not in agreement with the demands of the people. The models that were chosen caused great confusion. Few are those that can understand whether it is being dealt with a process of privatization of renting out. The results of the investigation will show that thus far the process of privatization has not fulfilled its objectives.

A lot has been said, but little has been written about this process. The process of privatization in the Republic of Kosovo was initially imposed and not well-understood. The local factors, for lack of specific knowledge or lack of knowledge of other factors, was kept out of this game.

Since this process is still ongoing, I do not claim to have the final word on the process. This work aims to contribute in how the process should continue. It will serve beneficial to those that have the means to implement this process while minimizing its negative consequences. The suggestions that will be given will serve as a model of how the process should continue, provided that it is not already too late.

DEDIKIMI

Te gjithë atyre që kontribuan lidhur me procesin e privatizimit të pronës shoqërore në Republikën e Kosovës .

FALENDERIME

Tema e doktorates me titull “Procesi i privatizimit në Republikën e Kosovës,modelet,zbatimi dhe ndikimi i tij në zhvillimin ekonomik” eshte e punuar në mbikqyrjen e Prof.Asoc. Dr. Aleksandër Biberaj. Falenderim i veçantë për mentorin i cili nuk kurseu kohën dhe mundin në dhënien e këshillave me qëllim që ky punim të ketë formën finale. Pa ndihmën e familjes sime për mirëkuptim, gruaja Sadetja dhe fëmijët Fisniku dhe Endriti, puna ime do të ishte e pamundur. Andaj, Ju falënderohem pa masë.

Me respekt,

Bajram Fejzullahu

PËRMBAJTJA E LËNDËS

1	KAPITULLI I:	1
1.1	Hyrje.....	1
1.2	Motivacioni	4
1.3	Qëllimi i studimit.....	5
1.4	Pyetjet hipotezat dhe objektivat kërkimore	6
1.5	Kufizimet dhe rëndësia e punimit.....	7
1.6	Struktura studimit	8
2	KREU II – Rishikim i literaturës	11
2.1	Konceptet teorike dhe filozofike të pronës, privatizimit dhe krahasimet e modeleve të privatizimit.....	11
2.2	Analiza teorike e procesit të privatizimit në disa vende të Evropës Juglindore dhe të ish Jugosllavisë.....	23
2.3	Dinamika e zhvillimit ekonomik dhe politik, si kusht i tranzicionit dhe transformimit pronësor përmes procesit të privatizimit	31
2.4	Influenca e shtetit në procesin e transformimit pronësor dhe të privatizimit .	36
2.5	Procesi i transformimit dhe privatizimit të pronës, shembuj të reformave në vendet e Evropës Juglindore, si një hap drejt privatizimit	47
2.6	Vështrime teorike te procesit të privatizimit në Kosovë	65
3	KREU III – Historiku- Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore Rast studimi Zyra Rajonale Gjilan	72
3.1	Modelet e transformimit të pronës, krahasimet, mundësitë dhe përvojat nga vendet tjera për zbatimin e procesit të privatizimit në rastin e Kosovës.....	72
3.2	Struktura ligjore e procesit të privatizimit në ish Jugosllavi	83
3.2.1	Ligji për ndërmarrjet i RSFJ-së.....	83
3.3	Situata ekonomike-politike në Kosovë para procesit të privatizimit.....	87
3.4	Krijimi i parakushteve për procesin e privatizimit në Kosovë	91
3.4.1	Roli i UNMIK-ut në procesin e privatizimit të pronës shoqërore në Kosovë	93
3.4.2	Komercializimi i Ndërmarrjeve Shoqërore,si fazë kalimtare drejtë procesit të privatizimit	96

3.4.3	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM).....	97
3.4.3.1	Ndërmarrjet publike dhe AKM-ja	107
3.4.4	Agjencionit Kosovar i Privatizimit (AKP).....	108
3.4.4.1	Ligjet dhe rregulloret e Agjencionit Kosovar i Privatizimit (AKP), ...	110
3.4.4.2	Baza ligjore në funksion të zbatimit të procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës	112
3.4.4.3	Zbatimi i ligjshmërisë në funksion të procesit të privatizimit.....	123
3.4.5	Struktura organizative e Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP) ...	124
4	Kapitulli IV Metodologjia	126
4.1	Metodat dhe metodologjia e kërkimit.....	126
5	KREU V : Analiza e të dhënave	131
5.1	Të gjeturat dhe analiza e studimit.....	131
5.1.1	Të gjeturat dhe analiza e studimit të procesit të privatizimit përmes AKM- (Agjencionit Kosovar i Mirëbesimit)	132
5.1.2	Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore përmes Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP)	141
5.2	Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore përmes Zyrës Rajonale të AKP në Gjilan	156
5.2.1	Gjendja e Ndërmarrjeve Shoqërore në regjionin e Gjilant para dhe pas procesit të privatizimit.....	156
6	KREU VI: Konkluzione dhe rekomandime	172
6.1	Konkluzione dhe rekomandime.....	172
6.2	Disa probleme dhe të meta të punës së Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM).....	172
6.3	Ndikimet ekonomike, politike, socio-demografike dhe etike të procesit të privatizimit në Republikën e Kosovës	177
6.3.1	Efktet e procesit të privatizimit në zhvillimin ekonomik të Kosovës	180
6.4	Rekomandime për të metat e procesit të privatizimit në Kosovë.....	198
6.5	Modeli i propozuar për vazhdimin e procesit të privatizimit- Metoda e kreditimit të spin-off-it special dhe Partneriteti Publik-Privat i investimeve	199
6.6	Procesi i privatizimit si domosdoshmëri dhe metodat e gabuara për përmbushje efikase të tij.....	202
	SHTOJCA	209
	BIBLIOGRAFIA	228

Lista e tabelave :

Tabela 1 Privatizimi në disa vende të Evropës dhe mundësitë likuide të ndërmarrjeve.	27
Tabela 2- Procesi i privatizimit përmes AKP	109
Tabela 3- Organogrami i organizimit të Shtylla IV UNMIK.....	118
Tabela 4 - Organogrami i AKP-së	124
Tabela 5- Ndërmarrjet e komercijalizuara.....	147
Tabela 6- Ndërmarrjet e privatizuar me spin-off special.....	149
Tabela 7- Kontratat e nënshkruara nga shtija përmes AKM-së dhe vlera e tyre	151
Tabela 8 Ndërmarrjet e reja të krijuara dhe vlera e tyre	151
Tabela 9 – Përmbledhje e spin-off-it të zakonshëm të privatizimit	154
Tabela 10 – Shitjet 2009	154
Tabela 11 ; Përmbledhje e rezultateve të vitit 2010	155
Tabela 12- Shitjet përmes Spin off 2012	158
Tabela 13 – Shitja përmes likuidimit 2012	159
Tabela 13 – Projektet individuale 2012	160
Tabela 14- Shitjet përmes Spin off 2013	162
Tabela 15- Shitjet përmes likuidimit 2013	162
Tabela 16- Shitja e aseteve me likuidim 2014	166
Tabela 17- Ndërmarrjet të cilat kishin karakter të NSH- Komuna Gjilan.....	170
Tabela 18 – Ndërmarrjet me rëndësi primare në Komunën e Gjilanit	171
Tabela 19- Ndërmarrjet e reja të krijuara nga privatizimi.....	172
Tabela 20- Lista e vlerës së pasurisë të ndërmarrjeve para procesit të privatizimit ZR në Gjilan	173
Tabela 21-Lista e Ndërmarrjeve Shoqërore nga Komuna e Ferizajt për privatizim	175
Tabela 22- Ndërmarrjet Shoqërore në Komunën e Ferizajt me rëndësi primare	176

Tabela 23 Ndërmarrjet e reja të themeluara nga privatizimi i komunës së Ferizaj	177
Tabela 24 - Lista e vlerës së pasurisë të ndërmarrjeve me rëndësi para procesit të privatizimit, Komuna, Ferizaj	178
Tabela 25- Lista e Ndërmarrjeve Shoqërore në Komunën e Kamenicës	179
Tabela 26- Ndërmarrjet Shoqërore me rëndësi parësore në Komunën e Kamenicës	180
Tabela 27- Ndërmarrjet e reja të krijuara nga privatizimi i Komunës Kamenicë.....	180
Tabela 28- Lista e vlerës së pasurisë të ndërmarrjeve me rëndësi, para procesit të privatizimit në Komunën Kamenicë	181
Tabela 29- Ndërmarrjet e reja të krijuara nga privatizimi i komunave: Viti, Kaçanik, Shtërpç dhe Novobërdë	183
Tabela 30 Lista e vlerës së pasurisë të ndërmarrjeve me rëndësi para procesit të privatizimit në komunat: Viti, Kaçanik, Shtërpçë, Novobërd.....	184
Tabela 31- Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2008-2015: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2008-2015	187
Tabela 32- Pasqyra e gjendjes së fondeve në mirëbesim	188
Tabela 33- Gjendja e punësimit në regjionin e Gjilanit para dhe pas procesit të privatizimit	200
Tabela 34 – Ndryshimi i numrit të punetoreve para dhe pas procesit të privatizimit në disa ndërmarrje ZR Gjilan	2

1 KAPITULLI I:

1.1 Hyrje

Procesi i privatizimit paraqet një nga ngjarjet më të rëndësishme të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar dhe fillimit të këtij shekulli, qoftë në aspektin ekonomik ose atë politik, teknologjik, social, etik, etj. Procesi i privatizimit, edhe pse në dukje lë përshtypje të një procesi të lehtë dhe të thjeshtë për zbatim, njerëzit e rëndomtë e shohin si proces i cili ka detyrë parësore, të vetme: të bartë pronën nga një pronar tek tjetri; megjithatë ai shpreh natyrën e vet të ndërlikuar në të gjitha format e mundshme. Privatizimi paraqet “*një tërësi të reformave ekonomike*” (Musa, Limani, 2006). Te ky konstatim i këfillë arrihet që në fillim tek përfundimi logjik, sepse shtrohet çështja e një sistem të tërë ekonomik dhe shoqëror. Shtetet dhe pashkëputshëm edhe sistemet ekonomike e shoqërore të tyre, lindin dhe rriten me një ritëm të caktuar, krahas mundësive të tyre. Ato si përfaqësuese të pushtetit dhe grupeve të interesit, në njërën anë, dhe popullit në anën tjetër, në periudha të caktuara, paraqesin domosdoshmërinë e ndryshimeve, me qëllim të përshtatjes, të tejkalimit të individuale dhe përfshirjes saj në tërësinë globale të rrjedhave. Në këtë shumësi bashkëveprimesh, privatizimi ngërthen vlera të mirëfillta të përmbushjes së tij.

Transformimi i pronës ka të bëjë me arritjen e një gjendjeje të këfillë, e kushtëzuar pikërisht nga krijuesit e mëtimeve për ndryshime cilësore të rendit dhe strukturës prodhuese. Ky ndryshim, ndikimin do ta shtrijë edhe në çështje të demokratizimit të shoqërisë e në tërë sistemin ekonomik, politik e shoqëror.

Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë është çështje e cila diskutohet, por ende pa i shteruar të gjitha përvojat, të gjithë qarqet e shoqërisë, të shkencës e ndërmarrësish në Kosovë.

Te gjithë kanë pikëpamje lidhur me këtë çështje, mirëpo shpeshherë nuk akumulohen konceptimet në një pikë të përbashkët, të përqendruar dhe me efekt të përfitimit të gjithanshëm. Andaj, shpërqendrimet në fushë të përshtatjes së ndërmarrëseve, pa ndjeshmëri dhe kritere shkencore nuk dhanë rezultate të prekshme. Ky proces, ndonëse është në vazhdim, pritet që pas një studimi shterues për pjesën e mbetur të procesit të privatizimit, do t'i shërbejë shmangies për mospërsëritje të gabimeve, duke marrë qëndrim të drejtë për procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ky proces do të marrë mjaft kohë dhe do të kërkojë parametra të saktë e qasje përmasash të shumëfishta profesionale.

Ngjashëm nga shumë aspekte ku problemi i Kosovës është shfaqur si *sui generis*, edhe procesi i privatizimit (së paku deri më tash), është proces i panjohur më herët për arsye të veçantive që i ka Kosova. Studimi kryesisht do të bazohet në të dhëna parësore, sepse ato sekondare konsideroj se janë të pamjaftueshme. Për periudhën që kemi para vetes, ku për disa herë ka ardhur në shprehje çështja e vazhdimësisë së këtij procesi, mendoj se një studim i tillë do të ndihmojë për gjetje të alternativave të reja, të cilat do të ndihmojnë në përgjithësi lidhur me procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore ende të pa privatizuar. Në veçanti do të ndihmojë edhe për privatizimin e Ndërmarrjeve Publike, të cilat janë në nismë të këtij procesi.

Aktualisht procesi i privatizimit zhvillohet përmes Agjencionit Kosovar të Privatizimit, që është i organizuar në pesë Zyra Rajonale: në Prishtinë, në Gjilan, në Prizren, në Mitrovicë dhe në Pejë. Vështirë të posaçëm do t'i jepet procesit të privatizimit përmes Zyrës Rajonale në Gjilan. Kjo do të ndodhë ngase në Gjilan është vendosur zyra që menaxhon procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore të komunave: Gjilan, Ferizaj, Kamenicë, Viti, Kaçanik, Shtërpçë, Novobërdë (Artanë), Hani i Elezit, Klllokot, Partesh dhe Ranilluk.

Kjo zyrë do të jetë e mjaftueshme, ngase ky territor përfshin një të pestën e hapësirës urbane të Republikës së Kosovës. Duke analizuar procesin e privatizimit përmes Zyrës Rajonale, do të arrijmë në përfundime të cilat pasqyrojnë procesin e privatizimit në nivel vendi. Metodatat analitike janë unike për tërë Kosovën, ndaj, po ashtu, dhe rekomandimet që do të jepen së fundi, do të mund të zbatoheshin në formë e përmbajtje të njëjtë. Efikasiteti i procesit deri më tash, na bën të kërkojmë metoda alternative, me qëllim që vazhdimi i mëtejshëm të ketë qasje të re, me metoda dhe mënyra që do të jenë në funksion të kërkesave të parashtruara nga procesi vijues i aktualitetit ekonomik.

Çështja e procesit të privatizimit në Republikën e Kosovës dhe zbatimi praktik i tij, më shumë se një herë, u dëshmuar se është problem më vete. Thelbi i kësaj çështjeje qëndron në faktin se si të tejkalohen dilemat, që ky proces a duhet të udhëhiqet që nga fillimi nga vendorët? Sepse kohë-zgjatja prej pesë vitesh, i filluar dhe udhëhequr nga ndërkombëtarët, solli dështime me pasoja të pariparueshme. Dilema tjetër lidhet për kohën e fillimit. A do të ishte veprim më i drejtë: së pari të shpallej shtetësia e Republikës së Kosovës e, pastaj t'i rrekeshim problemit të privatizimit, ose të veprimeve ashtu si u veprua?

Ekzistimi i pronës shoqërore ishte veçanti pos për vendet e ish Jugosllavisë. Shtruarja e problemit, duke filluar nga vetë specifikat e një prone të panjohur për pjesën tjetër të botës, si dhe metodat unike të zbatuara, shikuar nga këndvështrimet analitike e teorike, janë prova që e ndërlikuan problemin.

1.2 Motivacioni

Në numër të vogël janë njerëzit në Republikën e Kosovës të cilët nuk kanë qëndrim lidhur me procesin e privatizimit të pronës. Këtij procesi i cili po përmbush 14 vite, ende fund nuk i shihet. Kritikët e shohin si proces të dështuar i cili përmbushi kërkesat e një shtrese të caktuar të shoqërisë aspak meritore, kurse masat e gjëra të popullsisë u varfëruan edhe mëtej. Ithtarët (edhe pse në numër të vogël) e shohin si proces i cili i parapriu shtetësisë së Kosovës dhe hapi dyert drejtë integriteteve me botën demokratike. Që nga fillimi ky proces nuk ishte mjaft transparent. Burimet e informatave të cilat dilnin jashtë kultureve të agjencisë ishin të pakta dhe konfuze. Kështu, asnjë herë nuk u dijt se kush ishte blerësi, çka do të bëhej me paratë nga shitja, ku ruheshin ato, sa do të zgjatë ky proces etj. Mëdyshjet ishin të shumta andaj edhe fjalët po ashu. Të gjithë mundoheshin të dijnë diçka mirëpo nga dera e hekurt dilin pak informata. Një proces i tillë më ngjallte në vazhdimsi kureshtje dhe dëshirën që ta kuptoj se çka po ndodh dhe pse po ndodh procesi i privatizimit. Kuptohet sukses do të ishte që të hulumtoj një qështje e cila është sa e mistershme aq edhe e vështirë për studim sepse për momentin mungon ajo që quhet informatë. Situata momentale lidhur me procesin e privatizimit të pronës shoqërore në Kosovë kërkon ndërhyrje në të. Ajo mund të bëhet duke ofruar modele të reja të procesit të privatizimit dhe munësisë së riorganizimit. Për vazhdim të mëtejme duhet të kuptojmë së pari se ku jemi, çka arrijtëm dhe çka duam të arrijmë së fundit. Kjo mund të bëhet vetë pasi të epen argumente se pse duhet rishikuar procesi i privatizimit dhe në cilën rrugë të vazhdohet. Kjo në mua u paraqit si impuls i cili nuk më la të qetë që të provoj të jap një mendim timin se cila ishte e mira dhe e keqja e këtij procesi dhe të jap alternative të vazhdimet.

1.3 Qëllimi i studimit

Procesi i privatizimit nuk është një risi, që ka ndodhur vetëm në Kosovë dhe askund tjetër. Ky proces është mjaft i njohur, si në teori po ashtu dhe në praktikë. Mirëpo, ajo që ndodhi gjatë privatizimit në Republikën e Kosovës, është çështje më vete, është unik dhe i veçantë.

Qëllimi i këtij studimi mëton që të analizojë procesin e privatizimit në Republikën e Kosovës, të analizoj dhe krahasoj metodat e zbatuara të privatizimit dhe përfundimisht të tentohet të kontribohet në gjetjen e formave të reja të privatizimit për asetet të cilat ende janë të pa privatizuara. Për 14 vite të kaluara konstatojmë, se më tepër se 70% e pronës shoqërore në Kosovë është e privatizuar. Metodatat e propozuara do të ndikojnë për përshtetshmërinë e procesit, mbylljen e kanaleve negative konsistuar në jo transparencë, duke eliminuar ose pakësuar korrupsionin, etj. Padyshim procesi i privatizimit, mund të konsiderohet i përfunduar, atëherë kur të marrë fund procesi i likuidimit të ndërmarrjeve. Andaj, mund të pritët që studimi nga kjo fushë të jetë i rëndësishëm së veçantë, qoftë si çështje e zbatimit praktik, ose si çështje teorike, e cila do të shërbejë edhe në lëmë tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e proceseve shoqërore.

Po ashtu, çështja e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nuk është çështje vetëm e karakterit teorik. Privatizimi është proces i vijueshëm, proces i cili e preokupon përditshmërinë e jetës kosovare. Problemi i kësaj natyre qëndron në faktin, se shënimet në formë të shkruar, të cilat pasqyrojnë këtë proces, e dëshmojnë përvojat e vendeve që e realizuan më me sukses procesin e privatizimit. Dëshmitë e përvojave të shteteve tjera, fare pak janë marrë në konsideratë, sepse çështja e privatizimit në Kosovë është e re, si për metodatat e zbatuara, ashtu edhe për kohën dhe kushtet tjera.

1.4 Pyetjet hipotezat dhe objektivat kërkimore

Pyetjet kërkimore kontestojnë për gjetjen e zgjidhjes për problemin e parashtruar. Pas përkufizimit të pronës dhe kuptimit të saj, në aspekt teorik, një nga pyetjet kryesore që kërkojnë përgjigje do të jetë:

1. Si u zhvillua procesi i privatizimit në Kosovë dhe cilat metoda u përdorën, a ishin ato në harmoni me kërkesat e ekonomisë kosovare

Ngjashëm me këto pyetje të cilat kërkojnë përgjigje, do të parashtrohen edhe shumë të tjera, me qëllim të zbardhjes së gjithë asaj që ka ndodhur gjatë këtyre viteve, dhe kërkimin e zgjidhjes për periudha të ardhme që mundësojnë mbarëvajtjen e këtij procesi; ngase privatizimi si proces është i domosdoshëm për njësimin, bashkimin a trupëzimin e Kosovës në rrjedha bashkëkohore të botës demokratike.

Hipoteza e punimit bazohet në përmbushje të qëllimit. Duke u përgjigjur në pyetjet, se a ka mundur ky proces të jetë ndryshe dhe të menaxhohej në mënyre më efikase. Kjo do të ndikonte për të parashtruar pyetje të tjera... A do të mundej dhe çka është ajo që duhet të jetë ndryshe, me qëllim të arritjes së rezultateve të dëshiruara. Përmes dhënies përgjigje në këto pyetje, do të ketë mundësi që të projektohet ardhmëria, duke dhënë orientime përkatëse dhe metoda, po ashtu, përkatëse, me qëllim të evitimit të gabimit momental (nëse ekziston), dhe hapje të alternativave të tjera përmes metodave shkencore, për përmbylljen me sukses të këtij procesi. A ishte procesi i privatizimit i imponuar dhe, a u zgjodh koha e përshtatshme? Kush dhe si do të duhej të vazhdonte këtë proces? Si do t'iu sqarohet pasardhësve kjo mënyrë e tjetërsimit të pronës?

Cilat probleme do të trashëgohen dhe pse? Në emër të cilit qëllim madhor u bë një transformim i tillë pronësor ?

Pashmangshëm logjikës së procesit i shtrohen shumë pyetje, duke kërkuar po aq, mos më tepër, përgjigje të natyrës së tillë.

Shtruarja teorike e problemit, në pajtim me kronologjinë e të shkruarit, do të kërkojë përgjigje për vërtetimin e hipotezave, të cilat do të kenë karakter induktiv, deduktiv dhe analogjik :

Hipoteza 1-Procesi i privatizimit në Kosovë u zhvillua në kushte dhe me metoda të veçanta krahasuar me vendet tjera.

Hipoteza 2-Modeli i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë është model që nuk i përshtatet ekonomisë së Kosovës.

1.5 Kufizimet dhe rëndësia e punimit

Mundësitë për realizimin e këtij studimi, mendoj se janë të arritshme, ngase këtë do ta mundësojë qasja e drejtpërdrejtë, parësore për ndërmarrjet dhe gjendjen e tyre brenda këtij procesi. Publikimet lidhur me procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, nuk janë të shumta, por studimi do të arrijë që të vërë në funksion, çështjet më relevante të parashtruara në këtë studim.

Kufizimet kanë karakter të natyrës së grumbullimit të të dhënave nga ndërmarrjet, që u privatizuan dhe tek të cilat tashmë ka ndryshuar në tërësi afarizmi e struktura organizative e tyre. Po ashtu, një kufizim i llojit të vet, është e dhëna, se janë të pakta botimet të cilat kanë të bëjnë me procesin e privatizimit në Kosovë.

Ky studim do të ofrojë njohuri kryesisht për procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, duke vënë në pah të metat dhe të mirat e tij. Misioni i këtij studimi, mëton të ketë qëllim praktik, përmes propozimeve të dhëna dhe metodave analitike, të analizoj gjendjen e tanishme të procesit të privatizimit në Kosovë, të hulumtoj alternativa të reja, të përshpejtojë procesin, të përmirësoj dhe të rris transparencën e tij. Shmangia ose së paku, zbutja e dobësive të konstatuara, do të shërbejë si udhërrëfyes për periudhat e ardhshme të këtij procesi.

Ky studim shpresoj se do të gjejë zbatim edhe në lëmë të tjera të shkencës në Kosovë dhe më gjerë.

1.6 Struktura studimit

Struktura e këtij studimi është në harmoni me qëllimin e parashtruar, dhe analiza është shpërndarë në kapitujt vijues:

Në kapitullin e parë janë shqyrtuar : qëllimi i këtij studimi, burimet e referimit, pyetjet kërkimore , hipotezat e punimit, metodat dhe metodologjia e kërkimit, mundësitë dhe kufizimet, rëndësia e studimit dhe përfundimisht struktura e studimit. Këto më shërbejnë si udhërrëfyes për shtjellimin e studimit

Në kapitullin e dytë fillohet nga qëshjet esenciale të cilat kanë të bëjnë me konceptin e pronës si nocion duke i dhënë rëndësinë e caktuar në karakterin ekonomik të saj. Për të mundur të kuptohet në dritë sa më të plotë kategoria e pronës si nocion ajo është shqyrtuar edhe në aspektin filozofik duke paraqitur edhe llojllojshmërinë e saj. Gjatë gjithë studimit objekt paraqitet prona dhe modalitetet e saj si dhe domosdoshmëria e privatizimit të saj, respektivisht transformimi i saj. Pas definimit të pronës dhe llojeve të saj studimi përqëndrohet në modelet, krahasimet, mundësitë dhe përvojat nga vendet tjera për zbatimin e procesit të privatizimit dhe mundësitë që këto modele të zbatohen në rastin e Kosovës lidhur me transformimin e pronës. Që në fillim të analizës mund të vërehet se metodat të cilat u zbatuan gjatë privatizimit të pronës shoqërore në Kosovë nuk gjasojnë me metoda të zbatuara më herët në vendet tjera të botës. Andaj ato paraqiten si “sui generis” sepse ky term për shumë qështje ka të bëjë me Kosovën.

Në vazhdim të këtij kapitulli kemi të bëjmë me vështrimin e literaturës lidhur me procesin e privatizimit në përgjithësi duke analizuar në veçanti literaturën lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë. Vlenë cekur se procesi i privatizimit nuk është një dukuri e cila ka kaluar pa u vërejtur edhe në rrethet shkencore. Kjo do të vlente për vendet e tjera. Mirëpo kur kjo ka të bëjë me Kosovën atëherë mund të konstatohet se procesi i privatizimit të pronës shoqërore u karakterizua me zhurmë të madhe për të

cilën pak kush la gjurmë në formë të shkruar. Pas vështirimit të rrethanave ekonomike, politike, ligjore, sociale etj të privatizimit dhe influencën e këtij procesi në rrjedhat e tërësishme të jetës në këtë kapitull u analizuan edhe procesi i transformimit të pronës në disa vende të ish Jugosllavisë, dhe disa vende të Europës Juglindore dhe Shqipërisë. Analiza e procesit të privatizimit në këto vende na jep dëshmi më shumë se ngjashmëritë me procesin e privatizimit në Kosovë janë të vogla si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik.

Kapitulli i tretë analizohen rrethanat ekonomike dhe politike të cilat i paraprinë procesit të privatizimit në Kosovë duke vazhduar me vetë procesin e privatizimit. Në gjendjen e pasluftës në Kosovë (pas vitit 1999) mungonte çdo gjë . Ajo që krijonte problemin më të madh ishte mungesa e infrastrukturës ligjore që do të krijonte kushte për zhvillim ekonomik. Faktori ndërkombëtar i instaluar në Kosovë morri përkujdesjen edhe në këtë aspekt. Ligjet nga ish Jugosllavia dhe dhuna sistematike ekonomike dhe politike a periudhave të mëhershme shprehën rolin e tyre edhe në periudhën pas vitit 1999. Analiza në këtë kapitull lidhur me ndikimin e rrethanave ekonomike dhe politike në Kosovë, që kanë të bëjnë me procesin e privatizimit, janë analizuar në dy periudha : atë para vitit 1999 dhe atë pas këtij viti. Po ashtu edhe periudha pas vitit 1999 është analizuar në dy etapa 1999-2003 dhe 2003-2016. Lexuesi mund të vërej gjatë leximit dhe titujve në këtë pjesë se për çka ëshë fjala. Në vazhdim të kapitullit është analizuar procesi i privatizimit nën mbikqyrjen e faktorit ndërkombëtar UNMIK që u zhvillua në periudhën 2003-2008 që njihet si privatizim përmes Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM) , dhe atë që pason pas vitit 2008 deri në ditët e sotme 2016, që njihet si periudhë e privatizimit përmes Agjencionit Kosovare të Privatizimit (AKP) Analiza e mëtejme ka të bëjë me procesit të privatizimit përmes Zyrës Rajonale të AKP në Gjilan. Kjo analizë më shërben edhe si rast studimi. Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore përmes Zyrës Rajonale të AKP Gjilan nuk ka ndonjë të

veçantë specifike krahasuar me regjionet tjera (ekzistojnë pesë Zyra Rajonale të AKP: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan) i dhe zyra qendrore e AKP në Prishtinë. Analiza e shtruar në këtë kapitull na bënë të kuptojmë se metodologjia është unike për tërë territorin e Kosovës, Analiza e ndërmarrjeve përmes ZR Gjilan shërben si mostër e mjaftueshme studimi që të kuptohet se si u zhvillua procesi i privatizimit në Kosovë. Rrethanë lehtësuese për mua ishte që të analizoj procesin e privatizimit përmes ZR Gjilan duke u nisur edhe nga fakti se disponoj me të dhëna primare (punoj në cilësi të zyrtarit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në ZR të AKP në Gjilan)

Në kapitullin e katërt është shqyrtuar metodologjia e punimit, respektivisht metodat e hulumtimit, rëndësia e tyre dhe përcaktimi i pjesëve ku ato gjejnë zbatim.

Në kapitullin e pestë janë paraqitur analiza e të dhënave duke specifikuar të gjeturat e procesit të privatizimit përmes AKM (Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit) dhe ëjnë AKP (Agjencioni Kosovar i Privatizimit) për të vazhduar me të gjeturat të cilat kanë të bëjnë me ato që i përkasin privatizimit përmes Zyrës Rajonale Gjilan e cila na shërben si mostër studimi.

Në kapitullin e gjashtë janë të paraqitura të gjeturat nga hulumtimi dhe rekomandimet nga këto të gjetura. Kjo ka të bëjë edhe me të metat dhe problemet e procesit, rekomandimet për eliminim të metave me qëllim të vazhdimit të procesit. Në këtë mënyrë është kushtuar edhe efekteve të procesit të privatizimit duke analizuar raste konkrete. Në përfundim të këtij kapitulli janë rekomanduar metoda të reja se si ka mundësi të përmbillet ky proces

Në pjesën e cila ka të bëjë me shtojcat të cilat janë të paraqitura në fund të punimit, lexuesi përmes tabelave dhe fotove do të arrijë të nxjerr shumë përfundime lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë.

2 KREU II – Rishikim i literaturës

2.1 Konceptet teorike dhe filozofike të pronës, privatizimit dhe krahasimet e modeleve të privatizimit

Njeriu ka të drejtë që të ketë pronë, të trashigoj atë dhe të lejë trashigimi atë pasardhësve. Në shumicën e vendeve të botës një qështje e tillë është rregulluar me ligji. Ajo përmbushet që nga lindja e sojit njerëzor. Lidhjet e ndërsjella duhet vështruar në aspekte të përkatësisë dhe të marrëdhënieve të detyrueshme (obligative), përmes aktesh të këtyra ndërtohen marrëdhëniet e pronës e të pronësisë. Deri sa fëmijës së vogël i përket dhe është pronar i djetit të tij; ndërsa po ashtu, ushqimi e pajisjet për mirëmbajtje, kushtëzojnë marrëdhënie të detyrueshme për mbikëqyrësit, përkatësisht prindërit, kështu fëmijës i mundësohet qasja në pronën e trashëguar, por edhe detyrimi i ndërsjellë: fëmijë-prind.

Nisur nga një qëndrim i tillë, njeriu që nga lindja edhe në aspektin pronësor nuk është “*tabula rasa*”. Kjo ka kuptim ngase njeriu me vetë aktin e lindjes së tij, është pronar në aspektin material, por edhe në qenësinë e përkatësisë intelektuale.

Filozofia e Hegelit për të drejtën natyrore, përtrollitet në analizën e të kuptuarit të teorisë dhe zbatimit të filozofisë, e cila do t'i shërbente aspekteve praktike të së drejtës natyrore. Ajo nismë ngërthen në vete filozofinë e pronësisë, përkatësisht filozofinë e pronës (S.Selmanaj, 1996). Qasja ndaj një mënyre të tillë ka të bëjë me aspektin juridik. Mirëpo, prona ka karakter përmasash, si nga këndvështrimet ekonomike, sociologjike, intelektuale dhe, në më shumë tërësi të tjera, nga të cilat shtrihet shumësia konceptuale e pronës.

Kur flitet për pronën, për nevoja e hulumtimit tonë, këtë duhet vështruar nga aspekti ekonomik. Këtu kemi të bëjmë me marrëdhënie pronësore, të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga pasja (posedimi) dhe krijimi i saj.

Nga kjo qenësi rrjedh se prona ka karakter natyror, po ashtu, sikur se vetë njeriu. Ekzistenca e njeriut nuk është e mundur pa krijimin e marrëdhënieve prodhuese, para së gjithash, në vartësi të ndërsjellë: natyrë-njeri; si dhe ndërtimi i lidhshmërive tjera, të cilat kushtëzohen gjatë realizimit të nevojave jetësore të njeriut. Dinamika e këtij procesi lëviz ndërmjet premisë: ti të kesh, ata të kenë dhe gjithsecilit t'i takojë gjithçka, sepse prona ju takon të gjithëve. Një libër i mirë, edhe pse është pronë e autorit, ai njëkohësisht i takon dhe njerëzimit, në qoftë se i tejkalon vlerat individuale dhe kombëtare, ai bëhet pronë universale.

Çështje më vete janë format e krijimit të pronës.

Kryesisht janë dy forma:

- Në formë natyrore prona intelektuale dhe materiale, të cilat mund të krijohen gjatë vitalitetit të jetës së njeriut. Kjo nënkupton pronën që është krijuar përmes punës dhe trashëgimisë.
- Në formë të dhunshme, përmes ligjit të forcës nënkuptohet përvetësimi i pasurisë dhe pronës. Forma e dhunshme dhe zbatimi i forcës për përvetësimin e saj, nga ata të cilëve ajo më herët iu përkiste, sjell ndërlikime dhe trauma individuale e shoqërore. Një formë e tillë e përvetësimit vjen në shprehje edhe në kushtet e monopolit a të monopolizimit.

Derisa në fillim të lindjes së njerëzimit, format e pronës kishin karakter hapësinor për krijimin dhe mbajtjen gjallë të jetës, dhe ishin të shprehura me zbatimin e dhunës (ruajtja e ushqimit dhe hapësira e jetesës)... në sistemin feudal krijohen mundësitë e përvetësimit të pronës, pronën mbi pasuritë materiale, njëherësh dhe nënshtrimin ose robërimin e njeriut. Më vonë, kjo formë e pronës përcaktohet dhe merr karakter formal në sistemet ekonomike.

Në bazë të interpretimit të së drejtës romake, prona ka kuptim edhe të mundësisë së kontrollit, që ka karakter të pushtetit ndaj sendeve nga ana e individit a institucionit, duke pasur mundësi të marrjes së vendimeve dhe përdorimin e tyre. Mbi këtë rend, prona është institucioni më i rëndësishëm i së drejtës, sepse shkalla dhe zhvillimi i qarkullimit, të drejtat e detyrimeve varen nga prona. Romakët pronën e quanin *proprietas* ose *dominum*, terme që kanë lindur vonë, në shekullin e parë p.e.r. Nga këto shprehje e ka prejardhjen shprehja e fjalës ose kuptimit (nacionit) pronë (nga *proprietas*).

Ndonëse shprehja *proprietas* është paksa e çuditshme, megjithatë paraqet një nga të arriturat e Romakëve në Historinë e së Drejtës Botërore. Sipas hulumtimeve popujt e vjetër, përfshirë dhe Grekët me gjuhën e tyre mjaft të përparuar, nuk kanë ndonjë term gjithëpërfshirës; që do të bënte diferencimin në mes potencialit natyror dhe material, me të cilin ngërthehet individi, bashkësia a shteti. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ata nuk e kanë pasur të qartë se çka është prona. Ajo ekziston, por u kishte munguar tërësia e rrumbullakimit të kuptimit të fjalës pronë.

Vlen veçuar këto lloje të pronave:

Prona Kolektive - Ekziston që nga komuniteti i parë, sistemin skllavopronar, feudal, socialist si dhe ai kapitalist, në të cilin paraqiten më shumë titullarë pronësorë. Vështruar nga aspekti i krijimit të pronës, atëherë arrihet në përfundim, se llojet e saj janë aq sa janë mënyrat e bërjes së pronës. Te prona kolektive paraqitet më shumë se një titullar.

Të drejtat që i kanë pronarët përfshijnë jo vetëm ato që kanë të bëjnë me pronën, por dhe të tillat që nuk kanë karakter pronësor. Marrëdhëniet ndaj gjërave dhe sendeve ndërliken me raportin e pushtetit ndaj njerëzve, politikës, ekonomisë, etj.

Prona private - Kjo formë e pronës ka vetëm një titullar me të drejta ekskluzive ndaj sendeve, kurse jo të atyre që kanë karakter politik. Mirëpo, pronësia ndaj kësaj prone, varësisht nga forma e shfrytëzimit të saj, pronarit mund t'i sjellë privilegje si në aspektin ekonomik, social, ndaj edhe politik.

Sipas klasifikimit tradicional, në mënyrën kapitaliste të prodhimit, mbizotëron prona private ndaj mjeteve të prodhimit. Në sistemet e llojit etatist zotëron prona shtetërore ndaj mjeteve të prodhimit, përderisa në sistemin vetëqeverisës mbizotëronte prona shoqërore.¹

Prona private është pronë e individit ose korporatës. Sistemet që e njohin këtë formë të pronës, pronari ka të drejta pronësore, me ç'rast ekziston sistemi i mbrojtjes dhe kufizimet që lidhen me shfrytëzimin e saj.

Përkitazi me konceptin e pronës nuk ekziston ndonjë përkufizim i pranuar në pikëpamje të përgjithshme. Ngjashëm me konceptet tjera, rëndësia e këtij koncepti nuk është e njëjtë për të gjithë. Shkencat e ndryshme, si: ekonomia, drejtësia, sociologjia, antropologjia, etj; e përkufizojnë këtë koncept në forma të ndryshme, të përshtatshme për nevoja të studimit vetjak.

Në pamjen më të gjerë, prona ka karakter që paraqet “diçka personale” të dikujt, dhe paraqet lidhjet në mes objektit (të mirave) për të cilat individi pretendon se janë të tija. Në shkencat shoqërore kjo logjikë ka karakter si **“tërësi e të drejtave dhe obligimeve”**. Në këtë kontest, prona nuk është në marrëdhënie mes individëve dhe sendeve, por në relacione mes individëve e sendeve ose objekteve.

Kuptimi bashkëkohor i pronës këtë çështje e vështrohet, si çështje që ka të bëjë me pronën personale. Këtu individi trajtohet si person fizik, ndërsa grupet e këtilla mund të kenë karakter të korporatave.

¹ Kjo formë e pronës e emërtuar si “prona shoqërore” ishte krijesë e ish Jugosllavisë, e cila nuk kishte karakter të qartë, që nga atëherë e deri në ditët e sotme. Thënë ndryshe, kjo prone ishte “e çdo kujt dhe e askujt”. Ky kuptim i dyfishtë gjatë tërë ekzistimit të këtij shteti, mund të thuhet se ka sjellë një varg problemesh, të cilat janë trashëguar; kështu që këto probleme paraqiten edhe tani me rastin e procesit të privatizimit të saj.

Ky koncept dallon të mirat publike (si ajri, resurset tokësore, etj.); që në shumicën e rasteve drejtohen nga qeveritë e vendeve të ndryshme, megjithatë parimisht mund të jenë burime të shfrytëzueshme për të gjithë. Po ashtu, ekziston edhe prona e përbashkët, që në të shumtën e rasteve i përket bashkësive më të vogla (bashkësive lokale).

Prona private është mjaft e lashtë, këtë dëshmi e gjejmë edhe në sistemet më të hershme, ku pronari e përdorë dhe realizon interesin e tij, si rezultat i pronësisë. Të drejtat pronësore të tashme u zhvilluan, sipas idesë që prona private është e rëndësishme dhe vlerë e përgjithshme, është gjenerator i zhvillimit ekonomik.

Me pronësi shpesh kuptohet tërësia e të drejtave që garantojnë pavarësinë përkitazi me të. Kjo pavarësi përkufizohet si **”e drejtë e patjetërsueshme për shtrirje të autoritetit”**; posaçërisht në marrëdhënie me pronën. Le të kuptohet se e drejta ndaj pronësisë nuk do të thotë edhe pavarësi, në të vërtetë ekziston kufizimi ndaj pronësisë. Thënia se **“kjo është pronë e imja dhe mund të bëjë çfarë të dua me të”**, nuk paraqet një koncept modern ndaj të drejtës pronësore.

Tradicionalisht të drejtat dhe detyrimet ngërthehen në:

- kontrollin e përdorimit të pronës;
- dobitë nga shfrytëzimi i saj;
- ndërrimi ose shitja e pronës;
- të drejtën e patjetërsueshme ndaj pronës.

Sistemet ligjore kanë evoluar në drejtim të kontrolleve lidhur me të drejtat, përdorimin, operimin, ndarjen ose shitjen, që kushtëzohen me pronën dhe pronësinë.

Prona private, si një formë e sistemit kapitalist të prodhimit, përfaqëson një grup të drejtash, me të cilat shoqëria obligon pronarët, grupet, individët dhe shoqatat e ndryshme, për kujdesin dhe racionalizimin e përdorimit të këtyre pronave. Pronari ka të drejtë që ta shfrytëzojë dhe gëzojë pronën e tij sipas ligjeve të përcaktuara.

Duke i përtrollitur liritë dhe të drejtat e pronës private, pronarët mund të hyjnë në transaksione të ndryshme, me qëllim të afarizmit sa më fitimprurës.

Ndërmjetësues në këto çështje gjithsesi është ligji, që kërkon zbatimin e tij. Kjo do të thotë, se shteti është i obliguar për mbrojtjen e pronës private dhe të pronarëve, kurse pronarët janë të detyruar të përmbushin detyrimet, që rrjedhin nga pasja e pronës në formë të tatimeve dhe formave të tjera të përcaktuara me ligj. Të tëra këto detyrime të ndërsjella mundësojnë zhvillimin ekonomik, akumulimin dhe paraqesin shprehje të qytetëruar.

Prona shtetërore - Ky lloj i pronës është karakteristikë për vendet me rregullim shoqëror dhe politik socialist. Ajo trajtohet si pronë e përgjithshme popullore, ndërsa atë e qeverisë shteti përmes organeve të veta. Rezultatet e prodhimit në bazë të kësaj forme pronësore, i përvetëson shteti, që me anë të sistemit centralist të planifikimit, vendosë edhe për shpërndarjen e të mirave materiale e mjeteve të prodhimit. Në këtë fakt qëndron fuqia dhe dobësia e shtetit. Nga njëra anë shteti ka fuqinë e përvetësimit të rezultateve, kurse në anën tjetër bën shpërndarjen jo të barabartë të tyre.

Një nga pyetjet, që për një kohë të gjatë është shtruar në qarqet shkencore, ishte se cila formë e pronës është më efikase; ajo private a shtetërore? Diskutimet përkitazi me këtë çështje kanë vijuar përgjatë një shekulli. Historia deri tash ka dëshmuar se vetëm prona private është themeli i vetëm i shëndosh i zhvillimit ekonomik.

Për këtë arsye, sistemet të cilat mbështeteshin në pronën shtetërore dhe atë shoqërore, ngadalë janë duke u shuar pothuajse tërësisht.

Teoria bashkëkohore ekonomike vlerëson se prona shtetërore është njësoj efikase, nëse plotësohen parakushtet mbi tregun e përkryer, informatat e plota dhe marrëveshjet korrekte dhe të përkryera.

Argumentet klasike në favor të pronës shtetërore janë ato, të cilat kanë të bëjnë me dobësitë e tregut, respektivisht kur rrënohet konkurrenca e përkryer në degët, nga të cilat vjen deri te rënia e shpenzimeve mesatare, dhe kjo pastaj sjell deri te krijimi i monopoleve. Pasi që monopolet janë në pronësi private, që paraqet përvojë jo të mirë; andaj është mirë që kjo ndërmarrje të jetë në pronësi shtetërore, duke paragjykuar se shteti është qëllim mirë për popullin e vet. Kështu arrihet deri te konstatimi, se shumë ndërmarrje ishin nacionalizuar dhe kishin kaluar në monopole të shtetit, pas Luftës së Dytë Botërore.

Ky argument në favor të pronës shtetërore, me kalimin e kohës u zbeh dhe në fund u zhduk. Kjo ndodhi me rastin e proceseve zgjedhore, duke vërtetuar qëllimet e mira të shtetit, të politikës së dalë nga zgjedhjet, por konstatimi nuk ishte i saktë. Këtë e vërteton e dhëna e hapjes së tregjeve vendore ndaj konkurrencës në nivel global, kurse një hapje e tillë nuk lejonte të përvidheshin gabime në nivel të tregjeve vendore, dhe të zvogëlonte rolin e shteteve që ishin zotëruese në këto tregje.

Nga konstatimet e mësipërme, shteti përmes pronësisë dhe instrumenteve të tjera, arrinte të përvetësonte rezultatet e prodhimit, dhe pastaj përmes buxhetit shtetëror të mbulonte humbjet, deri sa mbetjet t'i shpërndante përmes fondeve investuese. Pronën shtetërore e zotëron shteti në emër të popullit përmes punonjësve publikë.²

Në krye të ndërmarrjeve dhe të organeve vendoseshin drejtorët në mënyrë centraliste dhe shtetërore. Mirëpo, nga presioni i kohës, në kushtet e tregut bashkëkohor, shtetet me rregullim socialist filluan të lëshojnë pe në aspektin e kontrollit.

Në vendet socialiste përpos pronës shtetërore e cila ka karakter popullor, ekziston edhe prona kooperativiste dhe ajo individuale, e cila kryesisht shtrihet në fushën e bujqësisë dhe formave të ndryshme me karakter zejtar.

² Pasuria e konfiskuar pas Luftës së Dytë Botërore nga ana e shteteve socialiste në emër të popullit, kanë ndikuar që pronarët e mëhershëm të pamundësohen, që të shfrytëzojnë pronën e tyre, kurse shteti ishte fshehur pas parullës “**unë nuk kam asgjë, kurse ti i ke të gjitha. Ta ndajmë pasurinë tënde që të kemi të dy.**”

Kooperativat kanë karakter grupor. Kjo formë e pronësisë karakterizohet me paqëndrueshmëri dhe ka karakter të përkohshëm.

Prona shtetërore në bllokun e vendeve socialiste kryesisht është krijuar, si rezultat i konfiskimit të pasurisë nga titullarët e mëhershëm, në emër të nacionalizimit, eksproprijimit, etj, me qëllim që ajo të shpallet si pronë popullore, ku shteti luante rolin qendror në drejtimin dhe shfrytëzimin e saj.

Përvojat për sa i përket pronës shtetërore ishin të pavolitshme. Ndërmarrjet shtetërore kryesisht funksiononin jo nga të priturat e planifikuara. Ato i sillnin dëm arkës shtetërore dhe konsumatorit.

Qeverisja jo e mirë dhe e nënshtruar diktateve politike, organizimi joefikas, numri i madh i punëtorëve joproduktivë, teknologjia e vjetruar, pamundësia konkurruese, ndihma e vazhdueshme nga shteti, etj. Do të jenë faktorë të pamundësisë së ekzistimit të ndërmarrjeve të tilla, ndaj dhe të një forme të tillë pronësore

Prona shoqërore - Prona shoqërore³ është kategori relativisht e re e të drejtave pronësore, ndaj dhe qasjet analitike përkitazi asaj janë relativisht të reja. Duke përfillur faktin e kësaj kategorie të pronës, që është zbatuar (aplikuar) në ish Jugosllavi gjatë viteve të pesëdhjeta, teoricienët për këtë formë të pronës kanë rezultuar, se ajo nuk mund të përfaqësojë teori të kënaqshme; dhe si e tillë individi shpronësohet në formë të plotë nga struktura pronësore.

Përkitazi këtij përkufizimi të pronës shoqërore ekzistojnë qasje të ndryshme. Disa teoricienë pronën shoqërore e konsiderojnë, si pronë e bashkësisë së gjerë (jo e shtetit), e bashkësisë së qytetarëve. Me këtë vlerësohet se të gjithë qytetarët janë bashkëpronarë, dhe nga kjo rrjedh interesimi për rritje e zhvillim ekonomik.

³ Isa Mulaj, Redefining Property Rights with Specific Reference to Social Ownership in Successor States of Former Yugoslavia: Did it Matter for Economic Efficiency? Central European University, Budapest, Hungary, 5 – 7 May 2006 pg. 5

Prona shoqërore lindi si pasardhëse e pronës shtetërore⁴ në ish Jugosllavi, gjatë vënies në jetë të një sistemi të panjohur dhe unik në botë, si “**sistemi socialist vetëqeverisës**”. Shikuar historikisht, kjo formë e pronës daton nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve të Jugosllavisë me Rusinë, atëbotë kur prona shtetërore zëvendësohej me pronën shoqërore. Prona publike edhe tutje mbajti karakterin e pronës shtetërore, pronar i së cilës është shteti, kurse te prona shoqërore pronari mbetet i pa definuar⁵.

Këtë formë të pronësisë, edhe pse e pa përkufizuar plotësisht, pushteti i Jugosllavisë Federative, përmes “**vetëqeverisjes**” bëri përpjekje që ta ngrite në shkallë të përsosjes, dhe t’i jepte formë të qartë. Në bazë të Kushtetutës së vitit 1974, të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Ligjit të Punës së Bashkuar, në ndërmarrjet shoqërore zbatohen dy lloj të drejtash dhe marrëdhëniesh pronësore:

- e drejta për punë me mjete shoqërore;
- e drejta e pasjes së mjeteve shoqërore.

Bartësit e së drejtës, sipas rrethanës së parë, ishin punëtorët pjesëmarrës në “**punën e bashkuar**”, përderisa bartës të çështjes së dytë, ishin personat juridikë. E drejta e parë, sipas natyrës është e drejtë jo pronësore, dhe shprehet si e drejtë vetëqeverisëse e punëtorëve, me mjete në pronësi shoqërore, ndërsa forma e dytë ruajti formën e vetë pronësore.

Përkritazi marrëdhënieve pronësore, po ashtu, ato qenë dy llojesh:

- ndërmarrjet në vete ishin objekt i pronësisë, që përmes akteve të veta përvetësonin dhe bartnin pronën në persona të tjerë;

⁴ Pas Luftës së Dytë Botërore Jugosllavia miratoi Ligjin për vërtetimin dhe ndryshimin për Vendimet e kalimit në pronë shtetërore të pronës së okupatorit, mbi qeverisjen shtetërore të pronës të personave që nuk ishin prezentë, si dhe me sekuestrimin e pasurisë që okupatori në mënyrë të dhunshme e kishte përvetësuar.

Neni 1.

Prona e Republikës Federale të Jugosllavisë kalon dhe bëhet pasuri kombëtare : 1) e tërë pasuria e Rajhut gjerman dhe qytetarëve të saj, e cila është në Republikën Federale të Jugosllavisë.2) të gjithë personave me kombësi gjermane. 3) e tërë pasuria e kriminelëve të luftës dhe të bashkëpunëtorëve të tyre, dhe të gjithë personave që me vendim gjyqësor ose civil iu është konfiskuar kjo pasuri.

⁵ Augestad Knudsen, Privatization in Kosovo: The International Project 1999–2008 NUPI Report pg. 34

- themeluesit e ndërmarrjes qenë kreditorë rezidentë, që përvetësonin fitimin neto të ndërmarrjes, merrnin pjesë në shpërndarjen e fitimit, bënë kontrollin ndaj ndërmarrjes, dhe sipas nevojës bënë mbulimin e humbjeve. E tërë rrethana, në sistemet ekonomike ku prona shoqërore paraqitet si mbizotëruese, punëtorët kanë të drejtë që të qeverisin ndërmarrjet e tyre, dhe të marrin pjesë në shpërndarjen e fitimit; mirëpo ata nuk do të jenë kreditorë rezidentë të ndërmarrjes. Me këtë rast shteti paraqitet si kreditor.

Mbi këtë bazë, në asnjë moment nuk kontestohet pronari, dhe nga ana tjetër ai përsëri është i pa qartë dhe i papërcaktuar. Kështu bëhet e ditur, se gjendja e pronës paraqitet si mjaft e ndërlikuar, sepse në të njëjtën kohë pronarë paraqiten “ **të gjithë dhe askush**”, asisoj të shpërndarë “ **çdo kund dhe askund**”.

Konstatimi tjetër që mund të shtohet këtu, është forma e pronës që para së gjithash kishte karakter politik, kurse në masë fare të vogël atë ekonomik. E tëra kjo ndodhte, me qëllim të ruajtjes së “**qetësisë sociale**”, që më vonë u dëshmuua në aspektin politik, social, ekonomik, etik, etj ishte plotësisht e paqëndrueshme. Rritmet e kohës parashtruan domosdoshmërinë e ndryshimeve strukturore. Këto ndryshime mund të bëheshin vetëm përmes procesit të transformimit dhe privatizimit, pastaj do të pasojë procesi i kapërcyellit(tranzicionit), si përbërës që do të sillte ndryshime rrënjësore në çdo sferë.

Sipas Historisë së të Drejtës Romake mund të vërehen katër periudha të zhvillimit pronësor:

1. Periudha e hershme paraqet mbetje të pronës kolektive;
2. Familja paraqet formë të pronës kalimtare;
3. Familja kognate pronën klasike skllavopronare;
4. Elementet e pronës feudale paraqesin shprehje të gërshetimit të pronës private dhe asaj të sundimtarit.

Shpjegimet e lart pohuara dhe që kanë të bëjnë me çështjen e pronës, do të na japin në vazhdim të kësaj qasjeje drejtimin përkitazi procesit të privatizimit. Këtu, në radhë të parë, kemi të bëjmë me ndërrimin e titullarit të pronës. Shqyrtimi i pronës në sistemet ekonomike, do të na mundësojë të kuptuarit e saj në aspektet e pronësisë ndaj mjeteve të prodhimit. Kjo rrethanë paraqet bazën shoqërore dhe ekonomike të dominimit. Në bazë të kësaj, do të mund të jepet edhe një përkufizim (jo gjithëpërfshirës) i asaj që quhet pronë. Pra, ajo” ***nuk paraqet gjë tjetër përpos një të drejtë të një njeriu apo grupeve të caktuara të njerëzve, për zbatimin e vendimeve lidhur me shfrytëzimin e objekteve pronësore***” (S.Selmanaj, 1996)

Pronësia është një institut i lashtë juridik, ajo ka lindur me lindjen e të së drejtës. Pronësia respektivisht e drejta e pronësisë, paraqet njërin ndër institutet juridike më të rëndësishme të së drejtës civile në përgjithësi, përkatësisht institutin juridik më të rëndësishëm të së drejtës sendore në veçanti. Rëndësia e saj shprehet me faktin se ajo është objekt rregullimit, dhe mbrohet jo vetëm në aspektin ligjor, por edhe kushtetues e ndërkombëtar. Kështu, e drejta e pronësisë gëzon mbrojtje në aspektin nacional e ndërkombëtar. E drejta e pronësisë është kategori kushtetuese.

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës garantohet e Drejta e Pronësisë, në nenin 121, paragrafi 1,2,3. Në rrafshin ndërkombëtar: E drejta e Pronësisë garantohet me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të vitit 1948 dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me Protokollet e saj. Protokolli nr. 1 garanton të drejtën në pronë dhe cekë: ***“...çdo person juridik apo fizik ka të drejtë në gëzimin e pronës së vet. Askush nuk mund të tjetërsohet nga prona e tij, përpos për interesin publik dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligje të së drejtës ndërkombëtare”***⁶

⁶ Aida Grgić, Zvonimir Mataga, Matija Longar i Ana Vilfan- Pravo na imovinu prema Evropskoj Konvenciji o ljudskim pravima- Savet Evrope, 2007 fq.4

Në bazë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, me rastin e hartimit të saj, shtetet nuk kanë mundur të kenë marrëveshje lidhur me mbrojtjen e pronës. Formulimi i miratuar kufizon të drejtat ndaj pronës dhe në një masë të madhe, i jep shtetit të drejtën që të ndikojë në këtë të drejtë.

Nga kjo rregull vërehen tri lloje të drejtash që konsistojnë në të drejtën e gëzimit të pronës:

1. E drejta për kontroll;
2. E drejta për përvetësim të rezultateve që janë realizuar në bazë të objektit të pronës;
3. E drejta për tjetërsim, duke kushtëzuar të drejtën për bartje të pronës te të tjerët.

Me këtë rend të së drejtës prona trajtohet si tërësi e të drejtave. Nëse këto të drejta përkohësisht iniciohen te pronari, ose te një grup pronarësh, ata shndërrohen në pronarë (*J.Bajec, L.Joksimoviq*).

Këto të drejta ndaj pronës, vlerësohen si bazë themelore për përcaktimin e pozicionit dominues gjatë procesit të riprodhimit. Gjatë krijimit të pronës materiale, titullarët e saj janë, para së gjithash, pronarë të mjeteve të prodhimit. Nga ky rend, e drejta rrjedh kushtimisht edhe te format e llojet e pronës.

2.2 Analiza teorike e procesit të privatizimit në disa vende të Evropës Juglindore dhe të ish Jugosllavisë

Ndarja ekonomike dhe politike në mes të vendeve të Evropës, deri në ditët e sotme, është një nga pengesat e cila mbajti të ngufatur një potencial të madh, para së gjithash ekonomik, i cili do të mund të krijonte një mirëqenie për popullatën mbi 500 milionëshe të saj. Një lirim i tillë, përpos si element i brendshëm, do të ndikonte edhe në paritetin ndaj vendeve tej oqeanike. Krijimi i Unionit Evropian kërkonte para së gjithash krijimin e tregut të përbashkët i cili do të jetë i bazuar në pluralizmin e pronës dhe demokratizimin e shoqërisë si faktor i zhvillimit të përgjithshëm.

Fundi i shekullit të kaluar për vendet e Evropës në përgjithësi, dhe për ato të Evropës Juglindore në veçanti, ishte një kthesë e madhe për kërkimin formave të mëtejme të zhvillimit ekonomik. Kjo rrethanë kërkonte në radhë të parë zbatimin, (aplikimin) e reformave në të gjitha porët e shoqërisë dhe të shteteve, që do të përballen me dukurinë e privatizimit.

Marrëdhëniet që kanë të bëjnë me rrethanat dhe lidhen me pronën, kërkojnë domosdoshmërinë e mënyrës së prodhimit, menaxhimit, organizimit, me një fjalë, ndryshimin e mënyrës së jetesës. Një nga ndryshimet, me përbërës themelore, kërkohej të bëhej privatizimi i pronës shtetërore. Kjo rrethanë i paraprin shumësisë (pluralizmit) të pronës, kurse çështja e demokratizimit të shoqërisë i përket sferës politike.

Privatizimi, procesi i transferimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në atë private, ka nxitur interesim nga shumë akterë, përfshirë politikanë, akademikë, si dhe punëtorë të sektorit privat dhe atij publik. Ekspertët e fushës e lavdërojnë por edhe e kritikojnë privatizimin, duke e bërë adoptimin e tij si politikë një vendim sfidues që kërkon vlerësim serioz. Privatizimi ofron fleksibilitet dhe hapësirë për inovacion përderisa në të njëjtën kohë rrezikon të ndikojë negativisht në moralin dhe sigurinë e punëtorëve.

Ngjashëm me vendet e tjera privatizimi i NSh-ve në Kosovë e bëri të nevojshëm krijimin e strategjive të reja dhe kornizave ligjore me qëllim kryesor zhvillimin e ekonomive në vendet në zhvillim⁷.

Pas rënies së socializmit, transformime të thella politike dhe ekonomike karakterizuan vendet post komuniste/socialiste dhe Kosova nuk përbën përjashtim. Ishte pretenduar që privatizimi të ishte gurthemel nga tranzicioni te demokracia dhe ekonomia e tregut⁸. Në vendet perëndimore, privatizimi ishte i kufizuar vetëm te disa ndërmarrje, por në vendet postkomuniste ky proces mori kuptim tjetër⁹. Në këto vende, privatizimi pritej të transformonte të gjithë ekonominë në një ekonomi të tregut. Kjo kërkonte procesimin e një numri të madh të ndërmarrjeve nga pronësia publike në atë private, zhvillimin e elementeve dhe institucioneve të nevojshme për një ekonomi të tregut (përfshirë shkathtësitë njerëzore për ekonominë e re), si dhe komercializimin e kompanive para dhe pas ndryshimit të pronësisë¹⁰. Shpesh është thënë që privatizimi në vendet postkomuniste në Evropën Lindore duhej të ishte i shpejtë dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që ta bënte tranzicionin ekonomik të pakthyeshëm, të stimulonte efikasitet të alokimit dhe përshtatshmëri, si dhe ta bëjë stabilizimin makroekonomik më të besueshëm¹¹.

Duke përcaktuar qartë të drejtat pronësore dhe duke zvogëluar ndërhyrjet e dëmshme nga shteti, ishte konsideruar që privatizimi të përmirësonte nxitjet, monitorimin dhe të rriste konkurrencën.

⁷ Kousadikar, A. dhe Singh, T.K. (2013). Advantages and Disadvantages of Privatisation in India. International Journal of Advanced System and Social Engineering Research [Përparësitë dhe mangësitë e Privatizimit në Indi]. Vol 3(1). f. 18-22

⁸ Savas, E.S. (1992). Privatization in post-socialist countries [Privatizimi në vendet post-socialiste]. Public Administration Review. Vol. 52 (6), f. 573-581

⁹ Goldstein, M. dhe Gultekin, B. (1994). Privatization in Post-communist Economies: A Theoretical Analysis [Privatizimi në ekonominë post-komuniste: Një analizë teorike, NATO Economic Colloquium series]

¹⁰ Agarwal, J.P. and Nunnenkamp, P. (1992). Methods and sequencing of privatization: what post-socialist countries can learn from Chile [Metodat dhe pasojat e privatizimit: çfarë mund të mësojnë nga Kili vendet post-socialiste]. Kiel Working Papers, Nr. 527 <http://econstor.eu/bitstream/10419/611/1/042680344.pdf>

¹¹ Tan, J. (2008). Privatization in Malaysia: Regulation, rent-seeking and policy failure [Privatizimi në Malajzi: Rregullimi, kërkimi i qerasë dhe dështimi i politikave. Routledge Taylor and Francis Group: New York http://www.untagsmd.ac.id/files/Perpustakaan_Digital_2/PRIVATIZATION%20Privatization%20in%20Malaysia,%20Regulation,%20rent-seeking%20and%20policy%20failure.pdf

Rrjedhimisht, ishte menduar që rritja e efikasitetit do ta nxiste pronarin privat që të bënte investimet kapitale që janë aq të nevojshme.

Privatizimi në vendet e Evropës Lindore ka karakter shumëdimensional. Ai në radhë të parë përfshin ripërkufizimin e të drejtave pronësore, andaj dhe të ndërmarrjeve. Privatizim do të thotë, rikrijim, ri-funksionalizim i institucioneve të një sistemi të tregut financiar, qeverisje e korporatave nga ana e menaxherëve, e pronësisë, kapitalit, bursave, dhe shumëllojshmëri financiare si: fondet e pensione, fondet e përbashkëta, trustet e investimeve, etj. (**David Lipton- Jeffrey Sachs ,1990**)¹²

Qasja ndaj këtij procesi kërkon, së pari rregulla ligjore , pastaj krijimin e institucioneve, që do të merreshin me zbatimin efikas të tyre. Për krijimin e ambientit ligjor të privatizimit të pronës shtetërore, në mënyrë radikale, duhet të ndërrohet legjislacioni përkatës në fushën e financave. Sipas rregullave zbatohet tërësia e ligjeve, me të cilat rregullohet krijimi i ndërmarrjeve të reja, likuidimi i tyre, letrat me vlerë, konkurrenca, tatimet, standardet e kontabilitetit, etj.¹³ Dy nga mënyrat thelbësore që i parashtrihen procesit janë: 1 procesi i shpejtë i privatizimit, që ndryshe është i njohur si proces i përmasave të gjera dhe, 2 ritmi gradual, që ndryshe njihet si ngritje shkallore. Në kornizat e këtyre dy mënyrave gjenden të gjitha metodat e privatizimit. Procesi i privatizimit në vendet e Evropës Juglindore (EJL) dhe ato të Evropës Qendrore e Lindore (EQL), identifikoi dy rrethana kryesore: së pari, për kapërcimin e mangësive të sistemit socialist, duhej të ndodhte procesi i përshpejtimt të privatizimit masiv, dhe kalimi në ritmet e ekonomisë së tregut dhe, së dyti, privatizimi i shpejtë të ndikojë në çështje të punësimit (**Joseph M. Dogget**)¹⁴.

¹² David Lipton- Jeffrey Sachs, Privatization in Eastern Europe: The Case of Poland ,Brookings Papers on Economic Activity,2/ 1990 fq 294

¹³ Legal Aspekts of Privatization in Industry, Economics Comision for Europe, Geneve 1992 fq. 14

¹⁴ Joseph M. Dogget- Privatization on Central and Eastern Europe <http://cog.kent.edu/lib/doggett1>

Mënyra e dytë e procesit që po shtjellojmë, shkaktoi shkurtime masive të vendeve të punës. Konkretisht, disa vende u përcaktuan për procesin masiv të privatizimit, që iu mundësoi shtresave të gjera të shoqërisë të jenë pjesëmarrëse në kapitalin e përgjithshëm shtetëror, dhe zvogëlimin e mbizotërimit që e kishte deri në këtë periudhë.

Debatet mes teoricienëve të ndryshëm lidhur me procesin e privatizimit në EJT, kanë të bëjnë me ritmin e realizimit të një strategjie sa më efektive. Disa autorë mendojnë se përfitimet e mundshme nga procesi i privatizimit janë aq të mëdha, sa që procesi duhet të përshpejtohet për aq sa është e mundur.

Ithtarët e privatizimit të shpejtë (*Stanley Fischer, 1991*)¹⁵ theksojnë domosdoshmërinë e privatizimit të përshpejtuar. Kështu, firmat e vogla duhet të privatizohen në formë të njëhershme, ndoshta me një formë të financimit nga shteti. Firmat e mëdha duhet të shndërrohen në korporata, me qëllim që sa më shpejt të dalin nga korniza mbikëqyrëse e ministrive përkatëse, dhe të vihen nën administrimin e këshillave, (bordeve), që kështu të bëjnë shpërndarja e aksioneve. Përmes procesit të privatizimit arrihet deri te ndryshimi i pronarit të kapitalit. Ai kapital humb karakterin administrativ të pronës (*V.Vukotic 1993*)¹⁶. Privatizimi paraqitet si pjesë e tranzicionit ekonomik, me të cilin kuptojmë procesin e bartjes së planifikimit centralist administrativ në atë të ekonomisë së tregut, që paraqitet si proces aktual në të gjitha vendet post socialiste.

Krijimi i korporatave paraqitet si hap i parë i procesit të privatizimit. Me rastin e krijimit të tyre zbatohet mënyrë e re e qeverisjes, si për shembull në Poloni.

Nga përvoja polake mësuam se si arrihej deri te kombinimi i qeverisjes së këshillave të punëtorëve me sindikatat.

Privatizimi i ndërmarrjeve të vogla, që kanë të bëjnë me shërbime dhe tregti, shiten sipas modelit të shitjes me “*likuidim*”, (shitja e të gjithë pasurisë së ndërmarrjes), kur

¹⁵ Stanley Fischer 1991, Privatization in Eastern Europe, National Bureau of Economic Research Cambridge, 1991 fq.3

¹⁶ Vukotić V., Privatizacija, Institut društvenih nauka, Beograd, 1993, fq. 29

nuk vjen deri te krijimi i korporatave (**V.Vukotic 1993**). Megjithatë, varësisht nga shtetet, themelimit të korporatave dhe funksionimit të tyre i jepet karakter dhe qasje e ndryshme, si: në Rusi me dekret të Presidentit (viti 1992) u zbatua largimi nga koncepti i privatizimit “**për çdo ndërmarrje veç e veç**”. Ky model i aplikuar i transformimit me detyrim, (hyrja në korporata) e të gjitha ndërmarrjeve shtetërore, me më shumë se një mijë të punësuar, ose pasuri me mbi 50 milion rubla, (përpos në ato ndërmarrje ku është i ndaluar procesi i privatizimit).

Në Bullgari (1992) procesi i krijimit të korporatave vihet në kompetenca të Këshillit të Ministrave. Këto kompetenca mund t'i barte në ministritë përkatëse (për ndërmarrjet të cilat kanë vlerën kontabël më të vogël se 10 milion leva).

Në Hungari për transformimin e pjesës më të madhe të ndërmarrjeve në korporata, kërkohej leje nga Agjencioni i Privatizimit kushtimisht, që në ato ndërmarrje ku ekzistonin këshillat e punëtorëve të lypej dhe leja e tyre me dy të tretat (2/3) e votave.

Në Poloni Ligji për Privatizimin (1990) për transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri aksionare (korporata), vendosej sipas rregullores së Ministrisë për Privatizimin, sipas parimit: “**ndërmarrje pas ndërmarrjes**“, sipas kërkesës themelore të drejtorit dhe këshillit të punëtorëve. Ngjashëm paraqitet gjendja dhe në vende të tjera.

Në këtë diskurs nuk do të parashtrohej pyetja e krijimit të shoqërive aksionare për ndërmarrjet, por përfillen vlerat e resurseve, të burimeve të tyre që kanë një vlerë të lartë, të përcaktuar sipas rregullave dhe ligjeve të atyre vendeve; mirëpo, njëkohësisht kërkohet dhe çfarë do të jetë karakteri i tyre, veprimtaria, organizimi dhe mënyra e qeverisjes.

Sllovenia, për dallim nga vendet e tjera të ish Jugosllavisë, procesit të privatizimit iu qas në mënyrë më të organizuar. Kështu, **Janez Sustresic, (2001)**¹⁷, drejtor i Zyrës për Çështje Makroekonomike (Slloveni), konsideronte se njëra nga anët më të mira të Ligjit mbi Privatizimin është shkollimi i revizorëve për vlerësimin e pronës shoqërore.

Kur bëhet fjalë për transparencën e procesit, konsiderohet se është arritur maksimumi, dhe se nuk janë regjistruar probleme të theksuara. Tash në Slloveni dihen të gjithë pronarët, dhe në këto shënime kanë qasje të gjithë.

Procesi i privatizimit në Shqipëri paraqitet me koloritin e vet, duke provuar që t'i përshtatet nevojave aktuale të vendit. Metoda e privatizimit që u përdor në Shqipëri, u bazua kryesisht prej blerjeve nga brenda (punëtor dhe drejtues) të ndërmarrjeve, dhe rezultoi me një strukturë mjaft të shpërndarë pronësie (**Fatmir Mema**),¹⁸ mungoi plotësisht angazhimi i institucioneve financiare në këtë proces. Mungesa e fondeve të investimit në këtë proces, që mund të angazhoheshin në emër të individëve të veçantë për monitorimin e drejtimit, dhe për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes, i zhveshi këta individë nga ky shërbim i specializuar. Një situatë kjo e Shqipërisë krejt ndryshe, nga ato që do të ndodhni në republikat Çeke e Sllovake dhe në Poloni.

Hyrja (inkorporimi) në rrjedha demokratike dhe krijimi i tregut financiar, janë përbërës që iu paraprin shumësia (pluralizmi) e pronës, në këtë mënyrë u zhvillua dhe vetë procesi i privatizimit. Të lidhur ngushtë me metodën e privatizimit, secili vend ka para vete detyra të rëndësishme për zhvillimin e tregjeve të letrave me vlerë (**Shyqeri Llaci 2010**).¹⁹ Bursa e Tiranës ende nuk ka filluar funksionimin, pavarësisht se hapja e saj është miratuar qysh në vitin 1996. Nga kjo rrjedh përfundimi, se në cilën periudhë të zhvillimit është procesi i privatizimit në Shqipëri.

¹⁷ <http://www.vesti.rs/vesti/kako-je-tekla-privatizacija-u-sloveniji.html>

¹⁸ Fatmir Mema, Privatizimi dhe efekte e tij në Shqipëri, fq. 197 <http://www.bankofalbania.org/web/pub/fatmirmema>

¹⁹ Shyqereri Llaci- Jorida Tabaku, Qeverisja e Korporatve, Tiranë : Albpaper, 2010 fq.238

Procesi i privatizimit në Shqipëri duhej të kishte karakter të një projekti, i cili do të krijonte mirëqenie. Kjo do të mundësonte krijimin e fondeve publike, të cilat duhej të orientoheshin në tri drejtime (**Ardian Civici, 2010**)²⁰ : 1. garantimi dhe rritja e punësimit, 2. përtrollitja e kërkesave të brendshme, 3. politika sociale ndaj shtresave të varfra dhe atyre në rrezik.

Konstatimet që lidhen me procesin e privatizimit në Shqipëri do të mund të përmbledheshin, se ai u zhvillua në kushte të veçanta, që i ofroi koha dhe shteti, duke ngërthyer dilemat se ai u zhvillua në mënyrën më të mirë të mundshme. Sidoqoftë, procesi u soll në korniza të privatizimeve të zhvilluara në vendet e EJT.

Përqendrimi ekonomik i privatizimit të zgjeruar, që u zhvillua në vendet e EJT, ka të bëjë me strukturën e pronësisë në drejtim të rritjes së prodhimit dhe veprimtarive shërbyese. Shumësia(pluralizmi) e pronës, me qëllim të realizimit të pronës private, ofron mundësinë e qeverisjes me anë të proceseve, përmes rolit të marrjes së vendimeve frytdhënëse. Ndonëse ka mjaft elemente të përbashkët, procesi i privatizimit masiv mes shteteve të ndryshme, megjithatë është zbatuar në harmoni me interesat e shteteve dhe të shoqërisë përkatëse. Kështu, procesi i privatizimit masiv ka të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet shteteve, si: Polonia, Çekia, Sllovakia, Rumania, Bullgaria, shtetet e ish Jugosllavisë, etj; andaj edhe efektet e privatizimit janë të ndryshme.

²⁰ Ardian Civici, *Kriza Financiare...apo Globale*, UET Press 2010, fq. 125

Tabela 1 Privatizimi në disa vende të Evropës dhe mundësitë liquide të ndërmarrjeve

Vendi	Viti	Nr i firmave profitabile	Cash pozitiv	Nuk kanë mundësi të paguajnë shërbimet	Nuk kanë mundësi të paguajnë borxhet	Nuk kanë mundësi të paguajnë furnitorët	Total
Bullgaria 828 firma	1995	45	13	17	22	4	100
	1994	43	11	29	13	4	100
	1993	22	18	23	32	5	100
	1992	28	10	31	27	4	100
Çekia 676 firma	1995	75	19	6	0	0	100
	1994	71	20	6	3	0	100
	1993	63	25	10	2	0	100
	1992	60	11	15	13	0	100
Hungaria 301 firma	1995	0	0	0	0	0	0
	1994	68	12	8	11	2	100
	1993	66	8	9	12	5	100
	1992	59	6	15	14	6	100
Polonia 940 firma	1995	36	31	15	15	2	100
	1994	50	21	9	17	2	100
	1993	40	17	12	24	8	100
	1992	37	16	17	20	10	100
Rusia 158 firma	1995	46	27	5	21	1	100
	1994	27	37	21	11	4	100
	1993	0	0	0	0	0	0
	1992	0	0	0	0	0	0
Sllovakia 905 firma	1995	53	35	9	13	0	100
	1994	57	21	9	13	0	100
	1993	51	23	12	14	0	100
	1992	0	0	0	0	0	0
Sllovenia 727 firma	1995	64	17	9	8	2	100
	1994	67	14	13	6	0	100
	1993	67	13	15	5	0	100
	1992	65	13	17	5	0	100

Burimi: Banka Botërore

Nga shënimet e mësipërme arrihet në përfundim, se procesi i privatizimit ishte mjaft i suksesshëm në Çeki, Sllovakia, Hungari dhe vende të tjera, që pasojnë në pikëpamje të profitabilitetit të ndërmarrjeve të reja të krijuara, parasë së gatshme, pagesat e të ardhurave personale, pagesa e borxheve, etj.

Të pakta janë ato vende të cilat e karakterizuan procesin e privatizimit si proces transparent dhe “të pastër”. Efektet e tij ndryshuan nga vendi në vend, duke krijuar parakushte të ndryshme drejt bashkimit (inkorporimit) në rrjedha globale dhe demokratike

2.3 Dinamika e zhvillimit ekonomik dhe politik, si kusht i tranzicionit dhe transformimit pronësor përmes procesit të privatizimit

Gjysma e dytë e shekullit të kaluar, padyshim la vulën e vet në zhvillimin e njerëzimit në të gjitha poret e jetës. Koha e ndryshimeve u shkurtua, se bashku me reformat nëpër të cilat kaluan vendet e botës. Prijatare e ndryshimeve, sikurse për shumë gjëra më herët, ishte Evropa. Për shtjellimin e modelit të zhvillimit ekonomik dhe transformimet që duheshin të bëheshin, do të shërbejë si përvojë për vendet e tjera, pikërisht nismat e kontinentit të vjetër. Të arriturat teknologjike, heqja e kufijve, ndryshimi i mënyrës së menaxhimit, zhvillimi i demokracisë dhe, thënë në mënyrë më të përgjithësuar, forma e re e të menduarit ndaj natyrës dhe shoqërisë, ishin premisa të qasjes ndryshe drejtë kërimit të reformave për një tranzicion ekonomik, politik, social dhe etik, me qëllim që jeta të bëhet më e lehtë. Nuk parashtrohej pyetje se a duhej bërë ato, mirëpo parashtrohej çështja, se cilat duhen të jenë ato dhe si të zbatohen.

Shkatërrimet e Luftës së Dytë Botërore, kërkuan një kohë relativisht të gjatë drejtë këndelljes së Evropës. Kaluan mbi 30 vite që ndarja e saj dypolare të kërkojë forma të tjera të zhvillimit. Periudha kohore 1970-2000, paraqet një periudhë të zhvillimeve dinamike në vende të ndryshme.

Përpjekjet për ndryshimin e gjendjes, në aspektin ekonomik dhe politik, posaçërisht në vendet e Evropës Lindore, fillet i kanë që nga viti 19968 (pranvera e Pragës) e ndoshta edhe ca më herët.

Mirëpo, me rënien e murit të Berlinit, ishin shenjat e para se diçka e madhe do të ndodhte. Energjia e shtrydhur me dekada kërkonte lirim, me qëllim që njerëzimit të bënte jetën më të lehtë.

Procesin e ndryshimeve në vendet e Evropës Lindore, Bashkimit Sovjetik, vendet e ish Jugosllavisë dhe disa vende të tjera në Ballkan, vlen vështruar në dy aspekte :

1. Transformimi i sistemit politik, mënyra e organizimit politik socialist, me kohë u tregua si sistem i cili nuk ka prirje të jetë në hap me atë kapitalist. Andaj, si i tillë, ai duhej ndryshuar. Mbyllja e tij në vete, mungesa e pluralizmit demokratik, mënyra e qeverisjes dhe marrjes së vendimeve, e cila ishte në duar të pjesëve elitare partiake, paraqiste pengesë drejtë krijimit të formave të reja, që i kërkonte koha dhe zhvillimi modern botëror. Çështjet politike të një vendi janë të lidhura në pikëpamje të lidhjeve prapavajtëse, me ato që kanë të bëjnë me ekonominë dhe zhvillimin e shoqërisë.
2. Transformimi i sistemit ekonomik-drejtimi drejt tregut, që ishte shtytje e botës kapitaliste, arriti përparësitë e dukshme ndaj vendeve që kishin orientim socialist të prodhimit, i mbështetur në diktate dhe planifikim të dirigjuar . Për këtë arsye, prodhimi socialist kurrë nuk mundi të realizohej në tregjet ndërkombëtare, dhe të ishte konkurrent. Ngecjet në aspektin makroekonomik ishin parakusht i kërimit të ndryshimeve. Pluralizmit politik duhej t'i paraprinte pluralizmi i pronës. Transformimi i pronës kërkonte, që sa më shpejtë që të ishte e mundur të përcaktohej pronari. Kjo kërkonte që prona shtetërore, andaj edhe ajo shoqërore, që ishte pronë e çdo kujt dhe askujt, të kalonte në duar të sektorit privat, në mënyrë që të dihet se kush zotëron me atë pronë. Kjo dëshmohej se procesi i privatizimit të pronës ishte domosdoshmëri, e cila më nuk mund të anashkalohej.

Në mësimet për socializmin, një ndër kritikën themelore për sistemin ekonomik kapitalist, ishte se bota kapitaliste kalonte në formë ciklike në kriza ekonomike në çdo 30 vite. Kjo rrethanë, ndonëse mund të ketë dhe aspektin shkencor. Mirëpo, dallimi në mes vendeve socialiste dhe atyre kapitaliste, konsistonte në faktin se shtetet socialiste, në formë të përhershme ishin në krizë nga e cila nuk dolën dot, derisa bota kapitaliste, megjithatë gjente forma për frenimin e krizave ekonomike.

Kriza e viteve të 90-ta e vendeve të Evropës Lindore, kishte karakter ekonomik dhe shoqëror, me paralajmërim të transformimit të domosdoshëm, nga një sistem socialist centralist dhe me plan të dirigjuar, drejt një sistemi ekonomik demokratik, i nxitur në konkurrencën e lirë në mes subjekteve ekonomike, dhe veprimin e lirë të ligjeve ekonomike (*ligji i vlerës*)²¹.

Kjo ndikoi për rënie të sistemit socialist, dhe shkatërrimin e sistemit ekonomik e politik të vendeve me rregullim shoqëror centralist.

Këto ndryshime përfshijnë procesin e tranzicionit, si periudhë kalimtare nga sistemi monist e një partiak, drejt një sistemi pluralist dhe i ngritur në ligjet e tregut. Dukuritë e mësipërme të cekura, ishin paralajmërim i domosdoshmërisë të procesit së tranzicionit. Në pikëpamje të përgjithshme, procesin e tranzicionit mund ta përkufizojmë, si kohë e cila sjell kalimin nga një sistem etatist burokratik i shoqërisë, në atë pluralist e demokratik. Aspekti ekonomik vepron sipas ligjeve të tregut. Procesi i kapërcimit të pronës duhet të jetë i bazuar në :

- përcaktimin e sistemit ekonomiko-shoqëror;
- shmangien e mënyrës centraliste dhe të planifikuar të zhvillimit ekonomik
- zbatimin e metodave dhe mënyrës së riprodhimit sipas parimeve të tregut të lirë, pluralizmit të pronës, duke i dhënë përparësi asaj private;
- liberalizimi ekonomik; ndërmarrja e masave për stabilizim makroekonomik;
- transformimin e pronës, me theks të veçantë, privatizimin e pronës shtetërore;
- ndryshimet afatgjata të institucioneve dhe strukturës ekonomike, si pikënisje për mirëqenien e shoqërisë dhe të ekonomisë kombëtare.

Procesi i transformimit i përket historisë së re, andaj për arsye të hulumtimit jo të mjaftueshëm në aspektin teorik, çdo ditë e më tej, paraqitet si mjaft kompleks; kështu zbatimi praktik është problem më vete.

²¹ Musa Limani, Makroekonomia Aplikativa Prishtinë 2003 faqe 69

Deri në ditët e sotme nuk ekziston ndonjë model shkencërisht i pranuar, që do të mund të vinte në pikëpyetje transformimin e pronës, e cila kishte karakter socialist.

Mbi këtë pikënisje, nuk ekziston ndonjë metodë e përcaktimit real të kohës së tranzicionit, dhe tërheqja e kufirit kur ka përfunduar ky proces. Kjo ndodh, ngase rruga e transformimit rrënjësor është e gjatë dhe kërkon ndryshime thelbësore. Bazë e problemit është përkufizimi i pronës. Për vendet e ish Jugosllavisë problemi sa vjen e shtohet. Duhej përcaktuar realisht, se çka është ajo që e përcakton pronën shtetërore dhe, çka është ajo që përcakton pronën shoqërore. Përcaktimi formal i kësaj çështjeje është i domosdoshëm, me qëllim që mos të mbetet barrë për brezat e ardhshme. Në rastin e Kosovës, nuk mund të ketë krenari, se kjo çështje është zgjidhur në mënyrë fatlume. Andaj, nga shkak i rëndësisë tejte të madhe ekziston ndërlikimi i këtij procesi, dhe veçmas i procesit të privatizimit të pronës si bartës i zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit shoqëror.

Duke vështruar procesin e tranzicionit, procesi i privatizimit paraqet hallkën kryesore pa të cilin nuk mundet të ketë suksese në reformat ekonomike dhe shoqërore, që përmbajnë rezultatin e këtij procesi. Definimi i procesit të privatizimit kërkon një përshkrim paksa më të gjerë të sinonimeve të ngjashme:²²

- në një numër të vendeve në zhvillim, vendet post socialiste, dhe një numër i vendeve të Evropës Perëndimore, prona shtetërore është shprehje e ekzistimit të ndërmarrjeve. Privatizimi i tyre paraqet bartje të pronësisë, në tërësi a pjesërisht, nga shteti në duar të pronarëve privat. Kjo njëkohësisht quhet denacionalizim (destatization).
- Ndonëse ekziston një mirëkuptim, se shitja e ndërmarrjeve shtetërore, paraqet privatizimin e tërësishëm, nuk ekziston pajtimi përkitazi me shitjen e mjeteve të ndërmarrjes, siç janë ndërtesat e toka si shembuj real të privatizimit.

²² E.S. Savas, Privatization and Public-Private Partnerships, (New York: CQ Press, 2000

- Në SHBA, ku numri i ndërmarrjeve, që janë në pronësi të shtetit, është i vogël, shprehja privatizim rëndom ka të bëjë me mënyrën e kontraktimit të shërbimeve publike.
- Privatizimi mund të vështrohet edhe nga aspekti i qeverisjes së pronës dhe konkurrenca e një personi ndaj tjetrit.
- Në aspektin financiar lidhur me këtë çështje, mund të shqyrtohet mundësia e kalimit të aksioneve në bursë nga shteti në pronar privat. Kjo, po ashtu, paraqet një formë të privatizimit e cila më pas reflektohet në mënyrën e qeverisjes.
- Në rastet kur agjencionet qeveritare janë të shtyra që të veprojnë në kushtet e tregut, me qëllim të grumbullimit të mjeteve, në tregun e kapitalit, si dhe të shitjes së shërbimeve të tyre, atëherë dukuria quhet “marketizim” e jo privatizim.
- Transformimi i disa agjencioneve publike dhe kalimi i tyre në duar private, fjalë më e mirë identifikuese, do të ishte “komercializim” e jo privatizim.
- Shprehja “partneritet publiko-privat”, po ashtu, paraqet një formë të privatizimit, ngase shteti paraqitet në anën e partnerit me sektorin privat, që ka karakter afatgjatë sikurse janë: auto udhët, urat, ndërtesat, etj.

Në përkim të kësaj dhe qasjeve të tjera, lidhur me procesin e tranzicionit dhe të privatizimit, mund të konstatohet se në esencë privatizimi është shumë më tepër se veprimtari drejtuese (menaxheriale) dhe financiare.. Kjo paraqet një qasje filozofike për marrëdhëniet në shoqëri, të institucioneve private dhe të pushtetit. Forma e tillë e shqyrtimit është mjaft komplekse.

Ndërlikimi i formës qëndron në faktin, se procesi i privatizimit pasqyrohet, duke u krijuar parakushtet për reformë të sistemit të tërësishëm shoqëror të vendit. Në kuadër të kësaj arrihet deri te ndryshimi i strukturës institucionale, e cila kërkon ndryshimin e rregullave ligjore, politike, sociologjike, etike dhe të marrëdhënieve të tjera shoqërore.

Me fjalë të tjera, kërkon ndryshime thelbësore në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Privatizimi paraqet rënien e rolit të shtetit, krahasuar me sektorin privat, për plotësimin e nevojave njerëzore. Kjo qasje, edhe pse mund të konstatohet se ka mjaft elemente të marketingut, do të na shpie në përfundimin, se kur është fjala për plotësimin e nevojave njerëzore, dhe vetë procesi i privatizimit ka një karakter për përmbushje nevojash.

Varësisht nga organizimi politik i vendeve të ndryshme, edhe procesi i privatizimit ndryshon në aspektin e përmasave dhe të ndërlikimit të tij. Nga kjo rrjedh, se procesi i privatizimit nuk do të thotë vetëm ndërrim i raporteve pronësore, mirëpo dhe ndryshim i rolit të shtetit e organeve vetëqeverisëse (në rastin e ish Jugosllavisë) në ekonomi, në kuptimin e zbatimit, kontrollit dhe realizimit të vendimeve.

2.4 Influenca e shtetit në procesin e transformimit pronësor dhe të privatizimit

Ngjashëm si dhe në shumë aspekte të tjera, përkitazi me procesin e privatizimit, nuk ekziston ndonjë qëndrim unik lidhur me rolin dhe rëndësinë e shtetit, në procesin e transformimit pronësor dhe atë të procesit të privatizimit. Pajtureshmëria ngërthehet në domosdoshmërinë, që të tejkalohet mënyra administrative e qeverisjes së prodhimit drejtë hyrjes (inkorporimit) në rrjedha bashkëkohore. Mirëpo, shmangia e sistemit administrativ centralist dhe të planifikuar të vendeve socialiste, nuk ishte faktor i mjaftueshëm për tejkalimin e problemeve të shumta ekonomike. Problemet shfaqeshin kryesisht në “tepricën e të punësuarve”, efikasitetin e vogël të investimeve dhe përparimi i ngadaltë teknologjik.²³

Këto vende gjatë procesit të sprovimit, tranzicionit kanë hasur në vështirësi që lidheshin me ndryshimet pronësore në ekonomi, bartje të pronës nga sektori shtetëror në atë privat, me qëllim të hapjes së procesit të privatizimit.

23 Milanovic B. Privatization Options and procedures in the Transitions from Socialism in Eastern Europe, Washington DC 1992, fq.49

Për të pasur sukses privatizimi konsiderohet se është e domosdoshme, që shteti të zbatojë ligje të përshtatshme dhe institucione, të cilat do të mbrojnë sferën e pronës individuale dhe të korporatave, me qëllim të krijimit të besimit të investitorëve vendor dhe të jashtëm, si dhe sistemin e tillë juridik harmonik për zhvillimin e aktiviteteve të ndërmarrjeve private.²⁴

Roli i shtetit, në aspektin e fuqizimit e të funksionalizimit të tij, qëndron në efikasitetin që t'i kryej shërbime cilësore popullit të vet. Populli është i detyruar të paguaj të gjitha ato që i kërkon shteti. Por mund të ketë raste, kur shteti e vendos veten mbi popullin.

Në raste të tilla, arrihet deri te fetishizimi i rolit të shtetit. Atëherë populli vjen në përfundim se ky nuk është shteti që e ka ndërtuar vetë. Ai(shteti) merr karakter hyjnor.

Fatkeqësisht ka raste kur pushteti i fituar në mënyrë demokratike, është marrë në mënyrë jodemokratike, andaj ndodh të kthehet si bumerang, në ato momente kur ai është mbi popullin. Njëmendësia e jetës në vendet socialiste, për gati një shekull, mbi mënyrën e të menduarit, qeverisjes dhe prodhimit, tash pas një kohe relativisht të gjatë, arrihet në përfundim, se disa breza të njerëzve kanë kaluar, duke mos e ditur se a ka ekzistuar mënyrë më e mirë e jetesës, krahasuar me atë që kanë pasur. Zhvillimet e reja, në radhë të parë, ato teknologjike, krijuan premiset e shikimit të botës përtej perdes së hekurt dhe e bënë atë më të afërt. Në dritë të kësaj rrethane, duhet vështruar ndryshimet shoqërore-ekonomike dhe të gjitha fushave të tjera të jetës. Në këto kushte, shteti përmes aparatit të vet duhet të japë orientimet kryesore të zhvillimit, dhe në kushte demokratike të sistemit, ai do të duhej që t'i përmbahej konceptit themelor: të jetë në shërbim të popullit. Në këtë kontekst, shteti do të duhej t'i qasej dhe procesit të transformimit dhe privatizimit të pronës. Kjo do të duhej të ishte kështu. Sidoqoftë faktet tregojnë se shtetet këtë rol nuk e kanë luajtur mjaft mirë .

24 V.Legal issues in Privatization, United Nation Commission on international Trade Law, Viena, 1993 fq.2

Devijimet kanë mundur të jenë aq të mëdha, aq sa të arrihet në përfundimin se shteti e bëri privatizimin për vete. Kjo çështje kuptohet se ndryshon nga njëri vend në tjetrin, varësisht nga niveli i demokracisë dhe transparenca e procesit.

Në të gjitha vendet post socialiste ekzistojnë dy mekanizma, përmes të cilëve shteti realizon ndikimin e tij në procesin e transformimit dhe privatizimit të pronës:²⁵

1. mekanizmi i parë: mbështetet në ndryshimet institucionale, kur shteti përcakton rregullat ligjore-juridike dhe institucionale, të domosdoshme për zhvillimin e ekonomisë së tregut.

Ky mekanizëm qëndron në faktin, se vetëm shteti mund të krijojë dhe zbatojë rregullat juridike, që themelojnë institucionet e tregut, garantojnë pronën private, përkufizojnë funksionimin e sistemit monetar dhe kreditor, dhe sigurojnë lirinë e raporteve konkurruese.

Në këtë mënyrë, shteti mundëson përdorimin e tregut si mekanizëm themeltar. Ky funksion rregullator i shtetit është i rëndësishë tejtejt të madhe në vendet në tranzicion, nga sistemi i planifikimit centralist ose vetëqeverisës (vendet e ish Jugosllavisë), në ekonomi të tregut, për arsye se në vendet ish socialiste nuk kanë ekzistuar institucionet e tregut.

Në aspektin e alokimit shteti luan rolin e vetë neutral, sepse nuk paraqitet si pjesëmarrës në prodhim, në konsum dhe shërbime. Ai shërben vetëm për sigurimin e veprimit të tregut si shpërndarës i resurseve.

2. Mekanizmi tjetër ka të bëjë me masat, të cilat shteti i ndërmerret në fushën e politikës makroekonomike. Sipas kësaj ligjësie segmentet e ndryshme caktojnë hapësirën e procesit të privatizimit të pronës. Ky funksion ligjor, në të shumtën e rasteve qartëson ndikimin e shtetit për shpërndarjen e burimeve. Në këtë formë, shteti paraqitet si rregullator i drejtimit të resurseve në të mira publike,

25 Dr. Selman Selmanaj – Sistemet ekonomike bashkëkohore, Prishtinë 1996 fq. 49

neutralizimin e faktorëve negativë, të jashtëm dhe të brendshëm e, në këtë mënyrë, dhe procesin e transformimit dhe privatizimit do ta mbajë nën kontroll.

Këta dy mekanizma ndodhen në ndërlidhmëni reciproke dhe ndikojnë njëri në tjetrin. Në vendet post socialiste, ndërlidhja reciproke ndërmjet këtyre dy mekanizmave, kushtëzohet nga fakti se procesi i transformimit dhe privatizimit të pronës zhvillohet në rrethana jo të qëndrueshme makroekonomike.

Ato i karakterizon rënia drastike e prodhimit shoqëror, brutoprodhimi shoqëror, bankrotimi i një numri të madh të ndërmarrjeve industriale, shtimi i papunësisë, borxhi i jashtëm, zgjerimi i korrupsionit dhe i dukurive të tjera negative, që çojnë deri te çrregullimi politik dhe social në këto vende. Me qëllim të shmangies nga këto dukuri negative, qeveritë, në shumicën e vendeve post socialiste, përmes masave të politikës ekonomike, bëjnë përpjekje që procesin e privatizimit të pronës ta mbajnë nën kontrollin e tyre. Ato zbatojnë politikën “ndal dhe ik”, duke i kombinuar kërkesat shoqërore-politike, me qëllim të sendërtimit të rrethinës makroekonomike të orientuar në ekonominë e tregut.

Në shumë vende jashtë bllokut lindor, privatizimi solli përfitime të mëdha dhe për qeveritë e atyre vendeve. Vendet e Evropës Lindore nxitën procesin e privatizimit të pronës shtetërore, edhe pse ato nuk ishin gati për zbatimin e tyre shkaku i situatës ekonomike.²⁶ Për të mbajtur një rishpërndarje të barabartë të këtyre aseteve shtetërore, qeveritë dorëzuan bonot dhe kuponët publik në mënyrë të kontrolluar.

Këto mjete janë përdorur për të shmangur inflacionin, pasi ato nuk mund të përdoren për të blerë ndonjë gjë, (me përjashtim të aktiviteteve të tjera shtetërore në Letoni dhe Slloveni).

26 Vichentia Milea, Privatization in Eastern Europe,
http://econc10.bu.edu/economic_systems/Economics/Transit/Privatization/privat_europe

Në Republikën Çeke ndërmjetësve financiarë iu ofrohen alternativa të pronësisë personale të letrave me vlerë, ndërsa Polonia ka përdorur një numër të fondeve të përbashkëta, për të ndarë kuponët dhe për të kufizuar konsolidimin e pronësisë.

Devijimet e kuptimit të procesit të privatizimit, varësisht nga vendet, ishin të ndryshme. Disa vende iu qasën procesit të privatizimit ngase ishte bërë “ modë ”, ishte bërë diçka që e kërkonte koha.

Fillimisht privatizimi, si përbërës themelor i procesit të tranzicionit, në drejtim të restaurimit të kapitalizmit në vendet e Evropës Lindore, pas vitit 1989, nuk kishte për qëllim “ *zhvillimin ekonomik në kushtet e ekonomisë së tregut*”, por ndryshimin e raporteve pronësore në shoqëri.²⁷ Më vonë, rolin e vet që ushtroi shteti mbi këtë proces, gjërat ishin më të qarta. Roli fillestar do të duhej të ishte ristrukturimi i ekonomisë, përmes formimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me anë të tyre do të mund të zbatoheshin procesi i transformimit dhe privatizimit të pronës.

Çdo veprim ose jo veprim i shtetit, në fushën e ekonomisë, ka karakter të rregullimit të marrëdhënieve në mes subjekteve. Urdhëresat, ligjet, vendimet, etj. që shteti përmes organeve të veta, i ndërmerr dhe i realizon, ndikon në atë formë asisoj, sa të ndryshojë raportet në mes pjesëmarrësve në ekonomi. Mungesa a marrja me vonese e këtyre vendimeve, po ashtu ndikon në marrëdhëniet mes subjekteve ekonomike. Këto veprimtari paraqiten si funksione rregullatori të shtetit.²⁸

Shikuar në retrospektivë, të gjitha ekonomitë e vendeve të ndryshme, nuk i janë nënshtruar rregullatorit të shtetit. Varësisht nga zhvillimi ekonomik dhe teknologjik, ndryshon struktura ekonomike dhe mënyra e prodhimit, si dhe sfera e zotërimit të drejtpërdrejtë a tërthore e ligjeve shtetërore.

27 Marija Obradović, <http://www.nspm.rs/ekonomska-politika/uloga-medjunarodnih-finansijskih-organizacija-i-agencija-stranij-vlada-u-privatizaciji-drustvenog-kapitala-u-srbiji-2002>

28 Goran Mitić,; Regulatorna funkcija države u savremenim tržišnim privredama, <http://www.link-elearning.com/linkdl/elearning/jedinica>.

Mund të pritet që në aspektin makroekonomik funksionet rregulluese të shtetit, në kushtet bashkëkohore të ekonomive me treg të lirë, edhe më tej të forcohen. Sidoqoftë ato do të kombinohen nga zbatimi i modifikuar i instrumenteve fiskale dhe i politikës monetare-kreditore, duke zbatuar politikën e çmimeve, të zhvillimit ekonomik ose politikë të ristrukturimit të ekonomisë, etj.

Në shumicën e vendeve ish socialiste, zotëronte logjika e kalimit në ekonomi të tregut, dhe duhej të bëhej sa më shpejt që të jetë e mundur. Zbatimi i metodës të “**shok terapisë**” ka ndikuar në kërkesën për para.

Shteti ishte i detyruar të bënte zhvlerësimin e valutës vendore, dhe të vendoste konvertibilitetin intern. Politika monetare-kreditore kishte karakter restriktiv, me qëllim që pastaj të vinte deri te çrregullimi i çmimeve dhe liberalizimi i qarkullimit ndërkombëtar.

Rolin e vet këto shtete, në aspekt të realizimit të planit rregullues, realizuan në këto kushte:

- zhvillimin e kanaleve të komunikimit në mes subjekteve ekonomike, qytetarëve, shtetit dhe administratës;
- bashkëpunimi dhe partneriteti në mes të zyrtarëve dhe institucioneve në aspektin regjional dhe lokal;
- përgjegjësia e zyrtarëve shtetëror për punën e kryer;
- krijimi i institucioneve specifike, të cilat do të ndikonin në procesin e privatizimit të pronës, dhe kufizimin e kontrollit nga ana e shtetit në rrjedhën e procesit.

Realizimi i këtyre kushteve të parashtruara, do të duhej të ketë kuptim për zvogëlimin e rolit të shtetit, për kalimin drejt ekonomisë së tregut, me anë të gërshetimit të politikës makroekonomike dhe institucionale.

Në rrjedhën e procesit të transformimit dhe privatizimit të pronës në Republikën e Kosovës, çështja është komplekse, si në aspektin e qasjes këtij problemi, po ashtu, dhe në zbatimin e metodave të dedikuara për këtë proces. Thelbësore ishte se Kosova po bëhej shtet, dhe njëkohësisht po e fillonte procesin e privatizimit.

Ajo ishte e pamundësuar nga e drejta, që e kishin shtetet tjera, që problemet e parashtruara për zgjidhje t'i kërkonte për t'i zgjidhur vet, gjithnjë sipas veçorive vetjake dhe përvojave të suksesshme të tjerëve. Pas vitit 1999, bartës i politikës makroekonomike në Kosovë ishte Misioni i Kombeve të Bashkuara, i quajtur UNMIK (United Nations Interim Administration Mission in Kosovo). Ky mision ndërkombëtar, njëkohësisht ishte përgjegjës për çdo gjë, përpos për sigurimin e kufijve të jashtëm, që iu besua po ashtu, misionit të OKB-së, i cili kishte karakter ushtarak dhe quhej KFOR. (Kosovo Force). UNMIK –u së shpejti vuri në veprim institucionet e veta, (për të cilat mendonte se i nevojiteshin Kosovës), dhe tërë jetën civile në Kosovë e organizoi përmes katër shtyllave. Çështja që kishte të bënte me procesin e transformimit dhe privatizimit të pronës, i përkiste shtyllës së katërt (IV).

Puna fillestare e UNMIK ishte mjaft premtuese, në pikëpamje të zhvillimit ekonomik dhe stabilizimit. Mirëpo, shtyllës së katërt (IV) të UNMIK-ut i mungonte koncepti, strategjia e përgjithshme e zhvillimit²⁹.

Kuptohet, mungesa e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm për mbarë-shtruarje, dhe zbatimin e politikës makroekonomike, paraqiti një mangësi të madhe për orientimin e zhvillimit të përgjithshëm, sektorial, territorial të zhvillimit aktual dhe perspektivës të ekonomisë së Kosovës.

UNMIK-u zbatonte një politikë shkurt parëse, dhe në mënyrë të pjesshme në pikëpamje të zhvillimit, duke lënë anash ekonominë e pronës shoqërore, e cila ishte mjaft e shkatërruar dhe pa përkrahje politike.

29 Musa Limani, Makroekonomia Aplikativa , Prishtinë 2003 fq. 73

Po ashtu, nuk kishte ndonjë lëvizje pozitive as sa i përket sektorit privat. E tërë kjo gjendje kontribuoi për moszbatimin e politikës makroekonomike, as për një zhvillim ekonomik të shpejtuar. Kështu, Kosova u ndodh në krizë të madhe. Popullata u soll në prag të ekzistencës. Duhej kërkuar rrugëdalje.

Njeriu si qenie më e përsosur e planetit tokë, ka të drejtë që të trajtohet në çdo pikëpamje me dinjitet të plotë. Për njeriun si individ, e drejta për qeverisje të jetës së vet, dhe krejt ajo që e karakterizon mirëqenien e jetës, është e drejtë natyrore. Bashkimi i qenies individuale në grup, krijon marrëdhënie të detyrueshme, të tilla që të investohet individualisht, dhe të kërkohet bashkëveprimi i dijes dhe kapitalit, bashkëpërgjegjësia e të drejtës për marrje e dhënie, sipas ligjit për të drejtën dhe detyrimin. Kjo qartëson shfrytëzimin e së drejtës, në proporcion me angazhimin në bashkësi, dhe të drejtat që i delegon bashkësia te individi. Kthimi i detyrimeve të marra nga bashkësia, në të shumtën e rasteve, vjen në shprehje përmes kthimit në formë të shërbimeve.

Mbi këtë premisë, mund të nxirret përfundimi logjik, se shteti përmes pushtetit duhet të jetë shërbëtor i qytetarëve, të cilët e kanë ndërtuar. Ai mund të jetë totalitar dhe të shërbejë vetës, ose demokratik që të jetë në shërbim të krijuesit, popullit.

Fjala demokraci nuk është e datës së re. Pa pretendime, që në tërësi të analizohet kjo fjalë, konsideroj se për hire të asaj që ky nocion do të përdoret edhe në vazhdim, le të jepet një sqarim pak më i zgjeruar.

Demokracia për herë të parë paraqitet në Greqinë antike në shekullin e katërt (IV) p.e.s. në Athinë. Demokracia e parë e kohës së re ishte e vendosur në SHBA, në vitin 1789. Platoni i kishte gjithsej 20 vite, kur mësuesi i tij Sokrati, duke mbrojtur mendimin e lirë, pas fitores së revolucionit dhe të demokracisë, një grup bashkëmendimtarësh, u dënuan me vdekje duke pirë helmin e kukutës.

Një fakt i tillë, kishte nxitur te Platoni ndjenjën e urrejtjes ndaj demokracisë; aq sa të pohonte se ajo demokraci, sa më shpejtë që të jetë e mundur duhej shkatërruar, në mënyrë që pushteti tu takojë njerëzve më të mençur dhe më të mirë që kishte vendi.

Ky ishte qëllimi kryesor i mësimëve të Platonit.

Një përkufizim i përgjithësuar i fjalës demokraci, do të kuptohej si shprehje e qeverisjes nga ana e popullit. Ngase qeverisja ka karakter politik, andaj duhet kërkuar kuptimin në këtë kontekst: demokracia është drejtim politik, që favorizon pushtetin e popullit, në të vërtetë, përfaqësuesit e tij.³⁰

Demokracia është sistem politik i bazuar në mundësinë që qytetarët (populli) të mund ti zgjedh përfaqësuesit e tij. Kjo e drejtë në zgjedhjen e përfaqësuesve, paraqet konceptin themelor, i cili mund të zbatohet me metoda dhe forma të ndryshme.

Demokracia mund të kuptohet dhe si sistem i sundimit të shumicës. Kjo do të thotë, se shumica mund t'ia imponojë vullnetin e saj pakicës.

Por mendimtarë të shumtë mendojnë se ky koncept ka karakter të gjerë:

- ***demokracia është forma më e keqe e shtetit nëse i përjashtojmë të gjitha të tjerat (Winston Churchill);***
- ***fryma e demokracisë nuk mund të imponohet nga jashtë. Ajo duhet të rrjedhë nga brendësia e popullit (Mahatma Gandhi);***
- ***jeta në liri nuk është e lehtë, kurse demokracia kurrë nuk është e plotë. (J.F.Kennedy);***
- ***pyetja se kush duhet të qeverisë është gabimisht e parashtruar. Mjafton nëse qeveria e keqe të mund të ndërrohet. Kjo është demokracia (Karl Popper);***
- ***ai që në vendin e tij aplikon demokracinë, nuk duhet kërkuar leje për këtë. (Bülent Ecevit);***

³⁰ <http://sr.wikipedia.org/sr>

- ***demokracia është proces i cili na garanton se me ne nuk do të qeveriset më mirë se që e meritojmë (George Bernard Shaw).***

E kundërta e demokracisë janë të gjitha sistemet e tjera e, para së gjithash, sistemi totalitar në vendet e Evropës Lindore dhe disa vende të tjera, zotëroi për më shumë se 50 vite, me një planifikim centralist... Përvoja diktaturës, qoftë individuale ose kolektive, ishte njëra nga përvojat më të ndërlikuara në historinë e shoqërisë njerëzore.

Institucionalizimi i demokracisë, si formë e qeverisjes politike, kishte pikënisjen në qeverisjen sipas ligjit, ku të gjithë janë të barabartë para tij, në parimet e barazisë, pluralizmit partiak, të pushtetit të shpërndarë në institucione, me tregun e lirë, etj; e gjithë kjo shumësi ligjore është në funksion të realizimit të mendësisë demokratike, d.m.th sundim i popullit, i shumicës së tij. Në burimin e kësaj fjale rrjedh lumi më i gjerë i nocionit: qeverisje e popullit me votën e lirë. Këtu ngërthehet burimi i kësaj fjale.³¹

Liria si qëllim i procesit të transformimit dhe privatizimit të pronës, në periudhën e tranzicionit, realizohet përmes procesit të demokratizimit të shoqërisë dhe funksionimit të shtetit ligjor.

Demokracia politike realizohet përmes shprehjes së lirë, votimeve të lira dhe bashkimit të lirë të anëtarëve të shoqërisë, ndërsa demokracia ekonomike realizohet sipas parimit, “***secili banor (qytetar) të posedojë së paku një fletë-aksion.***” Në këtë mënyrë, vijmë deri te shpërqendrimi (dispersioni) i strukturës së pronës, që duhet të jetë më unike se sa në kushtet e përqendrimit (koncentrimit) të pronës. Partia Konservative në Britaninë e Madhe dhe Partia Republikane në SHBA, përmes procesit të privatizimit përpiqen të promovojnë demokracinë. Socialistët dhe partitë e tjera, me orientime të majtë, në të gjitha vendet e zhvilluara Euroatlantike dhe në ato, të cilat ndodhen në

31 Lorna Štrbac , Prikaz knjige Zorana Vidojević, *Demokratija na zalasku – autoritarno – totalitarna pretnja*, Službeni glasnik i IDN, Beograd, 2010

periudhën e tranzicionit, orvaten që proceset e demokracisë politike dhe ekonomike t'i përurojnë nëpërmjet procesit të nacionalizimit të ekonomisë.

Partitë konservatore bërthamën e procesit të demokratizimit, e shpjegojnë me anë të zgjerimit dhe zhvillimit të shoqërive aksionare; përderisa socialistët dhe partitë e tjera të majta, demokratizimin e ndërmarrjeve e shpjegojnë nga pjesëmarrja sa më e madhe e punëtorëve në procesin e drejtimit (menaxhimit) (*N.Saviq*)³²

Gjysma e dytë e shekullit 20 , në zhvillimin e njerëzimit, posaçërisht për vendet post-socialiste, ishte e vështirë në çdo aspekt. Çdo formë e kolektivizmit përçonte drejtë praktikave të totalitarizmit dhe mohimit të lirisë individuale. Shoqëritë kolektive kërkonin qeverisje centraliste të burimeve, si dhe shpërndarjen e tyre. Mirëpo, personeli përgjegjës për këtë shpërndarje nuk mund të kishte diturinë e mjaftueshme që të bënte alokime, shtojca financiare efikase. Si alternative e këtij modeli është riafirmimi i idesë së lirisë së individëve, të cilët janë të aftë që me veprime të veta të kryejnë alokimin optimal të resurseve përmes mekanizmit të çmimeve (*Fridrih fon Hajek- Nobelist për ekonomi 1974*). Një sistem spontan i tillë, i vetë-rregullimit që u mundësohet të gjithë individëve, me anë të bashkëveprimit vullnetar për t'i realizuar qëllimet e tyre, *Friedrich Hayek* e quan katalaks (Catallaxy). Sipas tij, kjo fjalë ka të bëjë me “këmbimin”, sepse fjala “ekonomi” nuk shpreh rregullim spontan, mirëpo një lloj planifikimi. Ai katalaksin e sheh si rregullim spontan, i cili krijohet në treg përmes procesit të interaksionit.³³

Pamundësia e qëndrimit të mëtejshëm të sistemit totalitar, si në formë po ashtu, dhe në strukturë, me qëllim të bashkimit të botës së zhvilluar, kërkon qasjen e ndryshimeve drejt tranzicionit të sistemit shoqëror në tërësi. Vetë procesi i kalimit politik qartëson tranzicionin e sistemit ekonomik. Tregu i lirë, ku vepron liria e ideve, mallrave dhe kapitalit është i pa akceptueshëm, për vendet me sisteme totalitare.

³² Dr. Selman Selmanaj – Sistemet ekonomike bashkëkohore, Prishtinë 1996 fq. 35 Citim

³³ Jelena Manić, Jedan liberalni pogled: Hajekova kritika socijalizma, Zbornik Beogradske otvorene škole, 2007

Në kushtet e demokratizimit të shtetit tregu funksionon në bazë të ofertës dhe kërkesës. E tërë kjo logjistikë krijon mundësinë e transformimit të pronës shtetërore (ose shoqërore për vendet e ish Jugosllavisë), duke ndjekur procesin e privatizimit dhe ndërrimin e marrëdhënieve pronësore, si dhe zvogëlimin e rolit të shtetit.

Pas vitit 1999, misioni civil i Kombeve të Bashkuara, i quajtur UNMIK zëshëm trumbetonte çështjen e plotësimit të standardeve, me qëllim të inkuadrimit në rrjedhën e botës së zhvilluar demokratike. U desh që të kalojnë tri vite, në mënyrë që Kosova të organizojë zgjedhjet në kuadër të një pluralizmi politik. Ato dhe zgjedhjet e tjera politike që pasuan, nuk arritën në plotësi të funksionojë një sistem politik, që me të vërtetë, do t'i plotësonte nevojat e qytetarit dhe të ishte në shërbim të tij. Pasojat e transformimit të pronës, në kushtet e një veprimi politik, i një çfarësie të këtillë, në aspektin makroekonomik, do të kenë pasoja.


Çështja qëndron ngjashëm sikur hartimi i llogarive financiare të fundvitit. Disa llogaritarë arrijnë që të maskojnë me mjeshtri “*humbjet e fshehta dhe fitimin latent*”. Periudhat e mëvonshme qesin në shesh të palarat e grumbulluara më herët.

2.5 Procesi i transformimit dhe privatizimit të pronës, shembuj të reformave në vendet e Evropës Juglindore, si një hap drejt privatizimit

Pamundësia për t'i përcjellë rrjedhat zhvillimore, krahasuar me ato në vendet e Evropës Perëndimore, para vendeve të Evropës Jug Lindore, paraqiti domosdoshmërinë e ndryshimeve politike. Këto ndryshime do të sjellin deri te reformimi i sistemit ekonomik në tërësi, nëpërmjet procesit të tranzicionit dhe transformimit të pronës. Kuptohet, procesi i privatizimit paraqet rolin zotërues... Baza e këtij mekanizmi për krijimin e tregut unik ose të brendshëm, kërkon harmonizim përkitazi rregullave ligjore.

Harmonizimi teknik me rregullat e Unionit Evropian, dhe metodat e vlerësimit të harmonizimit, mundësojnë qarkullimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve në nivel tregut të tërësishëm.

Ndonëse transformimi politik, në aspektin kohor është i kornizuar, reformat ekonomike kërkojnë kohë më të gjatë, sepse dimensionet e tyre janë mjaft të komplikuar dhe paraqet kërkesa të ndryshme. Përkitazi me këtë konstatim, ofrohet ky diagram që paraqet faktorët që ndikojnë në reformat ekonomike:



Burimi ; Staehr, Karsten, Tamazian, Artur and Vadlamannati, Krishna Chaitanya, Political Determinants of Economic Reforms in the Post-Communist Transition Countries, University of Santiago de Compostela fq. 5

Nga diagrami vërejmë se reformat ekonomike janë rezultat i vendosjes politike. Përbërja e parlamenteve, orientimi ideologjik i tyre dhe faktorët e tjerë, paraqesin sistemin e tërësishëm politik për mënyrën e qeverisjes. Çështja specifike e vendosjes politike drejt reformave ekonomike, paraqitet si rezultat i varësisë së paku nga katër faktorë:³⁴

1. *struktura ekonomike ekzistuese dhe institucionet, të cilat paraqesin kornizë të reformave ekonomike;*
2. *të arriturat ekonomike mund të ndikojnë në kërkesat për reforma, ose vlerësimin e shpenzimeve dhe dobitë nga reformat;*

34 Staehr, Karsten, Tamazian, Artur and Vadlamannati, Krishna Chaitanya, Political Determinants of Economic Reforms in the Post-Communist Transition Countries, University of Santiago de Compostela 01. May 2009 fq. 5

3. *duke marrë parasysh strukturën ekonomike dhe performancën e saj, popullata në vendet e ndryshme mund të ketë preferenca të ndryshme në aspekte të reformave ekonomike;*
4. *institucionet politike, përmes zgjedhjeve demokratike do të ndikojnë në vendimmarrje politike.*

Procesi i transformimit kapërcyellit të privatizimit, nuk kaloi në formë uniforme në të gjitha vendet. Varësisht nga struktura ekonomike dhe politike e atyre vendeve, privatizimi i pronës shtetërore (shoqërore) pati rrjedhën e vet.

Në vazhdim të shtjellimit të problematikës së parashtruar, që ka të bëjë me procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës, pa pretendime gjithëpërfshirëse, do të paraqesim disa nga përvojat e vendeve të ndryshme, edhe pse nuk gjetën zbatim në rastin e Kosovës. Megjithatë, ato përvoja do të na japin një pasqyrë, se cilat nga përvojat ishin pozitive dhe do të mund të zbatoheshin në rastin tonë.

Privatizimi në Republikën Çeke - Një nga modelet më kreative të procesit të privatizimit, u zbatua pikërisht në federatën Çeko-Slllovake, e miratuar nga ana e qeverisë kah fundi i vitit 1991, kurse realizimi i saj, nisi nga fillim viti 1992. Në fillim të vitit 1993, erdhi deri te shthurja e kësaj federate, dhe u krijuan dy shtete: Çekia dhe Sllovakia. Këto dy shtete në periudhën që pasoi, ndarazi vazhduan procesin e privatizimit.

Procesi i privatizimit filloi pas miratimit të disa ligjeve, që u miratuan në kuvend, ku pritej legjislacioni ligjor i nevojshëm:

1. ligji mbi privatizimin e vogël;
2. ligji mbi privatizimin e madh;
3. ligji mbi ndërmarrjet;
4. ligji mbi bursat dhe ligjet tjera përcjellëse.

Këto ligje mundësuan fillimin e procesit të privatizimit. Qeveria Çeke këtë e bëri në tri mënyra:

1. restituimi i pronës (Kompensimi);
2. privatizimi i vogël;
3. privatizimi i madh.

Pas shqyrtimeve gjithëpërfshirëse, procesi i privatizimit në Çeki e Sllovaki filloi në vitin 1992. Karakteristikë është se ekonomia e këtij vendi ishte mbi 97% e centralizuar.

U shtrua si domosdoshmëri, që sa më shpejtë të ndërrohen marrëdhëniet pronësore drejtë dinamizmit të sektorit privat. Kjo kushtëzoi qasje radikale për transferim të shpejtë të pronës shtetërore në duar të miliona pronarëve privat.

Kompensimi i pronës ka për qëllim kthimin e pronës atyre që iu ishte nacionalizuar gjatë regjimit komunist pas vitit 1948. Vlerësimi i pasurisë është përcaktuar me anë të marrëveshjeve direke, në mes pronarëve të tashëm dhe ish pronarëve.

Ishin së paku 200,000 kërkesa për tokë bujqësore, dhe 70,000 kërkesa që kishin të bënin me ndërtesat e banimit, të cilat qenë realizuar dhe iu ishin kthyer pronarëve paraprakë. Pronarët e ndërmarrjeve kishin të drejtë që të jenë pjesëmarrës, me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve. Ata po ashtu, mund të blinin pjesën tjetër të ndërmarrjes me kushte të volitshme (rëndom sipas vlerës kontabël), duke mos hyrë në garë me pjesëmarrësit e tjerë potencial.

Procesin e privatizimit qeveria e shtetit Çeko-Sllovak (së pari bashkërisht e pastaj ndarazi), e filloi me procesin e ashtuquajtur **privatizimi i vogël**, sepse ky sektor ishte mjaft i zhvilluar. Kreator i këtij procesi ishte Vaclav Klaus, ministër i atëhershëm i financave.

Themel i këtij modeli ishte i atillë, që secilit qytetar mbi 18 vite t'i jepej një voucher (kupon investiv), në vlerë prej 1000 poenëve si investim, me të cilët më vonë mund të blihen aksione të ndërmarrjeve, ose kjo rrethanë të realizohej nëpërmjet të ashtuquajturave fonde investuese të privatizimit.

Ato institucione, të cilat u krijuan, posaçërisht për këtë qëllim, në mënyrë që të mund të ndërmjetësonin në mes qytetarëve të interesuar dhe ndërmarrjeve, gjatë shitjes publike të aksioneve të ndërmarrjeve të caktuara. Ky ndërmjetësim nuk ishte detyrues, kështu që pronarët e kuponëve kishin mundësinë e blerjes së aksioneve dhe në formë të pavarur.

Çmimi i aksioneve shprehej në sasinë e pikëve investuese, kurse vlerësohej sipas parimit të ofertës dhe kërkesës. Nëse kërkesa për aksione ishte e madhe, atëherë pasonte korrigjimi nga lart dhe anasjelltas.

Gjithnjë sipas planit, në valën e parë (deri në fund të vitit 1992), duhej të privatizoheshin 1492 ndërmarrje shtetërore, kurse në valën e dytë (1993), po aq ndërmarrje.

Kështu, numri i ndërmarrjeve të privatizuar do të arrinte në 3000. Vlera kontabël e këtyre ndërmarrjeve që u transformuan në këtë mënyrë, ishte ofro 300 miliard kruna çeke (11,2 miliard USD).

Deri në fund të vitit 1992, më tepër se 22,000 njësi u privatizuan nëpërmjet formës së privatizimit të vogël, me vlerë mbi një miliard USD. Po ashtu, u lejuan që 10,000 njësi të tjera, të shiten për më vonë. Deri në fund të vitit 1993, kur kjo formë dhe zyrtarisht u ndërpre, 30,4 miliard kruna çeke arriti vlera e pronës së shitur te pronarët privatë.³⁵

³⁵ Jan Hanousek and Evzen Kocenda, The impact of Czech mass privatization on corporate governance, Center for Economic Research and Graduate Education, Charles University, Economics Institute, Academy of Sciences of the Czech Republic, Prague, Czech Republic fq. 281

Privatizimi i madh ishte proces nga i cili duhej të kalonin ndërmarrjet e mëdha, në kohën e paraparë prej 5 vitesh. Më tepër se 2,400 ndërmarrje i plotësonin kushtet për këtë formë të privatizimit. Në këtë mënyrë mund të aplikoheshin një ose më tepër metoda të privatizimit, duke përfshirë metodën e drejtpërdrejtë të shitjes blerësve vendor ose atyre të jashtëm, ofertën publike ose të formave të tjera, njëkohësisht dhe pjesëmarrjen në skemën nëpërmjet faturave a dorëzanës. Ndërmarrjet në formë autonome kishin mundësinë që të propozonin formën e shitjes ministrive përkatëse, kurse pastaj zbatohet i ashtuquajtur i programi konkurrues nga palët e interesuara ose ekspertët.

Një sistem i tillë, i mundësonte institucionit përkatës shtetëror, që të zgjidhte propozimin më të mirë për privatizimin e ndërmarrjes. Aksionet që nuk ishin në skemën e faturave mund t'i shiteshin drejtpërdrejtë blerësit të përzgjedhur, ose t'iu ofrohen qytetarëve në tregun e letrave me vlerë. Çdo ndërmarrje ishte e obliguar që të paraqes rezultatet financiare, numrin e punëtorëve, shpenzimet si dhe bilancin tregtar për periudhën 1989-1991.

Në fund të vitit 1996, vetëm disa ndërmarrje të mëdha, si: hekurudha, posta, kompanitë ajrore kombëtare, mbetën në pronësi shtetërore. Kompanitë e mëdha, së paku pjesërisht, u privatizuan.

Arsye kryesore pse qeveria u përcaktua për privatizim të shpejtë, ishte shpejtësia e këtij procesi, si dhe tejkalimi i problemit që konsistonte në mungesën e parasë. Kursimi në vete ishte mjaft i vogël, të ardhurat ishin mjaft të ulëta, dhe nuk mund të siguronin blerjen e ndërmarrjeve. Kështu, pasi që ishte fjala për privatizim masiv, shteti abstenoj nga të hyrat e shitjes³⁶

³⁶ S. KUSIC: Institucionalni i evolucijski aspekti privatizacije u srednjoj i istočnoj Europi Ekonomski Pregled, 58 (1-2) (2007) fq. 91-105.

Një model i tillë i shitjes përmes metodës së “voucher-ve”, u zbatua edhe në vende të tjera, si në Rusi, Bjellorusi, Ukrainë, Estoni, Lituani, Letoni, Armeni dhe në vendet e ish Bashkimit Sovjetik. Shitjen përmes fondeve investuese e pranoi Rusia (më 1991) dhe Polonia (më 1993).

Privatizimi në Poloni - Procesi i privatizimit në Poloni përfshin një varg teknikash dhe metodash të ndryshme. Në ligjin për privatizimin, të vitit 1991, i është dhënë fund një lloji të privatizimit spontan, marrjes së pasurisë shtetërore nga ana e të punësuarve. Qëllimi që konsiderohej se duhej përmbushur në bazë të ligjit, ishte që të krijohet sektori privat në lemën e shitjes së aksioneve, menaxherëve dhe të punësuarve, shitjen e mjeteve të ndërmarrjeve përmes likuidimit ose kombinimin e metodave të privatizimit.

Shitja e ndërmarrjeve kushtëzon shitjen e një pjese të rëndësishme të aksioneve jashtë institucionit të tregut financiar përmes licitacionit, shpalljeve publike, mbledhjes së ofertave ose nëpërmjet shitjes së drejtpërdrejt.

Shitja për menaxherët ose të punësuarit, do të realizohej nga përkrahja financiare e shtetit. Ligji i punës, të punësuarve iu siguron kushte të privileguara për blerjen e aksioneve, në vlerë prej 20 % me zbritje çmimi prej 50 %, me kusht që kjo zbritje e çmimit mos të tejkalojë pagën mesatare të tyre dymbëdhjetë mujore.

Oferta për blerje të aksioneve u jepet punëtorëve në afat prej dy muajsh nga dita kur aksionet ofrohen për shitje, sipas kushteve të përgjithshme. Të drejtën për aksione punëtorët mund ta realizojnë në afat prej një viti nga dita e shpalljes.

Megjithatë, metoda më e suksesshme e zbatuar në Poloni, përkitazi privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore, është ajo e *privatizimit përmes likuidimit*. Kjo metodë ngërthen mundësinë e shitjes ose lizingun, respektivisht marrjen me qira. E tëra filloi pas marrjes së vendimit për hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e Këshillit të Punëtorëve:

- a) e tërë pasuria e ndërmarrjes ose pjesët e saj, mund t'i shitet personit juridik apo fizik, a t'i jepet me qira kompanive të përbashkëta, të cilat i krijon shteti me partnerë vendor ose të jashtëm.

Shitja duhet të jetë publike, në bashkëpunim me ministrinë e financave, e cila mund të ofrojë lehtësi gjatë shitjes: 1. Pagesa e çmimit të një pjese me para të gatshme (jo më pak se 40 %) kurse pjesën tjetër në 16 anuitete për katër vite, me periudhë të mospagesës prej një viti. 2. Shuma e paguar me të gatshme paraqet vlerë, prej 1.25 herë më të madhe se sa pagesa sipas anuiteteve.

- b) Pasuria e ndërmarrjes mund të jepet me lizing, ose me qira posaçërisht për ndërmarrjen e re të formuar nga ana e të punësuarve (ndërmarrja e cila likuidohet). Kjo ndërmarrje e re duhet që të ketë kapital themeltar, së paku 20% nga vlera e ndërmarrjes në likuidim, kur shumica e të punësuarve duhet të jenë aksionarë të saj. Kontrata mes ndërmarrjes së re nënshkruhet për periudhë kohore 5 deri në 10 vjet, dhe mund të jetë në formë të qirasë.

Qiraja të ketë opsionin e blerjes së mëvonshme (lizing), ose qira pa opsion të blerjes së mëvonshme.

Programi i privatizimit masiv në Poloni është përgatitur me qëllim të përshpejtimit të procesit. Qëllimi ishte privatizimi i pjesshëm dhe i shpejtë të ca prej qindra ndërmarrjeve, me anë të shpërndarjes indirekte të aksioneve të tyre (të fondeve investuese) të gjithë qytetarëve të moshës madhore. Kështu 60% nga vlera e ndërmarrjeve shtetërore kalojnë në shoqëri aksionare, dhe kjo vlerë bartet te pronarët e rinj (fondet nacionale investuese), të cilët bëhen pronarë të këtyre aksioneve.

Shteti mban 30%, kurse të punësuarit marrin 10%. Fondet bëjnë ndarjen e certifikatave për të gjithë qytetarët që kanë mbi 18 vjet. Në këtë numër ishin të përfshirë mbi 28 milion qytetar.

Privatizimi në Bullgari - Modeli i privatizimit në Bullgari shpesh është quajtur edhe si “*koncepti Gjermanolindor në kushtet bullgare*”. Ky proces është rregulluar sipas Ligjit për Privatizimin, në prill të vitit 1992, i cili më 1991 ishte dërguar në kuvend (***drafti Michkovski***), që paraprakisht nuk ishte miratuar për shkak të përparësive që parashiheshin për të punësuarit, (çdo i punësuar do të kishte të drejtë deri në 49% të aksioneve të ndërmarrjes, i liruar deri në kuotën 50%).

Ligji parasheh rolin e centralizuar të Agjencionit të Privatizimit që financohet nga buxheti dhe qarkullon vetëm për shitje, si metodë e privatizimit.

Agjencioni është i detyruar që të përfshijë në planin vjetor, se cilat ndërmarrje do të privatizohen, që do t'i lejonte qeveria e pastaj do t'i dorëzoheshin kuvendit, së bashku me buxhetin për miratim. Për çdo ndërmarrje që arrin vlerën kontabël mbi 10 milion leva (valuta nacionale e Bullgarisë), duhet të paraprijë vlerësimi formal nga ana e ndonjë ndërmarrje të brendshme a të jashtme, përmes ekspertëve të tyre, të cilët kanë licencë për vlerësime të tilla.

Mënyrën e shitjes e zgjedh Agjencioni në pajtim me qeverinë për ndërmarrjet me mbi 200 milion leva. Metodatat e mundshme janë: ofertat e hapura publike, licitacioni publik i tufës së aksioneve, publikimi për grumbullimin e ofertave dhe, përmes marrëveshjeve direkt me blerësit potencial. Të gjitha këto ndërmarrje iu ofrojnë oferta preferenciale për shitje të punësuarve dhe pensionistëve: 20% të fletë-aksioneve me zbritje prej 50% (me vlerë në mes pagës prej 8-12 muajsh). Pronarët e këtyre fletë-aksioneve nuk kanë të drejtë të qeverisin ndërmarrjen për 3 vitet e ardhme.

Ndërmarrjet me vlerë kontabël nën 10 milion leva, nuk janë të detyruara që të zbatojnë vlerësimin formal; mirëpo janë të obliguara si metodë të shitjes të zgjidhnin atë të licitacionit publik, respektivisht atë të grumbullimit të ofertave. Nëse 30% të punësuarve deklarohen se janë për pjesëmarrje në shitje, dhe ata kanë përfaqësuesin e tyre, atëherë në licitacion çmimet ulen për 30%.

Pronësia e ndërmarrjeve që nuk janë transformuar në korporata kanë mundësi:

- a. të jepen me qira për 25 vjet me mundësi të blerjes më vonë;
- b. të jepen për qeverisje me opion të blerjes ose dhënies personave të tretë;
- c. të shiten me anuitete;
- d. po ashtu, shiten për vazhdimin e veprimtarisë së njëjtë, duke mbajtur numrin e punëtorëve, etj.

Në pajtim me ligjin, 25% e fletë-aksioneve të ndërmarrjes duhet të deponohet në fondin e përbashkët. Mjetet e këtij fondi orientohen sipas vendimit të Qeverisë në kapital, në fondin për sigurimin social, etj.

Një formë e tillë e privatizimit është mbështetje për konceptin e zbatuar nga ana e Gjermanisë Lindore. Por, përfundimisht nuk mund të thuhet se për kushtet e Bullgarisë pati ndonjë sukses të madh. Kështu, për shembull: nga 1000 ndërmarrje me vlerë kontabël, mbi 10 milion leva, gjatë vitit 1993, u privatizuan gjithsej vetëm 7 sosh.

Privatizimi në Maqedoni- Filozofia themelore e procesit të privatizimit në Maqedoni ka qenë i tillë, që të mos jetë proces vetëm për vete, por të jetë i mjet për rritjen e efikasitetit të ekonomisë, me anë të ndryshimit të raporteve pronësore, drejtë krijimit të tregut të kapitalit dhe qasjes në reforma, të cilat i kërkon bota e zhvilluar dhe demokratike.

Sipas Ligjit për Transformimin e Ndërmarrjeve Shoqërore, (gazeta zyrtare e Maqedonisë Nr. 38/93), i njohur si Ligji për Privatizimin, pritej që 1200 ndërmarrje do të privatizoheshin, nga të cilat: 113 ishin të mëdha, 274 të mesme dhe 830 të vogla, vlera e të cilave mendohej se do të jetë 3,3 miliard DEM.

Ky potencial përfaqësonte më tepër se gjysmën e aktives së ekonomisë maqedonase. Në vitin 1996, filloi privatizimi i sektorit të bujqësisë me 350 ndërmarrje. Në vitin 1997, shkalla e procesit të privatizimit u shtri në sektorin e sigurimeve dhe kompanive

të tjera, që përfshinte numrin prej 1600 ndërmarrjeve. Kështu, u arrit deri te transformimi i bankave. Numri i ndërmarrjeve që duhej privatizuar rritej në baza ditore.

Ngjashëm me shtetet e tjera të dala nga ish Jugosllavia, edhe në Maqedoni prona kryesore ishte prona shoqërore, pronë e gjithkujt dhe e askujt, (pasi nuk mund të shitej e as të transferohej). Pas vitit 1994, privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore në Maqedoni, duhej të bëhej sipas të metodave të përcaktuara nga Agjencioni i Privatizimit. Nëse ndërmarrja kishte filluar procesin e privatizimit para miratimit të Ligjit, atëherë ajo duhej të kërkonte rishqyrtim nga ana e Zyrës për të Ardhura Publike. Modelet e privatizimit ndryshonin varësisht nga madhësia e ndërmarrjes.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të propozonin modelet e privatizimit, ndërsa ato të mëdhatë duhej të zgjidhnin modelin, duke u këshilluar me Agjencinë.

Ndërmarrjet e vogla mund të privatizoheshin sipas modeleve :

1. shitja e ndërmarrjes punëtorëve. Punëtorëve iu jepej mundësia që të blejnë ndërmarrjen, në vlerë prej 51% të vlerësimit të saj. Pjesën e mbetur ata mund ta blenin për 5 vitet e ardhme, pa interes.
2. Vetëm të një pjese e ndërmarrjes me anë të bonove, që kanë karakterin e fletë aksioneve; pjesa tjetër mund të shitej me ofertë publike, ose në marrëveshje me blerësit potencial.

Ndërmarrjet e mesme mund të privatizoheshin:

1. shitja e ndërmarrjes në tërësi ose të pjesëve të saj, ngjashëm si te privatizimi i ndërmarrjeve të vogla.
2. Shitja e jashtme e pjesës së mbetur të ndërmarrjes, pasi 51% e saj të jetë është blerë nga punëtorët.
3. Shitja për menaxhmentin e ndërmarrjes në vlerë prej 20%.
4. Emetimi i aksioneve për investime shtesë. Kjo mundëson blerjen e 51% të aksioneve, për një periudhë kohore jo më të gjatë se 5 vjet.

5. Konvertimi i borxhit të cilin ndërmarrja e ka në pronarin e ri.

Ndërmarrjet e mëdha janë privatizuar ngjashëm me ato të mesme. Përpos këtyre modeleve janë përdorur dhe :

1. metoda e lizingut (qirasë) dhe mundësia e blerjes për një periudhë kohore, jo më të gjatë se 7 vjet.
2. Shitja e aseteve të ndërmarrjes përmes metodës së likuidimit vullnetar të ndërmarrjes.
3. Transformimi i ndërmarrjes sipas metodës së falimentimit.

Po të merren në përgjithësi, skema e procesit të privatizimit në Maqedoni është :

- 30% e vlerës së ndërmarrjes i ofrohet punëtorëve për blerje,
- 15% transferohet në Fondin Pensional në formë të aksioneve,
- 55% i ofrohet faktorit vendor ose të jashtëm.
- Punëtorëve i ofrohet në formë preferenciale me 30% ulje çmimi, me shtesë 1%, për çdo vit pune në ndërmarrje. Ata mund të blejnë fletë-aksione deri në vlerë prej 25,000 DEM, me anuitete për 5 vite për periudhë të lirimit të pagesës prej dy vitesh.

Shikuar realisht procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Maqedoni, filloi katër vjet para miratimit të Ligjit për Privatizimin, (Gazeta Zyrtare 84/89) që njihej si Ligji i Ante Markoviq (kryeministër i ish Jugosllavisë). Pas pavarësisë së Maqedonisë (më1991), ky ligj u shfuqizua dhe bëheshin përgatitjet e ligjit të ri, të cilin duhej ta miratonte Parlamenti i Maqedonisë.

Pas debatit dy vjeçar, në tetor të vitit 1993, u miratua Ligji për Themelimin e Agjencionit të Maqedonisë për transformimin e ndërmarrjeve me pronësi shoqërore, të përcjella me Ligjin për Investimet e Huaja, (Gazeta Zyrtare, 31/93), Ligjin për Koncesionin (G.Z. 42/93) dhe Ligjin për Letrat me Vlerë (G.Z.5/93).

Agjencioni i Privatizimit ishte Ndërmarrje Publike, që kishte karakter të institucionit qeveritar dhe financohej nga shitja e ndërmarrjeve.

Ky Agjencion ishte i menaxhuar nga një Bord drejtues, emëruar nga Qeveria. Po ashtu, ekziston dhe një Komision Qeveritar për privatizim, i përbërë nga ministra të Qeverisë që merr vendime përfundimtare përkitazi me procesin e privatizimit.

Institucion tjetër me rëndësi, paraqitet Zyra e të Ardhurave Publike, e cila e bën kontrollin e procesit të privatizimit, se a është në harmoni me ligjet aktuale.

Bankat paraqiten në pozitë jo të lakmueshme, dhe kërkohej një rehabilitim bankar, ngase së fundi ato ishin faktor kyç i procesit të privatizimit. Krijimi i fondeve investuese ishte domosdoshmëri.

Sidoqoftë, dhëna e mundësisë që punëtorët dhe menaxherët e ndërmarrjes të mund ta blejnë, i paraqiste ata në pozitë të favorshme. Mirëpo, shumica e ndërmarrjeve u privatizuan me pjesëmarrje nga jashtë. Në rast të mospagesës nga investitorët e brendshëm, (punëtorët dhe menaxhmenti), ligji lejonte përsëritjen e procedurës me një tjetër model të privatizimit. Kjo u bë pengesë për mbarëvajtjen e procesit të privatizimit. Në këtë mënyrë, kushtëzoi ndryshimin e tij, në vitin 1999. Kështu, u zbatua metoda e shitjes së drejtpërdrejt të investitorit strategjik, ose oferta publike e konkurrencës. E meta e kësaj metode ishte, sepse ajo menjëherë ngriti çështjen e transparencës dhe mundësive të korrupsionit. Kjo metodë u shfuqizua në vitin 2000, me miratimin e ligjit të ri për privatizim.

Shitja e kapitalit shoqëror ose shtetëror, u rregullua përmes bursave ose tenderimit publik. Maqedonia pothuaj ka përmbyllur procesin e privatizimit, larg efekteve të pritura nga ky proces.

Privatizimi në Shqipëri - Shqipëria e fillimit të viteve të 90-ta, kërkonte së pari tejkalimin e sistemit centralist dhe tejet jodemokratik, që për 40 vjet kishte sjellë ngecje dhe mjerim. Për tejkalim të situatës, para ekonomisë dhe pronës së Shqipërisë, u paraqit si domosdoshmëri aplikimi i reformave gjithëpërfshirëse, me qëllim të zënies së hapit drejtë një Evrope të bashkuar dhe demokratike. Procesi i reformës ekonomike filloi në korrik të vitit 1992, kur programi i qeverisë u mbështet nga marrëveshja "Stand By", me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Në gusht të 1991, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin për sanksionimin e mbrojtjen së pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit, që shërbyen si themele për fillimin e procesit të privatizimit dhe krijimin e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, e mbikëqyrur drejtpërdrejt nga Këshilli i Ministrave. Kjo agjenci ishte kompetente për drejtimin, organizimin dhe koordinimin e procesit të privatizimit.

Ky proces ka filluar me shpejtësi, për shkak të nevojës urgjente për të rritur efikasitetin e ekonomisë. Por, preokupimi i tepruar me shpejtësinë për realizimin e këtij procesi, dështoi në sferat e tjera që kanë të bëjnë me rregullsinë e tij. Keqpërdorimet në proces u vërejtën që në fillim, ngase rezultoi me një vendim të qeverisë të 25 prillit të vitit 1992 dhe për ndërprerjen e tij. Ndërprerja ka zgjatur vetëm dy muaj. Mirëpo, edhe pas vazhdimit, keqpërdorimet nuk kishin të ndalur. Edhe pse ANP-ja ka investuar me autoritet të drejtpërdrejtë për rregullsinë e procesit të privatizimit; ka pasur raste kur vendimet e veçanta të qeverisë janë marrë me përjashtimet, që nuk ishin në harmoni me rregullat e procesit. Më tej, në fund të muajit maj të vitit 1993, disa ndryshime janë bërë në skemën e privatizimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me anë të një vendimi qeveritar.

Në këtë vendim u përshkrua, se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duhet të privatizoheshin kryesisht përmes ankandeve, me përjashtim të rasteve të veçanta, si: privatizimi i një objekti nga një ish pronar, ose nëpërmjet personave të veçantë juridikë dhe fizikë. Kush ishin këta persona, dhe për çfarë arsyeje ata ishin të drejtë për këtë trajtim të veçantë? Përgjigja mbeti e paqartë. Gjithashtu, u vendos që dokumentet e objekteve të privatizuar, dhe gjithçka që konsiderohej privatizim, u provuan dhe u testuan vetëm për një vit. Pas një viti të sprovës testuese, nuk ishte e domosdoshme të mbaheshin këto dokumente, ngase në këtë mënyrë lejohej të shkatërroheshin, që do të thotë, se tashmë ka shumë pak prova dhe dëshmi të mbetura, që mund të shfaqen në të ardhmen, përkitazi abuzimeve të mundshme dhe korrupsionit...

Këshillat e privatizimit ishin të përbërë prej më shumë se 21 anëtarësh. Ata kishin shumë pak kontroll qendror; si të tillë u politizuan, ngase është fjala për zyrtarë të administratës qendrore... Këshillat qenë të pakualifikuar dhe të papërgatitur për këtë proces.

Objektivat kryesorë ishin:

1. stabiliteti makroekonomik, që synonte reduktimin e deficitit buxhetor, kontrollin e inflacionit dhe liberalizimin e çmimeve;
2. ristrukturimi i sektorit shtetëror nëpërmjet eliminimit të subvencioneve prej shtetit, nxitja dhe zhvillimi i konkurrencës së lirë, dhe riorganizimi i sektorit publik, përfshirë sistemin bankar;
3. privatizimi i ekonomisë, që u konceptua si një transferim i të drejtave nga sektori shtetëror në sektorin privat, duke synuar rritjen e standardit të jetesës nëpërmjet shmangies së jo efikasitetit të shtetit.

Sistemi ekonomik i Shqipërisë në çdo sektor të veprimit ishte në prag të falimentimit. Vetëm reforma ishte ajo që mund të ngjallte shpresa. Gjendja e rëndë në

këta sektorë kërkonte, ndërhyrje cilësore ristrukturuese, liberalizuese dhe çrregulluese, të shoqëruar më pas me atë privatizuese.

Ndërhyrjet për rikapitalizim kërkonin investime në vlera të mëdha të papërbalueshme, që kërkonin tërheqjen e kapitaleve të huaja ose vendase, private për të riaktivizuar dhe përdorur me efektivitet burimet natyrore dhe njerëzore të këtyre sektorëve.

Në procesin e transformimit ekonomik, që po pëson ende Shqipëria, privatizimi është konceptuar jo vetëm si ndryshim pronësie, por si një alternativë e re, që do të sigurojë funksionimin efektiv të veprimeve, të " lojtarëve të tregut " privatë a shtetërorë, dhe të garantojë konkurrencë reale midis tyre.

Ky proces shoqërohet me një kompleks problemesh, ndryshimesh dhe interesash politikë, sociale, makro dhe mikroekonomikë dhe ligjorë.

Synimi përfundimtar i qeverisë, nëpërmjet procesit të privatizimit, është realizimi i transferimit të drejtave shtetërore tek privatët, në të gjitha format e saj dhe nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm dhe eficient.

Në këtë kontekst, privatizimi është përkufizuar si transferim i tre lloje të drejtash nga shteti tek sektori privat:

- të drejtës së pronësisë;
- të drejtës së përdorimit;
- të drejtës së zhvillimit;

Nëpërmjet transferimit të drejtës së pronësisë (shitjes), shteti çlirohet nga të gjitha llojet e rrezikut, që lidhen me administrimin e ndërmarrjes a të shoqërisë, ndërsa nëpërmjet transferimit të së drejtës së përdorimit (kontratat e administrimit, shërbimit, etj.; shteti, përgjithësisht, mbetet i përfshirë në monitorimin e kushteve kontratore dhe të rrezikut financiar, nëse njësia ekonomike del me humbje.

Kontratat e koncesionit, të skemave BOT; BOOT; ROT dhe dhënia me qira, janë ndër mënyrat e përdorura gjatë privatizimit për transferimin njëkohësisht të drejtës së përdorimit dhe asaj të zhvillimit, të cilat përfshijnë ose jo shtetin në rrezikun financiar, në varësi të kontratave specifike. Në Shqipëri transferimi i të drejtës së pronësisë është përdorur gjerësisht në procesin e privatizimit, gjatë periudhës 1991-2000.

Strategjia e privatizimit ka synuar në objektivat kryesorë të mëposhtëm:

- përgatitje e shpejtë të procesit dhe tek të gjithë sektorët;
- rigjallërimi i ekonomisë me anë të përdorimit eficient të burimeve njerëzore dhe natyrore;
- garantimi i ritmeve të qëndrueshme për rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë;
- mbështetje dhe fuqizim i sektorit privat në aktivitetin e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve;
- tërheqje e investitorëve potencialë dhe strategjikë.

Metoda e privatizimit masiv, që u përdor në Shqipëri, u ngrit kryesisht në blerjet nga brenda (punëtor dhe drejtues) të ndërmarrjeve, dhe rezultoi në një strukturë mjaft të shpërndarë

pronësie. Punëtorët, ose ish-punëtorët janë të pranishëm në më shumë se 80 për qind të ndërmarrjeve të privatizuara, ndërkohë që mungoi plotësisht angazhimi i institucioneve financiare në këtë proces.

Mungesa e fondeve të investimit në këtë proces, që mund të angazhoheshin në emër të individëve të veçantë, për monitorimin e drejtimit dhe për të influencuar në procesin e vendimmarrjes, i privoi këta individë nga ky shërbim i specializuar. Kjo situatë e Shqipërisë u zhvillua krejt ndryshe nga ç'ndodhi në republikat Çeke e Sllovake dhe në Poloni.

Struktura e shpërndarë e pronësisë, që rezultoi nga kjo metodë, metoda e privatizimit masiv, që u përdor në Shqipëri, u përtrollit kryesisht në blerjet nga brenda (punëtorë dhe drejtues) të ndërmarrjeve, dhe solli deri te një strukturë mjaft e shpërndarë pronësie. Punëtorët dhe ish-punëtorët qenë të pranishëm në më shumë se 80 për qind të ndërmarrjeve të privatizuar, ndërsa mungoi plotësisht angazhimi i institucioneve financiare në këtë proces. Mungesa e fondeve të investimit në këtë proces, që mund të angazhoheshin në emër të individëve të veçantë për monitorimin e drejtimit, dhe për t'i dhënë kahe procesit të vendimmarrjes, i privoi këta individë nga ky shërbim i specializuar; e tëra solli situatën e Shqipërisë krejt ndryshe nga çfarë ndodhi në republikat Çeke e Sllovake dhe në Poloni. Struktura e shpërndarë e pronësisë, që rezultoi nga kjo metodë, solli si rezultat një sjellje pasive dhe mungesë motivimi nga ana e drejtuesve, për të ristrukturuar ndërmarrjet e tyre në periudhën e pas privatizimit. Rrjedhës së kësaj gjendjeje, shtrohet pyetja që përgjigjen e ka në retorikën e vet... çfarë do të jenë rezultatet e një sjelljeje të tillë pasive? Po ashtu, mungesa e motivimit nga ana e drejtuesve për të ristrukturuar ndërmarrjet e tyre në periudhën e pas privatizimit.

Procesi i privatizimit të pronës shoqërore në Shqipëri, ngjashëm me vendet e tjera të Ballkanit, u përshkua me jotransparencë (mos hapje) dhe dyshime të vazhdueshme, se edhe në këtë vend korrupsioni kishte shtrirë duart, ku më shumë e ku më pak.

As në mënyrë të përafërt, nuk u realizuan investimet nga jashtë krahasuar me të planifikuarat. Ato u ngufatën nga vendorët, shpesh me metoda jo të pastra. Andaj, as Qeveria Shqiptare nuk mundi të lavdërohej për një proces të rregullt, dhe pa pasoja makroekonomike të procesit të privatizimit.

2.6 Vështrime teorike te procesit të privatizimit në Kosovë

Procesi i privatizimit në Kosovë u proklamua zëshëm, që nga fillimi si proces, i cili do të sjellë mirëqenie dhe përparim ekonomik. Për shumë njerëz, madje edhe për ata me arsimim mesatar, kjo ishte një çështje e panjohur dhe, si rëndomë, e panjohura sjell frikë dhe dyshim. Procesi i privatizimit në Kosovë ndodhi në rrethana dhe kushte të veçanta. Për herë të parë u zbatua procesi i privatizimit në një vend, që në realitet nuk ishte shtet më vete.

Procesin e privatizimit duhet vështruar si një koncept mjaft të vështirë, si nga ana e vendosjes së kornizave të tija, ashtu dhe nga mënyra e implementimit. Qëllimi përfundimtar i tij duhet të jetë përcaktimi i titullarit të pronës, dhe krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik të përshpejtuar. Prandaj, privatizimi bëhet me qëllim të rritjes ekonomike, për shkak të reduktimit të ndërhyrjeve të qeverisë në ekonomi, në mënyrë që të pasurohet nisma private, të krijohen mundësitë e konkurrencës së lirë, rrjedhimisht dhe ekonomisë së tregut³⁷. Për këtë arsye dhe të tjera, konsiderohet se Ndërmarrjet Publike e, në rastin e Kosovës edhe ato Shoqërore, janë më pak të suksesshme, në formë të pronësisë të pa transformuar.

Kështu, Ndërmarrjet Shoqërore mund të vendosen në hierarkinë e performancës ekonomike, financiare, që radhiten nga shumë të mira deri tek shumë të këqija³⁸.

Ky proces në vete përfshin një mori rregullash dhe ligjesh, që nëse nuk janë të përcaktuara drejtë, mund të bëhen pengesë më vete për mbarëvajtjen e procesit të privatizimit.

Në vendet e periudhës kalimtare (tranzicionit), privatizimi kërkon përpjekje të dyfishta. Në njërën anë kemi ndikimin politik, kurse në anën tjetër, nivelin e pamjaftueshëm të zhvillimit ekonomik.

³⁷ Afërdita Dervishi-Berisha, Pas Privatizimi dhe performancat e ndërmarrjeve në Kosovë, Prishtinë, 2012, fq. 30

³⁸ Kikeri, Sunita, Nellis, Jon, Shirley, Marz, Privatization the lessons of Experience, A World Bank Publication, Washington DC, 1994

Në këto kushte, nuk mund të pritej ndonjë mrekulli, që procesi të kryhej shumë shpejtë dhe pa pasoja ekonomike.

Në këso rrethanash, shpesh kërkohen metoda të përshpejtuara, por pasojat e tyre të mëvonshme do të shfaqin influencën e tyre në aspektin makroekonomik. Kështu, arrihet deri te ngecja për tërheqje investimesh³⁹. Për këtë arsye të rëndësishme parësore janë rregulloret dhe zgjidhjet ligjore, si dhe stabiliteti makroekonomik i vendit. Pra, për privatizimin janë të rëndësishëm mjedisi i punës dhe infrastruktura politike e vendit.

Privatizimi i vendeve në tranzicion, shpesh ka ndodhur t'i ngjajë një revolucioni paqësor, por dhe të qytetëruar. Prandaj, jo rastësisht, ky proces është një nga çështjet më të mprehta të reformës ekonomike, megjithëse në vështrim të parë, nuk të lë këtë përshtypje. Dihet kaheerë se privatizimi mund të jetë një nga shkaqet themelore të tronditjeve sociale, ekonomike dhe politike, nëpër të cilat kalojnë këto vende⁴⁰

Një proces i suksesshëm i privatizimit domosdoshmërisht, duhet të ketë si objektiv përmirësimin e efikasitetit të ekonomisë vendore. Ajo mund të arrihet në disa mënyra⁴¹.

Së pari: kufizon ndërhyrjen e qeverisë në marrjen e vendimeve për zhvillim ekonomik.

Së dyti: udhëheqja (menaxhmenti) zgjeron shtytjet e veta për shkak të monitorimit më të mirë nga aksionarët ose punëtorët e ndërmarrjes së privatizuar.

Së treti: privatizimi e mëson ndërmarrjen për disiplinimin e tregjeve financiare.

Pas zbatimit të këtyre parimeve, ndërmarrja bëhet më efikase për prodhim. Sidoqoftë, privatizimi është efikas, atëherë kur ndikimi në nivelin makroekonomik është pozitiv dhe, kur e siguron nivelin makroekonomik, në formën që pronarët e rinj privat udhëheqin më mirë se sa pronarët e vjetër.

³⁹ Blaszezyk B, Hashi I, Woodward R, Secondary Privatization In Transition Economies, The Evolution of Enterprise Ownership in Czech Republic, Poland and Slovenia, Polgrave, 2003

⁴⁰ Mema Fatmir, Privatizimi në Shqipëri, Universiteti i Tiranës, 1997

⁴¹ Awadalla Sfwat A, Privatization with Economic Development: Study on the Effect of Privatization of the Economic Efficiency in Developing Countries: Egzpt BRILL, Arab Law Quarterly, Vol 18, Nr. 1, 2003 fq 30

Njësia e fundit federale nga vendet e ish Jugosllavisë dhe Evropës Jug Lindore, ishte Kosova që aplikoi procesin e privatizimit (**Isa Mulaj, 2006**). Pavarësisht modeleve të zbatuara në ato vende, privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore nuk ndoqi rrugën e njëjtë, për arsye se Kosova ishte problem më vete dhe specifik. Koloritet e procesit të privatizimit në Kosovë, nuk kishin vetëm ngjyrat bardh e zi.

Modelet e zbatuara të procesit të privatizimit nuk ishin çështje e panjohur për teoricienët dhe ekspertët tjerë kosovarë të kësaj fushe. Faktori ndërkombëtar i instaluar në Kosovë përmes misionit civil të UNMIK-ut, pas një periudhe prej katër vitesh, arriti në përfundimin se duhej qasur privatizimit të pronës shoqërore në Kosovë.

Vetë termi “**pronë shoqërore**” të UNMIK-u shkaktonte paqartësi. Ekspertët vendor provuan të japin kontributin e tyre (**M.Mustafa, N.Bashota, S.Selmani** etj), mirëpo ato rekomandime nuk u morën në konsideratë.

Veçantia e këtij procesi erdhi në shprehje që nga fillimi. Për herë të parë filloi privatizimi i pronës, e cila nuk ishte as pronë shtetërore, as private.

Për herë të parë filloi procesi i privatizimit në një vend, që nuk ishte shtet më vete. Po ashtu, për herë të parë u zgjodh modeli i privatizimit, që ishte përzierje e modeleve të mëhershme të zbatuara në vendet e tjera, por si i tillë karakterizohej me veçori të veta.

Gjatë eksperimenteve, që në rastin e Kosovës është fjala për një eksperimentim, gabimet ishin të paevitueshme. Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, **Isa Tahiri** (2012) theksoi: “ ... është dashur të bëhet një privatizim i ndërmarrjeve shoqërore, por jo i formës së tillë siç ka ndodhur deri tani... dy gabime të mëdha janë bërë në Kosovë; së pari privatizimi joreal, pasi është dashur të jepet një vlerë e caktuar për të shitur një pasuri të patundshme të Kosovës, p.sh, nëse shitet një tokë, duhet të jepet vlera e caktuar, që nën kuadrin e asaj nuk bën të jepet. E dyta, të mblidhen të gjitha mjetet financiare të grumbulluara nga privatizimi dhe të ndahen në mënyrë të njëjtë, për të gjithë ata që kanë punuar”.

Asgjë nga ato që propozon profesor Tahiri nuk u realizua. Së pari kjo ka të bëjë me një mënyrë të privatizimit e cila u paraqit si e veçantë dhe nuk kishte elemente të kopjes së privatizimit nga vendet e tjera. Kështu në shumë vende të Evropës privatizimi u përcoll me krijimin e ndonjë institucioni i cili do të mirrej me përcaktimin e vlerës së pasurisë. Pastaj kjo vlerë do të shërbente si orjentuese për realizim të shitjes.

Arian Zeka (nga Oda Ekonomike Amerikane, 2013) nënvizoi; “...Nëse ndalemi të analizojmë si ka shkuar procesi në fillim, atëherë ka pasur jashtëzakonisht të meta me mungesë të madhe të legjislacionit, natyrisht edhe me obstrukcionet e ndryshme politike nga ata, të cilët në atë kohë e kanë drejtuar procesin që ka qenë shtylla e IV e UNMIK-ut, në kuadër të së cilës ka funksionuar edhe Agjencia e Mirëbesimit.”

Procesin e privatizimit nuk e përzgjedhën kosovarët. Një prej elementeve të veçantisë është edhe ndërkombtarizimi i procesit. Ndonëse ka mundur që të metat të ishin më të pakta ato kosovarët nuk patën kompetencë që ti evitojnë.

Hasan Abazi (2013) nga Sindikata e Industrialistëve thotë, se: të gjitha shtetet, që kanë provuar procesin e privatizimit, kanë kaluar më mirë se Kosova. “Përvojat e këtyre shteteve nuk kanë hyrë në Kosovë, në veçanti e Sllovenisë si proces i suksesshëm nuk është aplikuar te ne. Këtu, në Kosovë, privatizimi ka shkuar në favor të njerëzve në pushtet. Nëse në vendet e rajonit procesi i privatizimit ka ndikuar në zhvillim ekonomik dhe zbutje të papunësisë, në Kosovë ka ndodhur e kundërta”.

Kompetencat e sindikatave të punëtorëve gjatë procesit të privatizimit ishin ngushtuar vetëm në përpilimin e listave për ata që do të ju takonte 20% e vlerës shitëse të ndërmarrjes. Për qështje të tjera askush nuk i pyeti asgjë.

Ata u përjashtuan nga puna dhe nga procesi. Amullinë e situatës e shtoi edhe mungesa e strategjisë se për sa kohë do të zgjatë procesi i privatizimit dhe cilat do të jenë efektet.

Pritjet e mëdha të kosovarëve, se procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore do të sjellë zhvillim ekonomik dhe zbutje të gjendjes së vështirë ekonomike, nuk janë realizuar (**Luljeta Krasniqi 2010**) “...analistë të çështjeve ekonomike dhe përfaqësues të biznesit në Kosovë, thonë se arsyeja themelore e mosrealizimit të këtyre pritjeve, ka qenë mungesa e investitorëve të huaj në këtë proces. Sidoqoftë, përfaqësues të institucionit që bëjnë privatizimin, këtë proces e konsiderojnë mjaft të efektshëm”.

Investitorët e huaj provuan të investojnë në Kosovë gjatë procesit të privatizimit. Në mungesë të sigurisë dhe ligjmerisë, me të shpejtë u tërhoqën. Në ato pak blerje që u bënë nga investitorët e huaj, si rezultat i rezistencës të faktorëve të shtetit dhe pushtetit, të pakta ishin rastet e afarizmit pozitiv.

Lekë Musa (2010) thotë se ky ambient jo i mirë ka bërë që të mungojnë rezultatet e privatizimit. “Privatizimi në Kosovë - mungojnë rezultatet për shkak të investimeve nga jashtë. Nuk mund ta quaj të pasuksesshëm, pasi që disa ndërmarrje janë transferuar - kanë kaluar në sektor privat, aty kemi investime. Po ashtu, është rritur numri i të punësuarve në këto ndërmarrje, është rritur efikasiteti dhe efekti në ekonomi tani vërehet”.

Fillimi i privatizimit ishte inkurajues edhe për investitorët nga jashtë. Mirëpo me kalimin e kohës me përjashtime të vogla investimet e tyre nuk patën sukses.

Ndërsa, përfaqësues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, këtë proces të shitjes së ndërmarrjeve shoqërore, të filluar që nga viti 2002 e quajnë të suksesshëm dhe mjaft sfidues.

Dino Asanaj, (ish udhëheqës i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit), shpjegoi: *“Natyrisht se gjatë kësaj periudhe kemi hasur edhe në sfida dhe ngecje, të cilat janë të paevitueshme, por ne mbetemi të përkushtuar në qëllimet e agjencisë që të vazhdojmë t’i evitojmë pengesat dhe të kontribuojmë në forcimin e ekonomisë kosovare”*.

Deri sa në kohën e AKM “faji” për mosuksese të privatizimit mund ti lihej faktorit ndërkombëtar, në qeverisjen e faktorit vendor të procesit të privatizimit përmes AKP-së faji mbetet te vendorët. Dino Asanaj ishte kryesues i bordit të AKP-së.

Të pakët janë njerëzit në Kosovë që mundën ti besojnë fjalëve të tij, përpos stafit të ngushtë me të cilët punonte.

Agjencia e konsideron procesin e privatizimit një sukses, por profesor **Musa Limani** (2013), vëren se procesi ka kontribuar në përkeqësimin e ekonomisë së Kosovës. *“Ndërmarrjet në pronësi shoqërore që përbënin 90% të industrisë e ekonomisë së Kosovës, u shitën shumë lirë e gjithashtu humbëm tregje, shitja e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore në Kosovë (ka mbledhur) vetëm 600 milionë euro... fabrika e duhanit në Nish, Serbi, u shit për mbi 500 milionë euro...procesi i privatizimit është plot me korrupsion e shpërdorime dhe mungesa e një ligji mbi privatizimin është një mangësi kritike. Privatizimi në Kosovë u bë pa një infrastrukturë gjyqësore, ajo po shfaq probleme tani me pronën e pronësinë.”*

Këshillimet të cilat mund të merreshin nga truri shkencor, nëse AKM nuk e bëri, atëherë AKP-në nuk e pengoi asgjë. Edhe pse ekzistonte gatishmëria e njerëzve në zë nga sfera e ekonomisë dhe drejtësisë që të kontribuonin në procesin e privatizimit, mirëpo për ata nuk pati vend. Në AKP vendin e tyre e nxënë njerëz të pakualifikuar dhe të pa ditur.

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, vazhdimisht e kishte kundërshtuar procesin.

Hasan Abazi, kryetar i Sindikatave të Industrisë të Kosovës (2013), thotë se procesi i privatizimit të ndërmarrjeve, si shoqërore, ashtu dhe publike, nuk ka qenë i drejtuar drejt krijimit të vendeve të punës, por më shumë drejt mbledhjes së mjeteve të privatizimit, që, sipas tij, ka qenë shkak kryesor që ka ndikuar negativisht në këtë proces. *“Kemi pritur që me privatizim do të vinte një rimëkëmbje e ekonomisë, por për fat të keq këto ëndrra të shoqërisë kosovare nuk u bënë realitet dhe privatizimi, i cili ishte bërë, si nga AKM-ja, ashtu edhe nga AKP-ja, ka dështuar dhe është degraduar komplet ekonomia e Kosovës, si nga ana e punësimit, si nga rritja e kapaciteteve ekonomike... të gjitha shtetet, të cilat kanë kaluar në këtë proces të privatizimit, kanë kaluar më mirë se Kosova”*

Në pozitën më të vështirë ishin punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara. Ata fillimisht u zhveshën nga prona dhe një pjesë e tyre u dashtë të jenë të kënaqur me 20% të vlerës së ndërmarrjes së shitur edhe pse e tëra ishte rezultat i punës së tyre.

Me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, u mendua se do të krijohen vende të reja pune të qëndrueshme.

Mirëpo, sipas kryetarit të sindikalistëve kosovarë, **Haxhi Arifi (2013)**, ndodhi e kundërta. *“Me këtë tranzicion dhe me këtë privatizim që po ndodh në Kosovë, po krijohet një gjendje alarmante, sepse vetëm është shtuar numri i të papunëve, punëtorët të cilët mbesin pa punë nuk kanë kurrfarë mbështetjeje, punëtori ka punuar me vite të tëra, ndërsa tash nga ndërmarrja që privatizohet e merr një 20 përqindësh, që punëtorëve nuk u garanton as kafshatën e gojës”*

Profesori universitar, **Muhamet Kelmendi**, thotë se të tillët, përfituesit e inkriminuar në procesin e privatizimit në Kosovë, por edhe të tjerët, nuk dalin para drejtësisë dhe nuk dënohen sepse shteti gjendet dhe funksionon vetëm për grupet ekonomiko-politike mafioze, si të nivelit qendror dhe lokal. *“Këto grupe janë ulur në ballë të shtetit dhe po dirigjojnë me shtetin. Ata e kanë kapur pasurinë e tundshme dhe të patundshme dhe për të privatizuar ato e kanë vendosur kontrollin mbi policinë, mbi prokurorinë dhe mbi gjykatat. Tërë këta mekanizma veprojnë nën dirigjimin e këtyre oligarkëve ekonomiko-politikë, andaj nuk kemi ndjekje dhe as përgjegjësi penale për vjedhjet e bëra... dihet ashikare se nuk ka mundësi që asnjë politikan dhe oligark mafioz ta arsyetojë me fakte pasurinë e krijuar. Shiko pasurinë e zyrtarëve, nga që presidenti, deputetët e Kuvendit dhe nga ministrat, prokurorët dhe gjykatat dhe domosdo del se kemi krim në përmasa të gjëra. Çdo njeri nga ata që gjoja se jeton me të ardhurat e veta kanë shtëpi, banesë e makina, rroba të shtrenjta, orë e telefona të mirë, që as me të ardhurat deri në 2 mijë euro nuk mund ta mbulojnë një luks të tillë. Pra, kemi vjedhje të kalibrit mafioz”⁴²*

Profesori i së drejtës, **Riza Smaka**, thotë se gjatë procesit të privatizimit të aseteve shoqërore në vendin tonë janë praktikuar metoda abuzive e korruptive në dëmin e interesave shoqërore, në dëmin e qytetarëve dhe të shtetit! *“Gjatë privatizimit të aseteve publike, kryesisht janë investuar para të pista në një anë dhe padrejtësisht dhe jo moralisht janë përvetësuar pasuri marramendëse me vlera të larta nga oligarkë të pasuruar në rrjedhat e mënyrat dubioze. Gjatë privatizimit, qëllimisht janë bërë kontrata të mangëta, nebuloze dhe problematike. Në rastet më të shpeshta, as kontratat e tilla nuk përfillen, ta zëmë referuar aktivitetit biznesor të mëparshëm që ishte*

⁴² Gazeta “Kosova Sot” dt. 10.02.2017

prodhimtar e në vijim hotelier apo në lokale zbavitëse. Me dhjetëra e dhjetëra punëtorë me vlera profesionale e praktike kanë mbetur jashtë pune, në vend që privatizuesit t'i përparonin asetet e privatizuara e në to të zhvillonin aktivitete produktive ata e ato e bëjnë të kundërtën", ka pohuar Smaka. Sipas tij, privatizimi i shumicës së tyre është bërë vetëm sa për formë dhe jo në vlerën reale."Pasi privatizuesit më të mëdhenj e më të shumtë janë persona të pasuruar në rrethana dubioze e abuzive dhe të njëjtë kryesisht ndodhen në pozita pushtetare influente, ose në biznese problematike që i financojnë pushtetarët e tillë, as procesi i një vlerësimi analitik e kritik i privatizimeve abuzive, së paku në rrethanat aktuale, vështirë se mund të pritët!"⁴³

Pa rregullsitë gjatë procesit të privatizimit në Kosovë dhe përfitimet e pa ligjshme, do të ofrojnë shumë punë për gjykata. Një gjë e tillë për zbardhjen e asaj se çka ndodhi me procesin e privatizimit do të mund të realizohej vetëm me presionin dhe kushtëzimin e bashkësisë ndërkombëtare për luftimin e korrupsionit dhe hulumtimin e pasurisë së krijuar. Kjo kohëve të fundit (2017) ka filluar edhe të jep rezultate (padia dhe arrestimi i Azem Sylës një nga komandantët e UÇK-së) . Mirëpo këta janë vetëm hapa fillestar.

Që të jetë ironia të jetë më e madhe, zëdhënësja e Prokurorisë së Shtetit, **Liridonë Kozmaqi-Hajdaraj** dëshmon se si ligji mund të shtrihet dhe të tkurret kur janë në pyetje oligarkët e pushtetit : *"..Prokuroria nuk merret me perceptime apo paragjykime për të deklaruar se po hetohen ose jo mjaftueshëm persona të caktuar, por është institucion i pavarur, kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Ky institucion ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme, duke siguruar trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime për të gjithë personat, pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, apo lidhjeve politike, besimeve fetare, apo pozitës shoqërore, andaj sa herë ofrohen prova të mjaftueshme se është kryer një vepër penale, pa marrë parasysh se nga kush, Prokuroria vepron dhe do të veprojë në përputhje me kompetencat që ka", tha për* "⁴⁴

Për një kohë, teoricienët e çështjeve që kanë të bëjnë me privatizimin, do të kenë punë

të mjaftueshme, të sqarojnë se modelet e privatizimit të zbatuara në Kosovë, për sa i kontribuan projektit të tranzicionit në tërësi, efekteve për ndërtimin e strukturës së përshtatshme zhvillimore ekonomike, efektet makroekonomike, etj.

Modeli i procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, deri tash, nuk i përmbushi të priturat e popullatës së Kosovës.

⁴³ Po aty

⁴⁴ Po aty

3 KREU III – Historiku- Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore Rast studimi Zyra Rajonale Gjilan

3.1 Modelet e transformimit të pronës, krahasimet, mundësitë dhe përvojat nga vendet tjera për zbatimin e procesit të privatizimit në rastin e Kosovës

Modelet e zbatuara të procesit të privatizimit në Kosovë nuk janë të njëjta, as për nga forma e përmbajtja, krahasuar me ato të zbatuara (aplikuara) në vendet e tjera. Të gjitha modelet e zbatuara në vendet e EJT, u krijuan në kushte të cilat qenësisht dallojnë nga ato që u zbatuan në Kosovë. E përbashkëta këtyre shteteve është se ato shërbejnë për transformimin e pronës nga ajo shtetërore (në rastin e Kosovës prona është shoqërore), në pronë private, që shërben si pikënisje drejt orientimit të rrjedhave bashkëkohore dhe demokratike.

Modelet e procesit të privatizimit paraqesin themelin drejt transferimit të pronës. Ky proces më pas do të ndikojë në strukturën e përgjithshme ekonomike dhe politike të vendit. Deri sa vendet tjera të EJT ishin në përfundim të procesit të privatizimit, ai në Kosovë ende nuk kishte filluar. Misioni Civil i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i quajtur UNMIK, i instaluar në Kosovë pas vitit 1999, përmes Departamentit për Tregti dhe Industri , në kuadër të shtyllës së katërt, që nga nisja e tij filloi hulumtimin e modeleve të aplikueshme të procesit të privatizimit.

Pas katër vitesh vonesë (më2003), përpjekjet filluan të japin rezultatet e para. Modelet e mëhershme, të cilat ishin të aplikueshme në shtetet e ish Jugosllavisë, tashmë u bënë të pa zbatueshëm.

Ngjashëm u mendua, se edhe modelet e zbatuara në vendet e EJT janë të pa zbatueshme në rastin e Kosovës. Kështu, modeli i vauçerëve nuk mund të aplikohet, shkaku i mungesës së statusit juridik të Kosovës. Po ashtu, mendohej se ky model më vonë mund të nxjerr në shesh probleme të shumta.

Për këtë arsye kërkoheshin modele të tjera, që do t'i përgjigjeshin specifikave(veçantive) të Kosovës. Çështje e re doli se privatizimit duhej qasur nga dy aspekte:

1. të shiten ndërmarrjet, kryesisht aktivi i tyre, derisa më vonë, përmes procesit të likuidimit të përmbillen kërkesat ndaj ndërmarrjes;
2. pasuria në formë të tokës të jepet me qira për periudhën kohore prej 99 vitesh. Kjo do të ndodh si pasojë e problemeve përkitazi dokumentacionit kadastral, sepse ai në masë të madhe ishte i dëmtuar ose ndodhej jashtë Kosovës.

UNMIK përmes AKM (Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit), procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, filloi ta realizojë përmes tri modeleve :

1. modeli i spin-off të rregullt
2. modeli i spin-off special dhe
3. modeli i shitjes përmes likuidimit.

Modeli i spin-off të rregullt- Rregullat e tenderimit për spin-off të rregullt, (i ashtuquajtur mbyllje e ciklit), ka të bëjë vetëm me shitje të aktivitetit të ndërmarrjes. Në kuadër të ndërmarrjes ekzistuese formohet ndërmarrja e re, kurse detyrimet mbeten në ndërmarrjen e vjetër, në të cilën pastaj do të zbatohet procesi i likuidimit.

Mjetet e grumbulluara nga shitja do të barten në fondin e posaçëm, i kontrolluar nga AKM, që i shërben përmbushjes së detyrimeve kreditorëve, pronarëve dhe punëtorëve.

Përmes këtij modeli, nga ndërmarrja e vjetër mund të formohen më shumë ndërmarrje të reja. Kjo ka kuptim, që së pari të merren pjesët e shëndosha dhe më pak problematike të ndërmarrjes, kurse pjesët tjera mund të shiten përmes metodës së likuidimit. Mjetet e grumbulluara me rastin e shitjes do të ndahen në proporcion : 20% do t'iu takojnë punëtorëve, kurse 80% do të mbeten në Fondin e Mirëbesimit, i cili do të shërbejë për përmbushjen e detyrimeve që janë krijuar gjatë punës së ndërmarrjes së vjetër.

Përpos një numri të vogël të detyrimeve (tatimi në pronë për 12 muajt e fundit, pagesa e shërbimeve publike për 3 muajt e fundit) , pronari i ri i ndërmarrjes së privatizuar, do të lirohet nga të gjitha detyrimet që i ka pasur ndërmarrja paraprake.

Modeli i spin-off special - Përmes këtij modeli vlejnë të gjitha rregullat e tenderimit, sikurse përmes spin-off-it të rregullt. Dallimi në këtë lloj spin-off-i qëndron në paraqitjen e disa kufizimeve për pronarin e ri. Përmes këtij modeli, pronari i ri duhet të përmbush disa detyrime, që rrjedhin nga tenderimi, si:

- çmimi më i lartë i tenderuar;
- investimet që do të kryhen gjatë periudhës së përcaktuar kohore;
- të mbahen në punë numri i punëtorëve ekzistues, dhe të bëjë punësime të reja gjatë periudhës së përcaktuar.

Modeli i shitjes përmes likuidimit- Një model i tillë gjen zbatim te ndërmarrjet e vogla dhe kryesisht te ato, që pjesa kryesore e pasurisë së ndërmarrjes është shitur më herët, kurse pjesët më të vogla shiten përmes këtij modeli. Me rastin e hyrjes së ndërmarrjes në likuidim nuk ekziston më menaxhmenti i saj, dhe nuk zhvillohet veprimtari në atë ndërmarrje .

Misioni i UNMIK-ut, si përgjegjës për organizimin e jetës civile në Kosovë, përkundër vonesave të shumta për fillimin e procesit të privatizimit, një nga gabimet fillestare bëri që nuk u konsultua fare me faktorin vendor përkitazi me përdorimin e metodave të aplikueshme dhe të mundshme, të cilat do të ishin të përshtatshme për Kosovën. Në fillim të procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, (**Muhamet Mustafa, 2001**) faktori vendor rekomandoi se politika e privatizimit duhet të jetë në funksion të:

- konsolidimit makro-ekonomik, zhvillimor dhe inovativ të ekonomisë;
- nxitjes së aktiviteteve ekonomike sipas resurseve të tregut dhe rritja e efikasitetit të ndërmarrjes;

- ndërtimi dhe rrumbullakimi i institucioneve të ekonomisë së tregut;
- eliminimi i pasojave nga aplikimi i administrimit të dhunshëm prej pushtetit të instaluar;
- ndërtimi i një strukture pronësore kompatible me vendet me ekonomi të tregut;
- nxitjes së investimeve private në NMV (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), sidomos të investimeve drekte nga jashtë;
- mobilizimi i kursimeve dhe potencialeve të diasporës, investimeve dhe rritjes së të hyrave buxhetore.

Këto dhe shumë rekomandime të tjera, në rastin e Kosovës nuk u përfillën. Proklamata e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe e Bankës Botërore, të rënies së sistemit komunist në vendet e EJT, gjatë viteve 1989-90, ishte “ **Stabilizimi, liberalizimi, privatizimi** “⁴⁵. Ky ishte një sinjal, që këto shtete duhej të respektonin këto tri urdhëresa, por me ndryshime qenësore si në aspekt të kohës, po ashtu edhe në pikëpamje të gjetjes së metodave dhe zbatimit të tyre. Në rastin e Kosovës nuk erdhi në shprehje asnjë nga metodat e njohura më herët. Emërues i përbashkët i të gjitha këtyre vendeve ishte privatizimi masiv. Kjo kishte të bënte me bartjen e pronës shtetërore në atë private.

Të gjitha modelet e zbatuara mund të sistemohen në dy kategori:

1. modeli i privatizimit të shpejtë përmes konceptit të “ **shok terapisë**”;
2. modeli i privatizimit gradual “**shkallë- shkallë** “ (**step by step**);

Modeli i parë ishte karakteristikë e shumicës së vendeve me gjendje kalimtare të ekonomisë dhe të pronës në. Ky model kishte përkrahjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar, që ndihmonte për arritjen e rezultateve të shpejta. Ky model u zbatua në Poloni e në Rusi gjatë etapës së parë të privatizimit, (reformat Gajdar), në ish Jugosllavi (reformat e Ante Markoviq), pastaj në Bullgari, në Rumani, në Shqipëri, etj.

⁴⁵ Anna Canning and Paul Hare, Political Economy of Privatization in Hungary: A Progress Report , Department of Economics, Heriot-Watt University, Riccarton, Edinburgh 1996 fq. 3

Ishte e qartë se një model i tillë i privatizimit mund të sillte rezultate të shpejta, mirëpo barte në vete riskun në aspektin makroekonomik.

Pas privatizimit mund të pritej mungesa e parasë dhe investimet në projekte kapitale, çështje e cila mund të ndikonte në normalizimin e rrjedhave ekonomike. Tash, kur shumica e vendeve të cilat e kanë zbatuar këtë model, mund të arrihet në konstatimin, se shikuar nga pikëpamja e efikasitetit, nuk u arritën rezultatet e pritshme. Kjo ndodhi, ngase ky proces u shndërrua nga procesi i privatizimit në proces për privatizim.

Kështu i mundësoi një elite të caktuar të njerëzve në pushtet, përmes partisë ose pushtetit që gëzonin, në emër të privatizimit të uzurpojnë, plaçkitin dhe të keqpërdorin një pjesë bukur të madhe të pasurisë shtetërore, përmes korrupsionit dhe formave tjera jashtë ligjore të përvetësimit.⁴⁶

Modeli gradual i privatizimit “*step by step*” u zbatua në pak vende në tranzicion. Përkundër të metave që ka, ky model u tregua me efikasitet më të lartë se ai paraprak. Modeli ka këto përparësi⁴⁷ :

1. nëpërmjet këtij modeli paraqitet efikasiteti ekonomik dhe aftësia e ekonomisë nacionale, me qëllim të bashkëngjitjes (inkorporimit) të saj në tregun botëror; ndryshimi i institucionit të tregut dhe aplikimi i vlerave të reja sistemore, duhet të jenë graduale;
2. nuk mohon ekzistimin e pronës publike a shtetërore që janë me interes vital si: elektro energjetika, telekomunikacioni, infrastruktura, etj.

Në disa vende ku ekzistonin mundësitë, është zbatuar kombinimi i të dy modeleve, mirëpo çdo herë duke i dhënë përparësi modelit të parë.

⁴⁶ Musa Limani, Makroekonomia Aplikative, Prishtinë 2003, fq 72-77

⁴⁷ Nuri Bashiota, Ekonomia Politike, Prishtinë, 1998 fq. 473

Modeli intern (i brendshëm)- Paraqitet në rastet kur punëtorët e punësuar dhe menaxherët e blejnë ndërmarrjen , përmes aksioneve të brendshme , me a pa kompensim. Përkitazi këtij modeli të rëndësishëm janë :

- modeli i re kapitalizmit dhe,
- modeli i etatizimit të pasurisë shoqërore (vendet e ish Jugosllavisë) si parakusht për procesin e transformimit.

Në shumicën e vendeve post socialiste, me qëllim të motivimit të punëtorëve për privatizim sa më të suksesshëm, është zbatuar modeli interno(i brendshëm) i privatizimit. Ky model realizohet në mënyrën e shitjes së aksioneve, dhënie e aksioneve pa kompensim, emetimin si aksione interne.

Përmes aksioneve interne , blerës potencial së pari janë punëtorët ose, ata që kanë punuar më herët, pensionistët, fondet e ndryshme dhe personat fizikë. Karakteristikat e këtij modeli janë:

- emetimi i aksioneve bëhet në bazë të masës së kapitalit shoqëror ose shtetëror;
- aksionet interne mund të jenë në pronësi të personave fizikë a juridikë;
- këto aksione mund të plasohen me çmime më të zbritura;

aksionet mund të jenë në emër të blerësit dhe lehtë mund të barten në persona të tjerë fizikë a juridikë;

aksionet mund të paguhen menjëherë ose në periudhën e përcaktuar kohore, në shumicën e rasteve deri në 10 vjet;

- ndikimi i personave juridikë është i vogël;
- pronarit të aksioneve i jepet e drejta e qeverisjes së ndërmarrjes varësisht nga numri i aksioneve që posedon.

Përparësitë e këtij modeli gjejnë shprehje në :

- privatizimin e pronës përmes modelit të aksioneve interne, që mundëson mobilizimin e kapitalit suplementar;

- eliminimin e shpejtë të një pjese të kapitalit shtetëror-shoqëror;
- motivimin pronësor të punëtorëve të punësuar;
- motivimin për akumulim dhe transaksionet inerte me aksione, si dhe përmirësimin e drejtimit të ndërmarrjeve;
- kontrolli i ndërmarrjes bartet nga faktori politik në atë pronarëve të brendshëm.

Të metat e këtij modeli konsistojnë :

- nuk zbatohet në masë të duhur kriteri i së drejtës. Vjen deri te prishja e baraspeshës, shpërndarjes së të drejtave në participim gjatë blerjes së aksioneve nga ana e blerësve potencial, të cilët iu përkasin kategorive të tjera sociologjike;
- menaxherët mund ta favorizojnë veten;
- mund të vijë deri te zvogëlimi i çmimeve të aksioneve krahasuar me atë që do të mund të ishte në tregjet financiare;

Përkundër të metave, kjo metodë ka gjetur zbatim në shumë vende në tranzicion, madje është paraqitur si mjaft efikase.

Metoda e shpërndarjes së aksioneve pa kompensim punëtorëve dhe pensionistëve të ndërmarrjes - Ky model si i tillë është zbatuar në vendet post socialiste. Modelin e këtillë e karakterizoi rezultati diskriminues, sepse përjashtoi grupe të caktuara sociologjike nga pjesëmarrja në privatizim, edhe pse ato kanë kontribuar në punën e ndërmarrjes. Gjatë shpërndarjes së aksioneve grupet përjashtohen prej procesit.

Metoda e fragmentimit, zbatohet kur shtrohet çështja e privatizimit të ndonjë ndërmarrjeje të madhe ose pjesëve të saj. Fragmentimi e mundëson privatizimin gradual të pjesëve të ndërmarrjes.

Modeli i privatizimit ekstern (i jashtëm) shërbehet me një varg metodash, përmes të cilave zbatohet shitja e aksioneve a shpërndarja e tyre në popullatën e tërësishme, ose grupimit të caktuar. Metodat që zbatohen mbi këtë model janë :

- **regjistrimi publik i aksioneve:** sipas kësaj metode shteti ofron aksione që e mbulojnë pasurinë e ndërmarrjes ose një pjese të saj. Çmimin e aksioneve mund ta përcaktojë shteti ose ankandet;
 - **shitja private e aksioneve:** në kuadër të kësaj metode ekzistojnë dy qasje: a) ankandet me pjesëmarrës të cilët të tashmë janë të njohur, b) biseda me investitorë potencial përmes procedurës sipas rastit (ad-hok). Kjo metodë është mjaft e paqëndrueshme (fleksibile), dhe i mundëson shtetit e pronarëve të mundshëm kontraktimet e veprimeve plotësuese, që kanë rëndësi për të ardhmen e ndërmarrjes;
 - **shitja e mjeteve të ndërmarrjes shtetërore-** paraqet metodë përmes së cilës ndërmarrja shtetërore ka mundësi, që të shes vetëm një pjesë të saj, kurse për pjesën tjetër i mundësohet që të mbajë statusin paraprak.
- Kjo shitje nuk mund të zbatohet përmes shitjes publike ose private të aksioneve, mirëpo blerësit potencial bëjnë kontraktimin e drejtpërdrejtë me organet përgjegjëse shtetërore.

Huazimet dhe kontratat për menaxhimin

Kjo metodë ka më tepër karakterin e komercializimit (marrjes me qira) të ndërmarrjes ose të një pjese të saj.

Shitja eksterne investitorëve të jashtëm

- Institucione të ndryshme të cilat janë jashtë ndërmarrjes, mund të paraqiten si blerës potencial si: bankat, fondet e ndryshme, shoqatat e sigurimit, etj, të cilat kanë karakter të institucioneve shtetërore. Kjo formë e privatizimit

është karakteristikë e vendeve të zhvilluara me orientim të tregut (Franca, Italia, Britania e Madhe, etj).

Metoda e privatizimit të pronës përmes korporatave holding - Sipas kësaj metode aksionet e një ndërmarrje shtetërore i shiten ndonjë holding korporate. Në këtë rast, aksionet mund t'i shiten korporatës a popullit pa kompensim, kurse qeverisja i mbetet korporatës. Përparësi e kësaj metode është shpejtësia e zbatimit. Privatizimi përmes kësaj metode forcon pronarë të mëdhenj dhe të fuqishëm të pronës së privatizuar. E meta e këtij procesi është se korporata në të ardhmen mund të jetë nën ndikimin e faktorit politik.

Modeli i privatizimit përmes shpërndarjes së aksioneve pa kompensim- Sipas këtij modeli dallojmë këto metoda:

- **metoda e shpërndarjes së aksioneve punëtorëve pa kompensim** (privatizimi intern përmes aksioneve interne);
- **koncepti i Figos**, ka të bëjë me lidhjen reciproke të disa aksioneve dhe të disa ndërmarrjeve . Kjo do të thotë, se aksionet që shpërndahen kanë karakter universal, ato paraqesin pjesëmarrjen në të gjitha ndërmarrjet, ku dividenda ndryshon sipas profitabilitetit mesatar. E meta e kësaj metode është se nuk ekziston pronari nominal i pronës.
- **Metoda Voucher (vouçerët)** mundëson ndërrimin e aksioneve universale me të drejtën, që çdo qytetar të jetë pjesëmarrës në garë për pronë në ndërmarrje. Sipas kësaj metode, u jepen “voucherët” të gjithë qytetarëve që janë kualifikuar për pjesëmarrje gjatë procesit të privatizimit, dhe ata pastaj garojnë për pronësi. Voucherët mund të shërbejnë për përfitimin e një pjese të pasurisë në më shumë ndërmarrje.

Ky proces përmbyllet me rastin e shndërrimit të” voucherëve” në aksione, dhe mbi këtë bazë përcaktohet prona private. Në teorinë ekonomike ekzistojnë disa lloje të privatizimit përmes “voucherëve”.

Së pari, shteti mundëson që në formë të decentralizuar të realizohet blerja e aksioneve. Mundësia e dytë është kur shteti përmes licitacionit publik, organizon dhe shet aksione për më shumë ndërmarrje. Në kuadër të kësaj metode bëjnë pjesë : a) licitacioni holandez, b) metoda Çeke dhe Sllovake, ndryshe e njohur si metoda *pro-rata*. Thelbi i metodës *pro-rata* qëndron në faktin, se çdo qytetar me vullnet merr një numër të “voucherëve”, që ata t’i angazhojnë në ndonjë ndërmarrje. Aksionet e disa ndërmarrjeve pa kompensim iu shpërndahen qytetarëve të caktuar, varësisht nga numri i “voucherëve” të paraqitur prej numrit të përgjithshëm, dhe i “voucherëve” të ofruar nga ana e ndërmarrjes, krahasuar me numrin e përgjithshëm të aksioneve të emetuara. Karakteristikat e modelit “voucher” të zbatuar në Çeki dhe Sllovaki, qëndrojnë në faktin se një numër i madh i “voucherëve” ndodhet në fondet për investime. Kjo përvojë lejon të formohet një klimë e mirë për ngritjen e pronarëve të mëdhenj, të cilët përkujdesen për krijimin e një udhëheqje (menaxhmenti) moderne.

Privatizimi përmes metodës së faturave paraqet një metodë elegante në aspektin teorik. Kjo mënyrë e tillë njëkohësisht përshpejton ritme për arritje të rezultateve, dhe i sjell klasifikim, vlerësim (rating) të lartë qeverisë e cila e zbaton. Përkundër faktit se shtetit nuk i sjell të hyra, është vërtetuar se humbjet shumë shpejt mund të kompensohen. Metoda e dorëzanës (voucher) është e hapur (transparente) krahasuar me modelet tjera, dhe përmes kësaj mënyre tejkalohen problemet që lidhen me përcaktimin e vlerës së ndërmarrjeve, e cila është e evidente te modelet e tjera.

Argumenti përkitazi metodës së përdorimit të kuponëve (vaucher), se qytetarët nuk kanë sasinë e nevojshme të parasë, shteti detyrohet të bëjë faljen e ndërmarrjeve, atyre që potencialet ekonomike mbeten në duart e faktorit vendor (rasti i Sllovenisë).

Për disa shtete, ky fakt nuk paraqet vlerë, kështu i mundësohet hyrje kapitalit të faktorit të jashtëm (rasti i Çekisë dhe Rusisë).

Privatizimi përmes metodës së kuponëve, “voaucher”, ka dhe përparësi të tjera, si: privatizimi i shpejtë që pamundëson formimin e koalicioneve kundër privatizimit, që do të mund të formohet me kohë, dhe të bllokojë procesin e privatizimit. Një argument i tillë vjen në shprehje gjatë viteve të 90-ta, por më vonë, duke përfillur përvojën, këto probleme tejkalohen. Kjo çështje u zgjidh asisoj, që për formimin e fondeve për investime, qytetarët i jepnin kuponët e tyre, kurse si kompensim merrnin aksione për fonde (rasti i Çekisë). Në këtë formë fondet paraqiten si pronarë të ndërmarrjeve. Çështje në vete në këto rrethana është se kush qeveris fondet. Pronësia e tyre ishte e shpërndarë dhe vështirë kontrollohej.

Për këtë arsye u paraqit domosdoshmëria e formimit të këshillave (bordeve) dhe organeve të tjera udhëheqëse (menaxheriale), që do të kishin mbikëqyrje ndaj fondeve dhe ndërmarrjeve të privatizuar.

Ndonëse modeli i zbatuar i procesit të privatizimit në Kosovë, herë pas here tangon proceset e zhvilluara në vendet e EJJ-së e të ish Jugosllavi; për shkak të veçantive dhe karakterit specifik, si i tillë është aplikuar vetëm në rastin e Kosovës. Konsideroj, se tentativa që të baras vlerësohet ky proces, i ndodhur në Kosovë, me ndonjë tjetër të ndodhur diku tjetër, është çështje e cila nuk do të mund të sillte rezultate konkrete.

3.2 Struktura ligjore e procesit të privatizimit në ish Jugosllavi

Vala e ndryshimeve strukturore e cila kishte filluar në shumicën e vendeve të Evropës Lindore, në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar, ishte e pamundur që të mos përfshinte dhe ish Jugosllavinë. Kjo kërkonte, së pari formimin e infrastrukturës ligjore, me qëllim të krijimit të parakushteve për bashkim me vendet e tjera të Evropës. Fjala është që pas ndryshimeve strukturore politike, duhej të bëheshin ndryshime në aspektin ekonomik. Këto ndryshime, gjë që u vërtetua edhe më vonë, sollën dhe deri te shkatërrimi i ish Jugosllavisë, ngase pamundësia e tejkalimit të situatës, ishte pengesë për funksionimin e mëtejshëm të këtij shteti.

3.2.1 Ligji për ndërmarrjet i RSFJ-së

Ligji për Ndërmarrjet në bazë të Gazetës Zyrtare të Republikës Socialiste të Jugosllavisë (RSFJ), është nxjerrë dhe publikuar, më 31 dhjetor 1988, me nr. 77, këtë ligj e ka aprovuar Kuvendi i RSJ-së, më 29 dhjetor 1988. Në pjesën hyrëse është precizuar se çka nënkuptohet me shprehjen „ndërmarrje“. *Ajo përkufizohet si: „... ndërmarrja është person juridik, e cila është bartëse e të drejtave dhe obligimeve në aspektin ligjor, mbi mjetet me të cilat disponon dhe i shfrytëzon, kryen aktivitete ekonomike për realizimin e të ardhurave, respektivisht fitimit përmes shitjes së produkteve dhe shërbimeve në treg dhe përgjigjet për afarizmin e saj...“⁴⁸*

Sipas këtij parimi nuk mund të vërehen ndryshime të mëdha në përkufizimin e ndërmarrjes, krahasuar me ligjet e tjera të aprovuara. Por në pjesët tjera ku përpunohet dhe sqarohet ky ligj, mund të vërehen risitë :

⁴⁸ Gazeta Zyrtare nr. 77 e RSFJ e dt. 31 Dhjetor 1988

- Neni 2 i këtij Ligji përcakton llojet e pronësisë në kuadër të ndërmarrjes : ndërmarrja mund të zhvillojë afarizmin e vet me mjete në pronësi shoqërore,
(në tekstin e mëtejshëm: **ndërmarrje shoqërore**), mjeteve në pronësi kooperativiste (në tekstin e mëtejshëm:**ndërmarrje komparativiste**); mjeteve në pronësi shoqërore, mjete në pronësi kooperativiste, mjete në pronësi të personave vendorë fizikë dhe personave juridikë, atyre personave të jashtëm
(në tekstin e mëtejshëm ; **ndërmarrje e përzier**); dhe mjeteve në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, vendor dhe të jashtëm (në tekstin e mëtejshëm; **ndërmarrje private**).

Mbi themele të këtij Ligji mund të vërehet, se përpos formave të tjera të pronësisë, paraqitet edhe prona private, ndërmarrjet private. Në nenet e tjera është sqaruar edhe mënyra e organizimit të këtyre ndërmarrjeve, si dhe mënyra e organizimit të atyre shtetërore, ose ndryshe të quajtura **ndërmarrje publike**.

Në përkim me këtë Ligj janë nxjerrë edhe Ligjet në Kuvende të të gjitha republikave në kuadër të RSFJ-së, ku janë saktësuar dhe marrëdhëniet në këto ndërmarrje, afarizmi i tyre dhe të drejtat pronësore.

Më 7 korrik 1989, në bazë të Gazetës Zyrtare të RSFJ-së, me nr. 40, merret vendim për miratimin e ligjit me plotësime dhe në nenin 2 theksohet :⁴⁹

- në pronësi shoqërore janë ndërmarrjet shoqërore, ndërmarrjet publike, si dhe shoqëritë aksionare me të drejta të kufizuara, kur kryejnë afarizmin e tyre me mjete në pronësi shoqërore.
- Në pronësi kooperativiste janë ndërmarrjet kooperativiste, shoqëritë aksionare, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë komandite dhe

⁴⁹ Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 40

shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar solidare, të anëtarëve të cilët kanë deponuar mjetet e tyre në pronësi të kooperativës.

- Në pronësi të përzier janë shoqëritë aksionare me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar solidare të anëtarëve, dhe ndërmarrjet publike, kur në to hyjnë mjete në forma të ndryshme të pronësisë shoqërore, kooperativiste, prona e qytetarëve, personave juridikë ose prona e personave nga jashtë.
- Në pronësi private janë ndërmarrjet private, shoqëritë aksionare me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë komandime, si dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar solidare të anëtarëve, të cilët i kanë deponuar mjetet e tyre në pronësi private.

Në përkim këtë janë precizuar dhe marrëdhëniet pronësore, në kuadër të ndërmarrjeve private mund të jenë edhe persona nga jashtë vendit. Kjo lejonte mundësitë e investimit nga jashtë.

Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Ligj, pasojnë me urdhëresën për Aprovimin e Ligjit me Plotësime, sipas Gazetës Zyrtare të RSFJ-së, nr. 46, 10 gusht 1990, ku në nenin 2 pasojnë plotësimet :

- ndërmarrjen në pronësi shoqërore qeverisin punëtorët;
- ndërmarrjen në pronësi të përzier e qeverisin pronarët, proporcionalisht me lartësinë e kapitalit të deponuar, punëtorët marrin pjesë në qeverisje, në pajtim me kontratat kolektive...
- Ndërmarrjet në pronësi kooperativiste qeverisin pronarët, punëtorët marrin pjesë në qeverisje në harmoni me statutin dhe kontratën kolektive.
- Ndërmarrjen në pronësi private e qeverisin pronarët, punëtorët marrin pjesë në qeverisje, në pajtim me kontratat kolektive...

Ligji për Ndërmarrjet i aprovuar në Kuvendin e RSFJ-së, me ndryshimet dhe plotësimet, ndikoi në miratimin e Ligjit për Veprimin e Shndërrimit të Pronës Shoqërore në Forma Tjera Pronësore, i miratuar në Kuvendin Popullor të Republikës së Serbisë, më 30 qershor 1991, dhe i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë, me nr. 48, të datës 5 gusht 1991. Në pajtim me këtë Ligj, ishte koha që në aspektin juridik, të ketë qasje në procesin e transformimit të pronës shoqërore në forma tjera pronësore.⁵⁰

Neni 1 i këtij ligji precizon :

- ndërmarrja në formë të pavarur vendos për shndërrimin e pronës shoqërore (në tekstin e mëtejme: kapitalin shoqëror) të cilin e ka në pronësi dhe e qeverisë, edhe në forma tjera pronësore, respektivisht organizimin në ndërmarrje të përzier a private, sipas kushteve dhe mënyrave që janë përcaktuar në përputhje të këtij ligji.

Me këtë ligj përcaktohet edhe emetimi i fletë-aksioneve dhe organizimin e ndërmarrjeve në formë të shoqërive, ku po ashtu, saktësohet emetimi dhe shitja e fletë-aksioneve, me qëllim të shitjes së kapitalit shoqëror, emetimin e fletë-aksioneve, me qëllim të rritjes së kapitalit (rekapitalizim), si dhe dhënie me qira e lidhje kontratash,që kanë të bëjnë me afarizmin e ndërmarrjes.

Me qëllim që ky Ligj të ketë karakter ekzekutiv, janë precizuar edhe masat ndëshkuese që ishin shumë të larta për mos zbatimin e tyre. Kjo do të thotë, se ato duhet t'i rreken procesit të transformimit.

Miratimi i ligjit me udhëzime dhe ndryshime, mund të vërehet se strukturat qeverisëse shoqërore nuk ishin në hap me ndodhitë, para së gjithash në aspektin ekonomik: çka është duke ndodhur, dhe çfarë po përgatitet për të ndodh në vendet e Evropës Lindore?

⁵⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 48, 5 Gusht 1991

Për shumë çështje ekonomia e ish Jugosllavisë ishte në hap para, krahasuar me vendet e bllokut socialist, para së gjithash në aspektin e liberalizimit dhe demokratizimit të shoqërisë. Mirëpo, në këtë periudhë kohore, proceset zhvilloheshin në dy drejtime :

1. në aspektin ekonomik Jugosllavia përgatitej të hynte në reforma të sistemit, që do të ishin të bazuara në ekonominë e tregut, me qëllim të bashkimit me vendet e tjera të Evropës
2. rritja e nacionalizmit dhe hegjemonizmit të skajshëm në shoqëri në aspektin politik. Më tutje kjo do të jetë vendimtare për shkatërrimin e ekonomisë dhe shtetit në tërësi.

3.3 Situata ekonomike-politike në Kosovë para procesit të privatizimit

Republika e Kosovës ka mbi 2 milionë banorë, të cilët jetojnë në një sipërfaqe, prej 10.887 km², mbi 200 banorë në një km². Struktura e moshës është 63% në 30 vjet, që do të thotë, se popullata e Republikës së Kosovës është ndër popullatat më të reja në Evropë.

Periudha e sistemit socialist, Kosovën e shihte si vend të lëndëve të para në aspekt të minierave, por në të njëjtën kohë si regjionin më të pazhvilluar të RSFJ-së.

Kjo rrethanë ndikoi për zhvillimin e ngadalshëm në njëërën anë, kurse në anën tjetër, reflektohet papunësia tejet e theksuar në këtë vend.

Pjesëmarrja e Kosovës në numrin e banorëve në Jugosllavi ishte 6.95%, në pasuritë minerale 10%, në aspektin territorial 4.25%, kurse në prodhimin nacional 1 2.02%.⁵¹

Fundi i viteve të 80-ta, po ashtu, i tërë dhjetëvjeçari i viteve të 90-ta të shekullit të kaluar, ishin shprehje e së keqes në Kosovë,

⁵¹ Dr Ismet Gusia , Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të KSA, Rilindja 1982, Prishtinë faqe 7

Rritja e nacionalizmit dhe hegjemonizmit serb, shkaktoi në të gjitha vendet e ish RSFJ-së, përjetime e trauma të tmerrshme të llojeve e formave të ndryshme, dhe në fund shpërthimin e luftërave të armatosura tejet të përgjakshme. Në këto ngjarje as Kosova nuk mundi të ishte e përjashtuar.

Pas miratimit të Kushtetutës së Serbisë, më 1989, ekonomia e Kosovës thellohej në krizë, fundi i së cilës vështirë se mund të parashikohej. Kjo ndikoi për të rënë në mënyrë rapide ekonomia e Kosovës, që kishte si pasojë ndikimet politike në ekonomi.⁵²

Shkatërrimi i ekonomisë së Kosovës, rrënimi i sistemit politik, rritja e revoltës së popullsisë, etj. ishin sinjale, që vetëm lufta e armatosur do t'i zhदारariste, dhe u realizua vetëm me pak “vonesë” në kohë. Fillim i fundit të keq ishte viti 1999. Ky ishte viti, kur erdhi në shprehje ekzistenca biologjike e popullit në Kosovë (e shqiptarëve), dhe solli në pyetje qenien e ekzistencës a të mos ekzistencës individuale dhe kolektive, nga dhuna e ushtruar me anë të pastrimit etnik.⁵³ Më tepër se një milion banorë lëshuan Kosovën brenda një periudhe të shkurtër kohore. Erdhi deri te rezistenca e armatosur. Bota demokratike nuk guxonte sërish të përsëriste gabimet nga e kaluara. Për 77 ditë u zhvilluan bombardime në caqet e ushtrisë serbe, në mënyrë që ajo të ndodhej para kapitullimit dhe tërheqjes nga territoret e okupuara të Kosovës.

Bombardimet e NATO-s ndaj caqeve ushtarake serbe, u zhvilluan në periudhën 24 mars 1999, deri më 9 qershor 1999. Veprimet luftarake përfunduan me marrëveshjen ushtarake në mes forcave ndërkombëtare (KFOR), të Qeverisë së Federatës Jugosllave dhe Republikës së Serbisë, me marrëveshjen e Kumanovës, më 9 qershor 1999.

⁵² Doc.Dr. Ramiz Livoreka, Argumentet relevante për shfrytëzimin e mjeteve nga privatizimi i ekonomisë së Kosovës. “Economia” nr.1-2 2003, Instituti Ekonomik, Prishtinë

⁵³ Dušan Janjić, Nacionalni identitet, pokret i nacionalizam Srba i Albanaca, u: Sukob ili dijalog, faqe. 113

Në përputhje me rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nr 1244 e datës 10 qershor 1999, Kosova vihet nën administrimin e UNMIK-ut (United Nation Interim Administration Mission in Kosovo) dhe KFOR (Kosovo Forces Organization Rescue). UNMIK ishte përgjegjës për çështje të jetës civile në Kosovë, kurse KFOR-i për ruajtjen e kufijve dhe sigurinë e Kosovës.

Një dukuri, pak e njohur më herët, ishte kthimi rekord, i shpejtë i mbi një milion të zhvendosurish nga Kosova. Forcat e instaluar të KFOR-it në Kosovë (mbi 50.000), ishin garanci e sigurisë dhe fillimit të jetës së re. Kjo jetë kishte kërkesa të mëdha, që duhej sa më shpejtë të organizohej.

Periudha e pasluftës ekonominë kosovare e gjeti plotësisht të rrënuar. Nuk qëndronte më mirë as jeta në aspektin politik, social, etik dhe në pore të tjera të jetesës. Ekonomia e Kosovës në periudhën e pasluftës mund të karakterizohej si ekonomi e një shteti:

- pa infrastrukturë financiare,
- fillimi i lulëzimit të krimit dhe korrupsionit,
- papunësi masive,
- mungesë e prodhimtarisë,
- bujqësi dhe blegtorie shkatërruar,
- mungesë e shërbimeve publike,
- infrastrukturë e shkatërruar, etj.

E tërë kjo situatë ishte pasqyrim real i një shteti të sapo dalë nga lufta. Kjo ishte një situatë kur Kosovës i nevojitej çdo gjë. Duhej kërkuar pikën fillestare të nisjes. Misioni i UNMIK-ut i instaluar në Kosovë për administrimin e jetës civile, i kishte vënë vetes objektivat e veprimit :

- krijimin e kushteve që Kosova të funksionojë si vend demokratik,
- ligjshmëria, ku njerëzit do të ishin të barabartë para ligjit,

- krijimin e kushteve për infrastrukturën e domosdoshme për zhvillimin ekonomik.

Ky mision së bashku me faktorin vendor, vuri themelet e institucioneve, që do të orientojnë ekonominë e Kosovës në parimet e tregut, që njëkohësisht ishte shumë shpresëdhënëse. UNMIK-u përmes urdhëresave administrative, për nevoja të ekonomisë, ngriti shtyllën e IV(katërt) dhe:

- 1. Autoritetin Fiskal Qendror të Kosovës** Ky institucion merrej me planifikimin dhe formulimin e buxhetit, zbatimin e tij, politikën tatimore dhe administrimin. Gjatë muajit dhjetor të vitit 1999, nëpërmjet këtij institucioni është formuar edhe Buxheti i parë i Konsoliduar i Kosovës, (Kosovo Consolidated Budget), i cili kishte mbuluar shpenzimet e qeverisë, komunave dhe ndërmarrjeve publike. Përmes këtij buxheti ishin ndërprerë të gjitha lidhjet dhe transferet me ish Jugosllavinë.
- 2. Departamenti për Rekonstruktiv** Ky departament kishte për qëllim përmirësimin dhe përgatitjen e programit për investime publike.
- 3. Sistemi tatimor dhe administrimi i tatime** Ka për qëllim sigurimin e burimeve për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, dhe ndryshimin e tatimeve paralele që ishin gjatë viteve të 90-ta.
- 4. Autoriteti Bankar i Pagesave** i Kishte për qëllim themelimin e sistemit të pagesave në nivel vendi, licensimin dhe kontrollin e bankave, sigurimin e likuiditetit, dhe lehtësimin e kushteve për funksionimin e rregullt të sistemit financiar në Kosovë. Rritja dhe zgjerimi i numrit të bankave në Kosovë filluan dhe pagesat ndër bankare.

Përdorimi dhe aplikimi i Euros, si mjet pagese në vitin 2001, shpresat për një rritje më të shpejtë ekonomike, në atë kohë dukeshin reale. Shpresohet se valuta e përbashkët me Evropën, do të jetë një nga elementet e përbashkëta me botën e

zhvilluar, dhe Kosova do të mund të kishte qasje më të lehtë për rimëkëmbje ekonomike. Mirëpo, përkundër kësaj, shikuar në aspektin makroekonomik, për periudhën kohore 2000-2001 pati rënie, kurse për periudhën kohore 2004-2005, kishte një rritje modeste të GDP-së për 3%, inflacioni dhe deficitit buxhetor u vunë nën kontroll. Por deficitit në tregti ishte 70%; mjetet nga dërgesat (remitencat) 13%, kurse ndihma nga jashtë 34%. Ngritje më të madhe sektoriale pati në tregti dhe ndërtimtari. Sektori i bujqësisë dhe industrisë nuk mund të krenoheshin se kishin rezultate pozitive. Ngecja më e madhe ishte në fushën e punësimit, që u paraqit si çështje shumë problematike dhe e pazgjidhur deri në ditët e sotme.

3.4 Krijimi i parakushteve për procesin e privatizimit në Kosovë

Krahas organizimit të jetës ekonomike, para popullatës së Kosovës pas vitit 1999, u shtrua organizimi i jetës dhe strukturave qeverisëse politike. Institucionet e përkohshme vetëqeverisëse (IPVQ) u themeluan si institucione shtetërore qeverisëse, të cilat e përfaqësojnë popullin e Kosovës, dhe veprojnë nën mandatin e Qeverisjes së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK).

Kosova, sipas Rezolutës 1244, ishte nën Protektoratin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, çka nënkuptonte Administrimin e Përkohshëm të Kosovës nga kjo organizatë, e cila këtë e ushtronte me Misionin e saj në Kosovë, të njohur me shkurtesën UNMIK ose Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. UNMIK-u udhëhiqej nga Autoriteti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së .

Mirëpo, me kalimin e kohës, sipas Rezolutës 1244, UNMIK-u kishte për detyrë t'i ndihmonte vendorët për krijimin e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ). Së pari u formua Këshilli i Përkohshëm Administrativ(KPA), ku u përfaqësuan të gjitha grupet politike dhe bashkësitë etnike që jetojnë në Kosovë.

Në vitin 2001 nxirret Korniza Kushtetuese e Kosovës, dokument i që ishte miratuar me konsensus në mes të strukturave ndërkombëtare dhe UNMIK-ut, në njërën anë dhe atyre vendore të KPA-së. Sipas kësaj Kornize Kushtetuese filloi ndërtimi i institucioneve vendore nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Ndërkombëtarët i njihnin të drejtat për krijimin e institucioneve vetëqeverisëse, si ato qendrore ashtu dhe lokale, me anë të zgjedhjeve të lira dhe votës së lirë të qytetarëve për të dy nivelet e pushtetit.

Gjatë kësaj kohe vendorët fitojnë të drejtën që të kenë Presidentin e Kosovës (me Kabinetin e Presidentit), Parlamentin e Kosovës, (të përbërë nga 120 ulëse, 100 ulëse për deputetët e zgjedhur nga vota e lirë, ndërsa pavarësisht nga rezultatet e zgjedhjeve dhe numrit të fituar të votave, 10 ulëse janë të rezervuara për deputet e minoritetit serb, si dhe 10 të tjera të rezervuara për minoritetet tjera, si: turq, egjiptianë, boshnjakë, rom, etj). Kryetari dhe Kryesia e Parlamentit(komisionet dhe grupet parlamentare), Qeverinë e Kosovës, (kryeministri, ministrat dhe zëvendës ministrat). Funkionarët e këtyre institucioneve janë zgjedhur me votën e lirë të kosovarëve, si dhe, njëkohësisht pranoheshin nga UNMIK-u⁵⁴

Përkundër legjitimitetit demokratik, autorizimet e IPVQ-ë ishin të kufizuara, sepse ato mbetën në kompetencë të Përfaqësuesit Special të Sekretarit Gjeneral (PSSG), të Organizatës së Kombeve të Bashkuara . Megjithatë, IPVQ-të si përfaqësues të zgjedhur të popullit, kishin të drejtë dhe përgjegjësi për shqyrtimin, vlerësimin, analizën dhe vërejtjet për vendimet që i merrte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, që janë në kompetenca të tij.

Pas vitit 2001, sistemi politik në Kosovë filloi të merrte formën e vet, por përsëri mbikëqyrej nga PSSG. Fillimisht ishte e domosdoshme formimi i infrastrukturës ligjore, e cila filloi me urdhëresat e UNMIK-ut, që kishin përcaktuar përparësitë dhe afatet e

⁵⁴ <http://sq.wikipedia.org/wiki/Institucionet>

realizimit. Para Kosovës u “**përcaktuan standardet**”, që dalin nga dokumenti “**Plani për Zbatimin e Standardeve për Kosovë**”.

Implementimi përzgjedhës (selektiv) i përparësive të caktuara, sipas këtij dokumenti paraqiste një domosdoshmëri “*si condicio sine qua non*”,⁵⁵ të plotësimit të tyre deri në vitin 2005 (këto standarde asnjëherë nuk u plotësuan).

Plotësimi i këtyre “standardeve”, do të mundësonte procesin e transformimit të ekonomisë, nga ekonomia e pronës shoqërore e sistemit socialist në atë demokratik, me sistem pluralist shoqëror, ku njerëzit janë të barabartë, me pikënisje në ekonominë e tregut dhe konkurrencën e plotë të subjekteve ekonomike.⁵⁶

Një prej çështjeve thelbësore, jo vetëm nga aspekti ekonomik, por dhe nga ai politik, ishte përgatitja për procesin e transformimit dhe privatizimit të pronës. Konsiderohej se ishin pjekur kushtet, që të fillohej privatizimi i pronës shoqërore e, pastaj të vazhdohej përmbushja e pronës publike.

3.4.1 Roli i UNMIK-ut në procesin e privatizimit të pronës shoqërore në Kosovë

Privatizimi filloi para se Kosova të ketë shtetësinë e saj (2002). Kosova kuptohet se e fundit zbatoi procesin e privatizimit, të cilin e filloi UNMIK si mision civil me mandat nga Kombet e Bashkuara . Kritikët fillestar të procesit të privatizimit, thumbnin për kohën e humbur (vonesa zgjati 4 vite). Mirëpo, këtë vonesë duhet vështuar nga aspekti i krijimit të rregullave ligjore, që kuptohej se do të merrte kohë. Që nga fillimi, përpjekjet e UNMIK-ut ishin të dukshme. Përmes Shtyllës së katërt (IV) dhe Departamentit të Tregtisë e Industrisë (që kishte rolin e Ministrisë), bëheshin përpjekjet serioze. Dyshimet dhe politizimi i procesit, po ashtu, ishin shkasë që zinin vend ende pa filluar privatizimi. Procesi i privatizimit u paraqit si proces i ngjyrosur politikisht, mjaft i ndërlikuar dhe i ngarkuar me paragjykime.

⁵⁵ “kusht pa të cilin nuk mundet” (përkthim i lire)

⁵⁶ Dr Nuri Bashota, Ekonomia e Tregut-detyrë prioritare në dokumentin “Standardet për Kosovën”-Publikim 2006

Kështu, filluan diskutimet në të gjitha instancat e shoqërisë, dhe lindën pyetje të shumta përkitazi padrejtësive, të cilat qenë bërë më herët, në emër të nacionalizimit, eksproprijimit dhe uzurpimit të pronës.

Procesi i privatizimit të pronës në Kosovë paraqitej mjaft kundërthënës. Brenga qëndronte në mundësinë e keqpërdorimeve të kompetencave. Lënia anash e faktorit vendor dhe eksperteve, të cilët i njihnin këto rrethana, është fakt i mjaftueshëm, se në çfarë rrethanash filloi procesi i privatizimit të Kosovë.

Procesin e transformimit të pronës shoqërore⁵⁷ në Kosovë, duhet vështruar në tri etapa kohore:

1. periudha shtator 1999 shtator 2000; pas hulumtimeve në detaje, përkitazi natyrës së pronës shoqërore (ngase kjo formë e pronës për faktorin ndërkombëtar, nuk ishte mjaft e kuptueshme), Shtylla e katërt (IV) e UNMIK-ut, në pjesën e dytë të vitit 2000, doli me propozim e njohur, si **“Letra e bardhë e Joly Dixon”** (udhëheqës i Shtyllës së Katërt) lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë, përparësia i jepet pronës private, përmes:
 - themelimit të Agjencionit dhe të Fondit për Privatizim, me mundësi që punëtorët, si mënyrë e metodës komplementare, të kenë pjesëmarrje 30% deri 40%;
 - Komercializimi dhe dhënia me qira e ndërmarrjeve për periudhën kohore prej 10 vitesh, ideja e procesit të privatizimit nuk u përkrah nga OKB-ja, derisa çështja e komercializimit filloi dhe mbeti si opsion, por me rezultate modeste.⁵⁸

⁵⁷ Në bazë të Kushtetutës të vitit 1974 të RSFJ, parashihej se të gjitha mjetet e prodhimit dhe mjetet e tjera kolektive, rezultatet e punës kolektive dhe burimeve natyrore, si dhe mjeteve të tjera të përcaktuara për shërbime publike, të jenë pasuri shoqërore. Prona shoqërore konsiderohet si kategori juridike e pavarur, e cila ishte e ndryshme nga prona private. Karakteristika kryesore e pronës shoqërore ishte, se poseduesit e saj nuk mund të kishin pronësinë ndaj saj, mirëpo kishin të drejtën e përdorimit. Ndërmarrjet kishin karakter të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH)

⁵⁸ Forum 2015- Riinvest, Prishtina , 2004, faqe 17

2. Periudha nëntor 2001,qershor 2002; në fund të vitit 2001, Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë dha një propozim të ri për transformimin e Ndërmarrjeve Shoqërore në shoqëri aksionare, duke përfillur ligjin e njohur, si “ Ligji i Ante Markoviqit, i vitit 1989”⁵⁹. Sipas këtij ligji, pjesa më e madhe e aksioneve do tu takonte punëtorëve (60%-70%), përderisa pjesa tjetër do të lejohej për shitje investitorëve të jashtëm, dhe me këtë do të themelohej fondi për privatizim. Kjo konsiderohej si zgjidhje e mirë për OKB-në dhe investitorët nga jashtë. Mirëpo, për OKB-në kjo nuk paraqiste ndonjë zgjidhje, dhe nuk kaloi më mirë se propozimi paraprak, pra u refuzua.
3. Periudha qershor 2001, maj 2002, UNMIK-u orientohet në një model krejtësisht tjetër të procesit të privatizimit, pa prejudikim të pronës, që mbetet të zgjidhet me procedura të veçanta.

Kështu, propozohej një model i quajtur “**Spin-off**“, i cili kishte kuptimin e amputimi(shkurtimit), që do të thotë, se nga Ndërmarrja Shoqërore mund të krijohen një mori ndërmarrjesh të reja, si ndërmarrje pa hyrë në pronën e ndërmarrjes. Të gjitha mjetet nga shitja e ndërmarrjes të ruhen në fondin, i cili do të jenë në “mirëbesim”, dhe përmes Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM). Përparësi e këtij modeli ishte se ndërmarrjet e reja asnjë detyrim nuk trashëgonin nga ndërmarrjet paraprake, kurse rrethanë rënduese ishte se kërkoheshin mjete likuide, për ekzistimin dhe vazhdimin e punës së ndërmarrjeve të reja.

3.4.2 Komercializimi i Ndërmarrjeve Shoqërore, si fazë kalimtare drejtë procesit të privatizimit

Prona Shoqërore paraqet një term i dalë nga sistemi socialist, që konsiderohej se punëtorët nuk janë të shtypur nga ata që posedojnë pronën, respektivisht ajo pronë u përket atyre, sepse për ata krijojnë vlera përmes saj. Një sqarim sado pak i kësaj kategorie pronësore (për faktorin ndërkombëtar), çështjet po kthjelloheshin. Megjithatë, përkundër problemeve të shumta, në kushtet aktuale, filloi procesi i privatizimit në Kosovë nëpërmjet procesit të komercializimit (dhënia me qira). Kjo formë fillimisht konsiderohej si masë e përkohshme, me qëllim të krijimit të mundësive për investime nga jashtë. Konsiderohej se ky proces do të jetë më i pakët se privatizimi, por do të paraqiste parakushte drejtë transformimit pronësor.

Këtë proces UNMIK-u konsideronte se duhej ta zhvillonte, me anë të Shtyllës së katërt (IV) dhe Departamentit të Tregtisë e të Industrisë (DTI). I tërë ky proces, megjithatë ashpër u kundërshtua nga ana e OKB-së.

Gjatë komercializimit DTI (Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë, ofronte kontrata me koncesione afatgjata (për 10 vite) për Ndërmarrjet Shoqërore të përzgjedhura përmes tenderimit publik. Investitorët që fitonin këtë lloj tenderi, kishin të drejtën ndaj mjeteve fizike të ndërmarrjes dhe fuqisë punëtore, si dhe të drejtën e menaxhimit në atë ndërmarrje.

Me gjithë atë, investitorët nuk kishin fituar të drejtën ndaj pronës, që njëkohësisht paraqiste dallimin mes privatizimit dhe komercializimit. Pra, prona ishte e dhënë me qira⁶⁰.

Nga 512 ndërmarrje të parapara që të jepen për komercializim, DTI arriti që të komercializojë gjithsej 13 sosh. Mirëpo, edhe këto ndërmarrje të komercializuara, ashtu

⁶⁰ KIPRED (Kosovar Institute for Policy Research and Development), Prishtinë 2005, faqe.9

sikurse do të vërehet më vonë, ishin të përfshira në procesin e privatizimit pa kaluar afati i kohës kontraktuese.

Vetëm 5 sosh, nga këto ndërmarrje të komercializuara, ishin të suksesshme, kurse rezultatet e të tjerave qenë të pjesshme.⁶¹ Përkundër asaj që u prit shumë nga komercializimi, rezultatet do të jenë modeste. Kjo e dhënë erdhi në shprehje, në radhë të parë, për mungesë investimesh dhe rritjen e numrit të punëtorëve.

Ndonëse procesi i komercializimit të Ndërmarrjeve Shoqërore ishte një tentim i pa suksesshëm, megjithatë çështje pozitive është se kërkoheshin forma të reja, me qëllim të transformimit dhe privatizimit të pronës, e cila kishte karakter shoqëror dhe paraqiste pengesë për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe plotësimin e standardeve, të cilat bota e zhvilluar i kërkonte nga Kosova.

3.4.3 Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM)

Për një shekull të tërë, pas rënies së Perandorisë Osmane, Kosova ishte nën sundimin serb. Në asnjë periudhë kohore populli i Kosovës këtë pushtet nuk e ka konsideruar si të vetin. Çdo herë i ka dhënë trajtim të një pushtuesi. Kosova ishte regjion administrativ gjatë pjesës më të madhe të shekullit 20, qoftë si pjesë e “ Serbisë Jugore”, mes dy luftërash botërore, në periudhën e Mbretërisë Jugosllave, a si krahinë e Serbisë në kuadër të Republikës Socialiste të Jugosllavisë (RSFJ), e themeluar në vitin 1945.

Kushtetua e RSFJ-së e vitit 1974, iu dha autorizime mjaft të mëdha njësisë përbërëse të Federatës. Kështu, u bë decentralizimi i makinerisë administrative. Në nenin 1, Kushtetuta e RSFJ-së, Kosovën, edhe pse ishte pjesë e Republikës së Serbisë, e trajtoi me kushtetutën e vet, kuvendin, gjykatën supreme dhe bankën popullore. Të

⁶¹ Ndërmarrjet e komercializuara ishin : “Sharri Cement”, “Mirusha”, Mishtorja “Progresi”, “Progres-Eksport”, “Fapoli”, “Mustafa Goga”, “Alcon Luledielli”, “Betonjerka”, “Adi Shpesëtaria”, Fabrika e Tullave “Kosova”, “Termovent” dhe “Minex”.

gjitha këto, ishin elemente të shtetësisë. Një gjendje e tillë reflektoi deri në vitin 1989, kur Kosovës iu maur autonomia në të gjitha sferat. Një gjendje e tillë kushtëzoi shpërthimin e luftës në vitin 1999.

Lufta përfundoi në qershor të vitit 1999, kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës, në bashkëveprim me forcat ajrore të NATO-s , pas një robërimi shekullor, Kosovës i sollën lirinë. Në bazë të Rezolutës 1244, të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, më 10 qershor 1999, Kosova u vu nën mbikëqyrje të OKB-së. Organizimi i jetës civile iu besua UNMIK-ut, kurse siguria e jashtme dhe e brendshme KFOR-it.


Misioni UNMIK organizoi tërë sistemin administrativ, përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në katër shtylla, të cilat kishin rolin e ministrive përmes tri institucioneve ndërkombëtare Kombet e Bashkuara, Organizata Evropiane për Siguri dhe Bashkëpunim dhe Unioni Evropian:

- Shtylla e Parë (I)“Policia dhe gjyqësia” (KB);
- Shtylla e Dytë (II) “Administrata civile” (KB);
- Shtylla e Tretë (III) “Demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve” (Organizata Evropiane për Siguri dhe Bashkëpunim “OEBS”; dhe
- Shtylla e Katërt(I) :“Rindërtimi Ekonomik”,(Unioni Evropian) “EU”.

Shtylla e Katërt kishte për qëllim krijimin e kushteve për integrimin e Kosovës në rrjedha demokratike, dhe arritjen e kushteve për zhvillim e për afarizëm në bazë të tregut.

Në formë skematike organizimi i shtyllës së Katërt(IV) do të dukej në vijim:

Tabela 3- Organogrami i organizimit të Shtylla IV UNMIK



Burim: AKP

Pranisë së UNMIK-ut si mision civil ndërkombëtar në Kosovë, i takonin të gjitha të drejtat dhe obligimet për organizimin e jetës në Kosovë. Që nga fillimi UNMIK-u u orientua në çështje, të cilat kishin karakter pronësor, andaj dhe të pronës së Ndërmarrjeve Shoqërore ⁶². Korniza kushtetuese për Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, përcakton që Institucionet e Përkohshme në Kosovë, në kuadër të autorizimeve të tyre, nuk do të kenë autorizime të posaçme, por ato do të jenë në kompetencë ekskluzive të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSG).

Në mesin e këtyre autorizimeve janë edhe ato që kanë të bëjnë përkitazi me qeverisjen e pronës publike, shtetërore dhe shoqërore; si dhe përkufizimin e

⁶² Urdhëresa e UNMIK-a nr. 1999/01 e dt. 25. qershor 1999. , Mbi kompetencat e Qeverisjes së Përkohshme në Kosovë” e plotësuar me ndryshimet me Urdhëresën e UNMIK nr.. 2000/54, në nenin 6 përcakton:

6.1 „UNMIK qeveris me pronën e luajtshme dhe të paluajtshme në Kosovë...dhe pasurinë e cila është në pronë shoqërore”

6.2 „Qeverisja e UNMIK me pronën ... konsiderohet se hyn në fuqi me Rregulloren e UNMIK nr.. 1999/1 e dt. 10. qershor 1999, datën e aprovimit të Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të OKB me nr. 1244 (1999).

kompetencave juridike për zgjidhjen e kontesteve, që kishin të bënin me komercializimin e pronës⁶³

Kështu, UNMIK-u shpalli ligjet dhe themeloi dy institucione, të cilat do të udhëheqin procesin e privatizimit në Kosovë:

1. Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit dhe
2. Odën e Veçantë.

Këto institucione do të merren me çështjen e procesit të privatizimit të gjithë pronës në Kosovë, pronën publike, shtetërore dhe shoqërore, forma që ishin aktuale në Kosovë.

Themelimi i Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM)- Ndërmarrjet Shoqërore janë themeluar sipas Kushtetutës së vitit 1974 të RSFJ-së. Sipas këtij koncepti përcaktohet se pronësia ndaj pronës, nuk i takon individit mirëpo, ajo është pasuri e shoqërisë në tërësi. Kështu, ky koncept do të mund të përshkruhej, se prona është pronësi e “çdo kujt dhe e askujt”. Shoqërisë i takojnë të drejtat pronësore, kurse individët kanë të drejtën e shfrytëzimit.

Ky koncept është zbatuar në ndërmarrjet, që punëtorët, udhëheqësit dhe shoqëria në përgjithësi, teorikisht kishin të drejtën e shfrytëzimit të pronës, por nuk ishin pronarë të saj.

Misioni civil i OKB-së (UNMIK), që në fillim filloi zbatimin e pushtetit civil, dhe kësioj dhe të çështjeve që kishin të bënin me transformimin dhe privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore. UNMIK-u me anë të Urdhëresës 2002/1, më 13 qershor 2002 (e cila më vonë u ndryshua me Urdhëresën 2005/18)⁶⁴, themeloi Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit (AKM).

⁶³ Urdhëresa UNMIK nr . 2001/9, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, dt. 15. Maj. 2001. Neni 8.

⁶⁴ Urdhëresa. Nr. 2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit
Kreu 1 Statusi juridik, ciljevi i qëllimet dhe definimi

Neni 1..Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme “Agjencioni”) është themeluar si trup i veçantë në pajtim me Nenin 11,2 të Kornizës Kushtetuese.Agjencioni ka karakter të personit juridik dhe mundësi të veçanta që

Ky institucion morri përgjegjësi përkitazi pronës të Ndërmarrjeve Shoqërore. Këto Urdhëresa Administrative (që kishin fuqinë e Ligjit), të kombinuara me rregulloret tjera relevante, i jepnin AKM-së autorizime të gjera të qeverisjes së Ndërmarrjeve Publike dhe Shoqërore, të regjistruara në Kosovë, deri më 31 dhjetor 1988. Prona shoqërore, që ndodhej në Kosovë deri më 22 mars të vitit 1989, mbikëqyrej prej AKM-së, dhe qëllim parësor i saj ishte privatizimi i pronës publike dhe shoqërore.

Me Urdhëresën Administrative 2002/12, në formë të përpiktë përkufizohen detyrat dhe autorizimet e AKM-së, që menaxhonte (udhëhiqte) Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore, të regjistruara në territorin e Kosovës, si dhe veprimtaria që këto ndërmarrje kanë në Kosovë, prej 10 qershorit të vitit 1999.⁶⁵ Lidhur me këtë janë marrë në konsideratë dhe ligjet jo-diskriminuese, të cilat ishin në fuqi para 22 marsit të vitit 1999, (përpara Kushtetutës së Serbisë, më 24 mars të vitit 1989) dhe transformimit të këtyre ndërmarrjeve.

Nga urdhëresë e posaçme janë themeluar Këshilli i AKM-së, drejtori ekzekutiv dhe dy zëvendës, si dhe personeli zyrtar.⁶⁶ Këshilli (bordi) është i përbërë nga tetë drejtorë, nga të cilët katër sish kishin karakter të ndërkombëtarëve, dhe katër drejtorë vendorë të përcaktuar nga PSSG, të cilët mund të ndërroreshin me kërkesën e PSSG-së. Tre nga drejtorët kishin cilësinë e ministrave në Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë.

të lidh marrëveshje, krijoj, mbaj dhe disponoj pronën, dhe ka të gjitha autorizimet për kryerjen e punëve dhe autorizimeve të cilat i janë përcaktuar me këtë urdhëresë, si dhe në emër të vetin të padisë dhe të jetë e paditur.

Neni 2.

Qëllimet dhe definimi

2.1 Agjencioni në pajtim me kushtet e kësaj Urdhërese, qeveris me ndërmarrjet publike dhe shoqërore dhe me pronën në kontekst të Nenit 8.1 (q) të Kornizës Kushtetuese. Sa i përket Ndërmarrjeve Shoqërore, Agjencioni ka kompetenca shitesë të definuara në Neni 6.2 të kësaj Urdhërese.

2.2 Për realizim të këtij qëllimi Agjencioni:

- a) Qeveris me ndërmarrjet si i besuar i pronarit në pajtim me këtë Urdhëresë dhe rregulloret e tjera, si dhe urdhëresave administrative të cilat mund ti jep Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral.
- b) Kryen aktivitete me qëllim të ruajtjes apo rritjes së vlerës dhe qëndrueshmërisë së ndërmarrjes dhe qeveris me te.
- c) Kryen aktivitete të cilat mund ti përcaktohen me Urdhëresë.

⁶⁵ Urdhëresa 2002/12 Neni 5

⁶⁶ Urdhëresa 2002/12 Neni 11,12

Një pozitë e drejtorit i takonte minoritetit serb, kurse i katërti ishte përfaqësues i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Vendimet merreshin me shumicën e votave, ku duhej të ishin së paku pesë anëtarë. Drejtorin ekzekutiv dhe dy ndihmës duhej t'i përcaktonte Bordi i AKM-së.

Agjencioni kishte kapital të regjistruar në vlerë prej 10 milion euro, nga të cilët 1 milion € paguhej në të gatshme, në afat prej gjashtë muajsh nga konstituimi i Bordit.. Për shumën e mbetur vendos Bordi për të mbuluar detyrimet e Agjencionit.⁶⁷ Nga kjo shumë e përcaktuar vlen të kuptohet, se është fjala për agjencion, nga e cila mund të priten rezultate të dëshiruara.

Përkitazi kërkesave, që do të pasojnë më vonë, gjatë procesit të privatizimit, ishte e domosdoshme ngritja e institucionit, që do të merrej me çështje dhe veprime të AKM-së. Në pajtim me Urdhëresën 2002/12, u vendos që të themelohej Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, përkitazi me çështjet që kanë të bëjnë me AKM-në. Në formë të detajuar, kjo u rregullua me Urdhëresën 2002/13, e datës 13 qershor 2002. Me këtë Urdhëresë ishte përcaktuar, që Oda e Veçantë të jetë e formuluar nga këshilli, që e përbënin 5 gjykatës, nga të cilët 3 ishin gjykatës ndërkombëtarë, kurse 2 vendorë të emëruar nga PSSPG-ja. Detyrat e kësaj ode ishin parimisht ato, që kanë të bëjnë me kërkesat e ndryshme dhe pronësore, njohja e të drejtave të ndryshme, zbatimet e dhunshme nga ana e agjencisë, etj.⁶⁸ Oda e Veçantë ka përparësi autoritative ndaj të gjitha padive relevante dhe kërkesave të AKM-së. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në:

- sprova të vendimeve dhe veprimtarive të tjera të AKM-së;
- padive ndaj AKM-së për humbje financiare, si pasojë e vendimeve dhe veprimeve përmes AKM-së, si dhe rezultateve, rolit të saj si administrator i një ndërmarrjeje ose korporate;
- padive ndaj ndërmarrjeve a korporatave nën administrimin e AKM-së;

⁶⁷ Urdhëresa UNMIK 2012/12 Neni 17

⁶⁸ Urdhëresa e UNMIK 2002/13 neni, 1 dhe 4

- padive që përfshijnë njohjen e së drejtës ndaj pronës a fitimin e ndërmarrjeve që janë nën administrimin e AKM-së.

Asnjë gjykatë tjetër në Kosovë nuk mund të ketë autoritet ndaj këtyre llojeve të kërkesave. Oda e Veçantë në kushte normale vepron si organi më i lartë ligjor, ajo vepron edhe si organi i kërkesave gjyqësore.

Pas miratimit të kësaj rregullore administrative, UNMIK-u përmes AKM-së, filloi procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, kurse privatizimi i Ndërmarrjeve Publike u la për më vonë. Gjatë muajit maj të vitit 2003, filloi me grupin e parë, në mënyrë që të vazhdojë përkitazi me privatizimin dhe të tre grupeve të tjera, deri në prill të vitit 2005, atëbotë hyri në fuqi Urdhëresa 2005/12, e datës 2 prill 2005. Sipas kësaj Urdhërese, ndryshohet dhe plotësohet Urdhëresa 2002/12 për AKM-në. Kështu, ndryshohen dhe plotësohen nenet: 2,3,5,6,8,10,13,14,15 dhe 31. Këto nene kanë të bëjnë me qëllimet dhe kuptimin e ekzistimit të AKM-së, në raport me ndërmarrjet, likuidimin, politikat operative, përgjegjësitë, etj.⁶⁹ Të metat dhe vërejtjet në rregulloret e mëhershme ishin përmirësuar, dhe tash konsiderohej se mund të shpejtohej procesi i privatizimit. Me këto Urdhëresa, UNMIK-u përmes AKM-së, deri më 8 janar 2008, zhvilloi 30 radhë (grupe) të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ndërmarrjet Publike nuk ishin përfshirë në këto grupe të privatizimit.

Modeli i zgjedhur i privatizimit- Misioni Civil i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), përmes Departamentit të Tregtisë dhe Industrisë, në kuadër të Shtyllës së Katërt (IV), që nga fillimi ishin hulumtonin lidhur me modelin e privatizimit. Pas 4 vitesh vonesë, mundi filloi të shpërblehej. Modelet e zbatuara në vendet e tjera, të dala nga shthurja e ish Jugosllavisë, ishin të pa pranueshme. Po ashtu, modelet e aplikuara në vendet e Evropës Lindore, nuk u panë të arsyeshme që të zbatohen.

⁶⁹ Urdhëresa e UNMIK 2005/12 neni: 2,3,5,6,8,9,10,13,14,15 i31

Kështu, p.sh. modeli i faturave (voucherëve) nuk mundi të aplikohet, shkaku i mungesës së bazës ligjore të Kosovës. Kosova edhe pse kishte tiparet e shtetit, nuk ishte shtet. Ky model po ashtu, kishte probleme që të zbatohet. Kësisoj, kërkohej rruga për të gjetur një model të ri.

Risia e çështjes qëndronte në mënyrën se si duhej qasur procesit të privatizimit dhe, në këtë pikëpamje u shtruan dy aspekte:

1. shitje të ndërmarrjes, kryesisht të aktives së saj, kurse më vonë nëpërmjet procesit të likuidimit, përmbyllja e kërkesave të ndërmarrjes;
2. pasuria në formë të tokës të jepej me qira për 99 vite, shkaku i vështirësive që lidheshin për dokumentacionin kadastral.

Meqenëse dokumentacioni ishte shkatërruar gjatë luftës, ndërsa një pjesë ndodhej jashtë Kosovës (i plaçkitur nga ana e Serbisë).

Duke u nisur nga përvojat e procesit të privatizimit të zbatuara në shtetet tjera, me rastin e transformimit të pronës, UNMIK-u përmes AKM-së, procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore i rreket sipas modelit sipas modelit të tri formave:

1. spin-off i rregullt;
2. spin-off special dhe
3. likuidim.

Spin-off i rregullt „amputimi“ - Rregullat e tenderimit në bazë të spin-off-it të rregullt (e ashtuquajtur mbyllje e ciklit), ka kuptim të shitjes vetëm të aktives së ndërmarrjes. Në të vërtetë, në kuadër të ndërmarrjes ekzistuese formohen ndërmarrje të reja, kurse obligimet mbeten në ndërmarrjen e vjetër, të cilat do të shlyheshin gjatë procesit të likuidimit. Mjetet nga shitja derdhen në fondin e veçantë nën kontrollin e AKM-së, dhe shërbejnë për përmbylljen e detyrimeve ndaj furnitorëve, pronarëve dhe punëtorëve. Me këtë model nga ndërmarrja e vjetër, që privatizohet, mund të formohen më shumë ndërmarrje të reja.

Mjetet e grumbulluara nga shitja 20% sosh, iu takojnë punëtorëve, kurse 80% mbahen në fondin e mirëbesimit, të cilat shërbejnë për shlyerjen e borxheve që i kishte ndërmarrja e vjetër. Përpos një numri të vogël të detyrimeve (tatimi në pronë për 12 muajt e fundit, pagesa e shërbimeve publike për 3 muajt e fundit), pronari i ri i ndërmarrjes do të lirohej nga të gjitha detyrimet që i ka pasur ndërmarrja e privatizuar.

Spin-off special - Të gjitha rregullat që vlejnë për spin-off të rregullt, vlejnë dhe për spin-off special, përpos disa kufizimeve për pronarin e ri të ndërmarrjes. Pronari i ri, përmes kësaj metode, duhet të përmbush dhe këto detyrime, që janë të përkufizuara me rastin e tenderimit, si:

1. çmimi më i lartë tenderues,
2. investimet që duhet të bëhen në periudhën e përcaktuar,
3. mbajtja e punëtorëve aktual në punë dhe rritja e numrit të tyre gjatë periudhës së përcaktuar.

Likuidimi

Ky model përmbushet në përfundim të vitit 2013, dhe vazhdon gjatë vitit 2014. Me anë të këtij modeli shiten pjesët e mbetura më herët nga ndërmarrjet e privatizuar.

Në dy rastet e para, fjala është për shitje të bizneseve, kurse në rastin e tretë blerësi i ri nuk e blen biznesin, por vetëm asetet e tenderuar.

Duke analizuar veprimtarinë e AKM-së, arrijmë në konstatime, se janë realizuar gjithsej 30 valë (raunde) të privatizimit, dhe janë formuar 498 ndërmarrje të reja, me shumë të mjeteve të arkëtuara, prej 392,280,728 €, dhe janë nënshkruar 397 kontrata mbi shitblerjen. AKM pushon se ekzistuari, më 30 qershor 2008.

Valët e procesit të privatizimit, të kryera përmes AKM-së, do t'i paraqesim në formë tabelore;

Tabela 2- Procesi i privatizimit përmes AKM ⁷⁰

Vala br.	Numri i Ndërmarrjeve të Reja të krijuara	Data e tenderimit	Mjetet e gjeneruara nga shitja në Euro
1	5	V-2003	2,335,875
2	14	VII-2003	16,934,009
3	16	VII-2003	16,617,676
4	17	I-2005	18,228,850
5	22	VII-2005	43,703,200
6	30	VIII-2005	16,364,688
7	21	IX-2005	19,789,927
8	13	X-2005	10,229,961
9	13	XII-2005	16,742,836
10	13	II-2006	7,507,799
8b	4	II-2006	27,942,900
11	14	II-2006	10,428,113
12	16	III-2006	34,171,066
13	11	IV-2006	4,638,075
14	14	V-2006	5,674,397
15	16	VI-2006	6,810,594
16	24	VII-2006	7,199,734
17	18	IX-2006	6,443,533
18	19	X-2006	13,340,558
19	35	XII-2006	21,013,228
20	18	I-2007	11,584,839
21	18	II-2007	5,075,582
22	18	III-2007	8,721,695
23	10	IV-2007	5,867,817
24	19	V-2007	7,089,873
25	32	VI-2007	23,153,009
26	11	VII-2007	2,947,075
27	14	VIII-2007	3,681,991
28	9	X-2007	2,876,859
29	6	XII-2007	1,457,255
30	8	I-2008	13,707,715
Gjithsejtë:	498		392,280,729

Burim AKP

Nga tabela e mësipërme mund të vërehet, se valët më të suksesshme të privatizimit kanë qenë: V-më 2005, kur janë formuar 22 ndërmarrje të reja, me mjete të gjeneruar, prej 43,703,200 €, pason ajo e XII-ta, më 2006, me 16 ndërmarrje të reja dhe mjete të gjeneruar, prej 34,171,066 €, vala e XXV-të, më 2007 me 32 ndërmarrje të reja dhe 23,153,009 €, vala VIII b, më 2006, me 4 ndërmarrje të reja, dhe 27,942,900 €. Po ashtu, nga tabela vërehet se vetëm 3 valë të privatizimit paraqesin pjesëmarrjen, prej 26,97% nga shitja e përgjithshme.

⁷⁰ Burimi, Raporti i AKM-së Gusht 2008-Gusht 2009, fq.44

Procesi i likuidimit dhe privatizimi i ndërmarrjeve, me anë të metodës së likuidimit, po ashtu, ishte një nga prioritetet e AKM-së gjatë veprimit të saj.

Por, AKM-ja nuk ishte në gjendje të realizojë këso vëllime projektesh, nga arsye e mungesës së Komisionit të Likuidimit, posaçërisht për mungesë të personelit të nevojshëm. Kritikët e procesit të privatizimit nuk e lanë pa e cekur vlerën e ulët të pronës së shitur, sepse ishte fjala për një aktivë me vlerë relativisht të lartë, së paku sipas shënimeve kontabël, të dhëna në formë të bilanceve gjatë afarizmit të Ndërmarrjeve Shoqërore..

Procesi i privatizimit nëpërmjet AKM-së, që nga fillimi hasi në pengesa të natyrave të ndryshme. Që nga fillimi, obstrukcioni dhe pengesat që vinin nga Serbia ishin evidente, dhe kërkesat e saj për ndalje të menjëhershme të këtij procesi. Me anë të ankesave të shumta, dhe duke shfrytëzuar kanalet e tija diplomatike, shteti serb arriti që për pak kohë të ndalojë këtë proces. Serbia kërkonte që të jetë e përfaqësuar në procesin e privatizimit. UNMIK-u nuk i shqyrtoi asnjëherë këto kërkesa, dhe pezulloi të gjitha ligjet paraprake, përkitazi me transformimet që kishin ndodhur para 10 qershorit 1999, shteti i Serbisë ende e konsideronte pronë të saj, pronën e Kosovës.

3.4.3.1 Ndërmarrjet publike dhe AKM-ja

AKM-ja po ashtu,, ishte kompetente për menaxhimin e Ndërmarrjeve Publike, për të cilat parashihej ristrukturimi i tyre dhe pastaj privatizimi. UNMIK-u i kishte besuar AKM-së, që të bëjë menaxhimin e tyre, dhe njëkohësisht të vetë përgjigjej për suksesin a mosesuksesin e tyre. Në këto ndërmarrje (NP) bënin pjesë:

- ngrohtorja në Prishtinë dhe Gjakovë,
- korporata Energjetike e Kosovës (KEK),
- hekurudhat e Kosovës,
- aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës,

- posta dhe Telekom i Kosovës,
- Ndërmarrja e Ujësjetës dhe e Mbeturave.

Këto ndërmarrje kishin mbi 14.000 punëtorë, ato paraqisnin punëdhënësin më të madh në Kosovë. Nëse merret në konsideratë qarkullimi vjetor i mjeteve përmes këtyre ndërmarrjeve, ato ia jepnin kontributin më të madh Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Andaj, këto ndërmarrje kanë një peshë të madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Privatizimi i Ndërmarrjeve Publike nuk është kryer as nga ana e AKM-së , gjatë punës saj, as tashti nga ana e AKP-së (Agjencioni Kosovar i Privatizimit). Tashmë konsiderohet se këto ndërmarrje janë nën mbikëqyrjen e Qeverisë së Kosovës, dhe do të privatizohen nga ana e qeverisë. Nëse do të analizohej procesi i privatizimit deri më tash, mund të shfaqen dyshime për pa rregullsinë dhe për vijimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve publike.

3.4.4 Agjencionit Kosovar i Privatizimit (AKP)

Hapi i rëndësishëm për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, u ndërmor, më 26 mars 2007, kur Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, paraqiti raportin e tij mbi statusin e ardhshëm të Kosovës (S/2007/168/Add.1), mbi bazë të propozimit të Marti Ahtisari-t⁷¹ Në frymën e këtij propozimi, Kosova do të bëhet shtet i pavarur, që do të qeveris sipas kushtetutës së saj, por do të jetë e mbikëqyrur nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe e organeve ushtarake. Kosova do të ketë qeverinë e vet, mirëpo përfaqësuesi special do të ketë autorizime korrektuese. Këtë propozim Kuvendi i Kosovës e miratoi, dhe mbi këtë bazë shpalli pavarësinë me emër: Republika e Kosovës, me rregullim parlamentar, kurse më 15 qershor të vitit 2008, shpalli Kushtetutën e shtetit të Republikës së Kosovës. Në këto rrethana faktori ndërkombëtar dyhej të leshonte vendin faktorit vendor.

⁷¹ www.unosek.org/docref/report

Me kalimin e kohës ata do të mund të luanin rolin këshillues. Andaj edhe AKM duhej të lëshoj vendin një institucioni i cili do të merrej me procesin e privatizimit i cili do të kishte karakter vendor.

Puna e bërë përmes Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM), pati të meta të konsiderueshme. Me kalimin e kohës, ajo duhej të merrte formë tjetër, gabimet nga e kaluara nuk duhej përsëritur. Si pasuese e AKM-së u paraqit Agjencioni Kosovar i Privatizimit, ai (AKP) ishte shpresëdhënës. Tashti faktori ndërkombëtar kishte përgjegjësi shumë të kufizuara. Formimin e AKP-së duhet vështuar në kontekst të rrethanave që mundësuan krijimin e këtij institucioni..

Themelimi i Agjencionit Kosovar të Privatizimit- Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) është themeluar pas miratimit të Ligjit për Agjencionin Kosovar të Privatizimit (Ligji nr. 03/L067)⁷², që hyri në fuqi më 15 qershor 2008, (ne tekstin e mëtejme Ligji). Ky ligj do të zbatojë urdhëresat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, që nga 26 marsi i vitit 2007, (aneksi VII, Neni 2, i këtij ligji), i cili është pjesë e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, (Neni 145 i Kushtetutës së Kosovës).

Me këtë AKP-ja themelohet si një organ i pavarur publik, që ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe duke pasur të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe të kompetencave, të lejuara me këtë ligj, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

72 Ligj për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

KREU I

Statusi ligjor, qëllimet dhe përkufizimet

Neni 1

Themelimi dhe statusi ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”) themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj. Agjencia themelohet si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit të rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, me ndryshime, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Pas bartjes së këtyre kompetencave nga ana e UNMIK-ut, dhe shuarjes së funksionimit të Shtyllës së Katërt (IV), si dhe shpallja e shtetësisë së Republikës së Kosovës, pushoi nevoja e ekzistimit të Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit. Procesi i privatizimit duhej të vazhdonte. Duhet të aprovohen ligjet mbi bazë të së cilëve do të themelohej një institucion i ri, që do të vijonte punën e filluar.

Me miratimin e Ligjit nr. 03/L067, këto mundësi ishin reale. Agjencioni i ri trashëgoi dhe ligjet e tjera, të cilat nuk kishin karakter diskriminues.⁷³

3.4.4.1 Ligjet dhe rregulloret e Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP),

AKP-ja si pasuese e AKM-së, për procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, trashëgoi të gjitha ligjet pozitive, që nuk kishin karakter diskriminues. Ky vendim ishte marrë prej datës, 22 mars 1989. Kjo datë u mor nga fakti, se, më 23 mars 1989, nën presionin e rrethimit ushtarak Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome i Kosovës, kishte votuar ndryshimet në kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë. Kjo ngjarje është në harmoni me Rregulloren e UNMIK, nr. 1999/24, e datës 12 dhjetor 1999.⁷⁴

⁷³ Me ligje deskriminuese kuptohen të gjitha ligjet e aprovuara dhe zbatuara nga ana e ish Jugosllavisë (Serbisë) sipas të cilëve bëhej seleksionimi i njerëzve në baza nacionale, fetare, racore, apo ndonjë përkatësie tjetër me qëllim të arritjes së pozicioneve me të mira të një grupacioni të njerëzve, kombeve apo kombësive, në raport me përbërësit e tjerë të shoqërisë.

⁷⁴ Rregullore e UNMIK 199/24

PËR LIGJIN NË FUQI NË KOSOVË

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të përcaktimit të ligjit në fuqi në Kosovë,

Shpall sa vijon

Neni 1

LIGJI NË FUQI

1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:

Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe

Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

1.2. Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk

Po ashtu, edhe ligjet e tjera, që funksiononin më herët, dhe nuk kishin karakter diskriminues, ishin të zbatueshme në Kosovë. AKP-ja për punën e saj bazohet, jo vetëm në ligje që kanë të bëjnë me themelimin e saj, por edhe me ato, të cilat kanë të bëjnë me punën e përditshme, si :⁷⁵

- Ligji nr.02/ L-33, për investimet e jashtme,
- Ligji nr.03/ L-067, për Agjencionin Kosovar të Privatizimit,
- Ligji nr.03/ L-071 21.11, për borxhin e Ndërmarrjeve Shoqërore,
- Ligji nr.03/ L-109, për doganat dhe akcizën në Kosovë,
- Ligji nr. 03/L-113, për tatimin në qarkullim të korporatave,
- Ligji nr. 03/L-114, për tatimin në vlerën e shtuar,
- Ligji nr. 03/L-115, për tatimin në të ardhura personale,
- Ligji nr. 02/L-123, për shoqëritë tregtare.

Përpos ligjeve të përmendura për zbatimin e procesit të privatizimit, janë marrë edhe rregulloret tjera, si:

- Rregullorja nr. 2007/1, për drejtimet administrative,
- Rregullorja nr. 2005/48, për regjistrimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve,

është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj.

1.3.Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të gjithë personat me detyra publike ose që mbajnë pozita publike duhet të respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut siç pasqyrohen veçanërisht në:

Deklaratën universale të të drejtave të njeriut të 10 dhjetorit 1948;

Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut të 4 nëntorit 1950 dhe Protokollet e saj;

Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike të 16 dhjetorit 1966 dhe protokollet e saj;

- (a) Marrëveshjen ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 16 dhjetorit 1966;
 - (b) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial të 21 dhjetorit 1965;
 - (c) Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave të 17 dhjetorit 1965;
 - (d) Konventën kundër torturës dhe keqtrajtimit çnjerëzor dhe poshtërues apo degradues ose ndëshkues të 17 dhjetorit 1984;
 - (e) Konventën ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve të 20 dhjetorit 1989.
 - (f) 1.4 Asnjë person, i cili ushtron detyra publike apo mban ndonjë pozitë publike në Kosovë nuk lejohet të diskriminojë ndonjë person tjetër për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjes politike ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo sociale, shoqërimit me një komunitet kombëtar, pasurisë, lindjes ose të ndonjë statusi tjetër. Në procedurat penale, i pandehuri përfiton nga dispozita më e favorshme e ligjit penal në fuqi që nga data 22 mars 1989 deri në ditën e nxjerrjes së kësaj rregulloreje.
- 1.5Dënimi me vdekje hiqet. Kjo rregullore konsiderohet të ketë hyrë në fuqi më 10 qershor 1999.

75 www.pak-ks.org/ Këto ligje që të kenë bazën juridike kishin kaluar përmes procedurës së rregullt në Kuvendin e Kosovës.

- Rregullorja nr. 2001/30, për themelimin e këshillit për standarde dhe raporte financiare,
- Rregullorja nr. 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës,
- Rregullorja nr. 2000/13, për themelimin e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme.

Në bazë të këtyre rregulloreve dhe ligjeve, u hartuan rregullat ligjore, për vazhdimin e procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës.

3.4.4.2 Baza ligjore në funksion të zbatimit të procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës

Parimisht domosdoshmëria e procesit të privatizimit nuk ishte kontestuese asnjëherë. Inkorporimi(bashkimi) i Kosovës në botën moderne dhe demokratike, ku në aspektin ekonomik bazament është ligji i vlerës, kërkonte ekzistimin e pluralizmit pronësor , në dobi të pronës private, sepse ajo u dëshmuua se paraqet segmentin themeltar të zhvillimit ekonomik. Në këtë kontekst, privatizimi si koncept paraqet një proces ligjor të organizuar nga shteti, përmes të cilit prona shtetërore a shoqërore transformohet, respektivisht kalon në duart e pronarëve privatë, me qëllim që kjo pronë të jetë shumë më produktive, efikente dhe konkurruese për t'i përmbushur nevojat e shoqërisë (shërbimet e domosdoshme, të prodhimit, infrastrukturën, rritjen e taksave për shtetin, cilësinë dhe sasinë e prodhimeve dhe shërbimeve, etj).

Ky proces që nga fillimi kishte divergjencat e tij që pengonte rrjedhën normale.

- Fillimisht ky proces iu besua faktorit ndërkombëtar. Faktori vendor nuk u pyet fare, as për shprehjen e mendimit dhe gjetjen e formave të përshtatshme, që mund të ishin karakteristike e ekonomisë kosovare. Prania e tij në Bordin e Drejtorëve kishte qëllimin e maskotave për shfaqjen teatrale.

- U përcaktua baza ligjore mbi “përvojën” e ndërkombëtarëve, e cila që nga fillimi ishte mjaft e pa qartë, dhe jo gjithaq e lidhur me qëllimin përfundimtar që pritej të arrihej.
- Konfliktet pronësore, që ishin veçanti e procesit, edhe përkundër faktit se tash procesi i privatizimit është “në përfundim”, nuk arritën të zgjidhen në mënyrën më të drejtë.

Tashti, kur konsiderohet se mbi 70% procesi i privatizimit në Kosovë ka përfunduar,⁷⁶ mund të vërehen lehtë të metat e këtij procesi. Qëllim thelbësor për suksesin e këtij procesi ishte që ai t’i plotësonte kushtet, si: baza ligjore e qartë, drejtësia, transparenca, konkurrenca dhe konsensusi shoqëror. Konstatim i përgjithshëm lidhur me plotësimin e lëtyre kushteve, do të ishte se nuk është plotësuar në ploti asnjëri kusht, nga ato të cekurat, nisur nga vetë themelimi i Fondit të Privatizimit,⁷⁷ i cili nuk plotësoi kriterin bazë të themelimit, që ishte zhvillimi ekonomik i vendit.

Vështrimin në këtë pjesë do të përqendrohet në bazën ligjore, që u zbatua në këtë proces. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, si ligje të zbatueshme në Kosovë janë përcaktuar: ligjet në fuqi deri më 22 mars 1989, respektivisht para pezullimit të autonomisë së Kosovës, Rregulloret e UNMIK-ut, Ligjet e Kuvendit të Kosovës.

Ndërsa ligjet e nxjerra pas vitit 1989 janë konsideruar të zbatueshme, vetëm nëse kishte zbrazëti të ligjore dhe nuk janë të karakterit diskriminues.⁷⁸

⁷⁶ Procesi i privatizimit mund të konsiderohet i përfunduar, atëherë kur të kryhet edhe procesi i likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Lidhur me këtë çështje ende nuk mund të shihet dritë në tunelin e pafund, përkundër përpjekjeve dhe deklarimeve në kuadër të organeve qeveritare dhe vetë AKP-së

⁷⁷ Një prej vendimeve të debatueshme për ekonominë e Kosovës është Fondi i Privatizimit. Mjetet e këtij fondi nuk janë mjete për qarkullim në ekonominë e Kosovës, por Fond i izoluar, që në radhë të parë është formuar dhe ka qëllim të shërbejë për zgjidhjen e kontesteve pronësore në ndërmarrjet e privatizuar. Për dallim prej vendeve tjera në tranzicion, si p.sh Sllovenia, Kroacia, Hungaria, Çekia, Poloni, Gjermania Lindore, që kishin formuar Fonde të Zhvillimit, në mesin e të cilëve Fondi i Privatizimit ishte përdorur si Fond Zhvillimi. Në Kosovë ky Fond prima facie shërben për zgjidhjen e kontesteve pronësore, dhe si i tillë ende mbetet Fond i izoluar dhe nuk është përdorur për zhvillim ekonomik. 10 Sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEMDNJ), Protokoli, 1, neni 1, kërkohet sigurimi i mjeteve të nevojshme për kompensimin e pronarëve ose kreditorëve, nëse me veprime të shtetit merret prona për qëllim publik. Si qëllim publik dhe formë e shpronësimit kur ka konteste pronësore konsiderohet edhe privatizimi. Prandaj, një qëndrim i tillë në Kosovë, lidhur me Fondin e Privatizimit është në pajtim me kërkesat që dalin nga KLMDNJ. Një Fond i tillë nuk mund të shpenzohet, derisa të zgjidhen kontestet pronësore.

⁷⁸ Shih, Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 1999/24, për ligjin e zbatueshëm në Kosovë, e amenduar me Rregulloren, nr. 2000/59, neni 1.1 dhe 1.2: “1.1. Ligji në fuqi në Kosovë përfshin: a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe b)

Një prej defekteve kryesore është mungesa e saktësisht, se cilat ligje pas 22 marsit të vitit 1989, duhej të përjashtohen nga zbatimi, dhe cilat mund të zbatohen, por që nuk kanë karakter diskriminues.⁷⁹ Mungesa e një sqarimi të tillë, fatkeqësisht shtoi mundësinë, që shumë ligje të nxjerra pas vitit 1989 të zbatohen në praktikë.

Pas vendosjes së Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut, bazuar në Rregulloren nr. 1999/1 për administrimin e përkohshëm të Kosovës, UNMIK-u ishte përgjegjës për administrimin e pronës publike dhe shtetërore në Kosovë⁸⁰. Pavarësisht këtij fakti, shumë prona shoqërore dhe publike janë transformuar, respektivisht privatizuar, në përkim me ligjet e lëshuara nga Serbia, gjatë viteve të 90-ta, si rezultat i mos përjashtimit nga zbatimi i ligjeve të lidhura me transformimin (privatizimin) e pronës.

Me 17 shkurt 2008 është shpallur Pavarësia e Kosovës, e cila ka sjellë një situatë të re politike dhe juridike. Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 15 qershor 2008, të gjitha ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës, me të cilat janë ndryshuar Rregulloret e UNMIK-ut, janë ligje të vetme të zbatueshme. Një situatë e tillë, do të duhej të përkonte dhe me Ligjin Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), i miratuar në vitin 2008, me të cilin është ndryshuar Rregullorja e UNMIK-ut për AKM-në, nr. 2002/ 12. Si rezultat i këtij ligji, AKP-ja është themeluar si pasardhës i AKM-së, ndërsa të gjitha përgjegjësitë e AKM-së kanë kaluar në AKP .16

Ligjin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989. Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. 1.2 Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj

⁷⁹ Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/10 për shfuqizimin e legjislacionit për çështje banesore dhe të drejtat mbi pronën, vetëm dy ligje janë përjashtuar nga zbatimi në Kosovë - Ligji për Ndryshime dhe Shtesa në Kufizimin e Transaksioneve të Pasurisë së Patundshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, 22/91 e datës 18 prill 1991); dhe Ligji për Kushtet, Mënyrat dhe Procedurat e Dhënies së Tokës Bujqësore Qytetarëve që Dëshirojnë të Punojnë dhe Jetojnë në Territorin e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë (Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë, 43/91 e datës 20 korrik 1991).

⁸⁰ GAP, Haxhi Gashi- Analizë Politikash, Konflikti ligjor lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore: Ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, Ligjit për AKP dhe ligjet relevante, Prishtinë 2011

Kjo ka një rëndësi të veçantë, sepse i tërë procesi i privatizimit, duke përfshirë dhe përfaqësimin e rasteve pranë Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, duhej të udhëhiqej nga institucionet e Kosovës, respektivisht AKP-ja dhe jo AKM-ja.

Me gjithë këtë realitet të ri ligjor, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, ende e konsideron Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 për AKM-në ligj në fuqi, dhe nuk e njeh Ligjin e Kuvendit të Kosovës për AKP-në. Sipas Dhomës së Veçantë, vetëm AKM-ja është kompetente për t'i përfaqësuar rastet pranë gjykatës, pavarësisht faktit se pasojat juridike dhe ekonomike i bartë Kosova. Një qëndrim të tillë, Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, e mbështet në një Opinion Ligjor, të lëshuar nga zyra e UNMIK-ut, në vitin 2009; me të cilin sqarohet se cili ligj konsiderohet në fuqi rreth çështjeve të privatizimit. Pos tjerash, UNMIK-u ka shpjeguar se vetëm Rregullorja e AKM-së 2002/12, është ligji në fuqi dhe jo ligji për AKP-në, me arsyetim se Ligji i Kuvendit të Kosovës nuk mund t'i shfuqizojë Rregulloret e UNMIK-ut.⁸¹

Si pasojë e këtij opinionioni, Dhoma e Veçantë e njeh vetëm AKM-në kompetente për vendim përfundimtar, dhe përfaqësimin e rasteve pranë gjykatës. Kjo gjykatë nuk e njeh Ligjin për AKP-në, si ligj të zbatueshëm, por vetëm si rregullore të brendshme të Agjencisë së Privatizimit, por pa fuqi ligjore⁸².

Një qëndrim i tillë i Dhomës së Veçantë është shkelje e ligjit në Kosovë, e Kushtetutës së Kosovës dhe Planit Gjithëpërfshirës të Ahtisarit.⁸³

Më tej, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se Dhoma e Veçantë me veprimet e saja nuk e njeh Ligjin e nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës, që paraqet shkelje të Kushtetutës dhe vazhdon të injorojë ekzistimin e Kosovës si shtet⁸⁴.

⁸¹ UNMIK/RREG/2008/4- Clarification, 12 November 2009.

⁸² Shih Vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-09-0089, faqe III, ku thuhet shprehimisht: “Kjo nuk nënkupton se Dhoma e Posaçme e pranon Ligjin për AKP si ligj të zbatueshëm në Kosovë, por për të siguruar një proces privatizimi të drejtë dhe të sigurt, ky ligj duhet të konsiderohet si rregulla të brendshme të organizatës të vlefshme dhe detyruese brenda procesit të privatizimit”. Po ashtu shih Vendimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, ASC-09-0067, datë 9 Mars 2010, faqe, IV. Me këtë vendim gjykata e shpreh të njëjtin qëndrim duke e injoruar zbatimin e Ligjit për AKP.

⁸³ Shih, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ref. AGJ 109/2011, në rastin KI 25/10, Agjencia Kosovare e Privatizimit kundër Vendimit të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-089, të katër shkurtit 2010, paragrafët, 53-57.

Ndërsa Opinioni i GJND-së ka konfirmuar se shpallja e Kosovës si shtet ka qenë në harmoni të plotë me të drejtën ndërkombëtare, dhe nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244 të OKB-së. Në të drejtën e brendshme në Kosovë, mohimi i AKP-së si subjekt i plotë juridik dhe si palë në procedurë, është shkelje e rregullave procedurale përkitazi me përfaqësimin e drejtë të palës në procedurë gjyqësore civile;⁸⁵ por edhe shkelje e rregullave kushtetuese lidhur me një gjykim të drejtë.

Një veprim i tillë i Dhomës së Veçantë paraqet shkelje të nenit 6, të KEMDNJ-së (Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore), që garanton gjykimin e drejtë dhe të paanshëm në proceset gjyqësore⁸⁶. Mbi këtë platformë të kësaj çështjeje parashtrohet si domosdoshmëri, që sa më shpejtë duhet të ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut, 2002/13, që ka të bëjë me Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, si sovran për zgjidhjen e problemeve ligjore të procesit të privatizimit.

Ndryshimi i Rregullores nr. 2002/13, për Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, duhet të konsiderohet si çështje urgjente për të evituar konfliktin ligjor për privatizimin e NSH në Kosovë. Me ndryshimin e kësaj rregulloreje, do të përkufizoheshin qartë kompetencat e kësaj gjykate, duke e detyruar atë të njehte ligjet e Kuvendit të Kosovës, si ligje të zbatueshme. Në veçanti duhet të adresohet çështja e Ligjit për AKP-në dhe përfaqësimi i rasteve në këtë gjykatë. Këto fakte kanë qenë të njohura për institucionet e Kosovës, kanë qenë të këshilluara, që nga viti 2008 për të ndryshuar këtë rregullore, dhe për të nxjerr një ligj të ri për Dhomën e Veçantë, por diçka e tillë asnjëherë nuk u realizua.

⁸⁴ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i cituar, par. 53 në të cilin thuhet: “Ne këto rrethana, Gjykata vetëm mund të vijë në përfundim se Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk njeh dhe zbaton ligjet e miratuara ligjërisht nga Kuvendi. Në fakt, Dhoma e Posaçme thjeshtë vazhdon ta injoroi ekzistimin e Kosovës si shtet të pavarur dhe ligjet që burojnë nga Kuvendi i saj.”

⁸⁵ Ligji i procedurës kontestimore, nr. 03/L-006, neni 5, par. 1 i cili thotë: “Gjykata do t’i jep mundësi secilës palë që të deklarojë rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare”, dhe neni 7, par. 3 që thotë: “Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen” në lidhje me nenin 182, par 2, pika (i) e cila thotë: “182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë... (i) në qoftë se ndonjëri nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë

⁸⁶ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, neni 6

Një problem i kësaj natyre është theksuar vazhdimisht edhe nga AKP-ja në raportin pranë Kuvendit të Kosovës. Në këto raporte AKP-ja ka shfaqur brengosje për vështirësitë e marrëdhënieve me Dhomën e Veçantë, lidhur me përfaqësimin e rasteve të privatizimit. Institucionet, si duket, e kanë keqkuptuar situatën, duke menduar se me Ligjin e Gjykatave, të vitit 2010 është zgjidhur problemi i gjykatave dhe i Dhomës së Veçantë, që shpesh është dhënë arsyeimi “se nuk kemi nevojë për një ligj për Dhomën e Veçantë, që është organ i UNMIK-ut”. Kompetenca e Dhomës së Veçantë mund të ndryshohet, vetëm me ligj të veçantë për këtë gjykatë, respektivisht duke e ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13. Duke injoruar veprimin e kësaj gjykate, pasojat mund të jenë të mëdha, vlen të theksohet rasti për Trepçën, por dhe për vetë Fondin e Privatizimit, që duhet të adresohet sipas vendimeve të kësaj gjykate. I tërë Fondi i Privatizimit duhet të adresohet nga kjo gjykatë, bazuar në kërkesat e kreditorëve dhe të pronarëve potencialë ose të simuluar. Në anën tjetër, përfaqësimi i rasteve pranë Dhomës së Veçantë, nga ana e AKM-së është anakronike, kur dihet fakti se tashmë me Ligjin e AKP-së, vetëm AKP-ja është kompetente. Në vijim, AKM-ja nuk është treguar e frytshme për përfaqësim të disa rasteve pranë gjykatave, sepse me vetëdije ose pa vetëdijshëm ka humbur shumë raste të privatizimit, pos tjerash, vlen të përmendet rasti i Fabrikës së Çelikut në Ferizaj. Në këtë rast, Gjykata Komunale në Ferizaj e detyron Qeverinë e Kosovës, respektivisht AKP-në me 25.649.250 euro, me kamatë vjetore prej 3% në vit, nga viti 2002, që arrin një shumë afërsisht 30 milion euro, kompensim për pagat e punëtorëve të larguar nga puna, si rrjedhojë e masave të dhunshme të Serbisë në ndërmarrjet shoqërore gjatë viteve të 90-ta. Një vendim i tillë ka ardhur si pasojë e mos shfrytëzimit të ankesës kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr. 340/2001. Në këtë mënyrë, vendimi edhe pse i kundër ligjshëm, merr formën e prerë. Si rrjedhojë e kësaj, bazuar në parimin e drejtësisë, se vendimi i formës së prerë duhet zbatuar.

Gjykata Kushtetuese me një vendim, duke e konsideruar vendimin C.nr. 340/2001 si *res judicata* (çështje të gjykuar), urdhëron zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj: C.nr. 340/2001⁸⁷. Por, a është i ligjshëm vendimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj, C.nr. 340/2001? Kosova nuk mund të jetë përgjegjëse për veprimet e dhunshme në Ndërmarrjet Shtetërore, të ndërmarra nga Serbia gjatë viteve të 90-ta, përfshirë edhe largimin nga puna të punëtorëve. Ekzistojnë edhe raste ndërkombëtare kur shtetet nuk marrin përgjegjësinë për veprimet e një shteti tjetër. Rast i ngjashëm është ai i Gjermanisë, e cila nuk ka pranuar përgjegjësinë për kërkesat pronësore përkitazi me shpronësime, nga viti 1945, deri më 1949, si pasojë e Okupimit Sovjetik, me arsyetimin se Gjermania nuk mund të jetë përgjegjëse për veprimet e një shteti tjetër. Madje, as ndërmarrjet shoqërore, që janë në proces të privatizimit, nuk janë përgjegjëse për kompensim të çfarëdo page ose dëmi tjetër gjatë viteve të 90-ta.

NSH-të që priten të privatizohen, konsiderohen ndërmarrje, sipas statusit juridik që kanë pasur para 22 marsit 1989, respektivisht para suprimimit të autonomisë së Kosovës me dhunë nga Serbia⁸⁸. Ndonjë ndryshim në statusin juridik të tyre, pas vitit 1989, merret parasysh vetëm nëse është në pajtim me ligjin në fuqi që nënkupton Ligjet e Ante Markoviqit, para vitit 1989, dhe nuk janë të karakterit diskriminues. Ndërsa, çfarëdo ndryshimi i statusit të ndërmarrjeve shoqërore, pas vitit 1999, respektivisht pas vendosjes së administrimit ndërkombëtar, është i kundërligjshëm nga cildo organ, përfshirë dhe gjykatat, sepse UNMIK-u, e më vonë AKM-ja ishin përgjegjëse për administrimin e pronës shoqërore dhe publike. Përkitazi një vendim të këtillë, asnjëherë nuk është menduar për pasojat sociale, që do të mund të pasonin në nivel të vendit.

Fakte shtesë për mos-besueshmëri të AKM-së për përfaqësim të rasteve pranë gjykatave, është edhe asgjësimi i shumë dokumenteve në kohën e dorëzimit të

⁸⁷ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Ref.nr.:AGJ 75/2010, datë 17 Dhjetor 2010

⁸⁸ Rregullorja nr. 2002/12 për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, neni 5.

funksionit të AKM-së, të AKP-ja, që vë dyshime çështjen me transparencën e funksionimit të AKM-së⁸⁹.

Edhe në një raport i OSBE-së është kritikuar puna e Dhomës së Veçantë, sepse vepron në një ambient të paqartë ligjor, dhe me procedura jo publike është vënë në pikëpyetje paanshmëria e gjyqtarëve⁹⁰.

Prandaj, qëndrimi i Dhomës së Veçantë, se vetëm AKM-ja mund të përfaqësojë rastet pranë gjykatës, dhe injorimi i ekzistimit të Ligjit për AKP-në dhe vetë AKP-ja, si subjekt juridik dhe përfaqësues legjitim, është në çdo aspekt i kundërligjshëm për rrethanat politike dhe juridike në Kosovë. Se sa të rëndësishme janë rastet pranë Dhomës së Veçantë dhe vetë roli i kësaj gjykate për vendimmarrje, tregon edhe vendimi i Dhomës së Veçantë, me të cilin kërkohet vendosja e një Administratori Ndërkombëtar për Trepçën.

Çështje kontestuese do të mbetet se a duhet Trepça të privatizohet. Mendoj se së paku në forma të deri tanishme dhe me metoda, të cilat u dëshmuar si jo të përshtatshme, me një bazë ligjore aktuale, një privatizim kështoj do të ishte i pa arsyeshëm.

Ndonëse u konsiderua si i përsosur Ligji për AKP-në, 03/L-067, jo-efikasiteti i tij, kërkon ndryshim urgjent. Ligjin për AKP-në duhet të shtohet shprehimisht, se përfaqësimi i rasteve të privatizimit nga AKM-ja është i ndaluar, kurse vetëm AKP-ja është me kompetencë.

Ligji për AKP-në nuk jep ndonjë zgjidhje, sa u përket kërkesave pronësore të ish-pronarëve, përpos se thuhet, që kërkesat pronësore nuk e ndalin procesin e privatizimit, ndërsa këto kërkesa mund të kompensohen nga fondi i privatizimit. Prandaj, në këtë ligj duhet të saktësohet se nëpërmjet tij shfuqizohet çdo ligj i nxjerrë nga Serbia pas viti

⁸⁹ Raporti 2008-2009 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, fq. 8, 15, dhe 16. Në këtë raport janë paraqitur dëshmi të djegies dhe asgjësimit të dokumenteve të privatizimit nga AKM

⁹⁰ Raporti i OSBE-së, Privatizimi në Kosovë: Shqyrtimi Juridik i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, Maj 2008, fq. 42.

1989, që ka të bëjë me kthimin e pronave, ose formave tjera të privatizimit, deri në nxjerrjen e një ligji përkatës për trajtimin e kërkesave pronësore të ish-pronarëve. Në Ligjin për AKP-në, duhet të sqarohet çështja e Fondit të Privatizimit, dhe të krijohet mundësia që këto mjete të investohen për ekonominë e Kosovës, në mënyrë që të gjenerohen vende të reja të punës.

Procesi i likuidimit që nga viti 2013 iu besua Deloitte. U konsiderua se ky proces do të përshpejtohej. Puna e ngadaltë dhe jo-transparenca (hapja) e pamjaftueshme, përkundër faktit që marrëveshja e bërë kishte çmim të lartë, në këso rastesh transparenca asnjëherë nuk u bë publike në formë reale. Ky proces kërkonte, po ashtu, rishqyrtim të menjëhershëm përderisa ende mund të arrihej pikësynimi për të ruajtur kohën si faktor i çmuar. Kësisoj kërkohej që sa më shpejt të shfuqizohet Rregullorja 2005/48, që ka të bëjë me riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve e të pasurisë së tyre, me anë të autorizimit administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Kjo rregullore që paraqet bazën kryesore ligjore, mbi të cilën do të zgjidhen kërkesat pronësore dhe të kreditorëve, gjatë procedurës së likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore; duhet të ndryshohet dhe të shndërrohet në njërin nga ligjet e rëndësishme të Republikës së Kosovës. Rregullorja aktuale ka mjaft referenca, të cilat e ngarkojnë vetëm AKM-në, si përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve rreth privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Prandaj, nuk duhet lejuar baza të tilla ligjore, që gjykatat të thirren për marrje vendimesh të vlefshme në kontestet pronësore. Rregullorja nr. 2005/48, nuk parasheh mundësi, që disa ndërmarrje të riorganizohen dhe të transformohen në ndërmarrje publike.

Andaj, do të ishte me interes për disa ndërmarrje vitale për ekonominë e Kosovës, që tu njihej statusi i ndërmarrjeve publike. Ndërsa, privatizimi i tyre për qëllime të zhvillimit ekonomik, mund të bëhej sipas metodës së privatizimit të ndërmarrjeve

publike, respektivisht dhënies me koncesion ose nga marrëdhëniet e partneritetit publik-privat.

Nxjerrja e Ligjit për Denacionalizimin e ndërmarrjeve, është një prej ligjeve që duhej konsideruar, si pako e ligjeve për privatizim. Edhe pse ndoshta nuk është momenti, që Kosova t'i hynte zgjidhjes së këtij problemi mjaft të ndërlikuar, përmbushja është e domosdoshme për arsye se një numër i konsiderueshëm i kërkesave pronësore në gjykata, janë të lidhura me kthimin e pronave të nacionalizuara, ose të shpronësuar gjatë periudhës së komunizmit. Gjithsesi, në procedurën e likuidimit, duhet të trajtohen kërkesat e këtilla pronësore. Prandaj, mungesa e një baze të qartë ligjore, mund të lejonte zbatimin e ligjit në mënyra të ndryshme, për raste të njëjta. Fakti se ende nuk janë shfuqizuar ligjet e Serbisë, të nxjerra pas vitit 1990, përkitazi me kthimin e pronave, aktualizon rrezikun e zbatimit të ligjeve të tilla nga ana e gjykatave, meqë diçka e tillë ka ndodhur realisht.

Kështu, ligji për denacionalizim është i domosdoshëm për një qartësi në procedurën e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, dhe për zgjidhje të kontesteve pronësore të kësaj natyre, në mënyrë të njëjtë për të gjithë qytetarët.

Nuk ekziston ndonjë akt ndërkombëtar, që i detyron shtetet për kthimin e pronave të nacionalizuara gjatë periudhës së komunizmit. Madje, as praktika e Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nuk ka mundur t'i detyrojë shtetet për kthimin e pronave, për shkak se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, me protokollin 1, neni 1, nuk parasheh veprime retroaktive, në kohën kur kanë ndodhur procesi i nacionalizimit të pronave; sepse këto vende nuk kanë qenë nënshkruese të Konventës së lartpërmendur.

Në Kosovë situata paraqitej ndryshe nga vendet tjera, sa i përket këtij problemi⁹¹. Është thënë më lartë se ligjet e Serbisë për kthimin e pronave (denacionalizimin) nuk janë shfuqizuar.

Si rezultat i këtij defekti ligjor, në Kosovë ka mjaft raste, ku një kategori e qytetarëve (pjesa më e madhe e nacionalitetit serb, por pa i përjashtuar edhe të tjerët); duke i shfrytëzuar këto ligje i kanë kthyer pronat që u morën gjatë periudhës së komunizmit.

Madje, tashmë ato prona shiten lirisht në treg. Në kategorinë për kthimin e pronave, gjithsesi janë edhe ato bujqësore e banesat. Prandaj, ekziston kategoria tjetër e qytetarëve, që nuk i kanë shfrytëzuar këto ligje, si bazë për kthimin e pronave të tyre. Nëse brenda një shteti ekzistojnë baza ligjore, mbi të cilat disa qytetarë realizojnë të drejtën e kthimit të pronave, ndërsa pjesa tjetër e qytetarëve nuk e gëzon këtë të drejtë, kjo paraqet shkelje të nenit 14, nenit 1 të Protokollit 1, dhe Protokollit 12 të KEMDNJ; këto ligje sigurojnë mbrojtjen e pronës dhe trajtimin e barabartë të gjithë qytetarëve para ligjit.³⁸ Në anën tjetër, për mungesë të bazës së qartë ligjore, mund të supozohet se gjykatat e rregullta vendore, përfshirë dhe Dhomën e Veçantë, do të vazhdojnë t'i shfrytëzojnë ende këto ligje si bazë për zgjidhjen e kontesteve të kësaj natyre.

Kosova nuk duhet të lejojë që çështja e kthimit të pronave të zgjidhet në mënyrë të pa përqendruar, sipas stihive të çastit, ashtu që duke shfrytëzuar hapësirat ligjore, të shfrytëzohen ligje që bien ndesh me ligjet e privatizimit, respektivisht Rregulloren për AKM-në dhe Ligjin për AKP-në.

Kjo situatë ligjore lejon një **formë spontane për kthimin e pronave**, të cilin shtetet tjera post-komuniste e kanë evituar, duke funksionalizuar sistem të centralizuar, me anë të Planit Strategjik për kthimin e pronave. Përvojat e të tjerëve na mësojnë për mënyrën e kompensimit, respektivisht për të drejtën e nxjerrjes së ligjeve përkatëse. Kosova ka

⁹¹ GAP, Haxhi Gashi- Analizë Politikash, Konflikti ligjor lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore: Ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, Ligjit për AKP dhe ligjet relevante, Prishtinë 2011

nevojë të hartojë një Plan, për mënyrën e trajtimit të kthimit të pronave, në mënyrë të njëjtë për të gjithë qytetarët. Kosova duhet të marrë qëndrim politik dhe juridik: si të kthehen këto prona?

Në çfarë shume mund të kompensohen? Cila do të jetë baza ligjore e sistemit ish-komunist, që do të mund të thirreshin ish-pronarët për kthimin e pronave?

Në këtë kontekst, Kosova ka nevojë për një infrastrukturë ligjore, mbi bazën e së cilës do të zgjidheshin pozitivisht kontestet e tilla pronësore. Me këtë sistem ligjor, do të pengohet nxjerrja e vendimeve që nuk kanë për bazë qëllimin publik dhe interesin e vendit.

3.4.4.3 Zbatimi i ligjshmërisë në funksion të procesit të privatizimit

Ajo që u përcaktua ligjshëm për tu zbatuar, me rastin e procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nuk u respektua në plotësi. Shkaku i kësaj u paraqitën devijime gjatë zbatimit të këtij procesi.

1. Në procesin e privatizimit në Kosovë ekzistojnë konflikte ligjore, si pasojë, për marrjen e vendimeve gjyqësore, mund të shërbejnë baza të ndryshme ligjore. Në këtë drejtim, nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme nuk respektohet sistemi juridik i Kosovës.
2. Kundërshtimi i përfaqësimit të rasteve nga AKP-ja në Dhomën e Veçantë, mohon të drejtën e institucioneve të Kosovës përkatësisht të AKP-së, për mbrojtjen e interesave ekonomike-pronësore në rastet gjyqësore të lidhura me privatizimin.
3. Për disa ndërmarrje, me interes vital në Kosovë, institucionet e Kosovës tashmë nuk kanë fuqi vendimmarrëse politike, sepse rastet e tilla ndodhen në procedurë gjyqësore në Dhomën e Veçantë. E drejta e Kosovës mbrohet vetëm përmes përfaqësimit të drejtë në gjykatë. E drejta e këtillë, është tejte e ngushtuar ose e mohuar, për faktin se AKP-ja përjashtohet nga përfaqësimi.

4. Në Kosovë mungon baza ligjore që disa ndërmarrje shoqërore, me interes vital për Kosovën, të transformohen dhe shndërrohen në ndërmarrje publike, kurse privatizimi i tyre të realizohet me anë të metodës së privatizimit të ndërmarrjeve publike, ose partneritetit publik-privat.

5. Baza e pa qartë ligjore dhe mos-shfuqizimi i ligjeve të Serbisë, të nxjerra pas vitit 1989, përkitazi transformimit të pronës (privatizimit), ka lejuar hapësirë ligjore, që këto ligje të shfrytëzohen për kthimin e pronave (prona bujqësore dhe e banesave), të një numri të konsiderueshëm të ish-pronarëve, pronat e të cilëve janë nacionalizuar gjatë periudhës së komunizmit. Për trajtimin e këtyre rasteve, nuk ka bazë ligjore e nxjerrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

3.4.5 Struktura organizative e Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP)

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është përcaktuar edhe struktura e punës së kësaj agjensie. Struktura organizative e AKP-së është e ndarë në tri fusha funksionale:

- **Divizioni i Shitjes dhe Realizimit të mjeteve**, nën drejtimin e Zëvendësit të Drejtorit Ekzekutiv;
- **Divizioni i Qeverisjes së Korporatave**, nën drejtimin e Zëvendësit të Drejtorit Ekzekutiv;
- **Organi ekzekutiv** nën mbikëqyrjen direkt të Agjencionit, kurse Njësia për Revizionin interno dhe ajo për Media, i raportojnë Drejtorisë së Agjencisë e, në raste të rralla Këshillit(Bordit) Drejtues të AKP-së.

Divizioni i Shitjes dhe Realizimit të mjeteve përbëhet nga dy njësi:

- njësia e shitjes,
- njësia e likuidimit.

Divizioni i Qeverisjes së Korporatave përbëhet nga:

- njësia Trepça,
- njësia për Kontroll dhe Monitorim,
- njësia e Administrimit direkt,
- Njësia për Mbikëqyrje.


Nëndegët ekzekutive përbëhen nga Zyrat Rajonale të udhëhequra nga:

- njësia për bashkëpunim rajonal,
- njësia për buxhet dhe financa,
- njësia juridike,
- njësia e administratës,
- njësia e shërbimeve të kuadrove.

Bordin e Drejtorëve e përbëjnë 8 anëtarë të emëruar, nga të cilët 5 janë të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, kurse 3 të tjerë janë të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara. Po ashtu, një anëtar është përfaqësuesi i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Një anëtar nga këta ka karakterin e kryesuesit, një është zëvendës, kurse të gjithë të tjerët kanë pozita të drejtorit.

Në formë të organogramit është paraqitur struktura organizative e AKP-së:

Tabela 4 - Organogrami i AKP-së



4 Kapitulli IV Metodologjia

4.1 Metodat dhe metodologjia e kërkimit

Çështje themelore e dijes është mbledhja, sistematizimi dhe begatimi i njohurive paraprake me njohuri të reja, me qëllim të zbatimit praktik. Kjo parashtrohet si domosdoshmëri në hartimin e këtij studimi, si njëjtësim (inkorporim) i të gjitha metodave të mundshme, që si rezultat përmbyllës do të kenë arritjen e qëllimeve të parashtruara.

Metodologjia⁹² e punës shkencore kërkimore ,puna shkencore kërkimore, bëhet më e kapshme dhe më e lehtë, nëse mbështetet në metodologjinë përkatëse, të ndërtuar dhe të verifikuar. Termi metodologji gjenezën e ka nga greqishtja, përkatësisht nga fjala *methodos*, që do të thotë: mendim, qasje, përpunim dhe fjala tjetër *logos*, që do të thotë: fjalë, shqyrtim. Lidhshmëria e këtyre dy fjalëve e përbënë togfjalëshin metodologji. Pra, metodologjia (gr. *methodos* + *logos* = fjalë, bisedë, të folur = shkenca e metodave të kërkimeve shkencore). Pra, metodologjia është shkencë për metodat e kërkimeve shkencore. Në kuptim të gjerë metodologjia është shkencë e tërësisë të të gjitha formave dhe mënyrave të kërkimit, me ndihmën e të cilave vjen deri te dituria shkencore e sistemuar dhe objektive. Ose “metodologjia është disiplinë shkencore, në të cilën në mënyrë kritike vështrohen dhe me qasje eksplicite shfaqin metoda të përgjithshme dhe të veçanta”. Në shkencë veçohet metodologjia e përgjithshme, si dhe metodologjia e lëmenjve të veçantë shkencorë, përkatësisht e disiplinave. Metodologjia e ka kuptimin e qasjeve, të teknikave dhe të metodave për të mundësuar punët shkencore kërkimore, me qëllim të gjetjes dhe qartësimit të të vërtetave objektive, të ligjshmërive dhe të lidhjeve në mes të ligjeve në natyrë dhe në shoqëri. Metodologjia është udhërrëfim farkëtim, hyrje dhe finalizime të proceseve shkencore kërkimore.

⁹² Ali Jakupi Metodologjia e punës shkencore kërkimore, 2005, Ligjerata te autorizuar f.17

Metodologjia e punës shkencore kërkimore është e pranishme në të gjitha fushat, sektorët, segmentet, në të gjitha disiplinat, qofshin të karakterit ekzakt, psikologjik, pedagogjik, të shkencave humanitare, ekonomike, juridike, etj. Me zbatimin e metodologjisë shkencore kërkimore lehtësohen, përvetësohen mënyrat e hulumtimit për të sublimuar aktivitetet në rezultate, të cilat janë në funksion në të tashmen, por edhe për gjeneratat që vijnë. Dituritë shkencore përfshijnë identifikimin e esencës së lidhjeve ndërvlarësore, në mes të sendeve, dukurive, pra, të ligjshmërive që janë të involvuara në to. Duke i zbuluar dhe kuptuar këto fenomene, të qartësuara nga kërkimet shkencore, mundësohet manipulimi i tyre, mbizotërimet në çështjet që rezultojnë efekte të caktuara. Metodologjia e punës shkencore kërkimore në fushën e ekonomisë është e përqendruar në spektrin e metodave dhe të qasjeve, me qëllim të operacionalizimit të çështjeve, si segmente që mund të gjurmohen dhe të efektuohen në rezultate dobiprurëse, përvetësimi i metodologjisë në mënyrë të mirëfilltë, është një paraprijësae dhe parakusht për t'i vënë në spikamë ligjshmëritë, të cilat ndikojnë në zhvillim, në begatimin e indikatorëve kryesorë ekonomik, në ndikimin e ndryshimit të sjelljeve të prodhuesve, të konsumatorëve, të dhënësve të shërbimeve, siç janë bankierët, institucionet bankiere dhe institucionet tjera financiare.

Duhet pasur të qartë se metodologjia e njëjës shkencë nuk është identike me shkencën tjetër. Kështu, edhe metodologjia e punës shkencore kërkimore në ekonomi nuk është plotësisht e njëjtë me metodologjitë kërkimore në disiplinat e tjera shkencore. Megjithëkëtë, nuk duhet të kuptohet se në mes metodologjive shkencore kërkimore ekziston ndasi e plotë. Përkundrazi, ekzistojnë parime, qasje dhe metoda të përbashkëta, të cilat adaptohen nëpër lëmenj të caktuar shkencorë, për shkak të specifikave dhe të dallimeve që ekzistojnë në përmbajtje, në madhësi dhe në procedurat teknike. Me rastin e hartimit të këtij punimi, pasi që vetë procesi i privatizimit në Kosovë është specifik dhe i veçantë, edhe metodat e hulumtimit janë paksa më specifike. Kjo ka të bëjë në

rradhë të parë në pa mundësinë e krahasimit të këtij procesi me ndënjë tjetër të ngjashëm në botë, edhe pse megjithatë është përdorur metoda e krahasimit.

Burime kryesore të shënimeve që kanë shërbyer për hartimin e këtij studimi, kryesisht janë ato të natyrës parësore. Përkundër një jo transparence të këtij procesi, shpeshherë dhe mbylljes hermetike të qarkullimit të informatës, megjithatë nuk kanë munguar përpjekjet për sigurimin sa më të bollshëm të tyre. Burime të tjera të referimit janë të grumbulluara nga ndërmarrjet që kanë kaluar këtë proces, mandej shkrimet gazetareske, revistat, interneti dhe publikimet tjera.

Po ashtu, nga literatura janë shfrytëzuar shënimet e mundshme, që kanë të bëjnë me procesin e privatizimit në përgjithësi, dhe atë të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë, në veçanti.

Metoda deduktive studimit tim i shërben që nga e njohura dhe e përgjithshmja, të arrijë deri te ajo që është individuale dhe e veçantë. Për qasjen time kjo ka kuptim, sepse analiza e procesit të privatizimit, së pari zë fill nga përkufizimi i çështjeve dhe kategorive që kanë të bëjnë me termin pronë. Privatizimi ka të bëjë me pronën. Prona është ajo e cila duhet transformuar, ajo është çështje e studimit. Si e tillë ajo do të paraqitet si problem bazik. Gjatë punimit të disertacionit metoda deduktive do të vie në shprehje në analizën e rrënjëve të procesit të privatizimit. Analiza dhe deshifrimi i të kuptuarit të kategorisë së pronës do të jetë hapi fillestar. Nga prona fillohet çdo gjë në analizën e procesit të privatizimit. Pas sqarimit të kategorisë së pronës (e cila për sa është kategori ekonomike , për aq është kategori juridike) vazhdohet drejtë llojeve të sajë në periudha historike. Në këtë formë shkohet drejtë të veçantës që ka të bëjë me transformimin e sajë përmes procesit të privatizimit. Procesi i privatizimit në disa vende të Evropës do të jetë vazhdimi i kësaj metode.. Analiza e procesit të privatizimit vazhdon duke u bazuar në këtë metodë duke shqyrtuar procesin e privatizimit në vendet e ish Jugosllavisë të cilat u krijuan pas çthurrjes së saj, për të ndjekur pastaj

kronologjinë e filleve dhe vazhdimin e procesit të privatizimit në Kosovë. Këtu gjithsesi do të hyjë analiza e procesit të privatizimit, përmes Zyrës Rajonale në Gjilan, dhe së fundi rrjedhoja e disa rasteve konkrete pas qasjes përkatëse, duke dhënë zgjidhje dhe rekomandime për këtë proces të vijueshëm.

Metoda statistikore më shërben për krahasimin e të dhënave statistikore për periudha kohore, kryesisht për të dhënat nga rajoni i Gjilanit, me pjesë të tjera të Kosovës, dhe përmes procesit të privatizimit në aspektin më të gjerë të ngërthyer në brendinë e tij. Evoluimi i ish Ndërmarrjeve Shoqërore në periudha kohore është i ndryshëm. Analiza e indeksit të zhvillimit të tyre do të jetë e mundur përmes metodës statistikore. Efektet e pritura dhe të realizuara gjatë analizës së rezultateve të arritura dhe rekomandimeve do të jenë të arritshme përmes kësaj metode.

Metoda e krahasimit mëtimin tim i shërben si metodologji e mëvetësishme për të dhënat e afarizmit të Ndërmarrjeve Shoqërore, para dhe pas procesit të privatizimit, duke krahasuar treguesit të cilët pasqyrojnë periudha të caktuara kohore. Procesi i privatizimit në Kosovë, duke u bazuar në veçantinë e tij, nuk mund të krahasohet bazuar në metodat e zbatimit krahasuar me vendet e tjera. Në Kosovë u zbatuan metoda të panjohura më herët gjatë procesit të privatizimit. Mirëpo metoda krahasuese gjatë gjithë punimit do të jetë në funksion duke krahasuar gjendjen para procesit të privatizimit dhe gjendjen pas privatizimit. Kjo metodë nuk gjen zbatim të njëjtë në të gjithë kapitujt për arsye të specifikave që kanë.

Metoda analitike doemos është zbatuar në të gjitha rastet, duke përdorur PEST analizën, ngase për rastin konkret gjen zbatim në të gjitha format e paraqitjes së pronës. Metoda analitike me shërben gjatë punimit në analizimin e faktorëve të jashtëm të cilët shprehin influencën e tyre në procesin e privatizimit. Ndikimi i këtyre faktorëve edhe pse nuk mund të kontrollohen kanë forcën e influencës të ndryshme. Analiza dëshmon se procesi i privatizimit në Kosovë është i determinuar nga situata ekonomike, politike,

sociale e më pak nga ajo teknologjike. Së bashku me metodat e tjera të sipërpërmendura, metoda analitike do të vështroj edhe etapat kohore të zhvillimit të procesit.

Metoda e anketimit- Me qëllim të begatimit të punimit, metoda e anketimit paraqitet si element i sigurimit të të dhënave primare. Ndërmarrjet e privatizuara në Kosovë kanë karakter të njejtë sepse transformimi ndodhi me metoda të njejta dhe në kohë të njejtë, andaj metoda e anketimit mund të shërbekj si mostër e tërë ecurisë së privatizimit. Kjo ka qenë pjesa më e vështirë e hulumtimit sepse pronarët e ndërmarrjeve të reja të privatizuara hezitojnë të japin shenime mbi ecurine e ndërmarrjes pas procesit të privatizimit. Sidoqoftë, përmes kësaj metode nuk ka qenë tendencë që të anketohen sa më shumë ndërmarrje (sidomos në regjionin e Gjilanit), mirëpo megjithatë janë përdorur edhe të dhëna nga metoda e anketimit aty ku kanë ekzistuar mundësitë.

Metoda deskriptive- është mjaftë preyente gjatë punimit me qëllim të begatimit të punimit dhe përmes sajë, së bashku me metodat tjera, të përshkruhen ndodhitë në mes dy situatave të ndryshme e pastaj përmes ndonjërës nga metodat tjera të arrihet përfundimi i kërkuar.

Gjatë hartimit të këtij punimi është kërkuar një pikënisje. Konsideroj se kjo është kategoria e pronës. Problemi vështirësohet kur duhet definuar atë gjatë periudhave të ndryshme kohore. Një nga tendencat, të cilat besoj të kem arrijtur qëllimin, është që lexuesi të mundet të ndjek një kronologji të ndodhive dhe të kuptoj se në Kosovë ndodhi procesi i privatizimit të pronës të emëruar “shoqërore”, proces i cili do të lë pasoja edhe për gjenerata të cilat do të vijnë, proces për të cilin megjithatë do të lindin pyetje se si ishte e mundur të zhvillohej në këtë mënyrë.

5 KREU V : Analiza e të dhënave

Procesi i privatizimit në Republikën e Kosovës është zhvilluar përmes pesë zyreve rajonale dhe stë : Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjilan. Kordinimi i këtyre zyrave rajonale është bërë përmes zyrës qendrore në Prishtinë. Një ndarje e tillë është bërë me qëllim të menaxhimit sa më efikas të procesit. Në rastin tonë si rast studimor është marr procesi i privatizimit përmes Zyrës Rajonale Gjilan jo nga fakti i rëndësisë që ka kjo zyre krahasuar me të tjerat, mirëpo nga arsya se autori i këtyre rreshtave punon në cilësinë e zyrtarit për privatizim për këtë rajon në njerën anë dhe në anën tjetër metodat, rregullat dhe mënyra e privatizimit është unike për të gjitha nzyret rajonale. Andaj përmes analizës së privatizimit përmes Zyrës Rajonale Gjilan shpresoj të kemi përfshirë tërësinë, pa pretendime që të analizojmë çdo gjë që ka ndodhur me këtë proces, sepse është fjala për një proces me vëllim të madh dhe në kohë të stërzgjatur, tani janë afro 14 vite kurse ende nuk shihet dritë në tunel drejtë përfundimit të këtij procesi.

5.1 Të gjeturat dhe analiza e studimit

Analiza e të gjeturave nga procesi hulumtues i procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, do të shqyrtohet në aspektin historik dhe territorial të ndodhisë së procesit. Paraqitja e të dhënave do të kushtëzohet:

- nga procesi i privatizimit përmes Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, që paraqet periudhën fillestare (2003-2008);
- të gjeturat dhe analiza e të dhënave nga procesi i privatizimit përmes Agjencionit Kosovar të Privatizimit (2008-2013);
- të gjeturat dhe analizat e të dhënave përkitazi me procesin e privatizimit përmes Zyrës Rajonale në Gjilan.

5.1.1 Të gjeturat dhe analiza e studimit të procesit të privatizimit përmes AKM- (Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit)

Qëllimi parimor i procesit të privatizimit nëpërmjet AKM-së ishte që të nxitet zhvillimi ekonomik i vendit, me qëllim të krijimit të parakushteve ekonomike, politike, sociale dhe etike, që Republika e Kosovës të mund t'i bashkëngjitej botës së zhvilluar dhe demokratike, ndërsa ekonomia e këtij vendi të lirohet nga kontrolli shtetëror.

Do të ishte me vlerë shqyrtimi i ekonomisë së trashëguar, dhe efektet pas procesit të privatizimit përmes AKM-së. Sipas të dhënave statistikore, ekonomia e Kosovës, e viteve të 90-ta dhe periudha pas vitit 1999, ishte e ngjashme me zhvillimin ekonomik, të atillë që e kishte Kosova në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar⁹³.

- Prodhimi shoqëror ishte i përgjysmuar në krahasim me atë të viteve të 70-ta.
- Investimet në ekonomi ishin për 13 herë më të vogla.
- Eksporti ishte 7 herë më i vogël.
- Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese ishte gjithsej 10 %.
- Mungoi kuadri me shkollim të lartë.
- Konsolidimi financiar dhe investimet nuk kishin dhënë rezultate.
- Prodhimi ishte joracional.

Kjo situatë ishte edhe më e rënduar gjatë viteve të 90-ta dhe fillimi i dhjetëvjetëshit pasues. Prodhimi i energjisë, po thuaj, ishte ndërprerë, tregtia dhe keqpërdorimi ishin në rritje, etj. Gjatë periudhës kohore 1999-2004, vërehen ndryshimet e para. Mjetet financiare, kryesisht nga donacionet e jashtme, sollën deri te ndryshimi i një gjendjeje që jepte shpresë mbarësie. Në këtë periudhë kohore dëndur u kritikua qeveria se përpjekjet e saj ishin të vogla, për të nxjerrë shoqërinë nga varfëria. Donacionet nga jashtë, në njërën formë ose tjetrën, filluan të kthehen nga vendet që i dërgonin. Kështu, gjatë periudhës 2000-2009, kemi një rritje ekonomike gjithsej 4-6%, që ishte mjaft

⁹³ Gazeta Jedinstvo, Prishtinë, 02. Mars. 1997

modeste krahasuar me kërkesat. Inflacioni gjatë vitit 2007, arriti në kuotën 5,3%, kurse borxhi nacional 1,2 miliard USD.

Në këto kushte, AKM-ja e zhvilloi procesin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë. Përmes kërimit dhe gjetjes së mundësive, u privatizuan afro 50% e ndërmarrjeve, duke vështuar numrin e Ndërmarrjeve Shoqërore, kurse në aspektin e vlerave, privatizimi arrinte afro 90%. Çka u arrit me këtë privatizim?

Përgjigja nuk do të ishte aspak inkurajuese:

- ndërmarrjet Shoqërore tashmë i takonin sektorit privat;
- shitja bëhet për shfrytëzimin e këtyre pronave brenda 99 vitesh. Përgjigja mungoi se çka do të ndodhte pas kësaj periudhe;
- investitorët e huaj nuk gjetën dot veten për investime, me rastin e blerjes së këtyre ndërmarrjeve;
- numër i vogël i ndërmarrjeve të cilat pas procesit të privatizimit janë aktive, kurse ato që vazhduan aktivitetin që e kishin ndërmarrjet para procesit të privatizimit, është edhe më i vogël;
- tenderimet ishin jo transparente, ngase nuk dihej se kush është pronar i ndërmarrjes, cila ishte pala që kishte dhënë çmimin më të lartë tenderues. Një transparencë ndodhi vetëm gjatë dy valëve të para të privatizimit, kur AKM-ja kishte publikuar emrat e fituesve të tenderit.
- Çmimi i blerjes në të shumtën e rasteve u konsiderua se nuk ishte real.
- Mjetet nga shitja qenë jashtë qarkullimit dhe nuk shërbyen për investime në Kosovë.
- Numër i punëtorëve që kishin marrë vlerën prej 20% nga shitja, e cila ligjërisht iu takonte punëtorëve ishte i vogël. Nga vlera prej 76.166.646 €, e cila ishte e

paraparë për punëtorët, gjithsej vetëm 15.558,645 € ishin shpërndarë përmes Bashkimit të Sindikatave të Pavarura.⁹⁴

- Procesi i likuidimit të ndërmarrjeve nuk kishte filluar fare.
- Procesi i privatizimit krijoi armatë të papunëve. Papunësia arriti mbi 40%. Mbi 350.000 persona presin punë, dhe kryesisht breza të rinj, të moshës 25-39 vjeçe, kurse 2% kanë kualifikime superiore.
- Rritja e varfërisë deri në 42%, kurse 15% e popullatës përjeton varfëri të skajshme.
- Rënia e investimeve dhe donacioneve nga jashtë; ndërsa gjatë vitit 2007, kemi derdhje të mjeteve vetëm 11.643.000 €, kurse remitencat nga jashtë janë gjithsej 15%, me tendencë të rënies.

Pritjet nga procesi i privatizimit nuk u përmbushën :

- metodat e privatizimit që nga fillimi u shikuan me mëdyshje;
- koha e zhvillimit të procesit të privatizimit nuk ishte në harmoni me kërkesat;
- transparenca ishte cak i vazhdueshëm për t'i shtuar dyshimet;
- mungoi rimëkëmbja ekonomike dhe përparimi ekonomik në përgjithësi;
- tashti kur Kosova kishte shtetin e vet, vazhdimi i procesit duhej të jetë mësim nga pësimet e kaluara.

Pasuese e AKM-së që ishte përgjegjëse për procesin e privatizimit, pas shpalljes së shtetit të Kosovës, u bë Agjencioni Kosovar i Privatizimit.

Gjatë hulumtimit është konstatuar se si fazë e parë, drejtë procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, UNMIK-u aplikoi procesin e komercializimit të këtyre ndërmarrjeve. Kjo fazë erdhi në shprehje gjatë periudhës 2000-2003. Komercializmi i parë (dhënie me koncesion-qira), është bërë, më 13 qershor 2000. Deri në vitin 2003, janë dhënë me koncesion gjithsej 18 ndërmarrje. Përkundër rezultateve të pritura,

⁹⁴ Raport i Punës AKM-së për periudhën Gusht 2008-Gusht 2009, fq.7. Këtu janë paraqitur rezultatet e 30 valëve të privatizimit të zhvilluara përmes AKM-së.

UNMIK-u së shpejti erdhi në përfundim, se një formë e tillë nuk mund të jetë bazike përkitazi me privatizimin, që do të pasojë, sepse rezultatet nuk ishin inkurajuese sa i përket zhvillimit ekonomik.

Ky qe një tentim, që prona të kishte një zotërues, edhe pse nuk dihej se për sa kohë do të zgjaste kjo gjendje. Në këtë proces u përcaktua periudha kohore prej 10 vitesh, mirëpo asnjë nga ato nuk arriti të përfundojë këtë periudhë kohore, sepse në vitin 2003 filloi procesi i privatizimit.

Shumica nga këto ndërmarrje qenë aktive, dhe përmes komercializimit konsiderohej se do të vinte deri te rrita e tyre, por planifikimi nuk ndodhi. Ato u zvogëluan edhe më tej, ngase u keqpërdorën mjetet e tyre themelore.

Në vazhdim do të paraqesim listën e ndërmarrjeve të komercializuara:

Tabela 5- Ndërmrrjet e komercijalizuara

Nr	Emri i NSH	Komuna	Komercializuesi
1	Sharr Cem	Elez Han	Holderbank (Switz)
2	Industria Ushqimore	Prizren	Abi/Elif 19
3	Betonjerka	Mitrovicë	ZK Group (Shqipëri)
4	Fapol	Podujevë	CRK/Kosovë
5	Ferma e shpqqzëve	Lipjan	ADI/Kosovë
6	Termovent	Lipjan	Dajti/Kosovë
7	Fan Besiana	Podujevë	CRK/Kosovë
8	Zdrukthtaria	Prizren	Egi Bau/Prizren
9	Remont Servis	Prizren	Euro Food
10	Fabrika e Vajit	Ferizaj	Alcom
11	Minex	Ferizaj	Nera Impex
12	Artizanati	Prizren	Astra-B
13	Tullara	Kamenicë	Vëllëzërit Borovci
14	Industria për përpunimin e mishit	Prizren	Fructus
15	IMN Kosova	Prishtinë	Ital Kosova
16	Fabrika e Tullave Mustafë Goga	Ferizaj	Tullorja
17	Mirusha	Klinë	Sacet
18	Gjeravica	Deçan	Wood Industry

Burimi : AKP

Dështimi i procesit të komercializimit kërkoi që të hulumtohen forma të reja dhe institucione, të cilat do të realizonin procesin e privatizimit. Agjencioni Kosovar i

Mirëbesimit jetëgjatësinë e kishte për plot pesë vite. Çështje e dorës së parë doli të jetë prona, që ishte e gjithkujt dhe e askujt, ndërsa sidomos tash, filloi të merrte formë për tu zgjidhur. Fillimi i procesit të privatizimit më tepër u prit, si çështje e kureshtjes se sa me ndonjë entuziazëm të theksuar. Zyra Rajonale në Gjilan ishte njëra nga pesë zyrat, të cilat u themeluan sapa u themelua AKM-ja.

Detyrë e kësaj zyre ishte të udhëhiqte (menaxhonte) pronat, që kishin karakter të ndërmarrjeve shoqërore; të jetësohej privatizimi, dhe së fundit likuidimi i këtyre ndërmarrjeve.

Këto pesë zyra (në Prishtinë, në Pejë, në Gjilan, në Prizren dhe në Mitrovicë) kishin rregulla unike, të cilat kishin të bënin me këtë proces.

Procesi i privatizimit në Kosovë filloi, më 23 shkurt 2003 . Fillimin nuk ishte i mbarë. Pas gjithsej tre valëve të privatizimit, ky proces u ndërpre me ndërhyrjen e Beogradit dhe të zëvendësit të Përfaqësuesit special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) z. Lamsdorf. Ndërprerja ndodhi shkaku i “shqetësimit” të cilin e paraqitën serbët .

Arsye tjetër ishte dhe paqartësia përkitazi me përjashtimin ligjor, që e kërkonin serbët, të cilët pohonin se disa ndërmarrje nuk ishin nën juridiksionin e AKM-së, dhe si të tilla duheshin përjashtuar nga procesi i privatizimit. Megjithatë, privatizimi vazhdoi në vitin 2004 .

Kjo rrethanë ndikoi për humbjen e besimit, që punët të shkonin mbarë. Sipas rregullave ligjore, procesi i privatizimit kishte të bënte me bartjen e së drejtës pronësore për 99 vite . Blerësi i ri, si fitues i tenderit, do të lidhte një kontratë qiraje për 99 vjet. Pronari i ri mund të bartte pronën në emër të vet.

Konsiderohet se afro 600 ndërmarrje kishin karakterin e Ndërmarrjeve Shoqërore, që u menaxhuan nga AKM-ja. Në kuadër të një ekonomie të “lodhur”, konsiderohej se këto ndërmarrje kishin afro 60,000 të punësuar (mbështetur në listat e punëtorëve të deponuara në AKM, të cilëve iu takonte 20% nga shitja e ndërmarrjes).

Nën mandatin e AKM-së në tërësi, u përmbyll procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore me metodën e spin off-it special (shitje me kushte). Përmes kësaj metode u privatizuan gjithsej 25 ndërmarrje. Shitja nëpërmjet Zyrës Rajonale në Gjilan, prinë krahasuar me zyre të tjera sa i përket kësaj metode. Shuma e inkasuar me anë të kësaj metode kap vlerën prej 91,8 milion euro.

Duke pasur në konsideratë marrëdhëniet e publikuara vjetore nga Agjencia Kosovare e Privatizimit deri tashti , si rezultat i përmbushjes së obligimeve kontraktuese, sipas kontratës së shitjes, janë liruar nga kushtet e Marrëveshjes për Zotime, 17 prej ndërmarrjeve, që janë privatizuar me SOS. Këto ndërmarrje janë :

Tabela 6- Ndërmarrjet e privatizuar me spin-off special

1. Ndërmarrja e re “Përparimi”- Skenderaj
2. Ndërmarrja e re “Sunflower Oil”- Ferizaj
3. Ndërmarrja e re “Banja e Klllokotit”- Klllokot
4. Ndërmarrja e re “Peja Brewery” – Pejë
5. Ndërmarrja e re “IMN Brick Factory”- Gjakovë
6. Ndërmarrja e re “Ballkan”- Suharekë
7. Ndërmarrja e re “Feronikeli “ – Drenas
8. Ndërmarrja e re “Rahoveci Winnery”- Rahovec
9. Ndërmarrja e re “Fabrika e tubave”- Ferizaj
10. Ndërmarrja e re “Fabrika e tullave”- Kamenicë
11. Ndërmarrja e re “Fabrika e bukës”- Ferizaj
12. Ndërmarrja e re “Fabrika e fares”- Klinë
13. Ndërmarrja e re “Mulliri” – Fushë Kosovë
14. Ndërmarrja e re “M Sillosi” – Xërxë Rahovec
15. Ndërmarrja e re “Modeli”- Gjakovë
16. Ndërmarrja e re “Kosovatex”- Prishtinë
17. Ndërmarrja e re “Fan”- Podujevë

Që nga fillimi i procesit të privatizimit në Kosovë e deri më tash, janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së Spin Off-it special. Në anën tjetër, 6 ndërmarrje të privatizuar me metodën e Spin Off-it special, kanë qenë nën monitorim gjatë vitit 2013, prej të cilave dy ndërmarrje, për shkak të plotësimit të kushteve të parapara me marrëveshjen e zotimeve, janë liruar nga raportimi (Hotel Iliria dhe Minex), kurse gjatë periudhës kohore janar – 31 dhjetor 2013, 4 ndërmarrje kanë vazhduar të jenë aktive, respektivisht në proces të përmbushjes së kushteve të Marrëveshjes për Zotime.

Më poshtë janë të listuara NSH-të e privatizuar me anë të metodës së Spin Off-it special, që kanë qenë në procesin e monitorimit në periudhën janar – 30 shtator 2013:

- Hotel Iliria
- IDGJ Tobacco
- NBI Suhareka (Agrokosova Holding)
- MIM ,Golesh
- Minex
- Jugoterm

Përmes AKM-së janë zhvilluar 30 valë të privatizimit, dhe u nënshkruan 454 kontrata, nga të cilat 381 u privatizuan përmes Spin off-it, kurse 26 me spin off special; 13 ndërmarrje janë privatizuar me spin off, me kushte (ngjashëm me spin off special, me disa përjashtime), kurse 36 ndërmarrje u privatizuan përmes procesit të likuidimit.

Për periudhën kohore 2003-2008, janë nënshkruar 356 kontrata, me vlerë prej 326,186,505,34 euro. Shuma e grumbulluar vetëm nga SOS ishte 98,8 milion euro. Oferta më e mirë ka qenë ajo për NSH Feronikel, në shumë prej 30,5 milion euro, ku zotimet për investime kapin vlerën prej 20 milion eurosh, dhe u punësuan 1000 punëtorë të rinj.

Një arsenal i kësaj shume të përgjithshme të mjeteve të grumbulluara, nga procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, të mbi 392 milion eurosh është e depozituar në bankat jashtë Kosovës . Vlera e kontratave të nënshkruara tejkalonte shumën e mbi 350 milion eurosh.

Një veprim i tillë, kuptohet se kurrfarë të mire nuk i solli Kosovës në aspektin e zhvillimit ekonomik, dhe as në ndonjë aspekt tjetër. Përfitimet e punëtorëve në emër të 20% nga SOS-i, kapën shumën prej 11,317,443.11 euro . Gjatë mandatit të AKM-së shpërndarja e 20% ishte e ngadaltë. Megjithatë, mungesa e dokumentacionit nëpër Ndërmarrjet Shtetërore, dhe vonesat për shqyrtimin e ankesave nga DHVGJS (Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës), paraqesin ndërlikimet kryesore, me të cilat ballafaqohet AKM-ja e, po ashtu edhe AKP-ja.

Tabela 7- Kontratat e nënshkruara nga shtija përmes AKM-së dhe vlera e tyre:

Vitet	Numri i kontratave të nënshkruara	Vlera e kontratave të nënshkruara
2003	4	1,685,875,00
2004	12	13,814,209,00
2005	69	83,636,301,73
2006	145	146,868,198,72
2007	143	65,038,125,88
2008	81	45,143,795,01
Total	356	356,186,505,34

Burimi AKP

Nga 30 valët e tenderuar përmes AKM-së, vetëm 4 sosh përfshijnë më tepër se 30% të mjeteve të grumbulluara. Më të suksesshmet ishin Vala,5,8b,12 dhe 25.

Tabela 8 Ndërmarrjet e reja të krijuara dhe vlera e tyre

Vala	Numri i ndërmarrjeve të reja	Data	Shuma në Euro
5	22	VII 2005	43,703,200
8b	4	II 2006	27,942,900
12	16	III 2006	34,171,066
25	32	VI 2007	23,153,009
Gjithsejtë	74		128,970,175

Burimi AKP

Procesi i likuidimit, si një nga metodat e procesit të privatizimit, nuk u zbatua gjatë punës së AKM-së. Kjo ndodhi për shkakun se AKM-ja, nuk ishte e gatshme për një formë të tillë të privatizimit për mungesë të Komisioneve të Likuidimit. Kritikët e procesit të privatizimit pareshtur nënvizuan çmimin e ulët shitës të ndërmarrjeve përmes AKM-së. Ata mbronin qëndrimin në vlerën e lartë të aktives së këtyre ndërmarrjeve, të cilat ishin evidentuar në librat e tyre kontabël, në kohën kur kishin trajtimin e Ndërmarrjeve Shoqërore.

Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore përmes AKM-së, hasi në një numër të madh të pengesave dhe kundërshtive, si të faktorit të brendshëm, ashtu edhe të atyre të jashtëm. Që nga fillimi i këtij procesi, asnjëherë nuk është ndalur së vepruari politika destruktive e Serbisë.

Kërkesë përhershme e shtetit serb ishte, që ky proces të ndërpritej. Ajo kërkonte që të jetë faktori vendimtar në këtë proces nga arsye e pretendimeve pronësore. Nëpërmjet aktiviteteve të saja, Serbia arriti që për një periudhë të shkurtër të ndalte këtë proces. Mirëpo, UNMIK-u asnjëherë nuk i kishte shqyrtuar seriozisht këto pretendime; kështu që kishte suspenduar të gjitha ligjet të cilat kishin të bënin me çështjet pronësore, të aplikuara nga Serbia, që vlenin para 10 qershorit të vitit 1999. UNMIK-u krijoi rregullore ligjore unike, sa i përket këtij procesi.

5.1.2 Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore përmes Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP)

Me pavarësimin e Republikës së Kosovës dhe shpalljen e shtetësisë , pushoi së vepruari Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit, që ishte përgjegjës për procesin e privatizimit. Pas një ngecjeje të vogël, në qershor..... u miratua ligji për themelimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, si pasardhëse e AKM-së. Hyrja në fuqi e këtij ligji, në fund të muajit korrik , kushtëzoi fillimin e punës së këtij agjencioni.

Të gjitha trashëgimitë dhe detyrimet nga agjencioni paraprak u bartën në agjencionin e ri. Fillimi i punës së AKP-së nuk ishte gjithaq premtues. Kjo ka të bëjë, në radhë të parë nga mënyra e pranim- dorëzimit dhe bartjes së dokumentacionit. Në këtë aspekt, do të mbetet edhe më tej „ mister ” djegia e një pjese të dokumentacionit në prag të pranim dorëzimit. Kjo çështje shkaktoi dyshime, përkundër deklaramentit permanent, se këto dokumente ishin ruajtur në serverët e kësaj agjencie. Megjithatë, AKP-ja filloi punën me qëllim të përmbylljes së procesit të privatizimit në Kosovë.

Gjatë vitit 2008, AKP-ja zhvilloi tri valë të privatizimit, dhe Vala 31,32,33, kur u privatizuan 15 ndërmarrje, dhe u krijuan 20 ndërmarrje të reja që, ofertuan 117 ofertues dhe u grumbulluan 7,061,333.00 €.

Në vitin 2009, kemi një veprimtari të shtuar të punës së AKP-së. Gjatë këtij viti u tenderuan Valët 34,35,36,37,38,39,40,41, një pjesë e transaksioneve të domosdoshme, u kryen gjatë vitit 2010. Në vitin 2009, u privatizuan 85 ndërmarrje dhe u krijuan 92 të reja, ku morën pjesë 319 tenderues. Shuma e grumbulluar nga shitja kapte vlerën prej 59.053,353,00 €. Nga kjo mund të sjellim përfundimin, se gati për çdo muaj ishte nga një vale.

Kritikët e privatizimit në asnjë formë nuk u pajtuan me çmimin e ulët të realizuar për shitjen e 85 ndërmarrje, dhe u realizuan vetëm 59 milion euro.

Pas tërheqjeve kishin mbetur 49,312,732 €, sepse tenderuesit, në shumë prej 9,740,621,00 qenë tërhequr nga tenderimi.

Vlen të theksohet se në raste të këtilla, kur tërhiqen tenderuesit, atëherë pjesa e parave të dhëna për pjesëmarrje në tender (për shitje me privatizim) mbetet në AKP, që do të thotë, se nuk i kthehet tenderuesve/ Kjo shumë ishte në formë të zakonshme, prej 1000 €.

Tabela 9 – Përmbledhje e spin-off-it të zakonshëm të privatizimit

Përmbledhje e spin off-it të zakonshëm të privatizimit deri me 31 Dhjetor 2009									
2009 Aktivitete Spin Off-et	Vala 34	Vala 35	Vala 36	Vala 37	Vala 38	Vala 39	Vala 40	Vala 41	Total
Si Ndër të Reja	10	9	9	9	10	10	12	29	98
Oferta të Pranuar Dita e Ofertimit	39	28	34	34	43	27	47	82	334
Dita e Ofertimit Totali Çmimit të ofertave/€	7,958,971	2,301,810	3,010,825	6,200,756	1,341,340	2,319,216	27,953,54 5	7,966,890	59,053,35 3
Tërheqjet Refuzimet/€	3,284,500	825,467	705,887	3,517,425	316,130	30,240	846,874	214,098	9,740,621
Totali i Çmimit të Ofertave/ €	4,674,471	1,476,343	2,304,938	2,683,331	1,025,210	2,288,976	27,106,67 1	7,752,792	49,312,73 2
Nr. I Ndër të Reja të refuzuara nga BiD, të tërhequra	4	4	3	4	3	3	4	13	38
Shitjet e përfunduara të Ndër të Reja	5	5	5	1	3	0	0	0	19
Shitjet e pa përfunduara të Ndër të Reja	1	0	1	4	4	7	8	16	41

Burimi; Raport vjetor AKP 2009

Tabela 10 – Shitjet 2009

Departamenti i Shitjes – Aktivitetet 2009
8 Valët
98 Ndër e Reja
14 Tenderët e anuluar për Ndër të Reja (vendim i bordit)
8 Tenderët e anuluar për Ndër të Reja (Tërhequra)
16 Ndër të Reja pa oferta
334 Numri i përgjithshëm i ofertuesve
200,000 Euro totali i depozitave të konfiskuara
59,053,353 Euro çmimi total i ofertave
18,013,390 Euro Totali pagesave
(100 % i pagesave për Valët:34,35,36,37,38)
(25% Vala 39 & 25% Vala 40 - 25% Vala 41 afati i fundit 19 Janar 10)

Burimi; Raport vjetor AKP 2009

Viti 2010, u karakterizua, pothuaj se me intensitet të njëjtë si viti paraprak. Një nga qëllimet madhore, që i kishte vënë vetes AKP-ja, ishte përmbarimi i procesit të privatizimit, t dhe pastaj sa më shpejtë, të nisnin procedurat e likuidimit të ndërmarrjeve të privatizuar, si dhe shitja me likuidim për pasurinë e mbetur. Në këtë vit u organizuan pesë valë të privatizimit: 42, 43, 44, 45 dhe 45A. Në këto valë kryesisht u privatizuan shitore, toka dhe prona të tjera, të ndërmarrjeve të privatizuar më herët.

Agjencia ka zhvilluar punën sipas Planit të Biznesit për vitin 2010, të miratuar nga Bordi i Drejtorëve, duke e zbatuar dhe tejkaluar atë në tërësi.

Tabela në vijim paraqet përmbledhje të valëve të privatizimit, numrin e Ndërmarrjeve të Reja, të krijuara prej ndërmarrjeve shoqërore respektivisht, numrin e ofertave, si dhe çmimin total të arritur për valën përkatëse.

Tabela 11 ; Përmbledhje e rezultateve të vitit 2010

Valet e Privatizimit	Totali i NSH-ve	Nr. i Nder. Re	Nr. Ofertave	Nder.Re te shitura	Totali i çmimit ofertuar €'000
42	13	16	49	9	4.652
43	8	16	34	7	6.333
44	11	11	29	4	2.099
45	15	17	69	13	13.335
45A	11	13	44	11	22.677
46	13	15	62	12	6.437
SharrCem	N/A	N/A	N/A	N/A	30.1
47	12	18	34	13	4.561
Totali 2010	83	106	321	69	90.194

Ndërsa, sa i përket shitjes përmes likuidimit, rezultatet janë arritur si të parapara me planin e biznesit, dhe përmbledhja është si në vijim:

Shitja e aseteve përmes Likuidimit	Nr. i Njësive	Nr. i Ofertave	Njësitet e shitura	Totali i çmimit te ofertuar €'000
Shitja 1	15	41	8	1.185
Shitja 2	28	215	22	7.237
Shitja 3	18	42	9	0.821
Shitja 4	20	47	15	2.339
Shitja 5	28	120	20	3.538
Totali	109	465	74	15.12

Burimi ; Raport vjetor i AKP 2010

Viti 2011 nga AKP-ja u konsiderua si vit i suksesshëm. Veprimtaritë të cilat vazhduan në lëmi të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, gjatë këtij viti janë; Dita e ofertimit të Tenderëve të Valës 48-të të Privatizimit, mbajtur më 28 shkurt 2011, përbëhej nga dhjetë (10) NSH, në dhjetë (10) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranura për Spin-of të rregullt ishte 37.

Dita e fertës së Tenderëve të Valës 49-të të Privatizimit, është mbajtur më 13 prill 2011, eci përbëhej nga njëmbëdhjetë (11) NSH, në njëmbëdhjetë (11) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranura për Spinof të rregullt ishte 38.

Dita e ofertës së Tenderëve të Valës 50-të të Privatizimit është mbajtur, më 15 qershor 2011, përbëhej nga njëmbëdhjetë (11) NSH, në trembëdhjetë (13) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranura për Spinof të rregullt ishte 42.

Dita e Ofertës së Tenderëve të Valës 51-të të Privatizimit është mbajtur, më 17 gusht 2011, ajo përbëhej nga tridhjetë (30) NSH, në dyzetëdy (42) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për Spinof të rregullt ishte 82.

Dita e ofertës së Shitjes së Valës 52, përmes Privatizimit është mbajtur, më 19 tetor 2011, përbëhej nga shtatëmbëdhjetë (17) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për këtë Shitje ishte 33.

Dita e ofertës së Shitjes së Valës 53, me anë të Privatizimit është mbajtur, më 16 nëntor 2011, përbëhej nga njëzet e gjashtë (26) Ndërmarrje të Reja. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për këtë Shitje ishte 85.

Shitja përmes procesit të likuidimit, kishte të bënte me asete të ndërmarrjeve, të privatizuar më herët, që tashti nuk kishin trajtimin e shitjes së bizneseve, vazhdoi me intensitet të shtuar.

Dita e ofertës së Shitjes së 6(gjashtë) përmes Likuidimit është mbajtur, më 9 mars 2011, dhe përbëhej nga trembëdhjetë (13) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për shitje përmes likuidimit ishte 47.

Dita e ofertës të shitjes së 7(shtatë) përmes likuidimit është mbajtur, më 11 maj 2011, dhe përbëhej nga njëzet e katër (24) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për shitje përmes likuidimit ishte 107.

Dita e Ofertës të shitjes së 8(tetë) përmes likuidimit është mbajtur, më 20 korrik 2011, dhe përbëhej nga njëzet (20) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për shitje përmes likuidimit ishte 42.

Dita e ofertës të shitjes të 9(të nëntë) përmes likuidimit është mbajtur, më 21 shtator 2011, dhe përbëhej nga dyzet e tri (43) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për shitje përmes likuidimit ishte 106.

Dita e ofertës të shitjes së 10(dhjetë) përmes likuidimit është mbajtur, më 16 nëntor 2011, dhe përbëhet nga tridhjetë (30) njësi. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar për shitje përmes likuidimit ishte 58.

Për shkak të mospërbushjes së detyrimeve të marra, me rastin e privatizimit përmes SOS, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ,në mbledhjen e mbajtur në muajin shkurt 2011, ka marrë vendim që t'i imponojë ndëshkimet financiare për mospërbushje të kushteve të Marrëveshjes për Zotime. Në të njëjtën kohë, Njësia e Monitorimit ka vazhduar t'i dërgojë faturat mujore për ndëshkime financiare për katër ndërmarrjet e tjera, të ndëshkuara për mospërbushje të kushteve të Marrëveshjes për Zotime. Për periudhën kohore 1 janar 2011 – 31 dhjetor 2011, shuma e përgjithshme e ndëshkimeve financiare për këto ndërmarrje është e këtillë:

1. Hotel Grand 2,272,475 €
2. MIM Goleshi, 1,929,891 €
3. XIM Strezoci, 1,699,431 €
4. IDGJ Tobacco, 544,934 €
5. Agrokosova Holding, 3,324,610€

Gjithsej: 9,771,343 €

Kurse në mbledhjen e mbajtur, më 20 dhe 21 korrik 2011, respektivisht në mbledhjen e mbajtur, më 30 nëntor 2011, si rezultat i përmbushjes së zotimeve, sipas Marrëveshjes për Zotime, Bordi i Drejtorëve të AKP-së, ka marrë vendim që t'i lirojë blerësit e këtyre Ndërmarrjeve të Reja:

- M&Silloi – Xërxë, Rahovec,
- Modeli – Gjakovë,
- Mulliri – Fushë Kosovë dhe
- Kosovatex.

Gjatë vitit 2012, u bënë edhe disa ristrukturime në kuadër të AKP-së, me qëllim të përparimit të procesit të privatizimit. Me ristrukturimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Departamenti i Shitjes ka pësuar ndryshime të dukshme, dhe tashmë i tërë procesi i shitjes, që nga përgatitja e shitjes, realizimi i shitjes e, deri te kontrata e shitjes, është koncentruar në këtë Departament. Departamenti i Shitjes përbëhet nga Njësia për Përgatitjen dhe Përmbylljen e Shitjes,

Njësia e Shqyrtimit të Dokumenteve të Shitjes dhe Njësia e Kadastrale. Departamenti i Shitjes është përgjegjës për procesin e Privatizimit dhe Shitjes së aseteve të NSH-ve me anë të likuidimit. Gjatë këtij viti u realizua privatizimi i NSH-ve:

Tabela 12- Shitjet përmes Spin off 2012

SHITJET PËRMES SPINOF-IT						
PRIVATIZIMI						
Nr.	Valët e Privatizimit	Ndërmarrjet e Reja të ofruara për privatizim	Ndërmarrjet e Reja pa oferta	Ndërmarrjet e Reja të anuluar	Ndërmarrjet e Reja të aprovuara nga Bordi	Totali sipas Vendimit të Bordit
1	54	29	10	7	12	€ 1,546,174
2	55	23	6	1	16	€ 8,217,213
3	56	34	8	9	17	€10,627,097
Kontrata të nënshkruara të privatizimit në vitin 2012		Totali				
64		€ 21,071,336.00				

Burimi : AKP- Raporti vjetor 2012

Mospërputhja e totaleve e të hyrave mes shitjes së aseteve dhe kontratave të nënshkruara, është për shkak se, në vitin 2012, në tabelën e kontratave të nënshkruara përfshihen ratifikimet e kontratave, të mbetura nga vitet paraprake, si dhe kontratat për shitjen e aseteve 16, 17 dhe 18 që janë të përfshira për shkak të mungesës së Bordit të AKP-së.

Tabela 13 – Shitja përmes likuidimit 2012

LIKUIDIMI						
Nr.	Shitja e Aseteve	Asetet e ofruara për privatizim	Asetet pa oferta	Asetet e anuluar	Asetet e aprovuara nga Bordi	Totali sipas Vendimit të Bordit
1	11	29	7	4	14	€903,948
2	12	22	4	5	13	€1,839,426
3	13	23	12	3	8	€1,773,192
4	14	18	4	1	13	€3,891,187
5	15	34	11	4	19	€3,502,412
6	16	36	18	1	17	€1,476,146
7	17	62	25	8	29	€4,767,137
8	18	49	19	6	24	€2,956,763
		269	100	32	137	€ 21,110,211

Kontrata të nënshkruara të likuidimit në vitin 2012	Totali
98	€ 19,505,120.00

Burim AKP- Raporti vjetor 2012

Gjatë vitit 2012, kemi shitje të emërtuara si projekte individuale. Një shitje të tillë le të paraqesim këtu, me këto të dhëna.

Dita e paraqitjes së ofertës të Projekteve Individuale, që ka karakter të shitjes kushte speciale, është mbajtur më 20 korrik 2012. Oerta përbëhej nga Ndërmarrja e Re Hotel Onix, Banja e Pejës - Ilixhe Shëndetësore SHPK dhe Ndërmarrja e Re FBI Trepça SHPK. Numri i përgjithshëm i ofertave të pranuar ishte 3, me shumë totale të ofertave fituese, prej 8,135,000 euro. Për Ndërmarrjen e Re Hotel Onix Banja e Pejës - Ilixhe Shëndetësore SHPK., u pranua vetëm një ofertë, ndërsa për Ndërmarrjen e Re FBI Trepça SHPK., u pranuan dy oferta. Një formë e tillë e shitjes le hapësirë të vazhdueshme për dyshime për parregullsinë dhe paligjshmërinë e saj.

Tabela 13 – Projektet individuale 2012

Nr.	Projektet Individuale	Ndërmarrjet e Reja të ofruara për privatizim	Ndërmarrjet e Reja pa oferta	Ndërmarrjet e Reja të anuluar	Ndërmarrjet e Reja të aprovuara nga Bordi	Totali sipas Vendimit të Bordit
1.	Hotel Onix Banja e Pejës - Ilixhe Shëndetësore Sh.P.K	1	0	0	1	€6,100,000
2.	FBI Trepca Sh.P.K.	1	0	0	1	€2,035,000
Totali		2	0	0	2	€ 8,135,000

Burim AKP- Raporti vjetor 2012

Gjatë vitit 2012, deri më 31 dhjetor, janë nënshkruar dhe dorëzuar te blerësit 162 kontrata, prej tyre me privatizim 64, dhe me likuidim 98. Për pesë shitje ka ndalesë nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, dhe deri sa të mos largohen këto ndalesa, nuk mund të vazhdohet me shitje.

Ndërmarrjet të cilat janë larguar nga shitja janë:

1. Ndërmarrja e Re “Farmakos Blue Factory”, SHPK- Vala 2
2. Ndërmarrja e Re “ Agrokosova- Zyret”, SHPK – Vala 37
3. Ndërmarrja e Re “KB Shtime, Zyra Administrative” SHPK -së-Vala 42
4. Ndërmarrja e Re “Punëtorja Iliria”, SHPK, Vala 43
5. Ndërmarrja e re “ Tokë Bujqësore në Tërsatenik”,SHPK - Vala 51

Nga të dhënat e lartpërmendura, mund të konsiderohet, se viti 2012 ishte (ashtu si u vlerësua nga AKP-ja) vit i frytshëm.

Viti 2013, që nga fillimi konsiderohej se duhet të ishte vit, i cili duhej të përafrojë procesin e privatizimit drejtë përfundimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit në portfolin e saj, në fund të vitit 2013 numëron 585 ndërmarrje shoqërore. Gjatë vitit 2013, AKP-ja, ka mbajtur tri (3) valë të privatizimit: Vala 57, Vala 58 dhe Vala 59 dhe pesë (5) shitje

të aseteve të ndërmarrjeve në likuidim (SHAL): SHAL 19, SHAL 20, SHAL 21, SHAL 22, SHAL 23.

Nga administrimi i AKP-së, që nga fillimi e deri më tash, janë larguar 18 NSH , disa prej tyre janë larguar, pasi që janë themeluar mbi prona private, ndërsa disa sosh pas shqyrtimit të statusit, dhe sipas ligjit për ndërmarrjet publike, iu është ndryshuar statusi nga shoqërore në publike, dhe ca tjera i janë nënshtruar procesit të transformimit :

1. Gjilan KB, Agroblini
2. Gjilan KB, Agrodoganaj
3. Gjilan KB, Agrofryti
4. Gjilan KB, Arbana
5. Gjilan KB, Bleta
6. Gjilan KB, Burimi
7. Gjilan KB, Fara
8. Gjilan KB, Xhiki
9. Gjilan, Barber kooperative
10. Prizren, Kosovatrasi, Prizren
11. Prizren, Nerezina
12. Mitrovicë, Gornji Ibar Rozaje
13. Mitrovicë, Kolasingradnja
14. Mitrovicë, Drvoimpex
15. Mitrovicë, BVI për Banesa dhe Mbrojtjen e Ambientit
16. Peja, Kosovatrasi, Gjakova
17. Peja, Kosovatrasi, Pejë
18. Peja, Agjencioni Pyjor

Gjatë vitit 2013, u organizuan këto valë të shitjeve:

Tabela 14- Shitjet përmes Spin off 2013

Vala	Data e tenderimit	Ndër. e Reja	Nr. i ofertave	Shuma totale
57	29 maj 2013	31	79	9,506,340.00
58	29 maj 2013	23	54	5,188,345.00
59	09 tetor	40	85	9,525,674.00
Gjithsejtë:		94	218	24,320,359.00

Burimi : Raporti vjetor AKP 2013

Tabela 15- Shitjet përmes likuidimit 2013

SHAL	Data e tenderimit	Asetet	Nr. i ofertave	Shuma totale
19	24 prill 2013	30	83	5,402,469.00
20	03 korrik 2013	74	120	2,623,291.00
21	10 shtator 2013	47	94	4,532,927.00
Gjithsejtë:		151	297	12,558,687.00

Burimi : Raporti vjetor AKP 2013

Vala 57- Për trembëdhjetë (13) ndërmarrje të reja të tenderuar u pranuan tri (3) ose më shumë oferta, për tetë (8) Ndërmarrje të Reja të tenderuar, u pranuan më pak se tri (3) oferta, dhe për njëmbëdhjetë (11) ndërmarrje të reja të tenderuar, nuk u pranua asnjë ofertë. Për 21 ndërmarrjet, për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi dhe miratoi 10 oferta, ndërsa refuzoi (11) oferta. Rrjedhimisht u përmbyllen dhjetë (10) kontrata të shitjes. Pas analizës për ndërmarrjet e reja, për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë, u pa se:

- dy (2) Ndërmarrje të Reja ishin jo atraktive,
- një (1) ndërmarrje e re kishte kontest rreth investimeve të qiramarrësit paraprak,
- një (1) ndërmarrje e re ishte larguar nga vala e privatizimit paraprakisht, dhe për
- shtatë (7) ndërmarrje të reja shkaqet ishin të panjohura.

Vala 58: për gjashtë (6) ndërmarrje të reja të tenderuar, u pranuan tri (3) ose më shumë oferta, për tetë (8) ndërmarrje të reja të tenderuar, u pranuan më pak se tri (3) oferta, dhe për nëntë (9) ndërmarrje të reja të tenderuar nuk u pranua asnjë ofertë. Për 14 ndërmarrjet, për të cilat qenë pranuar oferta, Bordi pranoi aprovoi 5 oferta, ndërsa refuzoi (9) oferta. Rrjedhimisht

u përmbyllën (4) kontrata të shitjes, për arsye se për një ndërmarrje të re është pranuar.

Masa e parakohshme: pas analizës për ndërmarrjet e reja, për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë, u pa se:

- një (1) ndërmarrje e re ishte jo atraktive pozitivisht e papërshtatshme.
- Tri (3) ndërmarrje të reja, lokacioni i të cilave është në veri të vendit, dhe si rrjedhim është paraqitur mungesë interesimi.
- Një (1) ndërmarrje e re, aseti i së cilës gjendet në rajon rural dhe si rrjedhim është paraqitur mungesë interesimi dhe për
- katër (4) ndërmarrje të reja, shkaket ishin të panjohura.

Vala 59: për trembëdhjetë (13) ndërmarrje të reja të tenderuar, u pranuan tri (3) ose më shumë oferta, për shtatëmbëdhjetë (17) ndërmarrje të reja të tenderuar, u pranuan më pak se tri (3) oferta, dhe për dhjetë (10) ndërmarrje të reja të tenderuar nuk u pranua asnjë ofertë.

Për 30 ndërmarrjet për të cilat qenë pranuar oferta,

Bordi pranoi dhe miratoi 26 oferta, ndërsa refuzoi 9 oferta. Sa i përket përmbjlljes së kontratave të shitjeve, vlen të theksohet se, të gjitha procedurat janë bartur në vitin 2014, për shkak të afateve kohore të përcaktuara në rregullat e aplikueshme të tenderit.

Pas analizës për ndërmarrjet e reja, për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë, u pa se:

- katër (4) ndërmarrje të reja ishin jo-atraktive.
- Dy (2) ndërmarrje të reja kishin pretendime pronësore, dhe për njërin nga to ishte bërë thirrje publike në media nga pretenduesi për mos tenderim dhe për

- katër (4) ndërmarrje të reja shkaqet ishin të panjohura.

Përkitazi me shitjen ose likuidimin kemi këtë analizë:

SHAL (Shitja e Aseteve me Likuidim) 19, Për gjashtëmbëdhjetë (16) njësi të tenderuar, u pranuan tri (3) ose më shumë oferta, për dhjetë (10) njësi të tenderuar, u pranuan më pak se tri (3) oferta, dhe për katër(4) njësi të tenderuar nuk u pranua asnjë ofertë. Ndërsa gjatë procesit të shitjes së asetëve ka pasur (3) refuzime të ofertave. Për njëzet e gjashtë (26) asete për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi dhe aprovoi njëzet e dy (22) oferta, ndërsa refuzoi katër (4) oferta.

Si rrjedhojë u përmbyllen shtatëmbëdhjetë (17) kontrata të shitjes, për shkak se katër (4) asete kanë dështuar gjatë procesit, përkatësisht gjatë pagesave, dhe një (1) aset është ende në pritje të nënshkrimit nga ana e blerësit. Pas analizës për asetet e propozuara, për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë po ashtu u pa se:

- dy (2) asete ishin jo-atraktive,
- një (1) aset ishte e pavlerë dhe për
- një (1) aset shkaqet ishin të panjohura

SHAL 20: për njëzet e dy (22) njësi të tenderuar u pranuan tri (3) a më shumë oferta, për njëzet e pesë (25) njësi të tenderuar u pranuan më pak se tri (3) oferta, dhe për njëzet e shtatë (27) njësi të tenderuar nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së asetëve ka pasur (3) refuzime të ofertave. Për dyzet e shtatë (47) asete, për të cilat ishin pranuar oferta, Bordi pranoi përkatësisht aprovoi tridhjetë e katër (34) oferta, ndërsa refuzoi trembëdhjetë (13) oferta. Kështu u përmbyllën njëzet e gjashtë (26) kontrata të shitjes, për shkak se:

- për një (1) aset ishte pranuar masa e parakohshme,
- për një (1) aset kishin rezultuar probleme kadastrale (pas aprovimit të Bordit),
- dy (2) asete kanë dështuar gjatë procesit, ose në pagesa dhe
- katër (4) asete janë ende në proces.

Pas analizës për asetet e propozuara, për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë u pa se:

- për tri (3) asete interesimi ishte i vogël,
- për një (1) aset nuk kishte interesim fare,
- për njëmbëdhjetë (11) asete kishte pasur edhe asete tjera, afër Tri (3) të tilla ishin të uzurpuara nga palët tjera,
- tetë (8) asete ishin jo-atraktive dhe
- një (1) ishte i rrethuar me pronë private.

SHAL 21: për shtatëmbëdhjetë (17) njësi të tenderuar u pranuan tri (3) ose më shumë oferta, për trembëdhjetë (13) njësi të tenderuar u pranuan më pak se tri (3) oferta, dhe për shtatëmbëdhjetë (17) njësi të tenderuar nuk u pranua asnjë ofertë, ndërsa gjatë procesit të shitjes së aseteve ka pasur 2 refuzime të ofertave. Për tridhjetë (30) asete, për të cilat qenë pranuar oferta, Bordi pranoi dhe aprovoi njëzet e një (21), ndërsa refuzoi nëntë (9) oferta.

Rrjedhimisht u përmbyllën pesëmbëdhjetë (15) kontrata të shitjes, për shkak se:

- tri (3) asete janë ende në proces dhe
- tri (3) asete kanë dështuar gjatë procesit, përkatësisht në pagesa.

Pas analizës për asetet e propozuara për të cilat nuk u pranua asnjë ofertë doli se:

- dy (2) asete gjenden në veri të vendit,
- një (1) aset ka një hapësirë e cila nuk është atraktive për investitorë,
- një (1) aset kishte pësuar ndryshime kadastrale nga NSH-ja për person privat, sipas vendimit të Zyrës për Kadastër dhe Gjeodezi, në KK të Gjakovës.
- për trembëdhjetë (13) asete shkaqet ishin të panjohura.

Viti 2014 nga shumica e ekonomistëve në Kosovë, u karakterizua si vit i humbur. Mungesa e krijimit të Parlamentit të Kosovës për periudhë kohore, prej 6 muajsh, çrregulloi rrjedhat e jetës, dhe të funksionimit të institucioneve të tjera. Që nga muaji gusht i vitit 2014, AKP-ja mbeti pa këshill, që do të shpallte dhe miratonte shitjet e

planifikuara. Disa anëtarëve të këshillit iu kishte dalë afati, kurse ndaj disa të tjerëve u ngritën akuza ligjore për veprimet e tyre. Ndaj një pjese të anëtarëve të menaxhmentit të lartë, po ashtu u iniciuan masa, duke filluar nga burgosja e deri te izolimi shtëpiak. Kjo është një shenjë se dhe në të kaluarën, edhe sot, ka pasur çështje jo të çiltëra në AKP.

Dështimi i vitit 2014, në punën e AKP-së vërehet në organizimin e gjithsej tri shitjeve, përmes procesit të likuidimit, t dhe SHAL 24, 25 e 26.

Tabela 16- Shitja e aseteve me likuidim 2014

SHAL	Data e ofertimit	Nr i aseteve të tenderuara	Nr. i ofertuesve	Shuma
24	19 mars 2014	50	130	9,870,871.00
25	23 prill 2014	93	100	4,707,403.00
26	20 gusht 2014	82	95	8,212,876.00
Gjithsejtë:		225	325	22,891,150.00

Burim- AKP

Procesi i privatizimit të NSH-ve është në vazhdim pa një datë të saktë të përfundimit. Për vitin 2015 janë bërë plane për valët dhe për organizimin e shitjeve. Kryesisht do të bëhet shitja e aseteve përmes metodës së likuidimit. Po ashtu, do të tentohet të kompensohet koha e humbur e vitit 2014, që ndodhi shkak i mungesës së këshillit. Andaj, për këtë vit para AKP-në (Kuvendi i Kosovës), paraqitet si detyrë parësore çështja e konstituimit të këshillit të ri, dhe pastaj zgjedhja e menaxherit ekzekutiv dhe dy zëvendës drejtorëve, këto vende me përgjegjësi janë të zbraztë. Pas konstituimit të këtyre organeve pritet intensitet i shtuar i punës, me qëllim të përafrimit drejtë përfundimit të procesit të privatizimit, dhe prona e NSH-ve, më në fund, të kalojë në duar të pronarëve të rinj privatë, ngase kjo ka qenë parësore për AKP -në.

5.2 Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore përmes Zyrës Rajonale të AKP në Gjilan

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore më anë të zyrës rajonale të AKP-së, në Gjilan, nuk do të thotë se është përjashtim i procesit të privatizimit në Kosovë. Përmes kësaj zyre (ekzistojnë edhe katër sosh në Kosovë), është zhvilluar procesi i privatizimit në aspektin gjeografik, që përfshin këtë regjion. Nëpërmjet Zyrës Rajonale të AKP-së, në Gjilan janë menaxhuar dhe privatizuar Ndërmarrjet Shoqërore, të cilat i përkasin Gjilanit, Ferizajt, Vitisë, Kamenicës, Kaçanikut, Shtërpçës dhe Novo Bërdës.

5.2.1 Gjendja e Ndërmarrjeve Shoqërore në regjionin e Gjilant para dhe pas procesit të privatizimit

Duke nxjerr rezultatet e hulumtimit arrihet në përfundimin, se regjioni i Gjilanit në aspektin e përfshirjes teritoriale, të numrit të popullatës, të zhvillimit ekonomik dhe treguesve të tjerë, përmban 1/5(një të pestat) e ndërmarrjeve në Republikë e Kosovës. Hulumtimi dhe analiza e mëtejme e këtij regjioni, ka të bëjë edhe me aspektin kohor të studimit.

Me qëllim të analizës sa më të suksesshme, mendoj se duhet shqyrtuar gjendjen e Ndërmarrjeve Shoqërore në këtë regjion, para dhe pas procesit të privatizimit, që paraqet një nga objektivat fillestare. Nga kjo, do të arrihet në konkludimin se me transformimin e pronës, duhej të krijoheshin parakushte për një zhvillim më të hovshëm ekonomik, që njëkohësisht paraqet qëllimin parësor të procesit të privatizimit.

Duke përfillur një hulumtim të kryer nga Instituti Riinvest, i botuar më 8 mars 2001, përkitazi me Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë,⁹⁵ (anketa është zhvilluar me 192 Ndërmarrje Shoqërore, për periudhën kohore tetor-nëntor, të vitit 2000, dhe në 24 komuna të Kosovës), arrihet në përfundim se:

- numri më i madh i këtyre ndërmarrjeve të anketuara (86%), kanë qenë aktive (gjatë vitit 1999, 55-60%); mirëpo, kanë shfrytëzuar kapacitetet e tyre gjithsejtë 30%.

Shfrytëzim paksa më të lartë kanë pasur ndërmarrjet shërbyese 57,5%, ndërmarrjet transportuese 54,1%, ndërmarrjet prodhuese të materialit ndërtimor 51,1%, ndërmarrjet tregtare 43,7% dhe ndërmarrjet ndërtimore 40,6%

- Aktiviteti ekonomik i këtyre ndërmarrjeve gjatë vitit 2000, krahasuar me vitin 2001, është dyfishuar.
- Pengesat për rritje më të shpejtë janë: mungesa e mjeteve financiare, teknologjia e vjetruar, dëmet nga menaxhmenti i dhunshëm, para vitit 1999, pasojat e luftës, dilemat e UNMIK-ut përkitazi me karakterin e pronës shoqërore, etj.
- Këto ndërmarrje numronin 42,518 punëtorë, nga të cilët vetëm 24,662 ose 58% ishin aktiv, kurse 16.000 ishin në pushim pa pagesë, 3,300 i marrin pagat në shtëpi. Të ardhurat mesatare në këto ndërmarrje qenë 200 DM. Struktura moshore ishte 40-55 vite, që paraqet pengesë për zhvillimin e mëtejshëm.
- Kapitali fiks i këtyre ndërmarrjeve vlerësohet në 3,5 miliardë DEM, kurse shkalla e amortizimit vlerësohet në 55-60%, kurse në miniera 70%.
- Detyrimet e këtyre ndërmarrjeve janë dy herë më të mëdha se kërkesat (në mesatare 1 milion DEM për çdo ndërmarrje).
- Investimet e deritashme të këtyre ndërmarrjeve shoqërore ishin të pakta krahasuar me nevojat.

⁹⁵ Riinvest, Ndërmarrjet Shoqërore dhe Transformimi/Privatizimi, Prishtinë, 2001 fq.21

Humbjet në këto ndërmarrje nga pasojat e luftës vlerësohen në 1,3 miliardë DEM. Vetëm 38 milion DEM janë investuar në këto ndërmarrje, pas vitit 1999, kurse kërkesat për investime arrijnë shumën prej 785 milion DEM.

- Numri më i madh i këtyre ndërmarrjeve të anketuara, kishin qëndrim pozitiv, për sa i përket procesit të privatizimit 83%, përderisa 10% kishin qëndrim negativ.

Nga të dhënat e mësipërme, regjioni i Gjilanit (pasi që 15% e të anketuarve janë nga ky regjion), paraqet një gjendje reale të Ndërmarrjeve Shoqërore, të cilat edhe pse thuhet se ishin aktive, çdo herë e më shumë rrëshqitnin drejt gjendjes, që kërkonte ndryshim; kërkohej privatizimi i tyre, me qëllim që mos të humbej vlera e tyre. Çdo vonesë e mëtejme do të sillte situata jo të mira në aspektin social, dhe rrezikimin e pronës, e cila kërkohej që të kishte pronarin e vet.

Zhvillimi ekonomik i regjionit të Gjilanit ishte në harmoni me regjionet tjera të Kosovës. Çdo gjë që e karakterizonte Kosovën, gjente shprehje dhe në këtë regjion. Çdo dukuri diskriminuese e pushteteve imponuese, kishte po ashtu vulën e vet edhe këtu.

Në shërbim të analizës së mëtejme të Ndërmarrjeve Shoqërore, të cilat vepronin në këtë regjion, si rezultat i hulumtimit, do të japim pasqyrën e tyre, sipas komunave ku vepronin këto ndërmarrje.

Komuna e Gjilanit - Në komunën e Gjilanit gjithsej ishin 44 ndërmarrje, të cilat kishin karakterin e Ndërmarrjeve Shoqërore, të cilat iu nënshtruan procesit të privatizimit:

Tabela 17- Ndërmarrjet të cilat kishin karakter të NSH- Komuna Gjilan

Nr.	Emri i Ndbmarrjes	Statusi	Veprimtaria	Komuna
1	Industria e Duhanit	NSH	Prodhim	Gjilan
2	KBI "Agrokultura"	NSH	Bujqësi	Gjilan
3	N.Sh.I.M.B "Kualiteti"	NSH	Bujqësi	Gjilan
4	N.Sh.I.M.B "Stacioni Bujqesor"	NSH	Bujqësi	Gjilan
5	K.B "1 Maj"	Kooperativë	Bujqësi	Gjilan
6	K.B "Bresalci"	Kooperativë	Bujqësi	Gjilan
7	K.B "Cernica"	Kooperativë	Bujqësi	Gjilan
8	K.B "Kishna Pole"	Kooperativë	Bujqësi	Gjilan
9	K.B "Malisheva"	Kooperativë	Bujqësi	Gjilan
10	K.B "Morava" Partesh	Kooperativë	Bujqësi	Gjilan
11	K.B "Perlepnica"	NSH	Bujqësi	Gjilan
12	K.B "Pogragja"	NSH	Bujqësi	Gjilan
13	K.B "Shillova"	NSH	Bujqësi	Gjilan
14	K.B "Shurdhani"	Kooperativë	Bujqësi	Gjilan
15	K.B "Zarije Bujq" Pasjane	NSH	Bujqësi	Gjilan
16	K.B "Zhegra"	NSH	Bujqësi	Gjilan
17	K.B. "Mirusha"	NSH	Bujqësi	Gjilan
18	N.H.N.I. "Morava e Binçes"	NSH	Ndertimtari	Gjilan
19	"Ekonomia e Pyjeve" Gjilan	NSH	Pylltari	Gjilan
20	"IBG" Batteries	NSH	Prodhim	Gjilan
21	F.R.S.K "Jugoterm"	NSH	Prodhim	Gjilan
22	N.Sh."Çeliku"	NSH	Prodhim	Gjilan
23	N.T.Sh "Hekurishte"	NSH	Prodhim	Gjilan
24	Teknika Popullore	NSH	Sherbime	Gjilan
25	Barnatorja Gjilan (pharmacy)	NSH	Farmaci	Gjilan
26	N.SH. "Mekanizmi"	NSH	Tregti	Gjilan
27	Radio Gjilan	Publike	Sherbime	Gjilan
28	SH.A.M "Drita"	NSH	Sherbime	Gjilan
29	N.Sh.G.T. "Gra fikos"	NSH	Services	Gjilan
30	N.T.P "Teuta"	NSH	Tekstil	Gjilan
31	NSHIT "Integj"	NSH	Tekstil	Gjilan
32	SH.A.H "Kosova"	NSH	Hoteljeri	Gjilan
33	N.Sh.T. "28 Nentori"	NSH	Tregti	Gjilan
34	N.T.Sh "Anamorava"	NSH	Tregti	Gjilan
35	ShANT "Qarkullimi" Gjilan	NSH	Tregti	Gjilan
36	"Kosovatrans" Gjilan	NSH	Transport	Gjilan
37	Hidromorava	Publike	Tjera	Gjilan
38	Higjiena - Gjilan	Publike	Tjera	Gjilan
39	Bankos - Gjilane	Financiar	Tjera	Gjilan
40	Vet Station - Gjilan/Gnjilane 1	NSH	Bujqësi	Gjilan
41	Vet Station - Gjilan/Gnjilane 2	NSH	Bujqësi	Gjilan
42	Cinema Gjilan	NSH	Tjera	Gjilan
43	Airport - Gjilan	NSH	Transport	Gjilan
44	Barber Cooperative	Kooperativë	Sherbime	Gjilan

Burim :AKP

Varësisht nga periudhat kohore, në këto ndërmarrje ishin të inkuadruar mbi 10,000 punëtorë. Bartës të zhvillimit ekonomik në komunën e Gjilanit janë këto ndërmarrje: Kombinati i Tekstilit „Integj”, Ndërmarrja Ndërtimore “Morava e Binçës”, Fabrika e Radiatorve “Jugoterm”, Fabrika e Baterive IBG dhe Ndërmarrja Metalike “ Çeliku“, kurse ndërmarrjet e tjera kishin rëndësi më të vogël.

Për hirë të analizës së mëtejme, do të paraqesim gjendjen e këtyre ndërmarrjeve, të cilat kishin rëndësi të dorës së parë në Komunën e Gjilanit.

Tabela 18 – Ndërmarrjet me rëndësi primare në Komunën e Gjilanit⁹⁶

Nr	Emri i ndërmarrjes	Selia	Veprimtaria	Madhesia	Viti i privatizimit	Metoda e privatizimit	Nr i punëtorëve më 1989	Nr i punëtorëve aktiv për privatizim	Nr i punëtorëve të përfshirë në Listën e 20%	Shfrytëzimi i kapacitetit
1	NSHIT Integj	Gjilan	Prodhim	E madhe	2006	SO	2427	110	698	8-10%
2	IDGJ Industria e Duhanit	Gjilan	Prodhim	E madhe	2004	SOS	506	236	233	10-15%
3	KBI Agrokultura	Gjilan	Bujqesi	E madhe	2006	SO	2000	107	255	4-6 %
4	NSHT 28 Nëntori	Gjilan	Tregti	E madhe	2006	SO	662	78	223	12-16%
5	NHNI Morava e Binçës	Gjilan	Ndërtim	E madhe	2010	SO	1600	778	810	4-6%
Gjithsejtë;							7195	1309	2219	

Burim ; Sindikata e Pavarur e Ndërmarrjes

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme mund të vërehet, se privatizimi i këtyre ndërmarrjeve është bërë gjatë kohës së AKM-së. Përjashtim nga kjo është NHN „Morava e Binçës“, e cila u privatizua në vitin 2010 përmes AKP-së. IDGJ Industria e Duhanit në Gjilan u privatizua përmes SOS, kurse të tjerat përmes spin-off-it të rregullt.

Nga gjithsej 7195 punëtorë, sa kishin këto ndërmarrje para vitit 1999, me rastin e privatizimit të këtyre ndërmarrjeve, ishin aktiv gjithsej 1309, kurse në listën e kompenzimit prej 20%, që iu takonte punëtorëve nga shitja e ndërmarrjes, mbetën gjithsej 2219 punëtorë. Shfrytëzimi i kapaciteteve të këtyre ndërmarrjeve para procesit

⁹⁶ Burim i shënimeve; Sindikata e pavarur e këtyre ndërmarrjeve dhe librat e kontabilitetit mbi afarizmin e këtyre ndërmarrjeve. Ndërmarrjet e cekura janë marrë si mostër reprezentative, sepse ishin bartës të zhvillimit ekonomik të komunës së Gjilanit. Kjo nuk do të thotë, se nuk kishte edhe ndërmarrje të tjera me rëndësi si; Fabrika e Baterive, Fabrika e Radiatorëve etj, mirëpo rastet janë përzgjedhur në bazë të rëndësisë, strukturës dhe madhësisë.

të privatizimi,t sillej prej 4% deri në 16%. Ky shfrytëzim i paktë i kapaciteteve ka të bëjë me mungesën financiare për investime, teknologjinë e vjetruar, strukturën e tregut dhe fuqinë punëtore të vjetruar dhe të pakualifikuar

Nga ndërmarrjet e privatizuara u krijuan këto njësi në cilësi të ndërmarrjeve të reja:

Tabela 19- Ndërmarrjet e reja të krijuara nga privatizimi

Nr.	Nderrmarja	Ndërmarrja e re	Komuna	Çmimi i shitjes
1	Integj	Integj spinning and machie-woven carpets	Gjilan	1,010,000.00
2	Integj	Fabrika e perdeve Gival	Gjilan	1,680,000.00
3	Integj	Tjertorja e vjeter dhe fabrika e tepihave Tafting	Gjilan	797,000.00
4	Integj	Fabrika e perdeve Rashell	Gjilan	390,000.00
5	Integj	Njesia e nxemjes qendrore dhe e servisimit	Gjilan	470,000.00
6	Integj	Fabrika e trikotazhit dhe ndertesa administrative	Gjilan	1,290,000.00
7	Integj	Depoja ne Shillove	Gjilan	120,080.00
8	Integj	Shitorja ne Gjilan	Gjilan	356,000.00
9	Integj	Elemente (konstrukcione) metalike per ndertimtari	Gjilan	24,850.00
10	IDGJ Industria e Duhanit	IDGJ Industria e Duhanit	Gjilan	1,400,000.00
11	IDGJ Industria e Duhanit	Tokë	Gjilan	142,300.00
12	Agrokultura	Tokë në Livoq l poshtem	Gjilan	360,050.00
13	Agrokultura	Tokë në Gumnishte& Ponesh	Gjilan	211,000.00
14	Agrokultura	Tokë në Kravarica	Gjilan	269,250.00
15	Agrokultura	Ndërtesa Administrative	Gjilan	1,155,000.00
16	Agrokultura	Kompleksi Agro industrial B	Gjilan	111,222.00
17	Agrokultura	Kompleksi Agro industrial C	Gjilan	157,120.00
18	Agrokultura	Kompleksi Agro industrial D	Gjilan	238,444.00
19	Agrokultura	Toka në Ponesh	Gjilan	211,122.00
20	Agrokultura	Kompleksi Agroindustrial A	Gjilan	419,999.00
21	Agrokultura	Depoja Frigoriferinë Shillov	Gjilan	531,700.00
22	Agrokultura	Industria e mishit	Gjilan	1,205,000.00
23	28 Nëntori	29 Nentori Shitore Komplesi B	Gjilan	488,779.00
24	28 Nëntori	Shitorja (174m²) Rr.Abdullah Tahiri Gjilan	Gjilan	139,200.00
25	28 Nëntori	Shitorja (73m²) Rr.Bulevardi i Pavarsise Gjilan	Gjilan	266,666.00
26	28 Nëntori	Shitorja (82m²) Rr.Bulevardi i Pavarsise Gjilan	Gjilan	333,333.00
27	28 Nëntori	Depo ne Gjilan (5800m²)	Gjilan	740,000.00
28	28 Nëntori	Dy Objekte me karakter te perkohshem-garazhe (37m²)	Gjilan	3,250.00
29	Morava e Binçës	Moravamont	Gjilan	627,000.00
30	Morava e Binçës	Morava e Binçes Gurëthyesi Gllama	Gjilan	4,150,000.00
31	Morava e Binçës	Morava e Binces Administrata SHPK	Gjilan	1,222,222.00
32	Morava e Binçës	Shitoret Morava e Binçes	Gjilan	51,750.00
				20,572,337.00

Burim : Nga hulumtimi personal

Nga pesë ndërmarrje, që ishin bartës i zhvillimit ekonomik të komunës së Gjilanit për dekada të tëra, me rastin e privatizimit u parcelizuan dhe u krijuan gjithsej 32 ndërmarrje të reja.

Një strategji e tillë, e krijimit të më shumë njësive nga një ndërmarrje, gjatë privatizimit AKM-AKP, e arsyeton me faktin e rritjes së çmimit, që mund të arrihej, nëse janë më tepër njësi.

Një veprim i tillë nuk u dëshmuar, se me të vërtetë vlen për të gjitha rastet. Nga shitja e këtyre ndërmarrjeve u realizuan gjithsej 20,5 milion euro. Këtë çmim as pesimistët më të mëdhenj nuk arritën të besonin se do të përtrollitej në Kosovë.

Nga librat e kontabilitetit arrihet në përfundim, se vetëm vlera e objekteve dhe makinerisë së këtyre ndërmarrjeve arrin shumën prej 25 milion eurosh. Këto ndërmarrje ngërthenin pasuri tokësore, në sipërfaqe prej 1.337,39 ha. Nga kjo, arrihet përfundimi i vështirimit tonë, se së paku për 5 herë duhej të ishte më i lartë çmimi shitës i këtyre ndërmarrjeve, nëse merret në konsideratë edhe vlera e tokës.

Tabela 20- Lista e vlerës së pasurisë të ndërmarrjeve para procesit të privatizimit ZR në Gjilan:

Nr	Emri i ndërmarrjes	Objekte në Euro	Makineria në Euro
1	NSHIT Integj	9,554,297.00	2,620,717.00
2	IDGJ Industria e Duhanit	1,865,299.00	1,538,161.00
3	KBI Agrokultura	112,472.00	33
4	NSHT 28 Nëntori	420,291.00	13,353.00
5	NHNI Morava e Binçës	6,202,384.00	2,868,335.00
		18,154,743.00	7,040,599.00

Burim: Librat e Ndërmarrjeve

Nga tabela vërehet se vlera e objekteve, si mjete themelore, arrin shumën prej 18,154,743.00 euro, duke përfshi edhe normën së amortizimit, kurse makineria është vlerësuar në shumë, prej 7,040,599.00 e zbritur për normën e amortizimit.

Një nga argumentet që i jepte AKM-AKP –ja përkitazi çmimeve të ulëta shitëse, ishte se këto vlera ishin pikërisht vlera të tregut

Komuna e Ferizajit - Ndërmarrjet Shoqërore në komunën e Ferizajt ishin poashtu nën menaxhimin e ZR të AKP-së në Gjilan. Ngjashmëritë janë evidente në mes këtyre dy komunave, ngase shikuar si nga aspekti i numrit të banorëve, të ndërmarrjeve dhe të zhvillimit të tërësishëm të ekonomisë.

Tabela 21-Lista e Ndërmarrjeve Shoqërore nga Komuna e Ferizajt për privatizim:

Nr	Emri i Ndërmarrjes	Statusi i NSH	Aktiviteti	Komuna
1	N.SH "Minex"	NSH	Prodhim	Ferizaj
2	N.SH. Fabrika e Vajit	NSH	Prodhim	Ferizaj
3	K.B "Ferizaj"	NSH	Bujqësi	Ferizaj
4	K.B. "Bashkimi"	NSH	Bujqësi	Ferizaj
5	K.B. "Bujku" - Ferizaj	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj
6	K.B."Talinovci"	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj
7	N.Sh "Pasuria Bujqesore"	NSH	Bujqësi	Ferizaj
8	N.SH. Plantacioni i Pemeve	NSH	Bujqësi	Ferizaj
9	N.N.Z. "Mustafë Goga"	NSH	Ndërtim	Ferizaj
10	Ekonomia E Pyjeve Ferizaj	NSH	Ekonomi pyjore	Ferizaj
11	IMK Pipe Manufacturing	NSH	Prodhim	Ferizaj
12	N.P.SH.T."Metalografika"	NSH	Prodhim	Ferizaj
13	N.SH. Fabrika e Veglave dhe Aparateve Elektrike	NSH	Prodhim	Ferizaj
14	N.T.P.SH "Metali"	NSH	Prodhim	Ferizaj
15	NSH "Eurometal"	NSH	Prodhim	Ferizaj
16	Fabrika e Veglave dhe Makinave	NSH	Prodhim	Ferizaj
17	N.SH.T Autoshtepia "Mustafe Rexhepi"	NSH	Tjera	Ferizaj
18	Radio Ferizaj	NSH	Tjera	Ferizaj
19	SH.A.M "Semafori"	NSH	Tjera	Ferizaj
20	Sheep Farm Rakaj	NSH	Bujqësi	Ferizaj
21	N.H. "Drita" Hotel	NSH	Shërbime	Ferizaj
22	N.T. "17 Nentori"	NSH	Trade & Retail	Ferizaj
23	N.T.Sh "Tregtia"	NSH	Trade & Retail	Ferizaj
24	"Kosovatrans" Ferizaj	NSH	Transport	Ferizaj
25	N.Sh.T.Rr. "Fertrans"	NSH	Services	Ferizaj
26	Kombinati Drurit "Tefik Çanga"	NSH	Wood processing	Ferizaj
27	Fabrika e Bukës dhe Pjekurinave	NSH	Prodhim	Ferizaj
28	Hidrohigjiena - Ferizaj	Publike	Tjera	Ferizaj
29	"Barnatorja Popullore" Ferizaj	NSH	Shëndetësi	Ferizaj
30	"Bankos" Ferizaj	Bankare	Tjera	Ferizaj
31	Agroblini	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj
32	Agrodoganaj	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj
33	Agrofryti	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj
34	Agrokultura/Ferizaj	NSH	Bujqësi	Ferizaj
35	Arbana	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj
36	Bibaj	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj
37	Bleta	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj
38	Burimi	Kooperaativë	Bujqësi	Ferizaj

Si bartës i zhvillimit ekonomik të komunës së Ferizajt konsiderohen : Fabrika e Tubave, Kombinati i Drurit, NT 17 Nëntori, Fabrika e Aparateve Elektrike dhe NN Mustafë Goga. Gjatë analizës do të bëjmë përshkrimin e ecurisë tyre drejtë procesit të privatizimit.

Duhet theksuar se dy ndërmarrje nga kjo komunë : Fabrika e Vajit dhe NSH Minex, para procesit të privatizimit kaluan përmes fazës së komercializimit (dhënia me qira).

Tabela 22- Ndërmarrjet Shoqërore në Komunën e Ferizajt me rëndësi primare:

Nr	Emri i ndërmarrjes	Selia	Veprimtaria	Madhesia	Viti i privatizimit	Metoda e privatizimit	Nr i punëtorve më 1989	Nr i punëtorve aktivë para privatizimit	Nr i punëtorve të përfshirë në Listën e 20%	Shfrytëzuesi
1	Fabrika e Tubave	Ferizaj	Prodhimi	E madhe	2006	SOS	1317	658	677	20-30%
2	Kombinati i Drurit	Ferizaj	Prodhimi	E madhe	2005	SO	1050	196	714	14-16%
3	NT 17 Nëntori	Ferizaj	Tregtia	E madhe	2007	SO	349	193	242	25-30%
4	Fabrika e Veglave	Ferizaj	Prodhimi	E madhe	2006	SO	262	115	229	30-35%
5	NNI Mustafë Goga	Ferizaj	Ndërtimi	E madhe	2007	SO	1285	80	113	4-6%
							4263	1242	1975	

Burim: Sindikatat e Ndërmarrjeve Shoqërore

Ngjashëm me ndërmarrjet e privatizuara në Komunën e Gjilanit, edhe ndërmarrjet më të rëndësishme në Komunën e Ferizajt, u privatizuan që në kohën e AKM-së. Nga tabela e lartshënuar, arrihet në përfundim se problemet kryesore të këtyre ndërmarrjeve, ishin shfrytëzimi i pamjaftuar i kapaciteteve prodhuese, dhe rënia e numrit të punëtorve aktivë. Këta faktorë qenë të mjaftueshëm, sipas AKM-së, që të ruhej prona shoqërore. Këto ndërmarrje duhej të privatizoheshin sa më shpejt.

Nga ndërmarrjet që gravitonin në komunën e Ferizajt, karakterizohen për një zhvillim dinamik, më të lartë krahasuar me komunat e tjera. E shumta e këtyre ndërmarrjeve të cilat kishin rëndësi më të madhe, u privatizuan në kohën e AKM-së, duke themeluar njësi të reja përmes parcializimit të këtyre ndërmarrjeve, për cilësinë e

ndërmarrjeve të reja. Çështje më vete, do të mbetet çmimi i realizuar nëpërmjet njësive: se a do të jetë më i madh çmimi, se sa po të ishte shitur ndërmarrja si tërësi.

Tabela 23 Ndërmarrjet e reja të themeluara nga privatizimi i komunës së Ferizaj

Nr.	Ndërmarrja	Ndërmarrja e re	Komuna	Çmimi i shitjes	Dt e Kontrates
1	IMK Depo Fabrika e Tubave	IMK Depo Fabrika e Tubave	Ferizaj	630,000.00	04.07.2006
2	IMK Fabrika e Tubave	IMK Fabrika e Tubave	Ferizaj	3,657,000.00	21.11.2007
3	Kombinati i Drurit	Depo Komb. Drurit	Ferizaj	2,162,250.00	11.05.2005
4	Kombinati i Drurit	Fabrika e Komb. Drurit	Ferizaj	3,100,001.00	22.05.2006
5	17 Nëntori	17 Nëntori zyret dhe qendra tregtare	Ferizaj	1,666,666.00	16.05.2007
6	17 Nëntori	17 Nëntori shitoret	Ferizaj	401,000.00	18.05.2007
7	17 Nëntori	Shitorja "Vilezrit Gervalla' LLC"	Ferizaj	477,770.00	30.10.2007
8	17 Nëntori	Shitorja qendrore	Ferizaj	1,030,000.00	21.06.2007
9	17 Nëntori	Shitorja rruga e Gjilanit	Ferizaj	301,333.00	21.06.2007
10	17 Nëntori	Shitorja Dëshmorët e Kombit LLC	Ferizaj	942,346.00	09.05.2008
11	17 Nëntori	Shitorja në shesh LLC	Ferizaj	1,256,250.00	09.05.2008
12	17 Nëntori	Shitorja në qendër LLC	Ferizaj	1,476,007.00	30.05.2008
13	17 Nëntori	Shtëpia e bardhë LLC	Ferizaj	121,121.00	04.05.2009
14	17 Nëntori	Barakat	Ferizaj	140,000.00	10.06.2008
15	17 Nëntori	Shitorja në Lypjan	Ferizaj	72,199.00	08.06.2009
16	17 Nëntori	Toka komerciale dhe ndertesa	Ferizaj	873,333.00	06.11.2009
17	17 Nëntori	Shtëpia e bardhë shitorjaShop LLC	Ferizaj	49,555.00	22.12.2009
18	17 Nëntori	Shitorja West	Ferizaj	45,675.00	25.01.2010
19	17 Nëntori	Shitore në rrugen Woodrow Wilson Street	Ferizaj	1,458,888.00	02.03.2010
20	17 Nëntori	New Co Apartmenti ne shtepin e bardhë	Ferizaj	131,131.00	15.09.2011
21	Fabrika e Veglave	Veglat dhe aparatet	Ferizaj	135,555.00	19.06.2006
22	Mustafë Goga	Baza e lendes se pare	Ferizaj	405,250.00	03.06.2007
23	Mustafë Goga	Baza administrative	Ferizaj	1,555,555.00	25.10.2007
24	Mustafë Goga	Restauranti i punëtorve	Ferizaj	121,150.00	24.08.2007
				22,078,904.00	

Burim- Hulumtimi në AKP

Nga tabela vërehet se nga pesë ndërmarrje shoqërore të privatizuar në Komunën e Ferizaj, që janë marrë si objekt studimi, vërehet se janë gjallëruar 24 njësi të reja, për cilësi të ndërmarrjeve të reja. Vlera shitëse e këtyre njësive është 22,078,904,00 euro. Sikur në rastin paraprak (Komuna e Gjilanit), çmimi i realizuar dëshmohej si tejet i ulët krahasuar me vlerën e këtyre ndërmarrjeve, që udhëhiqej në librat e tyre. Po ashtu, edhe këtu do të mbetet çështje për diskutim, se a ishte kjo vlera e tregut e këtyre pronave ose

kishte gjëra të ndërmjetme. Për ilustrim të këtij pohimi, në vijim mund të vërehen shënimet nga tabela vijuese, përkitazi vlerës së këtyre ndërmarrjeve shoqërore, sipas librave që ato i mbanin.

Tabela 24 - Lista e vlerës së pasurisë të ndërmarrjeve me rëndësi para procesit të privatizimit, Komuna, Ferizaj

Nr	Emri I ndërmarrjes	Objekte në Euro	Makineria në Euro	Toka në Euro	Total
1	Fabrika e Tubave	16748.518.00	24,406,646.00	1,765,747.00	42,920,911.00
2	Kombinati I Drurit	37,601,918.00	4,948,423.00	14,316,173.00	56,866,514.00
3	NT 17 Nëntori	8,107,900.00	66,289.00		8,174,189.00
4	Fabrika e Veglave	4,060,450.00	1,882,300.00	9,132,000.00	15,074,750.00
5	NNI Mustafë Goga	1,564,348.00	22,856.00	3,653,400.00	5,240,604.00
		51,334,616.00	31,326,514.00	28,867,320.00	128,276,968.00

Burim- Librat e Ndërmarrjeve

Të dhënat e mësipërme nga tabela, na bëjnë të kuptojmë se këto ndërmarrje të marra për analizë, përbënin boshtin e zhvillimit të ekonomisë së Komunës së Ferizajt. Vlerësimi i këtyre ndërmarrjeve, në 188,276,968.00 euro, paraqet vlerën e gjashtëfishhtë më të lartë, se sa çmimi që u realizua me rastin e shitjes së tyre. Nëse përjashtohet toka, sepse çmimi i tokës lëviz nga vendi dhe boniteti i saj; atëherë vetëm vlera e objekteve dhe makinerisë së këtyre ndërmarrjeve arrin mbi 100 milion euro.

Në vërtetësinë e këtyre shënimeve duhet të besojmë, sepse ndërmarrjet nuk e kanë bërë këtë vlerësim, si kërkesë ndaj procesit të privatizimit. Nëse merret propabiliteti i gabimit, 20-30%, sërish çmimi i realizuar me rastin e shitjes, paraqitet si tejet i ulët.

Komuna e Kamenicës - me qytetin me të njëjtin emër, paraqitetet si komunë e cila kufizohet me Serbinë. Si qytezë e vogël, Kamenica karakterizohet me zhvillim ekonomik, kryesht pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo komunë është e pasur me xehe (magnezit dhe xehe tjera), andaj një anë e fortë e kësaj komune qenë lëmitë, që punësonin pjesën më të madhe të punëtorëve aktiv. Ndërmarrjet të cilat kishin trajtimin e ndërmarrjeve shoqërore, dhe që morën një kahe t'i nënshtroheshin procesit të privatizimit, janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme

Tabela 25- Lista e Ndërmarrjeve Shoqërore në Komunën e Kamenicës:

Nr	Emri i Ndërmarrjes	Statusi	Veprimtaria	Komuna
1	Agro Coop Ranilug	Kooperativë	Bujqësi	Kamenicë
2	K.B "Agroprodukti"	NSH	Bujqësi	Kamenicë
3	K.B. "Bujku"	NSH	Bujqësi	Kamenicë
4	K.B.K "Strezovci"	Kooperativë	Bujqësi	Kamenicë
5	KKB "Perparimi" Hogosht	Kooperativë	Bujqësi	Kamenicë
6	E.N.G. "Beton"	NSH	Ndertimtari	Kamenicë
7	N.P.T "Tullara"	NSH	Prodhim	Kamenicë
8	N.Sh. "Xiq Karaqeva"	NSH	Prodhim	Kamenicë
9	Ekonomia E Pyjeve Kamenice	NSH	Pyje	Kamenicë
10	N.Sh."IMKOS"	NSH	p	Kamenicë
11	Magnochrom/Xim Strezovci	NSH	Minierë	Kamenicë
12	N.T.P. "Kosovarja"	NSH	Tekstil	Kamenicë
13	Pionir	NSH	Tekstil	Kamenicë
14	N.T.Sh. "Hotel Mineral"	NSH	Shërbime	Kamenicë
15	N.T.Sh. "Qendresa"	NSH	Tregti	Kamenicë
16	Kosovatrans - Kamenica	NSH	Transport	Kamenicë
17	Ndërmarrja Publike Komunale	Publike	Tjera	Kamenicë
18	Vet Station - Kamenice/a 1	NSH	Bujqësi	Kamenicë
19	Vet Station - Kamenice/a	NSH	Bujqësi	Kamenicë
20	Radio Kamenica	Publike	Tjera	Kamenicë
21	N.Sh. Jometalet "KAOLINI"	NSH	Minierë	Kamenicë

Burimi AKP

Nga tabela e mësipërme, mund të vërehet, se në këtë komunë janë të përqendruara një numër i ndërmarrjeve, të cilat kanë karakter të minierave dhe industri përpunuese, që lëndë të parë e kanë xehen nga këto ndërmarrje .

Ndërmarrjet e hulumtuara që kanë rëndësinë parësore për këtë komunë, janë listuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela 26- Ndërmarrjet Shoqërore me rëndësi parësore në Komunën e Kamenicës:

Nr	Emri i Ndermarrjes	Komuna	Veprimtaria	Madhësia	Viti i tenderimit	Metoda e privatizimit	Nr i punetorve më 1989	Nr i punetorve të përfshirë në Listën e 20%	Nr i punetorve të përfshirë në Listën e 20%	Shfrytëzimi i kapacitetit
16	NSH Magnohrom-XIM Strezovci	Kamenicë	Prodhim	E Madhe	2007	SOS	408	145	59	3-5%
17	NSH Eng Beton	Kamenicë	Ndërtim	E Madhe	2004	SO	489	110	121	15-20%
18	NSH Tullara	Kamenicë	Prodhim	e Mesme	2008	SO	146	80	27	15-18%
19	NSH XIQ Karaqeva	Kamenicë	Prodhim	e Mesme	2006	SO	741	11	459	2-4%
20	NT Qëndresa	Kamenicë	Tregti	e Mesme	2007	SO	80	50	48	30-40%
							1864	396	714	

Burim- Sindikatat e Ndërmarrjeve Shoqërore

Ngjashëm si në komunitat e tjera, pas provave të analizuar, ndërmarrjet e lartë cekura kishin probleme të njëjta. Nga numri i punëtorëve aktiv prej 1864 (në vitin 1989), numri i punëtorëve që ishin të përfshirë në listat e kompensimit, prej 20% ishte 714. Poashtu, shfrytëzimi i kapaciteteve është prej 2% deri në 40%. Ngjashmëri me dy komunitat paraprake të analizuar, doli se ndërmarrjet shoqërore, me rëndësi primare për këtë regjion, janë privatizuar në mandatin e AKM-së.

Tabela 27- Ndërmarrjet e reja të krijuara nga privatizimi i Komunës Kamenicë:

Nr	Nr. i njëjësive	Ndërmarrja	Ndërmarrja e re	Komuna	Çmimi i shitjes
1	1	Xim Strezovci	Xim Strezovci Magnezit Mine"LLC	Kamenicë	45,555.00
	2	Xim Strezovci	Strezovci baza e transportit	Kamenicë	286,560.00
	3	Xim Strezovci	Toka në Topanice	Kamenicë	e pa shitur
2	4	ENG Beton	ENG Beton	Kamenicë	425,235.00
	5	Eng Betoni	Toka në Topanice	Kamenicë	e pa shitur
3	6	Tullara	Tullara	Kamenicë	109,136.00
4	7	XIQ Karaqeva	Karaqeva	Kamenicë	888,888.88
	8	XIQ Karaqeva	Karaqeva fabrika e vjetër	Kamenicë	605,689.00
5	9	Qëndresa	Qendresa Shtepia e Mallrave	Kamenicë	430,000.00
	10	Qëndresa	Qendresa Shitore	Kamenicë	43,650.00
	10				2,504,503.88

Burim: AKP

Shënimet tabelare na bëjnë të kuptojmë se nga pesë ndërmarrjet më të rëndësishme në Komunën e Kamenicës, u krijuan dhjetë njësi të reja, në cilësi të ndërmarrjeve të reja, me një çmim të përgjithshëm, prej 2,504.503,88 euro. Se sa do të jetë një çmim i tillë real dhe i pranur, vlen të përmendet se ka shtëpi në Komunën e Kamenicës, vlera e të cilave është përcaktuar mbi një milion euro, ose së paku pesë shtëpi, do të kishin arritur çmimin e pesë ndërmarrjeve të shitura.

Nga hulumtimi dhe shënimet e mundshme, të grumbulluara përmes Sindikatës së Pavarur (gjithsej 3 të tilla) të këtyre ndërmarrjeve (në bazë të librave të kontabilitetit), arrihet në përfundim se çmimet e mbajtuara në evidencën e këtyre ndërmarrjeve, dhe çmimi i realizuar i shitjes është i pakrahasueshëm

Tabela 28- Lista e vlerës së pasurisë të ndërmarrjeve me rëndësi, para procesit të privatizimit në Komunën Kamenicë:

Nr	Emri i ndërmarrjes	Objekte në Euro	Makineria në Euro	inventari në Euro	Toka në Euro	Total
1	NSH Magnohrom- XIM Strezovc	50,339,594.00				50,339,594.00
2	NSH XIQ Karaqeva	8,397,500	4,092,211.00		1,690,000.00	14,179,711.00
3	NT Qëndresa	3,164,727.00	3,293,00			3,168,020.00
		61,901,821.00	4092211		1690000	67,687,325.00

Burim: Sindikata e Pavarur

Nga tabela mund të vërehet, se çmimi i mbajtur në evidencën e këtyre ndërmarrjeve, në asnjë mënyrë nuk mund të krahasohet me çmimin e shitjes. Sipas teorisë së AKM/AKP-së, ky ishte „çmimi i tregut“. Athua, vallë vërtet ishte pikërisht kaq?

Komuna e Vitisë, Kaçanikut, Shtërpcës dhe Novobërdës- Gjatë analizës këto komuna janë shtjelluar bashkarisht për hirë të thjeshtësimit të tyre. Para së gjithash, të gjitha këto komuna, është fjala për komuna të vogla, ngase në to është koncentruar një pjesë e rëndësishme e ekonomisë së Republikës së Kosovës. Nga këto komuna procesit të privatizimit i janë nënshtruar gjithsej 45 ndërmarrje, të cilat kishin karakterin e ndërmarrjeve shoqërore (Viti 13, Kaçanik 13, Shtërpc 17 dhe Novobërdë 2). Vetitë e këtyre ndërmarrjeve janë të tilla: p.sh. në Komunën e Vitisë u përqendruan ndërmarrje, të cilat kanë veprimtari kryesore bujqësinë e, po ashtu, aty gjendet edhe një banjë me rëndësi të madhe për këtë komunë.

Në Komunën e Kaçanikut kryesisht janë ndërmarrjet, që merren me prodhim të materialit ndërtimor, kurse Komuna e Shtërpcës karakterizohet me ndërmarrje që i kushtonin rëndësi lëmesë së turizmit dimëror (kompleksi i hoteleve të Brezovicës). Komuna e Novobërdës karakterizohet me dy ndërmarrje, të cilat kanë karakter të Kooperativave Bujqësore, të cilat ende deri më sot nuk janë shitur.

Tabela 29- Ndërmarrjet e reja të krijuara nga privatizimi i komunave: Viti, Kaçanik, Shtërpc dhe Novobërdë:

Nr	Nr. I njesive	Ndërmarrja	Ndërmarrja e re	Komuna	Çmimi i shitjes
1	1	Agromorava	Agromorava Ramjan	Viti	353,535.00
	2	Agromorava	Agromorava Motel	Viti	215,500.00
	3	Agromorava	Depo dhe tokë në Gërmovë	Viti	309,990.00
	4	Agromorava	Agricultural Toka në Nec	Viti	106,122.00
	5	Agromorava	Agricultural Toka në Pozharan-S	Viti	51,500.00
	6	Agromorava	Agricultural Toka në Beli Dub	Viti	156,555.00
	7	Agromorava	Depo në Pozharan	Viti	50,150.00
	8	Agromorava	Agromorava Mulliri Elektrik	Viti	301,000.00
	9	Agromorava	Agromorava Ferma	Viti	41,111.00
	10	Agromorava	Agricultural Toka ne Nec 2	Viti	107,000.00
	11	Agromorava	Agricultural Toka në Begrac 2	Viti	107,000.00
	12	Agromorava	Toka ne Drobeshe	Viti	157,000.00
2	1	Banja e kllkotit	Banja e Kllkotit Uji Mineral	Viti	1,680,000.00
	2	Banja e kllkotit	Kllkot Toka Bujqësore	Viti	401,250.00
	3	Banja e kllkotit	Banja e Kllkotit Stacionari	Viti	3,601,00.00
3	1	Sharr Sallonit	Sharr Salloniti	Kaçanik	8,890,000.00
4	1	Silcapor	Silcapor (blocks producer)	Kaçanik	2,824,153.00
					15,751,866.00

Ndërmarrjet e shënuara në tabelën e mësipërme, paraqesin bartësit e zhvillimit ekonomik në këto komuna. Mirëpo, nga tabela janë përjashtuar edhe dy ndërmarrje të mëdha, të cilat kishin karakterin e ndërmarrjeve shoqërore: Fabrika e Çimentos në Han të Elezit dhe Kompleksi Turistik Brezovica. Në rastin e parë, Fabrika e Çimentos është shitur me çmimin prej 30,100,000 euro, si fabrikë e vetme në Kosovë. Nëse kësaj i shtohet fakti se së paku për dhjetë herë janë kërkesat për likuidim të kësaj ndërmarrje, atëherë lehtë arrihet në përfundimin, se cila ishte vlera reale e kësaj ndërmarrje. Kjo ndërmarrje është shitur nëpërmjet Zyrës Qendrore të AKP-së. Në këtë rast pyetja mbetet pa përgjigje.

Kompleksi Turistik Brezovica ishte kafshatë e madhe për menaxhim dhe privatizim përmes AKP-së, andaj qeveria në këtë pikëpamje filloi të “ndihmojë”, dhe e dha me koncesion për periudhën kohore prej 20 vitesh, një kompanie të jashtme, me çmim mbi 400 milion euro.

Ndërmarrja Shoqërore Agromorava në Viti, ka në pronësi tokë bujqësore mbi 1200 hektarë. Deri më tash janë shitur mbi 600 hektarë, kurse procesi i shitjes tashti vazhdon përmes shitjes me likuidim; sepse kjo ndërmarrje për momentin ndodhet në fazën e likuidimit.

Po ashtu, edhe çmimi sipas librave të ndërmarrjeve dhe çmimit të realizuar të shitjes, nuk mund të krahasohen.

Tabela 30 Lista e vlerës së pasurisë të ndërmarrjeve me rëndësi para procesit të privatizimit në komunat: Viti, Kaçanik, Shtërpçë, Novobërdë.

Nr	Emri i ndërmarrjes	Objekte në Euro	Makineria në Euro	inventari në Euro	Toka në Euro	Total
1	NSH Banja e Kllokotit	2,288,980.00	757,077.00	173,894.00	2,738,864.00	5,958,815.00
2	KAP Sharr Salloniti	6,620,489.00	365,232.00			6,985,721.00
3	NP Sillcapor	11,568,389.00	53,973,074.00		29,051,112.00	94,592,575.00
		20,477,858.00	55,095,383.00	173,894.00	31,789,976.00	107,537,111.00

Burimi: Sindikata e Pavarur

Nga tabela vërehet se mungojnë shënimet nga Komuna Shtërpç. Kjo ndodh, për shkak se në këtë komunë, përbërja kombëtare është me shumicë popullatë serbe, dhe mungoi vullneti për koperim nga ana e sindikatave të këtyre ndërmarrjeve.

6 KREU VI: Konkluzione dhe rekomandime

6.1 Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzionet dhe rekomandimet, kanë si rezultat të hulumtimit, i bërë përmes metodave të nënvizuara në fillim, dhe metodës së anketimit të zhvilluar me Sindikatat e Pavarura të Ndërmarrjeve Shoqërore të privatizuar, grumbullimit të shënimeve nga burimet primare AKM-AKP dhe të dhënave tjera dytësore.

Çështja studimore do të merrte kahe, pikërisht në vërtetimin e argumentuar të çështjes, se rruga e zgjedhur e procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, nuk ishte rruga më e mirë e mundshme. Mbetjet e ndërmarrjeve të cilat janë në proces të privatizimit, kërkojnë alternativa të tjera për zgjidhje më fatlume, më frytdhënëse, për të cilat duhet kërkuar metoda të reja.

6.2 Disa probleme dhe të meta të punës së Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM)

Procesi i privatizimit në Kosovë, nuk u prit me ndonjë entuziazëm. Më tepër vinte në shprehje dyshimi dhe frika nga e nesërmja, se sa gëzimi. Kosova ndodhej në situatë, që nga ajo kërkohej “përmbushja e standardeve”, me qëllim që të ishte më afër Evropës. Ishin të nevojshme tri vite përpjekje, që të krijohej baza juridike për fillimin e procesit të privatizimit. Po ashtu, u kaluan 11 muaj për miratimin e rregulloreve mbi pronësinë e tokës, me qëllim që përfundimisht të fillohet procesi i privatizimit.

Me dy valët e para të privatizimit, u konsiderua se filloi puna për së mbari. Në valën e tretë problemet dolën në dritë:⁹⁷

- Kontestimi i bazës juridike dhe të procedurave të politikës operationale.
- Pasuan konsultimet në Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Çështje Juridike, në New York.

⁹⁷ Dr Muhamet Mustafa –Privatizimi në Kosovë, Riinvest 2004, fq. 11

- Erdhi deri te ndërprerja e procesit të privatizimit, dhe u ndalua shpallja e valës së tretë.
- Filluan mospajtimet në kuadër të AKM-së, të AKM-së dhe qeverisë, përkitazi me ndryshimet fundamentale të qasjes ndaj procesit të privatizimit, dhe ndryshimeve të punës së menaxhmentit të AKM-së.
- Si rezultat i kësaj gjendje erdhi deri te paralizimi i punës së AKM-së për pesë muaj.

E tëra kjo ndikoi në:

1. vonesë për përmbushje të standardeve;
2. dekurajimin e investitorëve të jashtëm dhe rënia e imazhit për Kosovën;
3. humbjet dhe vështirësitë në të cilat hasnin pronarët e rinj të ndërmarrjeve;
4. dëme në potencialin kreditor të bankave;
5. çrregullime në bashkëpunimin në mes UNMIK -AKM dhe institucionet e Kosovës;
6. Politizimi i madh i procesit dhe krijimi i hapësirës për përzierje të qeverisë së Serbisë.

Lidhur me këtë çështje filluan të parashtrihen pyetje se kush e krijoi këtë situatë, dhe kush duhet t'i bartë përgjegjësitë. Pasojat, kuptohet se i bartte populli i Kosovës, në veçanti punëtorët, që kishin mbetur pa punë. Në të vërtetë, që nga fillimi nuk ishin marr në shqyrtim të gjithë faktorët relevantë, ata faktorë që kanë ndikim në këtë proces. Atëherë kur Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e miratuan rregulloren për themelimin e AKM-së, nuk morën në konsideratë rrugën ligjore, me anë të së cilës do të funksionojë AKM-ja... P.sh a do të mund dhe si Qeveria e Serbisë do të bëjë blerjen e ndërmarrjeve në Kosovë? Nuk kishte asnjë nen, në bazë të së cilit një gjë e tillë do të mund të pengohej⁹⁸.

⁹⁸ KIPRED- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Pronës Shoqërore, Prishtinë, 2005, fq. 13

Institucionet e Kosovës nuk e kuptonin se mjetet e grumbulluara nga procesi i privatizimi, nuk do të dedikohen për investime në projekte dhe zhvillim të infrastrukturës në Kosovë. Ata nuk e kishin të qartë, edhe pse dihej se 20% nga shitja, do t'iu takojë punëtoreve.

Shtrohet pyetja: çka do të bëhej me pjesën prej 80% të mjeteve të grumbulluara nga shitja e ndërmarrjeve? Nuk i kishin të qartë të dhënat, se këto mjete do të shërbejnë për pagesën e obligimeve, që i kishin ndërmarrjet ndaj kreditorëve real. Nga kjo rrjedh përfundimi, se meqë ndërmarrjet nga Kosova ishin ngushtë të lidhura, në pikëpamje afariste, me ndërmarrjet nga Serbia, megjithatë këto mjete do të kthehen në Serbi. Me ato mjete, kuptohet se Serbia do të mundej sërish t'i blinte ndërmarrjet, të cilat janë në proces të privatizimit pa investuar fare.

Situatë tjetër e pavoritshme, ishte ajo që kishte të bënte me çështjen, se AKM-ja ishte në gjendje të përfshijë të gjitha ndërmarrjet dhe pasurinë e tyre (Urdhëresa e UNMIK-ut 2000/45 e d. 11 gusht 2000), për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë⁹⁹. Me këtë rregullore e tërë pasuria e komunave bie nën administrimin e UNMIK-ut. Ndodhi kështu që komunat u përjashtuan për vetë-menaxhim të pronave të tyre, andaj edhe planet urbanistike e zhvillimore nuk kishin vlerë. Kjo çështje solli parakushtet e konfliktit të domosdoshëm në mes të komunave dhe AKM-së.

Po ashtu, edhe krijimi i Odës së Veçantë, që përjashtonte të gjitha gjykatat e tjera, përkitazi me çështjet pronësore, ishte burim i pakënaqësive. Dominimi me anëtarë të karakterit ndërkombëtar, faktorin vendor e la në pozitë inferiore, posaçërisht në fushën e vendimmarrjes.

⁹⁹ Urdhëresa UNMIK 2000/45, neni 1... Deri në rregullimin e statusit të Kosovës, kjo Rregullore, në harmoni me rezolutën 1244 të KSKB themelon institucionet e përkohshme demokratike për qeverisje në nivel komune si hap drejtë bartjes graduale të kompetencave administrative në Institucionet e Përkohshme të Administrimit UNMIK, i cili do të mikçyr dhe jep përkrahje në konsolidimin e këtyre institucioneve

AKM-ja ishte shtet më vete. Askujt nuk i jepte llogari dhe sqarime për punën e vet, prandaj as faktorit vendor. Kjo kushtëzoi që nga fillimi, të dyshohet në transparencën e këtij procesi dhe në punën e AKM-së.

Problemet e sipërthëna, sollën situata ku u vërejtën gabime të pa tej kalueshme. Kështu, për 5 muaj erdhi deri te ndalja e këtij procesi. Në mesin e parregullsive që u vërejtën ishin :

- mundësia e tenderëve të kontraktuar. Kjo zhvillohej në atë formë që gjatë tenderimit kualifikoheshin tre të parët, që kishin çmimin më të lartë, (në fakt ishte e mundur që të jetë vetëm një tenderues me tre emra të ndryshëm). Gjatë tenderimit të dytë, në mes këtyre tre të parëve, që kishin fituar të drejtën e kualifikimit, dy të parët mund të tërhiqeshin nga tenderi “me marrëveshje të fshehta” në mes të ofertuesve, në mënyrë që i treti të fitonte tenderin me çmim shumë më të ulët.¹⁰⁰
- Rolin e faktorit politik gjatë tenderimit, përkitazi me caktimin e çmimit për qasje në tenderim... Kjo do të thotë, se çdo kush që ka dashur të merrte pjesë për tenderim, është dashur që në formë kaucioni të deponojë një shumë të caktuar të mjeteve.

Për ndërmarrje të mëdha, kuptohet se ishte çmimi më i lartë, ndaj kështu përgatiteshin rrethana për mundësinë e pjesëmarrjes në tender, vetëm “të përzgjedhurit”, dhe ata që ishin pjesë e faktorit politik.

- Preferencat e bankave për kreditimin e njerëzve të caktuar në procesin e privatizimit. Ata që kishin fuqinë politike dhe materiale, ishin të ledhatuarit e bankave komerciale. Dikujt i nevojitej një vit që të merrte një kredi, kurse dikujt, më pak se një orë.

¹⁰⁰ Rregullat e tenderimit për privatizim- Spin OFF, fq. 9 Me ofrimin e ofertës, ofertuesi e kupton se garon për blerjen e Ndërmarrjes dhe artikujve të shpallur në tender dhe se Agjencioni bënë shitjen e Ndërmarrjes sipas Çmimit më të Lartë të Ofruar. Ofertuesi më i lartë do të ketë mundësinë e blerjes. Nëse, për çfarëdo arye nuk do të realizohet shitja sipas ofertës më të lartë, atëherë ai që është si i dyti i plasuar do të ketë mundësinë, jo obligimin, që të bëjë blerjen e ndërmarrjes të shpallur në tender sipas çmimit më të lartë.

- Derisa punëtorët mbeteshin pa punë, disa njerëz të influencës, brenda natës, pasuroheshin në mënyrë marramendëse.

Duke marrë në konsideratë këto të dhëna, të cilat qenë përcjellëse e punës së AKM-së, që nga fillimi i punës, është e kuptueshme se fundi dikur duhet të vijë. Gjatë punës së AKM-së janë zhvilluar 30 valë të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore.

U zhvillua një proces, për të cilin mund të thuhet: “ *një e keqe e domosdoshme pa të cilën nuk bënte dot*”. Në këto kushte, ishte e qartë se një agjencion i këtillë nuk mund të vazhdonte punën më tej.

Me rastin e bartjes së kompetencave nga UNMIK-u në faktorin vendor, u arritën rrethana për përfundimin e punës së AKM-së. Procesi i privatizimit duhej të vazhdonte përmes themelimit të një agjencioni tjetër, i cili do të merrej me privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore, kurse Ndërmarrjet Publike mbetën të shqyrtohen më vonë, dhe do të ishin nën kompetencat e Qeverisë së Kosovës.

Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) pushoi së vepruari, më 30 qershor 2008, ndërsa atë e pasoi Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP). Që atëherë u konstatua se pranim-dorëzimi dhe trazicioni i detyrave dhe përgjegjësi nga AKM-ja tek AKP-ja, nuk u bë në mënyrë të rregullt, qoftë për bartjen e dokumentacionit ose të elementeve të tjera, që ishin rezultat i punës së AKM-së. Komplikimin e kësaj çështjeje e shtoi edhe djegia e “rastësishme” e një pjese të dokumentacionit. Kuptohet, se së fundi u konstatua, se megjithatë të gjitha shënimet kanë qenë të “ ruajtura” në serverin e AKM-së.

6.3 Ndikimet ekonomike, politike, socio-demografike dhe etike të procesit të privatizimit në Republikën e Kosovës

Vështrimi i procesit të privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, nga ky aspekt, mendoj se duhet dhënë përgjigje objektive në një varg pyetjesh, si:

- procesi i privatizimit a i ka sjellë rezultatet e pritura financiar?
- Si është përdorur fondi i privatizimit?
- Cili është efikasiteti ekonomik i ndërmarrjeve të reja?
- Cili ishte roli i këtij procesi në aspektin e sigurimit të mirëqenies politike?
- Cili ishte efekti i këtij procesi në aspektin socioal-demografik përkitazi me përmirsimin e kushteve të jetesës për popullatën në përgjithësi?
- Cila është gjendja etike dhe psikike e punëtorëve dhe e popullatës në përgjithësi në Republikën e Kosovës pas privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore?
- Cilat janë bindjet dhe marrëdhëniet e popullatës, ndaj faktorit ndërkombëtar lidhur me procesin e privatizimit?

Pyetje të shumta të kësaj natyre mund të shtrohen, por?... Mirëpo, nisur nga supozimet e bazuara, se Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë, para vitit 1999, vlerësoheshin 30-50 miliardë DM, andaj shitja e pjesës më të madhe të tyre, në një vlerë prej mbi 630 milion euro, është argument i mjaftueshëm, përkitazi efekteve financiare të shitjes së Ndërmarrjeve Shoqërore me anë të procesit të privatizimit. Nëse kësaj të dhëne i shtohet konstatimi, se këto mjete për periudhën kohore sa do të zgjaste procesi i privatizimit, (tashmë 14 vjet), nuk kanë qenë në qarkullim, sasi e tillë parash, me qëllim të investimit dhe kapitalizimit të tyre, prandaj nuk arrihet të kuptohet, se cili ishte qëllimi i privatizimit. Gjithsesi është e pakuptueshme, se si lejohej që këto mjete të ndodhen jashtë Kosovës, në banka të ndryshme të deponuara, me kamata tejet të ulta, dhe t'i nënshtrohen riskut të turbulencave financiare në njerën anë, kurse në anën tjetër,

të kërkoheshin kredi, me kushte tejet rigoroze që lidhen me zhvillimin ekonomik të vendit dhe, të cilat tashmë i duhen Kosovës më shumë se asnjë herë më parë.

Procesi i privatizimit, një nga qëllimet parësore, ka pasur zhvillimin ekonomik të vendit, përmes krijimit të vendeve të reja të punës. Rezultati është i anasjelltë. Më tepër se gjysma e ndërmarrjeve të privatizuar është jo aktive, nuk është vazhduar aktiviteti paraprak, nuk është rritur numri i të punësuarve, dhe mëdyshjet e diskursit zhgënjyes nuk kanë të sosur...

Njerëzit si pjestarë të popullit kanë ëndrrat e tyre. Ata duan që ëndrrat të realizohen. Vështruar në aspektin politik, (pas shpalljes së shtetit të Kosovës, më 17.02.2008), u besua se jeta do të jetë me plot sfida por më e lehtë.

Nga privatizimit u pritet se do të ndikojë për së mbari. Stabiliteti politik u ruajt me dridhje të vogla. Mirëpo, çfarë ndodhi në realitet pas vitit 2008 ? Situata e krijuar ishte e pa paramenduar, ndoshta, por...?

- U shaktërruan tre breza njerëzish...

1. Gjeneratat e vjetra mbetën pa pensione. Ata filluan të marrin një ndihmë sociale 30-80 euro, disa ishin të prirur ta quanin pension.
2. Gjenerata e mesme mbeti pa ndërmarrjet e tyre ku punonin. Mbetetën pa punë. Një numër i madh i tyre, nuk e morën as kompezimin ligjor prej 20% , ngasea iu takonte me rastin e shitjes së këtyre ndërmarrjeve. Një kompenzim i tillë ishte, pos lyerje e syve, për ata që mos të shihnin se çfarë kishte ndodhur në realitet. Përnjëherë u zgjeruan shtresimet sociale, dhe kishim nevojë të vazhdueshme për asistencë.
3. Gjenerata e re me një cilësi të këtillë të sistemit arsimor, nuk sheh perspektivë. Sistemi arsimor në Kosovë (për gjendjen momentale) paraqet një dështim. Gjenerata e re bleu disa letra, të quajtura diploma, me anë të cilave nuk gjendeshin vende pune. Jo nga shkaku i cilësisë së letrës, por nga fakti se ajo

nuk iu dëshmonte njohuri, për të cilat ata zotohen me atë letër. U rrit një armatë e njerëzve të rinj e të pa punë. Për pjesën më të madhe të tyre, një vend pune mbetet ende e pa realizuar.

- Rrita e ngadalshme ekonomike, ditë pas dite po sjellte, deri te rrezikimi i ekzistencës biologjike të popullatës.
- Degradimi i popullatës në njërën anë, dhe shtresimi i „millionaire” brenda natës, përmes punës jo meritore (procesi i privatizimit edhe në këtë fushë dha vullën e vet), do të jenë detyra të mjaftueshme, me të cilat do të duhej të merrej gjykata në periudhat e ardhme.

Për njohësit jo të mirë të procesit të privatizimit, mendohej se ky proces megjithatë, po lëviz në ujëra të qeta. As pesimistët më të mëdhenj nuk mund të paramendonin, se ky proces do të jetë aq i gjatë. Tashti ka ardhur deri te largimi i mjegullës. Tashmë po shihet realiteti. Jo stabiliteti ekonomik, i cili po troket në dyert e Kosovës, ka të bëjë edhe me çështjen e privatizimit.

Më herët, dorëheqja e të parit të shtetit nga pozita (Fatmir Sejdiu), dhe pritjet e atëhershme politike mbi rënien e qeverisë, etj; ishin rezultat pikërisht privatizimeve që duhej filluar, të ndërmarrjeve publike Post-Telekomit, dhe ndërmarrjeve tjera. Këso ndodhish ishin vetëm nisma, kurse tash (më 2015), derisa shkruhen këto rreshta, çështja e Ligjit për Trepçën, u bë mollë sherri që rrugët të jenë të stërmbythura me protestues, që kërkojnë shtetëzimin e kësaj ndërmarrjeje. Është e kuptueshme, që do të pasojnë dhe kërkesa politike, fundi i të cilave nuk mund të parashikohet.

Një situatë e tillë etike dhe psikike e krijuar te shtresat e gjera të popullatës (një pjesë e njerëzve që kanë qenë bartës të këtij procesi, që moti i kanë zgjidhur problemet e tyre), soll deri te paknaqësia e kërkesat për ndryshimin e gjendjes. Mungesa e motivimit për ditën e nesërme, është çështja më e rëndë që mund t'i ndodh një populli të qytetëruar..

Prania e faktorit ndërkombëtar, përkitazi sferave të shumta të jetës, do të ishte njerëzore t'i shfaqej një falenderim i sinqertë për „**ndihmën e ofruar**”, dhe tashmë përzierja e tyre për gjithçka e gjithkund, është e tepërt. Qëndrimi i mëtejshmë i tyre, do të mund të kishte karakter këshillues e jo menaxhues. Nuk mund të jetë plotësisht e kënaqur Kosova me vazhdimin e mandatit të UNMIK-ut në Kosovë.

Ngjashëm së shpejti do të duhej të ishte dhe çështja e misionit të EULEX-it, dhe të disa institucioneve tjera, të cilat do të duhej të mbetnin pa punë në Kosovë.

6.3.1 Efektet e procesit të privatizimit në zhvillimin ekonomik të Kosovës

Për inkorporimi e Kosovës në rrjedhat e botës moderne, një nga domosdoshmëritë ishte transformimi i sistemit ekonomik dhe shoqëror dhe ndërtimi i një sistemi të ri i cili do të ishte kompatibil me shtetet tjera të Evropës. Një nga kushtet të cilat kërkoheshin të plotësoheshin ishte edhe procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë.

Kjo ndodhi në kohën kur :

- Mungonte organizimi i mirfilltë i jetës ekonomike dhe politike,
- Rënie e prodhimit dhe të gjithë parametrave ekonomik në periudhën 1999-2002
- Rënia e punësimit,
- Rënia e eksportit,
- Ngritje e ekonomisë së hirët etj.

Kjo na bënë të kuptojmë se Kosova ishte në krizë gjithëpërfshirëse. Një nga ndodhitë positive fillestare ishte se masë matëse e vlerës fillimisht ishte Marka Gjermane si valutë. Pataj nga viti 2002 ishte Euro e cila lehtësonte këmbimin dhe ishte mundësi shitesë për rrugë drejtë Evropës.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë u prit se do të sjellë rritje stabile të ekonomisë, në rradhë të pare në shtimin e numrit të të punësuarve, rritjen e prodhimit, dalja në tregjet ndërkombëtare etj.

Kosovës nuk i mjaftuan 15 vite që fondet e privatizimit ti investoj në zhvillim të ekonomisë së vet. Procesi i privatizimit në Kosovë pjesërisht arriti të përmbush detyrat të cilat i kishte parashtruar vetës që në fillim.

BPV (bruto prodhimi vendor) me çmime aktuale në vitin 2015 ishte 5,807.0 milion euro. Rritja reale në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014, ishte 4.1% BPV për koke banori për vitin 2015 ishte 3277 euro¹⁰¹

Tabela 31- Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2008-2015: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2008-2015

	(në milion Euro)							
	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
BPV me çmime aktuale	3.882,8	4.069,6	4.402,0	4.814,5	5.058,7	5.326,6	5.567,5	5.807,0
Shpenzimet e konsumit final	4.172,2	4.221,6	4.516,5	4.975,5	5.320,4	5.539,3	5.855,3	5.960,7
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shërbuese	3.488,9	3.528,5	3.768,2	4.142,3	4.458,1	4.652,4	4.926,2	5.045,1
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	659,8	668,1	722,3	802,1	842,1	863,9	910,4	893,9
Qeveria e Kosovës	358,0	407,2	495,7	578,4	625,0	658,8	723,5	772,2
Donatorët (pagat)	301,8	260,8	226,6	223,7	217,1	205,2	186,8	121,7
Të punësuar të huaj	196,9	178,7	157,4	155,5	150,9	142,6	129,8	84,6
Të punësuar vendor	104,9	82,1	69,2	68,2	66,2	62,6	57,0	37,1
Shpenzimet e konsumit final të UPSHESH	23,6	25,0	26,0	31,1	20,2	23,0	18,8	21,7
Formimi i bruto kapitalit	1.208,7	1.267,4	1.450,6	1.632,4	1.465,1	1.470,9	1.434,9	1.601,3
Formimi i bruto kapitalit fiks	1.052,7	1.129,8	1.301,2	1.475,9	1.316,8	1.322,6	1.293,8	1.498,9
Ndryshimet në inventar	156,0	137,6	149,4	156,5	148,3	148,3	141,0	102,4
Eksporti neto	-1.498,2	-1.419,4	-1.565,2	-1.793,3	-1.726,8	-1.683,6	-1.722,7	-1.754,9
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	608,9	694,9	878,0	943,4	922,1	927,1	1.091,5	1.118,9
Eksporti i mallrave	216,6	177,2	305,0	324,9	287,0	305,1	324,3	322,5
Eksporti i shërbimeve	392,4	517,6	573,0	618,5	635,1	622,0	767,2	796,4
Importi i mallrave dhe shërbimeve	2.107,1	2.114,2	2.443,1	2.736,7	2.648,8	2.610,7	2.814,1	2.873,8
Importi i mallrave (FOB)	1.866,3	1.828,9	2.057,1	2.383,9	2.360,0	2.297,1	2.382,9	2.431,8
Importi i shërbimeve	240,8	285,3	386,1	352,8	288,8	313,7	431,3	442,0
BPV për koke banori (Euro)	2.258	2.329	2.480	2.672	2.799	2.935	3.084	3.277

Burimi : Agjencia e Statistikave të Kosovës

¹⁰¹ Zyra e Kryeministrit –Agjencia e Statistikave të Kosovës - <http://ask.rks-gov.net/media/2404/bpv-2008-2015.pdf>

Tabela 32- Pasqyra e gjendjes së fondeve në mirëbesim¹⁰²

	Shënimi shpjegues nr.	31 Dhjetor 2014	Hyrje/Dalje gjatë vitit 2015	31 Dhjetor 2015
		1	2	3=1+2
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE				
Të hyrat nga shitjet	3	665,248,630	(311,758)	664,936,872
Të hyrat nga qiraja	4	10,080,071	4,796,952	14,877,023
Qiraja nga komercializimi	5	5,021,319	-	5,021,319
Interesi i fituar	6	34,839,700	5,000	34,844,700
Tarifa për pjesëmarrjen në tenderat e shitjes	7	7,705,480	(193,016)	7,512,464
Të hyra të tjera	8	4,796,689	326,001	5,122,690
Kapitali themeluar i Agjencisë	9	1,013,200	-	1,013,200
GUITHSEJ PRANIMET		728,705,088	4,623,179	733,328,267
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA				
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	10	96,216,840	8,028,314	104,245,154
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	11	9,006,327	1,704,575	10,710,902
Mallra dhe shërbime	12	7,631,304	2,165,570	9,796,874
Shërbime publike	13	449,281	378,409	827,690
Tatimet	14	1,611,132	746,892	2,358,024
Vendimet e gjykatave/përmbaruesve (depozita dhe taksa)	15	978,292	761,709	1,740,001
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	16	20,348,000	5,500,000	25,848,000
Të tjera	17	683,722	8,626	692,348
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	18	45,140	-	45,140
Fondet tepriçë transferuar Qeverisë	19	28,934,282	61,310,628	90,244,911
GUITHSEJ SHPENZIMET/SHPËRNDARJA		165,904,319	80,604,723	246,509,042

Burimi: AKP

¹⁰² http://pak-ks.org/repository/docs/160215_Pasqyrat_Financiare_Fondet_ne_Mirebesim_2015.

Fondet e akumuluar nga shitja e aseteve të NSH-ve kapin shumë mbi 600 milion Euro apo të rreth 10.5% të GDP (BPV)

Megjithatë këto fonde edhe më tutje mbahen të ngrira në Fondin e mirëbesimit të AKP të tërhequra nga aktiviteti dhe funksioni ekonomik. Përkund kërkesave të shumta që të zbardhet shuma e saktë e këtyre fondeve dhe vend ndodhja, misteri vazhdon. Po ashtu ka qenë e pranishme një vonesë kronike e pagesës së fondeve që u përkasin punëtorëve (20% nga vlera e aseteve të shitura). Vlerësohet se kanë mbetur për tu shpallur për privatizim jo shumë ndërmarrje mirëpo tani është në process e sipër procesi i likuidimit. Për arsye të ndryshme nuk ka mundur me saktësi të përcaktohet aktiviteti i pasprivatizimit të ndërmarrjeve të privatizuara. Një nga arsyet është frika nga publikimi i rezultateve afariste sepse te një numër i tyre ende dominon ekonomia e hirtë.

Procesi i privatizimit në Kosovë ka targetuar rreth 500 ndërmarrje shoqërore, nga të cilat pas luftës operonin vetëm 30 %, me 60,000 punëtorë. Nga ky numër i punëtorëve, vetëm 16,000 gjeneronin të ardhura. Në këto ndërmarrje gjatë viteve të 80-ta ishin të koncentruar asete të rëndësishme teknologjike dhe humane. Duke pasur parasysh qeverisjen e dhunshme nga Qeveria e Serbisë, vjetërsinë e aseteve teknologjike dhe ndryshimet në mjedisin biznesor të tregut rajonal dhe ndërkombëtar, shumica e këtyre ndërmarrjeve kanë operuar në mënyrë joefektive dhe nën kapacitetet e tyre.¹⁰³ Ndërmarrjet Shoqërore (NSH-të) dikur kishin një rol të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës.¹⁰⁴

Shumë nga NSH-të kanë arritur pjesërisht të rimëkëmben në vitet e para të pasluftës dhe trendet e përgjithshme të këtyre ndërmarrjeve janë pozitive, ngase aktiviteti i tyre ekonomik në vitin 2000 është dyfishuar krahasuar me vitin 1999. Megjithatë, ky trend nuk është vërejtur edhe pas privatizimit.

¹⁰³Riinvest ; Privatizimi dhe post- privatizimi në Kosovë : një gotë gjysmë bosh apo gjysmë e plotë?(Raport studimor) Shtator 2008, Fq. 11

¹⁰⁴Riinvest, (2001). NSH-të dhe privatizimi/transformimi i tyre. Në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Ndërmarrje Private, përkrahur nga USAID. Prishtinë: RIINVEST; Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) (2004). Draft-Strategjia për departamentin e Privatizimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Shumë nga këto Ndërmarrje Shoqërore pas privatizimit mbeten boshe apo ndërruan veprimtarinë e tyre në tërësi. Në përgjithësi, nga rreth 500 NSh të privatizuara, vetëm disa nga to mund të konsiderohen të suksesshme – apo së paku funksionale. Një sfidë drejt arritjes së funksionalitetit dhe revitalizimit ka qenë amortizimi i lartë i NSh-ve dhe teknologjia e vjetruar. Me kalimin e kohës, shumë NSh kanë humbur hisen e tyre në tregun global. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar negativisht në shpresën për mbijetesë në tregjet vendore dhe regjionale, megjithatë kjo nuk e justifikon faktin që shumica e ndërmarrjeve kanë dështuar, bankrotuar apo/dhe janë kryesisht të pasuksesshme.

Vetëm tetë nga 26 NSh-të e shitura përmes spin off-it special kanë rezultuar të suksesshme, që do të thotë se kanë arritur të përmbushin kushtet e vëna⁵⁵. Tetë kompanitë e promovuara si shembuj të suksesit nga AKP-ja janë ‘Ferronikeli’, ‘Klllokoti’, ‘Vreshtaria dhe Veraria Stone Castle’, ‘Hotel Theranda’, ‘Trofta’, ‘M&Silloi’, ‘Birraria Peja’ dhe ‘Hotel Nora’

Ferronikeli ka mbi 1,000 persona të punësuar të rregullt apo të kontraktuar dhe është ndërmarrja më e madhe private që është e përqendruar në industrinë e rëndë. Kjo kompani realizon mbi 50 për qind të të gjithë eksportit të Kosovës. Deri më tani, mbi 60 milionë euro janë investuar në të. Mineralet e Ferronikelit eksportohen në të gjithë botën duke përfshirë edhe Gjermaninë, Kinën, Italinë, Indinë dhe Korenë.

Fabrika e Ujit ‘Klllokoti,’ që aktualisht punëson 200 persona, prodhon 7,000 litra ujë në orë apo rreth 40 milionë çdo vit. Kjo kompani, për një kohë të shkurtër, ka arritur të jetë kompania më e suksesshme e ujit në Kosovë duke investuar mbi 4 milionë euro. Uji i Klllokotit eksportohet në Shqipëri, Maqedoni dhe Zvicër dhe pritet që të jetë edhe në vende të tjera në regjion dhe Evropë. E treta, Vreshtaria dhe

Veraria “StoneCastle” që gjendet në Rahovec punëson 260 punëtorë të rregullt dhe punëtorë shtesë që angazhohen gjatë sezonit të vjeljes së rrushit. Është një nga veraritë më të mëdha në Kosovë dhe regjion ngase prodhon deri në 12 milionë litra verë dhe eksporton produktet e saj në vende të ndryshme të Evropës.

Hotel Theranda në Prizren, ka qenë shumë e dëmtuar para privatizimit të saj dhe në mënyrë që të jetë e përdorshme dhe funksionale janë nevojitur investime të konsiderueshme. Rreth 850 mijë euro janë investuar që nga viti 2006 e që kanë ndikuar që të jetë pjesërisht funksionale. Sot, ky hotel punëson 18 persona dhe pritet që ta rrisë numrin e të punësuarve me përfundimin e procesit të renovimit.

Trofta në Istog është kompani e kultivimit të peshkut e që ka pasur investime të ndryshme esenciale që nga privatizimi i saj. Investimet kanë përmirësuar kushtet e punës dhe kanë çuar në një rritje të konsiderueshme në kultivimin e peshkut, duke e bërë kështu një kompani të suksesshme. Trofta synon të krijojë kapacitete të reja në kultivimin e peshkut dhe të arrijë në tregjet rajonale dhe ato evropiane.

M&Silloi në Xërxë, pas privatizimit pati investime të ndryshme që përmirësuan teknologjinë e saj dhe çuan në rritjen e kapacitetit prodhues të miellit. Aktualisht, ka një kapacitet të bluarjes prej 200 tonësh në ditë dhe kapacitet të silosave të grurit prej 55 mijë tonësh e që e bëjnë një kompani shumë të suksesshme në Kosovë. E shtata, Birraria Peja është privatizuar në vitin 2006 dhe në një periudhë prej gati 3 vitesh aty janë investuar gati 20 milionë euro. Kapaciteti fillestar i saj ka qenë 300 mijë hektolitra të birrës në vit. Tani me një kapacitet prej 612 punëtorësh ka arritur të prodhojë 900 mijë hektolitra në vit. Për fund por jo më pak e rëndësishme, Hotel Nora nuk ka qenë fare funksionale që nga viti 1996 e deri në privatizimin e saj. Aktualisht kjo kompani ka 90 persona të punësuar. Pjesë e Kompanisë Gllareva është Hoteli dhe Marketi Nora si dhe fabrika për prodhimin e armëve e cila pas privatizimit është transformuar në industri të ushqimit me 50 të punësuar.

Megjithë storiet e disa sukseseve të privatizimit të bërë përmes spin-offit special nuk mundet të lë vend për vetëkënaqësi. Kritika më e madhe për këtë metodë është mungesa e mekanizmave që do të siguronin që obligimet e blerësve të Ndërmarrjeve të Reja të përmbushen . Sidoqoftë, jo të gjitha ndërmarrjet e privatizuara përmes spin off-it special i kanë përmbushur obligimet e vendosura në kontratë. Për më shumë, një numër ndërmarrjesh janë privatizuar me kushte të veçanta si SharrCem, Llamkos, Amortizatorët, Famipa, Ferma e prodhimit të djathrave “Dubrava”, Kompleksi Industrial “Emin Duraku”, Emin Duraku Edico dhe Fabrika e Baterive Industriale “Trepça”.

Disa nga ndërmarrjet e privatizuara përmes spin off-it secial dhe kushteve të veçanta janë në proces të monitorimit ndërsa disa të tjera kanë rezultuar me tërheqje të aksioneve. Më konkretisht, dy ndërmarrje të privatizuara e të cilat janë nën monitorim për përmbushje të kontratës së shitjes nga AKP janë IDGJ Tobacco LLC dhe NBI Suhareka/Agrokosova Holding. Ndërmarrjet e privatizuara me kushte të veçanta e të cilat janë ende në proces të monitorimit janë Sharr Cem, Ferma e produkteve të qumështit Dubrava, Emin Duraku Edico, Kombinati industrial Emin Duraku, Hotel Onix Banja e Pejës, FBI Trepca në Pejë, Amortizatorët, Famipa në Prizren dhe Hotel Unioni në Prishtina. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve të privatizuara me spin off special janë liruar nga procesi i monitorimit nga AKP-ja.

Për katër nga ndërmarrjet e privatizuara me spin of special, për shkak të mospërmbushjes së obligimeve kontraktuale. u dasht të tërhiqen aksionet:: MIM Golesh, Hoteli Grand, Miniera Strezovc dhe Llamkosi.

Vlenë shqyrtuar ativitetin e disa ndërmarrjeve Shoqërore të privatizuara dhe efektet e tyre:

NBI Suhareka,- që dikur prodhonte tonelata me verë e produkte të tjera të rrushit dhe zotëronte 700 hektarë me rrush, u privatizua në vitin 2006. Punëtorët e saj e përkrahën privatizimin në mënyrë që ta zgjeronin ndërmarrjen dhe të rrisnin prodhimin. Ata kishin vullnet që ta blenin ndërmarrjen në mënyrë që përkushtimi dhe përpjekjet e tyre të fokusoheshin në ndërmarrje dhe në rritje të prodhimit. Megjithatë, ata nuk gjetën përkrahje sepse as metodat e privatizimit nuk e mundësonin atë e as nuk ekzistonte përkrahja politike, AKM kishte përdorur metodën e spin off-it special që obligonte pronarët të zotoheshin për investime të caktuara, punësimin e një numri punëtorësh dhe në të njëjtën kohë ndalonte ndërrimin e lokacionit apo të veprimtarisë. Problemet e vërteta filluan në momentin e përfundimit të procesit të privatizimit. Aksionarët e ish-NBI Suhareka, e çuan në shkatërrimin gradual këtë ndërmarrje. Shtatë muaj pas privatizimit, të gjithë punëtorët u larguan me forcë prej ndërmarrjes nga pronarët e rinj. AKP pranoi këtë gjendje në heshtje. Kjo jep indikacione që ka pasur ndërhyrje politike dhe marrëveshje të dyshimta në privatizimin e kësaj ndërmarrjeje. Punëtorët ishin takuar me zyrtarët e AKM-së e pastaj të AKP-së dhe kishin dërguar shumë ankesa, e megjithatë asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë për këtë çështje. Ata kishin dërguar dëshmi të manipulimeve me punëtorët dhe shkatërrimit të hardhive të rrushit. Sidoqoftë, ata morën vetëm kritika për ndërhyrje në punën e pronarëve. Ata kërkuan nga AKP-ja që t'ua tërheqë aksionet pronarëve aktualë ngase ata nuk kishin arritur të përmbushin obligimet për të investuar 8.6 milionë euro dhe për të punësuar 345 persona.

Grand Hotel Prishtina- , që ishte një nga hotelet më të njohur në Kosovë, ishte privatizuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit në vitin 2006 përmes metodës së spin off-it special. AKM-ja e kishte privatizuar këtë hotel për 8 milionë euro kompania 'Union Commerce', dhe ishte zotuar të investonte 20 milionë euro për një periudhë prej dy vitesh dhe të punësonte 400 persona. Deri në vitin 2010, pronari kishte investuar 1.2 milionë euro dhe AKP ishte duke e paralajmëruar që të përmbushte kontratën.

Problemet e hotelit kishin filluar kur partnered në mes vete nuk arrinin të merreshin vesh. Kështu filloi procesi perms Gjykatave. Përveç mosmarrëveshjeve në mes të aksionerëve, kishte akuza edhe për ryshfet nga ana e zyrtarëve shtetërorë

Me 3 maj 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte vendosur që të tërheqë aksionet e “Hotel Grand-it” që sipas kontratës së nënshkruar nuk ishin përmbushur obligimet. . Sipas kontratës obligimet ishin që pronari I ri të investonte 20.2 milionë euro dhe të punësonte 270 punëtorë në gjashtë muajt e parë dhe 540 të tjerë deri në fund të 12-mujorit. Të gjitha këto zotime do të duhej të përmbusheshin deri më 13 tetor 2009.. Më 17 korrik 2014, Gjykata kishte vendosur në favor të AKP-së dhe kishte tërhequr aksionet e pronarit aktual të hotel Grandit.Pasojat I bartën po ashtu punëtorët, 92 punëtor mbetën të pa punë,

Fabrika e Gypave IMK në Ferizaj- ishte privatizuar në vitin 2007 përmes një metode të spin off-it që la mbi 900 persona pa punë. Gjatë procesit të privatizimit ishin vetëm dy ofertues, , të cilët në raundin e parë ofertuan me 3,650,000 euro dhe respektivisht 200,000 euro . Në raundin e dytë, ofertuesi i pare ofroi edhe 7 mijë euro më shumë se në raundin e parë, përkatësisht 3,657,000 euro pasi AKP kontestoi çmimin e pare. Pronari i ri u zotua të investoi 13,200,000 euro në të. Në vazhdimësi u dyshua në transparencën e kësaj shitje.

Në qershor të vitit 2011, Fabrika e Gypave ka shitur aksionet e saj te “Mabetex” për vetëm 3,069,000 euro; shumë më pak se vlera blerëse. Kjo edhe i përket procesit të privatizimit, drejtori i sindikatës së punëtorëve të fabrikës ka deklarua më tej e përforcon dyshimin në rregullsi të procesit. Punëtorët paditën fabrikën në Gjykatën Komunale në Ferizaj në mënyrë që të kërkojnë të drejtat e tyre si dhe kompensimin për të punës gjatë viteve të 90-ta. Në vitin 2010, Gjykata Kushtetuese kishte obliguar Qeverinë e Kosovës dhe AKP-në që t’i kompensojnë ish- punëtorët e Fabrikës me një shumë prej 26 milionë euro. Pyetje e cila parashtrohet në këtë rast është se ku të merren

paratë kur fabrika ishte shitur për 3 milion euro. Deri tani -punëtorët e Fabrikës së Gypave nuk janë kompensuar dhe as AKP-ja e as Qeveria nuk kanë bërë asgjë në këtë drejtim.

Sharr Cem- Privatizimi i prodhuesit të çimentos Sharr Cem, i vlerësuar si një rastet më të suksesshme të privatizimit, ishte hetuar nga Prokuroria pasi që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kishte zbuluar që kjo fabrikë ishte shitur nën çmimin e tregut. Sharr Cem i ishte shitur kompanisë greke Titan në vitin 2010 për 30 milionë euro përmes procedurave të fshehta dhe të dyshimta të prokurimit dhe nën çmimin e tregut. Që nga viti 2000, Sharr Cem ishte komercializuar nga një kompani zvicerane me një kontratë 10 vjeçare, por gjashtë muaj para përfundimit të kontratës, kompania Titan e kishte blerë fabrikën për vetëm 30.1 milionë euro, megjithëse sipas zyrtarëve të komunës së Hanit të Elezit, profiti vjetor i fabrikës ishte rreth 20 milionë euro. Privatizimi i Sharr Cem ishte lavdëruar AKP d, Kryeshe faktori politik Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Fondit të Privatizimit për periudhën dhjetor 2010 deri më qershor 2011 theksonte që AKP e kishte favorizuar që nga fillimi kompaninë fituese të kontratës për shërbimet këshilluese të transakcionit për privatizimin e Sharr Cem-it. Sipas këtij raporti, procedura e kësaj kontrate fillimisht ishte nisur përmes njësisë së prokurimit por më vonë kjo ishte anuluar për të vazhduar me ritenderim përmes metodës së procedurave të brendshme të prokurimit. AKP kishte dërguar ftesën për ofertim vetëm te 5 kompani dhe e kishte përzgjedhur Raiffeisen Investment si konsulent për një shumë prej 580 mijë euro. Sipas raportit të auditorit, Raiffeisen Investment, e cila ishte përzgjedhur përmes procedurave jotransparente, ishte ajo e cila e kishte përcaktuar çmimin e shitjes për Sharr Cem e i cili ishte shumë nën çmimin e tregut. Konsiderohet se vlera e vërtetë e Sharr Cem-it është në mes të 80 deri 100 milionë euro. Mirëpo në vazhdimësi AKP-së thekson se kishte ndjekur një proces të hapur dhe transparent të privatizimit duke njoftuar të gjitha institucionet vendore dhe ndërkom-

bëtare që veprojnë në Kosovë rreth fillimit të procesit të privatizimit dhe metodave që do të përdorshin. Kjo bën me dije se megjithatë do të ketë punë për Gjykata.

Aktualisht, Sharr Cem punëson 490 punëtorë krahasuar me 790 sa ishin para privatizimit të tij. Kjo paraqet një dëshmi shtesë të privatizimit i cili nuk mund të quhet i suksesshëm. .

Kompania Kosova Petrol- për 12 vjet ka qenë duke përdorur pikat e karburanteve që ishin ndërtuar dhe përdorur nga kompania kroate INA (një ndërmarrje shoqërore e ish-Jugosllavisë). 45 për qind të aksioneve të saj mbahen nga shteti kroat.. Në vitin 2000, UNMIK-u i kishte dhënë kësaj kompanie një leje të përkohshme për t'i përdorur këto pika për të përmbushur nevojat e vendit për karburante gjatë dimrit të vitit 2000, apo dimrit të parë të pasluftës në vend. Megjithatë, kjo kompani ende vazhdon të përdor këto pika të karburanteve përkundër faktit që INA ka kërkuar të rifillojë aktivitetin e saj në Kosovë. Autoritetet kroate e konsiderojnë këtë një “uzurpim të pronës” që është pranuar edhe nga AKP-ja.

Drejtori i INA-s kishte ushtruar padi në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme në vitin 2005 për të kërkuar kthimin e pronës. Sipas Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, ky është një nga rastet më të vjetra që ende ka mbet i pazgjidhur. Kosova Petroll i kishte paguar obligimet financiare për shtetin e Kosovës vetëm në periudhën prej Janarit të vitit 2000 e deri në dhjetor 2001, mirëpo nuk kishte vazhduar të paguante tutje edhe përkundër faktit që ai ende vazhdon t'i përdorë këto pika.

Kosova Petrol aktualisht nuk ka licencë të shitjes. Argumenti që ishte përdorur për refuzimin e licencës së fundit ishte që, Kosova Petrol nuk kishte marrëveshje të qerasë me pronarin e pronës së paluajtshme e që ishte konfirmuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Në qershor të vitit 2014, AKP kishte vendosur të lëshonte me qera 10 nga pikat e shitjes (pikat e karburanteve) të përdorua nga Kosova Petrol-i përmes një ankandi publik.

Zëdhënësi i AKP-së kishte thënë që personat fizikë apo juridikë të cilët kanë uzurpuar prona dhe kundër të cilëve ishin nisur procedurat për lirim të pronës nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e ofertimit siç është rasti i Kosova Petrol-it. Në anën tjetër, AKP-ja është e obliguar të adiministrojë pronat shoqërore deri në vendimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për të zgjidhur rastin e INA-s që ishte dërguar aty që në vitin 2005.

Dështim shtesë i procesit të privatizimit paraqet pozita e rënduar sociale e ish të punësuarve në Ndërmarrjet Shoqërore. Një nga qëllimet e privatizimit duhet të jetë ruajtja e mirëqenjes sociale të vendit. Kjo do të duhej të ishte përmirësimi i gjendjes sociale, mirëpo nëse ajo fillimisht nuk mund të ruhet, së paku të mos keqësohet. Në rastin e Kosovës një kriter i tillë nuk u përmbush. Punëtorët e ish Ndërmarrjeve Shoqërore mbeten të pa punë. Kështu, procesi i privatizimit përkeqësoi gjendjen sociale të tyre, në vend që të përmironte atë. Në bazë të ligjeve paraprake punëtorët ishin pronarë të ndërmarrjeve. Tani me rastin e privatizimit ata u detyruan të jenë të kënaqur vetëm me 20% të vlerës shitëse të ndërmarrjes. Këtu mund të thuhet se u bë eksperiment me njerëzit se si do të veprojnë ata kur të zhvishen nga prona. Si do të jetë reagimi i tyre dhe në cilën mënyrë ata do të shfaqin revoltën e tyre. Nuk kanë qenë të pakta reagimet e përfaqësuesve të punëtorëve të organizuar në sindikata. . Përfaqësuesit e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) thonë që kanë kërkuar përqindje më të madhe të të ardhurave. Por, këmbëngulja e tyre nuk dërgoi drejt rezultateve të suksesshme. Nëse kësaj i shtohet edhe fakti i vonësës së pagesës së 20% që ju takon punëtorve, mund të merret me mend se për një kohë të shkurtër u krijua një armatë varënjakësh. Kjo inkurajoi protesta nga disa sindikata të organizuara që rezultoi në vendimin e AKP-së për të ndryshuar politikën e shpërndarjes së pjesës prej 20 përqind. Por, deri më tani, një shumë e konsiderueshme e fondeve vazhdojnë të jenë të

bllokuara. Sipas raportit vjetor të AKP-së për 2012, këto janë disa nga arsyet kryesore për vonesën:

A) Mungesa e gatishmërisë së menaxhmentit të disa ndërmarrjeve shoqërore për të përgatitur dhe finalizuar listën fillestare;

B) Një bord i pakompletuar drejtorësh i AKP-së, që ka ndikuar në publikimin e listës finale për rreth 20 ndërmarrje, edhe pse procedura e ankesave nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KSHLAP) ka përfunduar;

C) Mungesa e vendimeve finale nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për apele, kundërshtimet e dorëzuara nga punëtorët në këtë gjykatë si dhe vonesat në dorëzimin e informacioneve (të dhënave) për numrin e ankesave dhe kundërshtimeve.¹⁰⁵

Mungesa e anëtarëve ndërkombëtarë në Bordin e AKP-së krijoi një bllokim jo vetëm në shpërndarjen e 20 përqind të provizioneve për punëtorët por edhe në shpërndarjen e pagesave të kreditorët potencialë gjatë likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Për shpërndarjen e këtyre fondeve, AKP duhet ta ketë miratimin e tre anëtarëve ndërkombëtarë të bordit që sipas ligjit është edhe përfundimi final i likuidimit të një ndërmarrjeje.

Gjithashtu, për shkak të procesit të privatizimit, numri i atyre që kanë humbur punën nuk është i barabartë me numrin e atyre që kanë gjetur punë në sektorin privat. Një numër i madh i punëtorëve janë të papunë pasi ndërmarrjet shoqërore u privatizuan, meqenëse shumica prej tyre i ndryshuan aktivitetet e tyre në një fushë tjetër apo kanë falimentuar. Një nga arsyet mund të jetë reduktimi i numrit të punëtorëve për shkak të avancimeve në teknologji ose shkathtësi jo relevante për atë aktivitet. Ish-punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore ballafaqohen me papunësi kronike për shkak të mundësive të vogla punësimi.¹⁰⁶

¹⁰⁵ Agjencia Kosovare e Privatizimit (2013). Raporti Vjetor 2012: Mars 2013. AKP: Prishtinë.

¹⁰⁶ Arbëreshë Loxha and Delfinë Elshani Shitje në panik: vlerësim i sfidave dhe problemeve kryesore të procesit të privatizimit në Kosovë, Projekti financohet nga Bashkimi Europian dhe menaxhohet nga zyra e Bashkimit Europian në Kosovë., 2016, f.52

Sipas Bashkimit të Sindikatave të Pavarura, rreth 40,000 punëtorë kanë humbur punën si rezultat i privatizimit. Shqetësues është fakti që shumica e tyre janë mbi 50 vjeç, një moshë relativisht e shtyrë për të gjetur punë apo për të ri-hyrë në tregun e punës. Prandaj, mund të vihet në përfundim që procesi i privatizimit ka rezultuar në më shumë punë të humbura sesa të krijuara. Gjithashtu, nga shkalla e lartë e papunësisë dhe mundësi pune të rralla, sidomos në zona rurale, perspektiva e punësimit për ish-punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore duket e pashpresë. Prandaj shumica e ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore sot jetojnë në gjendje të vështirë ekonomike.¹⁰⁷

Zvogëlimin e numrit të punëtorve është si rezultat i ndryshimeve strukturore të ndërmarrjeve të privatizuara. Ngjashëm me regjonet tjera, edhe privatizimi i Ndërmarrjeve Shqërore në regjiionin e Gjilanit pati të njejtin fat.

¹⁰⁷ Po aty

Tabela 33- Gjendja e punësimit në regjionin e Gjilanit para dhe pas procesit të privatizimit

	Nderrmarrja	Nderr. E re	Regjioni	dt. E kontrates	Vala	Zyra Rajoni	Veprimtaria	A eshte mbajtur veprimtaria e njejt me NSH	Numri I punetoreve te NSH-se para vitit 89-te	Numri I punetoreve para privatizimit	Numri I punetoreve aktual	Komente	Storie suksesi - aktuale
1	Lepenci/Kacaniq	Lepenci	Kaqanik	8-Mar-04	vala 1	Gjilan RO	Prodhimtari	Po			78	Prodhimi i gëlqerës	
2	Silkapor / Kacaniq	Silcapor tulla	Kaqanik	16-Mar-05	vala 2	Gjilan RO	Prodhimtari	Po			60	Prodhimi i bllokash ndërtimor	
3	Tefik Çanga	Tefik Çanga Depo	Ferizaj	11-May-05	vala 4	Gjilan RO	Qendër tregtare	Jo	1378	669	120	Qendër tregtare "ETC" "VIVA" "JYSK"	
4	Celiku	Celiku Metal Construction	Gjilan	24-Nov-05	vala 5	Gjilan RO	Qendër tregtare	Jo	358	566	50	Qendër tregtare "Drini market"	
5	IT Integj	Integj (tekstil)	Gjilan	2-Mar-06	vala 7	Gjilan RO	Qendër tregtare	Po	2366	824	250	Qendër tregtare "Viva fresh"	
6	Tefik Çanga	Tefik Çanga Mobileria	Ferizaj	22-May-06	vala 9	Gjilan RO	Prodhimtari	Po			260	Prodhimi nga druri	
7	IMK Pipe Factory	IMK Shtime Warehouse	Ferizaj	4-Jul-06	vala 9	Gjilan RO	Prodhimtari	Jo	1202	804	70	Prodhimi te fasades dhe llaqeve	
8	NSHH Drita Ferizaj	Hotel Luboteni	Ferizaj	10-Apr-06	vala 9	Gjilan RO	Hoteleri	Po	100	37	112	Hoteleri + tregëti	
9	Fabrika e Veglave dhe e aparateve elektrike	Vegla dhe aparate	Ferizaj	19-Jun-06	vala 10	Gjilan RO	Prodhimtari	Po	462	257	52	Prodhimi i veglave	
10	SHAH Kosova	Hotel Kristal	Gjilan	3-Jul-06	vala 11	Gjilan RO	Hoteleri	Po	95	56	50		
11	KosovaTrans-Gjilan	Kosovatrans Gjilan vendparkim i autobusëve dhe zyra	Gjilan	20-Jul-06	vala 12	Gjilan RO	Qendër tregtare	Jo	409	125	150	Qendër tregtare "Agmia"	
12	17 Nëntori	17 Nëntori shitore	Ferizaj	16-May-07	vala 18	Gjilan RO	Qendër tregtare	Po			69	Qendër tregtare "Benaf"	
13	Banja e Klllokotit	Banja e Klllokotit Health Spa	Viti	13-Apr-10	vala 41	Gjilan RO	Shërbime rehabilituese	Po			113		Po
14	Sharr Salloniti	Sharr Salloniti	Kaqanik	29-Apr-10	vala 40	Gjilan RO	Terminal doganor	Po			76		
15	Sharr	SharrCem	Kaqanik	9-Dec-10		Gjilan RO	Prodhimtari	Po	2033	1648	503	Prodhimi i çimentos	
16	IBG Gjilan	IBG Industria Baterive Gjilan	Gjilan	18-May-12	vala 52	Gjilan RO	Qiradhëni	Jo			50	Qiradhëni e (repartet e prodhimit janë në shfrytëzim nga subjekte të ndryshme)	
17	IMK Pipe Factory	IMK Fabrika e Gypave	Ferizaj	20-Nov-07	vala 19	Gjilan RO	Prodhimtari	Po			140	Prodhimi i tubave te çelikut	
18	Minex	Minex LLC Ferizaj	Ferizaj	12-Jul-10	vala 25	Gjilan RO	Prodhimtari	po	263	113	195	Prodhimi ushqimore	
19	Jugoterm	Jugoterm	Gjilan	18-Apr-12	vala 15	Gjilan RO	Prodhimtari	Po	269	130	142	Prodhimi të radiatorëve	
20	DPP "Trajko Peric" – Ciglana; DD "Donja Morava" – Ciglana	Tullara	Kamenicë	4-Jun-08	vala 22	Gjilan RO	Prodhimtari	Po	142	27	52	Prodhimi i bllokave ndërtimor	
21	Banja e Klllokotit	Fabrika e ujit	Viti	24-Nov-05	vala 5	Gjilan RO	Prodhimtari	Po			96	Prodhimi i ujit mineral	Po

Burimi; AKP

Tabela 34 - Ndryshimi i numrit të punetoreve para dhe pas procesit të privatizimit në disa ndërmarrje ZR Gjilan

	Ndërmarrja e re	Numri i punetoreve të NSH-se para vitit 89-te	Numri i punetoreve para privatizimit	Numri i punëtorëve
1	Tefik Canga	1378	669	120
2	Celiku Metal Konstruksioni	358	566	50
3	Integj Tepihat	2366	824	250
4	Hotel Luboteni	100	37	112
5	Vegla dhe Aparate	462	257	52
6	Hotel Kristal	95	56	50
7	SharrCem	2033	1648	503
8	Minex LLC Ferizaj	263	113	195
9	Jugoterm	269	130	142
10	Tullara	142	27	52

Burimi ; AKP

Privatizimi perceptohet kryesisht si i pasuksesshëm në tërheqjen e investitorëve seriozë që do të revitalizonin, përmirësonin dhe ruanin vlerën e ndërmarrjes. Nuk janë të pakët ata që mendojnë se procesi i privatizimit në Kosovë kishte mungesë të investitorëve të huaj për shkak se ata u dekurajuan nga sundimi i dobët i ligjit dhe korrupsioni.

Shumica e ndërmarrjeve shoqërore u shitën pa ndonjë kusht ose obligim për të mbajtur përcaktimin e degës, punësimin ose investimet e ardhshme. Si pasojë, mungesa e kushteve i lejoi pronarët të përdorin ndërmarrjet ashtu siç e shihnin ata më së miri. Si rezultat, shumë investitorë i përdorën ndërmarrjet si ndërtesa (depo, për tokat e tyre, ndërtim apartamentesh ose aktivitete tjera biznesore si hotele, restorante, etj.) në vend që t'i revitalizonin ato dhe t'i bënin funksionale. Kjo mund t'i atribuohet metodës 'spin off', ku vetëm pronat iu shitën investitorit, që nuk kishte nevojë të përmbushte obligimet e ndërmarrjes për palët tjera.

Kështu, me procesin e privaatizimit Kosova ka humbur më shumë punë sesa që ka krijuar përmes procesit të privatizimit.

Procesi i privatizimit gjithashtu ka përfshirë shitjen e tokës bujqësore, që si duket i është shitur sipërmarrësve, politikanëve dhe kompanive ndërtimore por jo fermerëve. Me fjalë të tjera, të gjithë përpos fermerëve përfituan nga ky proces. Fermerët dhe fshatarët fillimisht ishin pronarë të tokave, por pronësia e tokës i kaloi shtetit. Nga fundi i vitit 2012, 111 ndërmarrje bujqësore dhe rreth 25,400 hektarë tokë ishin privatizuar. Vetëm disa nga ndërmarrjet ishin ende aktive. Çmimi mesatar për tokat e këtyre ndërmarrjeve të privatizuara ishte tmerrësisht i ulët, prej 20.14 eurosh për ari. Edhe pse çmimi mesatar për ari është rritur pak në dy vitet e fundit, është ende shumë më e ulët se çmimet reale të tregut¹⁰⁸. Toka është shitur shumë më ulët sesa vlera reale e tregut. Me fjalë të tjera, autoritetet e privatizimit nuk vendosën një çmim të caktuar të bazuar në çmimet e tregut nën të cilën toka nuk mund të shitej. Nga një këndvështrim zhvillimi ekonomik, privatizimi deri tani vetëm ka dobësuar ekonominë dhe është bërë pengesë për mundësitë për zhvillim ekonomik. Tokat e ndërmarrjeve bujqësore të Mirushës në komunën e Malishevës, që ka qenë pronë e fshatarëve që nga 1958, u shit për 11-12 euro për ari. Për shkak të ndërtimit të autostradës në atë zonë, toka që u privatizua për 11 euro për ari u rrit në vlerë dhe kur toka u konfiskua për t'u ndërtuar autostrada, vlera e kompensimit ishte mbi 1,000 euro për ari. Kjo do të thotë që personi që bleu një parcelë toke për 10,000 euro përfitoi 1 milion euro nga qeveria vetëm pas tre vitesh. Këto janë dëshmi të mjaftueshme se kush e privatizoi token në Kosovë. Fermerët do të duhej të ishin por një gjë e tillë nuk ndodhi dhe në të shumtën e rasteve ajo tani është djerrinë. AKP e arsyeton veten se ky ishte çmimi I tregut. Pak kush edhe do ta beson një gjë të tillë,

¹⁰⁸ Arbëreshë Loxha and Delfinë Elshani Shitje në panik: vlerësim i sfidave dhe problemeve kryesore të procesit të privatizimit në Kosovë, Projekti financohet nga Bashkimi European dhe menaxhohet nga zyra e Bashkimit European në Kosovë., 2016 fq. 58

Fondet e privatizimit në “funksion” të zhvillimit ekonomik - Fondet e akumulura nga shitja e Ndërmarrjeve Shoqërore tani arrijnë shumën mbi 650 milion euro. Ato që nga fillimi mbeten në mirëbesim që pak kush mund ta di se ku mbeten. Thuhet se janë të deponuara në Bankën Qëndrore të Kosovës, mirëpo ka mosbesim se një gjë e tillë është reale.. Ky fond asnjëherë (mbi 15 vite) nuk u përdor për stimulimin e ekonomisë. Një pjesë nga ky fond në formë të 20% ju shpërnda punëtorve kurse pjesën tjetër e mbuloi misteri.

Sipas Ligjit mbi AKP-në, 20 % të fondeve të gjeneruara nga privatizimi u shpërndahen punëtorëve të ndërmarrjeve përkatëse, 5 % përdoren për shpenzimet operationale të AKP-së dhe 75 për qind ruhen në fondin e mirëbesimit deri sa të përmbushen pretendimet e kreditorëve. Prandaj, fondet e privatizimit janë të ngrira/bllokuara deri në kohën e përfundimit të pretendimeve të kreditorëve potencialë. Me fjalë të tjera, mënyra se si është rregulluar ky proces në fakt ka vënë të gjitha fondet e privatizimit në favor të kreditorëve – duke i prioritizuar ata në vend të favorizimit të zhvillimit ekonomik. Përkundër vonesave në shfrytëzimin e këtyre fondeve, kritikë tjetër ka qenë edhe përqindja e dedikuar për pretendimet e kreditorëve. Në vend të alokimit të 75 për qind të fondeve, mund të ishte alokuar ndonjë shumë më të vogël, duke krijuar kështu hapësirë që fondet e mbetura të shfrytëzoheshin në favor të zhvillimit ekonomik. Rezultatet e procesit të privatizimit deri më tani, qartazi tregojnë që qëllimi i proklamuar se ky process do të jetë në funksion të rritës dhe mirëqenjes ekonomike dhe sociale nuk u përmbush.

6.4 Rekomandime për të metat e procesit të privatizimit në Kosovë

Ndonëse ka kaluar shumë kohë, në rastin e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, baza juridike e krijuar nga UNMIK-u ende është valide. Organet e ligjshmërisë në Kosovë janë vonuar mjaft në kohë, për miratimin e ligjeve, të cilat kanë të bëjnë me kohën dhe realitetin e ri, tashmë kur Kosova ka shtetin e vet.

1. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13, për themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme, duhet të ndryshohet dhe të shndërrohet në Ligj të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Dhoma e Veçantë formalisht e juridikisht konsiderohet si pjesë e Gjykatës Supreme, edhe pse nuk i raporton asaj asnjëherë. Sapo nxori ligjin e ri duhet kushtëzuar kjo gjykatë, që t'i raportojë për punën e saj Gjykatës Supreme të Kosovës, për bërjen e një praktike të njëjtë juridike në Kosovë.

2. Ndryshimi i Ligjit nr. 03/L-067, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe harmonizimi i tij me Ligjin e ri për Dhomën e Veçantë. Gjithashtu, me ndryshimin e këtij

Ligji duhet të sqarohet për kthimin e pronave të nacionalizuara gjatë periudhës së komunizmit, deri në nxjerrjen e një Ligji për denacionalizimin, (kthimin ose kompensimin) e pronave të ish-pronarëve.

Me ndryshimin e këtij ligji, duhet të sqarohet edhe statusi i Fondit të Privatizimi, t dhe mundësia e investimit të këtyre mjeteve në ekonominë e Kosovës.

3. Ndryshimi i Rregullores nr. 2005/48, për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre, me autorizim administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Me këtë ligj duhet të ngarkohet AKP-ja dhe të shmanget mundësia që AKM-ja të konsiderohet përgjegjëse për veprime, lidhur me riorganizimin ose likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore. Gjithashtu, me këtë ligj duhet të parashihet, riorganizimi i disa ndërmarrjeve shoqërore, të atyre me interes vital për Kosovën (në veçanti e Trepçës)... Ndërmarrjet së pari të transformohen në ndërmarrje publike, kurse

një pjesë e tyre mund të privatizohen me metodën e privatizimit të ndërmarrjeve publike, respektivisht me partneritet publik-privat.

4. Nxjerrja e ligjit për denacionalizim (kthimin ose kompensimin) e pronave të ish-pronarëve. Me këtë ligj duhet të merret një qëndrim, se si do të veprohet me kërkesat pronësore të kësaj natyre, që gjenden në procedurë pranë AKP-së dhe pranë Dhomës së Veçantë. Zgjidhja më e mirë për këto raste është kompensimi, duke e shfrytëzuar Fondin e Privatizimit. Ndërsa, vlera e kompensimit duhet të jetë e arsyeshme, duke i pasur parasysh mundësitë buxhetore të Kosovës.

5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës të ushtrojë kontroll dhe të ndërmarrë masa në pajtim me ligjin, përkitazi me vendimet e gjykatave vendore, të cilat kanë zbatuar ligje të Serbisë, të nxjerra pas vitit 1990, përkitazi me kthimin e pronave, edhe pse bazë e vetme ligjore për privatizim, ka qenë Ligji për AKM-në e më vonë Ligji për AKP-në.

6.5 Modeli i propozuar për vazhdimin e procesit të privatizimit- Metoda e kreditimit të spin-off-it special dhe Partneriteti Publik-Privat i investimeve

Në bazë të asaj se çfarë u paraqit deri tash në këtë studim, konsideroj se procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, nuk ia arriti qëllimit, as për së afërmi, as në formë, as në përmbajtje nuk solli rezultatet e pritura. Po ashtu, konsideroj se në kushtet e dhëna të aktualitetit (politike), procesi i privatizimit duhet të ndërpritet, të rishikohet, të ridizajnohet dhe pas një periudhe kohore (mundësisht sa më të shkurtër), në kushte dhe rrethana të tjera, të vazhdohet me metoda tjera. Njëkohësisht, procesi i likuidimit të ndërmarrjeve, pasi që vendorët nuk ishin të zotët ta kryenin vetë iu besua kompanisë jashtë Kosovës.

Përkundër premtimeve dhe kostos së lartë, procesi i likuidimit është tejet i ngadalshëm. Andaj, kërkohet domosdoshmërisht përshpejtimi i tij, për të vazhduar, i shmangur nga korrupsioni dhe kompromitimi.

Formë e mundshme e vazhdimit të procesit të privatizimit të pronave të mbetura, pas një analize dhe njohurive nga përvojat paraprake, konsideroj se metodë e frytshme do të ishte *metoda e spin-of-it special të kredituar*. Në të vërtetë, për çka është fjala?

- Gjatë kësaj analize mund të vërehet se numri më i madh i ndërmarrjeve të privatizuara, si sëmundje kronike kanë mungesën e kapitalit. Konsideroj se shteti nuk mund, që edhe mëtej të luaj rolin e deritashëm. Po ashtu, shteti nuk mund t'i merrte, nga procesi i privatizimit, të gjitha ato që mund të merren në njërin anë, kurse në anën tjetër, të mos ketë mbi vete asnjë pjesë të riskut. Shteti duhet të shtrijë dorën e vetë për së mbari. Rregullat e lojës do të ishin, së pari të kryhen analizat financiare të tenderuesit si kusht për tenderim. Këtu, do të vinte në shprehje paraja e gatshme dhe pastërtia e saj: llogaritë, pasuria e patundshme, etj.
- Pas selektimit(përzgjedhjes) të tenderuesve, për disa ndërmarrje, që më herët kanë qenë profitabile (fitimprurëse) dhe me rëndësi strategjike për vendin, është vazhdimi i veprimtarisë paraprake, me me progresion për rritjen e numrit të punëtorve.
- Për investimet e nevojshme pas procesit të privatizimit, shteti duhet të obligohet për dhënie të ndihmës financiare në formë të kredisë me kushte favorizuese. Ndër favoret kryesore është norma e kamatës dhe afati kohor.
- Kredia e dhënë nga ana e shtetit, do të duhej të monitorohej për të vazhduar për realizimin e obligimeve të marrura nga ana e fituesit të tenderit, madje edhe me klauzolë për tenderim të sërishëm, dhe mospranim të investimeve, duke

përfshirë marrjen e mjeteve, që kanë shërbyer si çmim për blerjen e ndërmarrjes..

- Monitorimi i kredisë do të konsistonte deri tek afati i shlyerjes. Kredia do të duhej të ishte në formë të anuiteteve krahas projektit investiv. Tenderuesi në fillim do të mund të propozojë afatin, për të cilin do të ketë nevojë për shtyerje të kredisë.
- Vlera e kredisë nuk do të mund të tejkalojë çmimin e blerjes së ndërmarrjes.

Çmimi i kostos përmes kësaj metode, për procesin e mbetur të privatizimit, do të përfshinte shumën afër 500 milion euro. Një pjesë e kësaj shume, do të financohej nga tenderuesi, për aq mjete të cilat pastaj do t'i ktheheshin tenderuesit përmes kredisë.

Pjesën që do të mbetej e mangët, shteti do ta financojë përmes buxhetit, ose ndonjë linje kreditore, e cila do të mund të merrej nga ndonjë institucion financiar jashtë Kosovës. Rrethanë lehtësuese do të ishte, se kjo shumë e parasë nuk do të duhej të paguhej me një anuitet, por në shumë të tillë, varësisht nga dinamika e investimeve, e përcaktuar më herët.

Efikasiteti i kësaj metode, do të fuqizohej, aq sa ndërmarrjet e privatizuara do të akumulonin mjete financiare qarkulluese të nevojshme, me qëllim të investimit, për siguri më të lartë mbrojtjeje nga investimet e dështuara, dhe për kapje të ritmeve të një zhvillimi më të shpejtë të vendit. Shitja e këtyre ndërmarrjeve, do të bëhej përmes ndonjë institucioni të formuar nga Kuvendi ose Qeveria e Kosovës, duke qenë monitoruese e vazhdueshme; sepse blerja ka risk të dyfishtë: dështimin e investimit në njërin anë, dhe të kredisë në anën tjetër. Do të ishte plotësisht reale pritja dhe angazhimi i shtetit. Në procese të rëndësishme, shteti nuk mund të jetë spektator. Një formë e tillë e shitjes do të kishte karakter valid, vetëm e vetëm nëse përmes ndonjë institucioni paraprak, do të bëhej vlerësimi i pasurisë së ndërmarrjes. Me këtë rast, çmimi tenderues do të duhej të jetë mbi çmimin vlerësues paraprak. Afati kohor i

përfundimit të kësaj forme, do të ishte deri një vit (për Ndërmarrjet Shoqërore të mbetura).

Sa u përket Ndërmarrjeve Publike, do të ishte gabim i madh, nëse ato do t'i udhëheqte (menaxhonte) AKP-ja, e cila zbatoi metodat e deritashme.

Me këtë logjikë të procesit të privatizimit, ato nuk duhet të privatizohen. Një nga metodat, do të ishte ajo e *Partneritetit Publik-Privat të investimeve*. Në këtë vështrim, kuptohet se në ndërmarrjet e reja, të formuara në formë të Shoqërive Aksionare, shteti do të kishte pjesëmarrjen më të lartë. Një metodë e tillë, do të ishte në shërbim të zhvillimit të vendit, përderisa të mundësohej fushë-veprimi i tregut financiar në Kosovë, kur edhe shteti do të blinte dhe do të shiste letra me vlerë.

Metodat e propozuara do të mund të zbatoheshin, për pjesën e ndërmarrjeve të mbetura dhe të pasurisë tjetër të mbetur.

Kjo metodë do të mund të zbatohet, edhe pas një procesi të revidimit të mundshëm të procesit të privatizimit të tërësishëm, i cili mund të ndodhë në një të ardhme.

6.6 Procesi i privatizimit si domosdoshmëri dhe metodat e gabuara për përmbushje efikase të tij

Menaxhimi i procesit të privatizimit në Kosovë iu besua AKM-së (Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit), deri më 2008, dhe u pasua nga AKP-ja (Agjencioni Kosovar i Privatizimit). Në pajtim me ligjin, të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë, që i kishte AKM-ja, u bartën në AKP.

Kështu, AKP-ja ka të drejtë të qeverisjes së ndërmarrjeve në Kosovë, të cilat janë regjistruar më 31 dhjetor 1988, ose në ndonjë datë të mëvonshme, (pa marrë parasysh se ato ndërmarrje a kanë qenë të transformuara).

Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë, andaj edhe përmes Zyrës Rajonale të AKP-së, në Gjilan, u zhvillua përmes tri formave:

- spin off i rregullt,
- Spin off special dhe
- përrmes likudimit

Modeli më i shpeshtë i aplikuar ishte ai i spin off-it të rregullt, nga fakti ngase kishte mundësi të ngriten një varg i ndërmarrjeve simotra, të cilat do të merrnin karakterin e ndërmarrjeve të reja...

Arsyet e zbatimit të këtij modeli, mendohej se do të ishin me pasoja pozitive në aspektin ekonomik, politik, social, etj, dhe do të sillnin një zhvillim proaktiv të vendit, dhe një hap para ofrimit të Republikës së Kosovës drejtë Bashkimit European.

Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në regionin e Gjilanit, sipas shënimeve të mëparshme, në pjesën më të madhe është zhvilluar me të gjitha të metat, dhe larg nga të priturat. Brezat e ardhshme do të japin përgjigje përkitazi me të gjitha pasojat e padëshiruara, që i ka sjellë ky proces për popullatën e Kosovës. Po ashtu, do të jepet përgjigje për procesin e privatizimit në Kosovë: a ishte domosdoshmëri ose nevojë? Përgjigja do të duhej të ngërthente edhe aspektin historik të ndodhisë. Procesi ndoshta ka qenë i nevojshëm, madje edhe i domosdoshëm, mirëpo në asnjë formë nuk është zgjedhur modeli më i mirë.

Ekonomia e Kosovës, si trashigimtare e një prone të paqartë dhe të pa përkufizuar, pas trashëgimit të një ekonomie të shkatërruar nga lufta, para kësaj ekonomie u paraqit nevoja e dëshmisë, për pamundësinë e ekzistimit edhe më tej, të një forme të tillë pronësore (shoqërore), duke mëtuar që sa më shpejt të krijohen kushte për

transformimin e saj. Koncepti i pronës shoqërore ishte i paqartë ¹⁰⁹, ndaj ishte i vështirë për tu përkufizuar.

Megjithatë, kjo pronë duhej transformuar. Domosdoshmëria e transformimit dhe joqëndrueshmëria e kësaj prone, nuk kishin alternativë. Misioni civil i OKB-së i instaluar në Kosovë, nuk ofroi alternativa për transformimin e pronës përmes procesit të privatizimit. Ata imponuan metodat, që mendonin se ishin të përshtatshme për këtë proces. UNMIK-u nëpërmjet shtyllës së Katërt (IV), përgjegjësinë ia besoi Bashkimit Evropian.

Faktorët relevantë, që nga fillimi i punës kishin tërhequr vërejtjen, se procesi i privatizimit në Kosovë është strategjia kryesore ekonomike e krijimit të shtetit të Kosovës. Faktorit vendor nuk iu dha e drejta, madje as që të jetë në cilësi të këshilltarit...! Për këtë arsye kjo formë e privatizimit, me të drejtë, u emërtua si privatizim ndërkombëtar.

Kjo nguti do të mbetej si çështje e hulumtimit, ndoshta për brezat e ardhshme? Do të paraqiten pyetje të atilla në stilin: se a ka qenë koha dhe kushtet e përshtatshme për ndërmarrjen e një hapi të tillë madhor, pastaj u vërejtën të metat që e rënduan procesin... Këto të meta, gjithsesi do të kenë pasoja afatgjata.

Ngutja e këtij procesi të privatizimit të pronës shoqërore, në formë të njëjtë u reflektua edhe në procesin e privatizimit, i cili u zhvillua përmes ZR të AKP-së, në Gjilan. Ndërmarrjet më me rëndësi strategjike dhe ekonomike, që kishin trajtimin e Ndërmarrjeve Shoqërore, u privatizuan nën mandatin e AKM-së, dhe të privatizimit ndërkombëtar. Karakteristikë e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore përmes Zyrës Rajonale në Gjilan, që nuk dallohen për shitje të shumta në Kosovë janë:

¹⁰⁹ Henry H Perrit, Jr. "Resolving claim when countries disintegrate: the challenge of Kosovo", Chicago-Kent Law Review, 80, 119, 2005, fq. 160

- u privatizuan ndërmarrjet më vitale,
- numri më i madh i këtyre ndërmarrjeve nuk është aktive,
- numri i punëtorëve të punësuar në këto ndërmarrje është i vogël,
- në të shumtën e rasteve nuk u vazhdua aktiviteti paraprak i ndërmarrjeve,
- procesi i likuidimit të ndërmarrjeve të privatizuar ka probleme të mëdha lidhur me kërkesat kreditore,
- vlera prej 20%, që iu takon punëtorëve nga shitja është paguar pjesërisht,
- rezistenca e faktorit politik nëpër komuna është duke u rritur, posaçërisht në ato ku janë partitë serbe në pushtet,
- vazhdimi i procesit të privatizimit në komunat me popullatë të përzier nacionale, së fundi, vështirë se do të mund të realizohet pas dhënies së kompetencave më të mëdha komunave,
- e tërë kjo mund të sjellë edhe deri te çrregullimi politik i vendit.

Metodat e privatizimit të pronës shoqërore nuk ishin të rëndësishme së njëjtë. Numri më i madh i ndërmarrjeve në Kosovë, andaj edhe përmes ZR-së, në Gjilan, u privatizuan përmes metodës së spin off-it . Metoda e spin off-it special u dëshmuar si e dëmshme, dhe paraqiti në vazhdimësi dyshimet për rregullat e saja ligjore dhe të zbatimit të tyre. Në rastin tonë, është shembulli i privatizimit të Industrisë së Duhanit në Gjilan, që u realizua përmes metodës së spin off-it special. Kjo ndërmarrje pas pak kohe pushoi së vepruari, dhe erdhi deri te largimi nga puna i punëtorëve të fabrikës.

Përkundër çmimit të ulët, prej gjithsej 1.400,000.00 euro, kushtet e tjera që përcaktonte spin off special nuk u përmbushën. Në këtë shembull, me të drejtë shtrohet pyetja dyshuese: kush i mundësoi pronarit nga ana e AKP-së, që kjo ndërmarrje të mbahej mbi 6 vjet nën monitorim të kundërligjshëm, dhe të mos ndërmerren masa për kthimin e aksioneve, përkatësisht ritenderimin e kësaj ndërmarrjeje? Burimin e këtij veprimi duhet kërkuar brenda AKP-së.

Situata politike e paqëndrueshme në Kosovë, që në vazhdimësi shpërtheu pas shpalljes së shtetit, varësisht nga periudhat kohore, herë më shumë e herë më pak, u karakterizua me greva, protesta, demonstrata, ndërprerje e parakohshme e mandatit të presidentit të vendit, qeverisë, parlamentit, etj, që në formë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kishin lidhje me procesin e privatizimit në Kosovë. Situata aktuale, që ka të bëjë me Trepçën, përpos rrjedhave të padëshiruara ekonomike, mund të sjell edhe deri te eskalimi politik, në përmasa të pa parashikuara. Për këtë arsye procesi i privatizimit, tashti do të duhej të ndërpritej: të rishikohej e kaluara që për gjykatat e Kosovës, do të paraqiste punë të bollshme, dhe pastaj, në kushte të një stabiliteti ekonomik dhe politik, me metoda dhe forma të reja, të vazhdojë procesi i privatizimit të pjesëve të Ndërmarrjeve Shoqërore të mbetura...Të fillohet privatizimi i Ndërmarrjeve Publike. Privatizimi alternativë nuk ka, por duhet në formë tjetër të vazhdohet.

Përfundim

Procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës, pa dyshim paraqet një rën nga ndodhitë më të rëndësishme të fillimit të këtij shekulli. Nuk mund të thuhet se ky proces ndodhi spontanisht. Së paku, u provua të planifikohej mirë, ashtu së paku thuhej. Mirëpo, prej të thënës në të bërë, një oqean i tërë. Procesin e privatizimit e planifikuan, organizuan dhe zbatuan “**ekspertë ndërkombëtarë**”, cilëve iu dha besimi symbyllur. Së fundi, të paktë ishin ekspertët në Kosovë, në atë kohë, që do të ishin në gjendje të shkruanin ndonjë shkronjë, përkitazi me këtë proces, nga mosdija ose nga mosgatishmëria e tyre.

Instalimi i UNMIK-ut në Kosovë, i dha vetës për detyrë organizimin e jetës civile. Në këtë fushë bënte pjesë edhe çështja e transformimit të pronës. Kjo do të mundësohej përmes procesit të privatizimit, që pronës do t'i jepte pronarin. Këtë e realizoi përmes Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit. Për shkak të përfaqësimit të paktë të faktorit vendor, ky proces u quajt privatizim ndërkombëtar.

Për periudhën kohore 2002-2008, për aq sa zgjati mandati i AKM-së u privatizuan pjesa më e madhe e ndërmarrjeve, që kishin rëndësi vitale për ekonominë e Kosovës. Rezultatet e pritura ishin larg nga ato të realizuara.

Asnjë nga kriteret, të cilat u përcaktuan dhe efektet e pritura, nuk u realizuan. Së paku, prona duhej të kishte pronarin e vet. Ajo ende mbeti pa pronar ngase, pos që u dha me qira për 99 vite, asnjëherë nuk iu dha përgjigje, se çka do të ndodh me atë pronë pas kësaj periudhe. Efektet ekonomike, sociale, psikike, etike, morale, etj, sollën të kundërtën e asaj, që u prit nga ky proces. Në qoftë se duhej veçuar ndonjë efekt për së mbari, atëherë ai do të ishte se procesi i parapriu shtetësisë së Kosovës, sepse këtë e kërkonte bashkësia ndërkombëtare.

Çështjet nuk qëndruan më mirë edhe pas mbarimit të mandatit të AKM-së. Atë e trashëgoi Agjencioni Kosovar i Privatizimit. Trashëgimia vazhdoi për së keqi. Atë që

filloi për së mbrapshti faktori ndërkombëtar, përkitazi me procesin e privatizimit në Kosovë, e vazhdoi faktori vendor përmes AKP-së. Asgjë nuk ndryshoi dhe nuk vazhdoi për së miri. Tashti sipas dinamikës së punës së AKP-së, konsiderohet se deri në vitin 2016, do të përfundojë procesi i privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë. Përmbyllja e procesit të privatizimit konsiderohet i mbyllur, atëherë kur të përfundojë likuidimi i ndërmarrjeve të tyre. Gjasat që të ndodh për këtë periudhë, me këtë dinamikë të punës, lë vend për dyshim. Sidoqoftë, një proces i qiradhënies do të përfundojë. Barrë për brezat e ardhshme dhe burim konflikti pronësor, do të mund të paraqitet në një periudhë pas 80 vitesh. Atëherë, me të drejtë do të vlejnjë akuzat se kjo gjeneratë e tashme përkitazi me këtë proces, paska luajtur vetëm lojë dhe i paska munguar ndërgjegjja e përgjegjësia. Sidoqoftë, këtij procesi, nëse nuk i ndodh ndonjë revidim *vis majoris*, po i vjen fundi. Mbetet për tu dëshiruar që fatin e njëjtë të mos e pasojnë Ndërmarrjet Publike. Në qoftë se merret si mostër Aeroporti i Prishtinës dhe Korporata Energjetike e Kosovës, që vazhduan rrugën e Ndërmarrjeve Shoqërore të privatizuar, le të kuptohet, se me njëmendësinë e cila ekziston në nivel qeveritar, edhe Ndërmarrjet e tjera Publike, do të vazhdojnë traditën e privatizimit paraprak.

SHTOJCA



Kombinati i Tekstilit INTEGJ- Gjiilan



Industria e Duhanit në Gjiilan



Ndërmarrja Ndërtimore MORAVA E BINÇËS në Gjiilan



Kombinati Bujqësor „Agrokultura“ në Gjilan



Qendra tregtare “28 Nëntori” në Gjilan



Fabrika e Tubave në Ferizaj



Kombinati i Drurit „TEFIK ÇANGA“ në Ferizaj



Ndërtesa e NT „17 Nëntori“- Ferizaj



Fabrika e Veglave- Ferizaj



Ndërmarrja Ndërtimore- Ferizaj



Ndërmarrja Magnohrom- XIM Strezovc- Kamenicë



Ndërmarrja Ndërtimore Eng Beton - Kamenica



Fabrika e Tjegullave - Kamenica



Repart i prodhimit i N.Sh. „Xiq Karaqeva“- Kamenica



Qendra tregtare e NT „Qendresa“ – Kamenica



Mulliri i KB „Agromorava“ - Viti



Repart i prodhimit i NSH „Vinex“



Ndërmarrja „Letnica“ -Viti



Ndërmarrja Banja e Kllokotit në Klokot- Viti



Qendra Tregtare e NSH „Morava e Eperme“- Viti



Repart i prodhimit i NSH "Lepenci" - Kaçanik



NSH "Sharr-Salloniti" - Kaçanik dhe terminali doganor



NSH "Silcapor" - Kaçanik

LISTA E NDËRMARRJEVE TE PRIVATIZUARA PËRMES AKM- ZR Gjilan

Nr	Emri i ndërmarrjes	Selia	Veprimtaria	Madhesia	Viti i privatizimit	Metoda e privatizimit	Nr i punetoreve më 1989	Nr i punetoreve aktive para privatizimit	Nr i punetoreve të përfshira në Listën e 20%	Shfrytëzuesi kapaciteti
1	NSHIT Integj	Gjilan	Prodhim	E madhe	2006	SO	2427	110	698	8-10%
2	IDGJ Industria e Duhanit	Gjilan	Prodhim	E madhe	2004	SOS	506	236	233	10-15%
3	NHNI Morava e Binçës	Gjilan	Ndërtim	E madhe	2010	SO	1600	778	810	4-6%
4	KBI Agrokultura	Gjilan	Bujqesi	E madhe	2006	SO	2000	107	255	4-6 %
5	NSHT 28 Nëntori	Gjilan	Tregti	E madhe	2006	SO	662	78	223	12-16%
6	Fabrika e Tubave	Ferizaj	Prodhim	E madhe	2006	SOS	1317	658	677	20-30%
7	Kombinati i Drurit	Ferizaj	Prodhim	E madhe	2005	SO	1050	196	714	14-16%
8	NT 17 Nëntori	Ferizaj	Tregti	E madhe	2007	SO	349	193	242	25-30%
9	Fabrika e Veglave	Ferizaj	Prodhim	E madhe	2006	SO	262	115	229	30-35%
10	NNI Mustafë Goga	Ferizaj	Ndërtim	E madhe	2007	SO	1285	80	113	4-6%
11	NBI Agromorava	Viti	Bujqesi	e Mesme	2005	SO	196	75	120	5-8%
12	NSH Vinex	Viti	Prodhim	e Mesme	2006	SO	505	101	228	18-20%
13	NSH Letnica	Viti	Prodhim	E madhe	2009	SO	400	15	42	
14	NSH Banja e Kllokotit	Viti	Shërbime	e Mesme	2005	SOS	226	220	223	60-70%
15	NT Morava e Epërme	Viti	Tregti	e Mesme	2007	SO	202	78	70	30-40%
16	NSH Magnohrom XIM Strezovc	Kamenicë	Prodhim	E Madhe	2007	SOS	408	145	59	3-5%
17	NSH Eng Beton	Kamenicë	Ndërtim	E Madhe	2004	SO	489	110	121	15-20%
18	NSH Tullara	Kamenicë	Prodhim	e Mesme	2008	SO	146	80	27	15-18%
19	NSH XIQ Karaqeva	Kamenicë	Prodhim	e Mesme	2006	SO	741	11	459	2-4%
20	NT Qëndresa	Kamenicë	Tregti	e Mesme	2007	SO	80	50	48	30-40%
21	FGG Lepenci	Kaçanik	Prodhim	e Mesme	2004	SOS	187	254	255	30-40%
22	KAP Sharr Salloniti	Kaçanik	Prodhim	E Madhe	2010	SOS	320	255	251	35-45%
23	NP Sillcapor	Kaçanik	Prodhim	E Madhe	2005	SOS	345	343	347	40-50%

**LISTA E VLERËS SË PASURISË TË NDËRMARRJEVE PARA PROCESIT TË
PRIVATIZIMIT ZR GJILAN**

Nr	Emri I ndermarrjes	Objekte në Euro	Makineria në Euro	inventari në Euro	Toka në Euro	Total
1	NSHIT Integj	9554297	2620717			12175014
2	IDGJ Industria e Duhanit	1865299	1538161	0	30151	3433611
3	NHNI Morava e Binçës	6202384	2868335	77055	126163	9273937
4	KBI Agrokultura	112472	33			112505
5	NSHT 28 Nëntori	420291	13353			433644
6	Fabrika e Tubave	16748518	24406646		1765747	42920911
7	Kombinati I Drurit	37601918	4948423		14316173	56866514
8	NT 17 Nëntori	8107900	66289			8174189
9	Fabrika e Veglave	4060450	1882300		9132000	15074750
10	NNI Mustafë Goga	1564348	22856		3653400	5240604
11	NBI Agromorava	0	0	0		0
12	NSH Vinex	1360092	2313669		1268004	4941765
13	NSH Letnica	429041	97343			526384
14	NSH Banja e Kllokotit	2288980	757077	173894	2738864	5958815
15	NT Morava e Epërme	11973200	6448			11979648
16	NSH Magnohrom- XIM Strezovc	50339594				50339594
17	NSH Eng Beton	0	0	0	0	
18	NSH Tullara	0	0	0	0	
19	NSH XIQ Karaqeve	8397500	4092211		1690000	14179711
20	NT Qëndresa	3164727	3293			3168020
21	FGG Lepenci					
22	KAP Sharr Salloniti	6620489	365232			6985721
23	NP Sillcapor	11568389	53973074		29051112	94592575
		182379889	99975460	250949	63771614	346377912

				Gjilan		
Nr.	Ndermarrja	Ndërmarrja e re	Komuna	Vala	Çmimi i shitjes	Data e Kontratës
1	IDGJ Industria e Duhanit	IDGJ Industria e Duhanit	Gjilan	10	1,400,000.00	14.08.2006
2	IDGJ Industria e Duhanit	Tokë	Gjilan	GJI 705	142,300.00	
1	Integj	Integj spinning and machie-woven carpets	Gjilan	7	1,010,000.00	02.03.2006
2	Integj	Fabrika e perdeve Gival	Gjilan	GJI 0704	1,680,000.00	10.08.2009
3	Integj	Tjertorja e vjeter dhe fabrika e tepihave Tafti	Gjilan	GJI 0704	797,000.00	10.06.2009
4	Integj	Fabrika e perdeve Rashell	Gjilan	GJI 0704	390,000.00	26.06.2009
5	Integj	Njesia e nxemjes qendrore dhe e servisimit	Gjilan	GJI 0704	470,000.00	26.06.2009
6	Integj	Fabrika e trikotazhit dhe ndertesa administra	Gjilan	GJI 0704	1,290,000.00	30.06.2009
7	Integj	Depoja ne Shillove	Gjilan	GJI 0704	120,080.00	24.07.2009
8	Integj	Shitorja ne Gjilan	Gjilan	GJI 0704	356,000.00	25.06.2009
9	Integj	Elemente (konstrukcione) metalike per nderti	Gjilan	GJI 0705	24,850.00	
1	Morava e Binçës	Moravamont	Gjilan	14	627,000.00	27.04.2009
2	Morava e Binçës	Morava e Binçes Gurëthyesi Gllama	Gjilan	20	4,150,000.00	09.08.2010
3	Morava e Binçës	Morava e Binces Administrata SHPK	Gjilan	23	1,222,222.00	08.05.2008
4	Morava e Binçës	Shitoret Morava e Binçes	Gjilan	45		18.04.2011
1	Agrokultura	Tokë në Livoq I poshtem	Gjilan	7	360050	23.03.2006
2	Agrokultura	Tokë në Gumnishte& Ponesh	Gjilan	7	211000	16.11.2005
3	Agrokultura	Tokë në Kravarica	Gjilan	11	269250	20.06.2006
4	Agrokultura	Ndërtesa Administrative	Gjilan	20	1155000	15.05.2008
5	Agrokultura	Kompleksi Agro industrial B	Gjilan	25	111222	09.06.2008
6	Agrokultura	Kompleksi Agro industrial C	Gjilan	25	157120	24.06.2008
7	Agrokultura	Kompleksi Agro industrial D	Gjilan	25	238444	24.06.2008
8	Agrokultura	Toka në Ponesh	Gjilan			19.03.2010
9	Agrokultura	Kompleksi Agroindustrial A	Gjilan	44		22.12.2010
10	Agrokultura	Depoja Frigoriferinë Shillov	Gjilan	59	531700	24.12.2013
11	Agrokultura	Industria e mishit	Gjilan	59	1205000	24.12.2013
1	28 Nëntori	28 Nëntori Shtëpia e Mallrave	Gjilan	8	3,170,000.00	23.03.2006
2	28 Nëntori	28 Nëntori Depo	Gjilan	8	652,000.00	06.03.2006
3	28 Nëntori	28 Nëntori Pjesa e Vjetër	Gjilan	12	656,000.00	26.06.2006
4	28 Nëntori	28 Nëntori Shitore	Gjilan	18	30.03.2007	30.03.2007
5	28 Nëntori	28 Nëntori Shitore	Gjilan	21	285,000.00	24.10.2007
6	28 Nëntori	28 Nëntori Shitore	Gjilan	21	325,555.00	24.10.2007
7	28 Nëntori	28 Nëntori Shitore Kompleksi A	Gjilan	21	361,555.00	21.05.2008
8	28 Nëntori	29 Nëntori Shitore Kompleksi B	Gjilan	21	488,779.00	15.05.2008
9	28 Nëntori	Shitorja (174m²) Rr.Abdullah Tahiri Gjilan	Gjilan	GJI 0703	139,200.00	
10	28 Nëntori	Shitorja (73m²) Rr.Bulevardi i Pavarsise Gjila	Gjilan	GJI 0703	266,666.00	
11	28 Nëntori	Shitorja (82m²) Rr.Bulevardi i Pavarsise Gjila	Gjilan	GJI 0703	333,333.00	
12	28 Nëntori	Depo ne Gjilan (5800m²)	Gjilan	GJI 0705	740,000.00	
13	28 Nëntori	Dy Objekte me karakter te perkohshem-gara	Gjilan	GJI 0705	3,250.00	

FERIZAJ						
Nr.	Nderrmarja	Ndërmarrja e re	Komuna	Vala	Çmimi i shitjes	Data e Kontratës
1	IMK Fabrika e Tubave	IMK Fabrika e Tubave Depo	Ferizaj	9	630,000.00	04.07.2006
2	IMK Fabrika e Tubave	IMK Fabrika	Ferizaj	19	3,657,000.00	21.11.2007
1	Tefik Çanga	Tefik Çanga Depo	Ferizaj	4	2,162,250.00	11.05.2005
2	Tefik Çanga	Tefik Çanga Fabrika	Ferizaj	9	3,100,001.00	22.05.2006
1	17 Nëntori	17 Nëntori Depo Ferizaj	Ferizaj	18	757,427.00	17.04.2007
2	17 Nëntori	17 Nëntori Zyre dhe qendra tregtare	Ferizaj	18	1,666,666.00	16.05.2007
3	17 Nëntori	17 Nëntori Shitore	Ferizaj	16	401,000.00	18.05.2007
4	17 Nëntori	Shitore "Vilezrit Gervalla"	Ferizaj	21	477,770.00	30.10.2007
5	17 Nëntori	Shitorja Qendrore	Ferizaj	18	1,030,000.00	21.06.2007
6	17 Nëntori	Shitorja ne rrugen e Gjilanit	Ferizaj	18	301,333.00	21.06.2007
7	17 Nëntori	Shitorja Dëshmorët e Kombit LLC	Ferizaj	21	942,346.00	09.05.2008
8	17 Nëntori	Shitorja ne Qender	Ferizaj	22	1,256,250.00	09.05.2008
9	17 Nëntori	Shitoret ne qender te qytetit	Ferizaj	22	1,476,007.00	30.05.2008
10	17 Nëntori	Shtëpia e Bardhë	Ferizaj	24	121,121.00	04.05.2009
11	17 Nëntori	Barakat	Ferizaj	24	140,000.00	10.06.2008
12	17 Nëntori	Shitorja nëLypjan	Ferizaj	28	72,199.00	08.06.2009
13	17 Nëntori	Tokë komeciale dhe ndërtesa	Ferizaj	35		06.11. 2009
14	17 Nëntori	Shitore në Shtëpia e Bardhë	Ferizaj	36		22.12.2009
15	17 Nëntori	Shitorja West	Ferizaj	36		25.01.2010
16	17 Nëntori	Shitorja ne rrugën Woodrow Wilson Street	Ferizaj	37		02.03.2010
17	17 Nëntori	Apartmenti ne Shtepin e bardhe	Ferizaj			15.09.2011
1	Fabrika e Veglave	Fabrika e Veglave	Ferizaj	10	135,555.00	19.06.2006
1	Mustafë Goga	Punishtja	Ferizaj	GJI0603	405,250.00	03.06.2007
2	Mustafë Goga	Administrata	Ferizaj	GJI0603	1,555,555.00	25.10.2007
3	Mustafë Goga	Restauranti i punëtorve	Ferizaj	GJI0603	121,150.00	24.08.2007

KAÇANIK						
Nr.	Nderrmarja	Ndërmarrja e re	Komuna	Vala	Çmimi i shitjes	Data e Kontratës
1	Lepenci	Lepenci	Kaçanik	1	650,000.00	08.03.2004
1	Sharr salloniti	Sharr salloniti kaçanik	kaçanik			04.05.2010
1	Silcapor	Silcapor (blocks producer)	Kaçanik	2	2,824,153.00	16.03.2005

KAMENICË						
Nr.	Nderrmarrja	Ndërmarrja e re	Komuna	Vala	Çmimi i shitjes	Data e Kontratës
1	Xim Strezovci	Xim Strezovci Magnezit Mine"LLC	Kamenicë	22	45,555.00	15.12.2007
2	Xim Strezovci	Strezovci baza e transportit	Kamenicë			26.03.2010
3	Xim Strezovci	Toka ne Topanic	Kamenicë	Shal 17		13.06.2013
1	ENG Beton	ENG Beton	Kamenicë	2	425,235.00	08.03.2004
2	Eng Betoni	Toka ne Topanic	Kamenicë	Shal 15		09.10.2012
1	Tullara	Tullara	Kamenicë	22	109,136.00	04.06.2008
1	XIQ Karaqeva	Karaqeva	Kamenicë	9	888,888.88	14.08.2006
2	XIQ Karaqeva	Karaqeva fabrika e vjetër	Kamenicë	27	605,689.00	16.04.2009
1	Qëndresa	Qendresa Shtepia e Mallrave	Kamenicë	17	430,000.00	23.03.2007
2	Qëndresa	Qendresa Shitore	Kamenicë			26.03.2010
				VITI		
Nr.	Nderrmarrja	Ndërmarrja e re	Komuna	Vala	Çmimi i shitjes	Data e Kontratës
1	Agromorava	Agromorava Ramjan	Viti	5	353535	24.11.2005
2	Agromorava	Agromorava Motel	Viti	5	215500	10.05.2005
3	Agromorava	Depo dhe tokë në Gërmovë	Viti	26	309990	27.07.2009
4	Agromorava	Agricultural Toka në Nec	Viti	26	106122	08.05.2009
5	Agromorava	Agricultural Toka në Pozharan-Stub	Viti	26	51500	08.05.2009
6	Agromorava	Agricultural Toka në Beli Dub	Viti	26	156555	07.10.2009
7	Agromorava	Depo në Pozharan	Viti	26	50150	18.05.2009
8	Agromorava	Agromorava Mulliri Elektrik	Viti	27	301000	08.06.2009
9	Agromorava	Agromorava Ferma	Viti	27	41111	07.10.2009
10	Agromorava	Agricultural Toka ne Nec 2	Viti	30	107000	30.11.2010
11	Agromorava	Agricultural Toka në Begrac 2	Viti		107000	08.10.2012
12	Agromorava	Toka ne Drobesh	Viti	57	157000	22.01.2014
13	Agromorava	Toka Bujqesore ne Gjylekar	Viti			04.03.2014
14	Agromorava	Toka ne Gërmovë	Viti			12.03.2014
1	Vinex	Vinex	Viti	7	730,000.00	20.02.2006
1	Letnica	Letnica Fabrika e Tekstilit	Viti	28	185,000.00	08.12.2009
2	Letnica	Letnica Viti prona	Viti	28	266,666.00	15.06.2009
1	Banja e kllkotit	Banja e Kllkotit Uji Mineral	Viti	5	1,680,000.00	24.11.2005
2	Banja e kllkotit	Kllkot Toka Bujqesore	Viti	5	401250	20.02.2005
3	Banja e kllkotit	Banja e Kllkotit	Viti			15.04.2010
1	Morava e Epërme	Morava e Eperme Margaritaret e Vitise	Viti	19	228,750.00	24.07.2007
2	Morava e Epërme	Morava e Eperme Shtepia e Mallrave	Viti	27	1,190,000.00	05.05.2009

deri më 31-Mar-14

Gjithsej numri i punëtorëve paguar nga Të hyrat e Dedikuara

Departamenti	Nr. i punëtorëve sipas organogramit	Nr. aktual i punëtorëve në fillim të periudhës raportuese		Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës raportuese	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
GJITHSEJ	271	259		258	

Numri i punëtorëve sipas departamenteve

Departamenti	Nr. i punëtorëve sipas organogramit	Nr. aktual i punëtorëve në fillim të periudhës raportuese		Nr. aktual i punëtorëve në fund të periudhës	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Zyra e Drejtorit Menaxhues	4	4		3	
Zyra e Zv. Drejtorit Menaxhues - KL	3	2		2	
Zyra e Zv. Drejtorit Menaxhues - RA	3	3		3	
Departamenti i Shitjes	30	30		30	
Departamenti i Financave dhe Buxhetit	12	12		12	
Department Ligjor	31	29		29	
Departamenti i Administratës	49	50		50	
Departamenti i Prokurimit	5	5		5	
Divizioni i KL/Departamenti për koordinimin e Likuidimit	14	10		10	
Divizioni i shitjes	19	16		16	
Sekretariati Ekzekutiv	3	3		3	
Njësia e Mediave dhe Marrëdhënieve me Publikun	3	3		3	
Njësia e Auditimit të Brendshëm	5	5		5	
Njësia për Riorganizimin e Trepçës	4	4		4	
Zyra Rajonale Gjilan	17	18		18	
Zyra Rajonale Mitrovica	17	15		15	
Zyra Rajonale Peja	16	15		15	
Zyra Rajonale Prishtina	18	18		18	
Zyra Rajonale Prizren	15	14		14	
Departamenti i Koordinimit Rajonal	3	3		3	
TOTAL	271	259		258	

LISTA E NDËRMARRJEVE TE PRIVATIZUARA ZR GJILAN										
Nr	Emri i ndermarrjes	Selia	Veprimtaria	Madhesia	Viti i privatizimit	Metoda e privatizimit	Nr i punetoreve më 1989	Nr i punetoreve aktiv para privatizimit	Nr i punetoreve te perfshirne Lista e 20%	Shfrytz kapac
1	NSHIT Integj	Gjilan	Prodhim	E madhe	2006	SO	2427	110	698	8-10%
	IDGJ Industria e Duhanit	Gjilan	Prodhim	E madhe	2004	SOS	506	236	233	10-15%
2	NHNI Morava	Gjilan	Ndërtim	E madhe	2010	SO	1600	778	810	4-6%
3	e Binçës	Gjilan	Bujqesi	E madhe	2006	SO	2000	107	255	4-6 %
4	KBI Agrokultur	Gjilan	Tregti	E madhe	2006	SO	662	78	223	12-16%
5	NSHT 28 Nëntori	Gjilan	Prodhim	E madhe	2006	SOS	1317	658	677	20-30%
6	Fabrika e Tuba	Ferizaj	Prodhim	E madhe	2006	SO	1050	196	714	14-16%
	Kombinati I Drurit	Ferizaj	Prodhim	E madhe	2005	SO	349	193	242	25-30%
7	NT 17 Nëntori	Ferizaj	Tregti	E madhe	2007	SO	262	115	229	30-35%
8	Fabrika e Veglave	Ferizaj	Prodhim	E madhe	2006	SO	1285	80	113	4-6%
9	NMI Mustafë Goga	Ferizaj	Ndërtim	E madhe	2007	SO	196	75	120	5-8%
10	NBI Agromora	Viti	Bujqesi	e Mesme	2005	SO	505	101	228	18-20%
11	NSH Vinex	Viti	Prodhim	e Mesme	2006	SO	400	15	42	
12	NSH Letnica	Viti	Prodhim	E madhe	2009	SO	226	220	223	60-70%
13	NSH Banja e Kllokotit	Viti	Shërbime	e Mesme	2005	SOS	202	78	70	30-40%
14	NT Morava e Epërme	Viti	Tregti	e Mesme	2007	SO				
15	NSH Magnohrom-XIM Strezove	Kamenic	Prodhim	E Madhe	2007	SOS	408	145	59	3-5%
16	NSH Eng Beto	Kamenic	Ndërtim	E Madhe	2004	SO	489	110	121	15-20%
17	NSH Tullara	Kamenic	Prodhim	e Mesme	2008	SO	146	80	27	15-18%
18	NSH XIQ	Kamenic	Prodhim	e Mesme	2006	SO	741	11	459	2-4%
19	Karageva	Kamenic	Prodhim	e Mesme	2007	SO	80	50	48	30-40%
20	NT Qëndresa	Kamenic	Tregti	e Mesme	2007	SO	187	254	255	30-40%
21	FGG Lepenci	Kaçanik	Prodhim	e Mesme	2004	SOS	320	255	251	35-45%
22	KAP Sharr Salloniti	Kaçanik	Prodhim	E Madhe	2010	SOS	345	343	347	40-50%
23	NP Silcapor	Kaçanik	Prodhim	E Madhe	2005	SOS				
			Gjithsejtë :				15703	4288	6444	

LISTA E NDËRMARRJEVE TË PRIVATIZUARA Gjilan

Komuna	Emri i N.Sh-së	Statuti i N.	Nr	Emri i Ndër.së Re	Cmimi i shitbl.
Gjilan	IDGJ Tobacco Industry	Në Likuidim	1	IDGJ Tobacco LLC	€ 1,400,000.00
			2	Residential development land	
Gjilan	Agrokultura	Në tranzicion	3	Land and Orchard Livoqi i Poshtem LLC	€ 360,050.00
			4	Land and Orchard Kravarica LLC	
			5	Land Gumnishte and Ponesh LLC	
			6	Administrative buildings and Orchard LLC	€ 1,155,000.00
			7	Agro industrial Complex B LLC	
			8	Agro industrial Complex C LLC	
			9	Agro industrial ComplexD LLC	
Gjilan	Kualiteti	Në tranzicion	10	Kualiteti International LLC	
Gjilan	Kualiteti	Në tranzicion	11	Kualiteti Shops LLC	€ 266,520.00
Gjilan	Stacioni Bujqësor	Në Likuidim	12	Stacioni Bujqësor Livoq LLC	€ 130,500.00
			13	Stacioni Bujqësor Reprocenter LLC	€ 302,350.00
Gjilan			14	Stacioni Bujqësor Administration LLC	€ 472,285.00
Gjilan	KB 1 Maj	%	15	%	
Gjilan	KB Bresalci	%	16	%	
Gjilan	KB Cernica	%	17	%	
Gjilan	KB Kishna Pole	%	18	%	
Gjilan	KB Malisheva	%	19	%	
Gjilan	KB Morava Partesh	%	20	%	
Gjilan	KB Perlepnica	%	21	%	
Gjilan	KB Pogragja	%	22	%	
Gjilan	KB Shillova	%	23	%	
Gjilan	KB Shurdhani	%	24	%	
Gjilan	KB Zarje Buiq Pasjan	%	25	%	
Gjilan	KB Zhegra	%	26	%	
Gjilan	KB Mirusha	Në Likuidim	27	Zyra Administrative Oborri dhe Ndertesat	
			28	Depoja	
Gjilan	Morava e Binces	%	29	Moravamont LLC	
			30	Morava e binces Quarry LLC	
Gjilan			31	Morava e Binces Administration LLC	€ 1,222,222.00
Gjilan	Ekonomia e Pyjeve	%	32	%	
Gjilan	IBG Batteries	%	33	%	
Gjilan	Jugoterm	%	34	%	
Gjilan	Celiku	Në Likuidim	35	Celiku Construction LLC	€ 625,376.00
			36	Celiku Rollers	€ 555,555.00
			37	Prone tokesore	
			38	Shitorja Celiku	
Gjilan	Hekurishte	%	39	%	
Gjilan	Teknika Popullore	%	40	%	
Gjilan	Barnatorja	Në Likuidim	41	Barnatorja Popullore II Gjilan LLC	€ 712,000.00
			42	Barnatorja Popullore I Gjilan LLC	€ 452,000.00
Gjilan	Mekanizimi	%	43	%	
Gjilan	Radio Gjilan	%	44	%	
Gjilan	SHAM Drita	Në tranzicion	45	Auto Shkolla Drita LLC	
Gjilan	Grafikos	Në Likuidim	46	Grafikos LLC	
Gjilan	Teuta	Në Likuidim	47	Teuta (Gjilan) LLC	€ 70,250.00
Gjilan	Integj	Në Likuidim	48	Integj Spinning and Machine-woven carpets	€ 1,010,000.00
Gjilan			49	Fabrika e perdeve Gival	
Gjilan			50	Tjertorja e vjeter dhe fabrika e tepihave Tafting	
Gjilan			51	Fabrika e perdeve Rashell	
Gjilan			52	Njesia e nxemjes qendrore dhe e servisimit	
Gjilan			53	Fabrika e trikotazhit dhe ndertesa administrative	
Gjilan			54	Depoja ne Shillove	
Gjilan			55	Shitorja ne Gjilan	
Gjilan			56	Elemente (konstrukcione) metalike per ndertimtar	
Gjilan	SHAH Kosova	Në Likuidim	57	Hotel Kristal LLC	€ 1,716,700.00
Gjilan	28 Nentori	Në Likuidim	58	28 Nentori Shopping Mall LLC	€ 3,170,000.00
			59	28 Nentori Warehouse and Administrative	€ 652,000.00
			60	28 Nentori Old Departament Store LLC	€ 656,000.00
			61	28 Nentori Shops and Offices LLC	€ 1,151,000.00
			62	28 Nentori Shops Complex A LLC	€ 361,555.00
			63	29 Nentori Shops Complex B LLC	€ 488,779.00
			64	30 Nentori Shops Complex C LLC	€ 285,000.00
			65	31 Nentori Shops Complex D LLC	€ 325,555.00
			66	Shitorja (174m²) Rr.Abdullah Tahiri Gjilan	
			67	Shitorja (73m²) Rr.Bulevardi i Pavarsise Gjilan	
			68	Shitorja (82m²) Rr.Bulevardi i Pavarsise Gjilan	
			69	Depo ne Gjilan (5800m²)	
			70	Dy Objekte me karakter te perkohshem-garazhe (37m²)	
			71	Anamorava Business Premisses LLC	€ 298,861.00
Gjilan	Anamorava	Në Likuidim	72	Anamorava Warehouse LLC	€ 303,000.00
Gjilan	Qarkullimi	%	73	Qarkullimi Administration and Yard LLC	€ 501,000.00
Gjilan	Kosovatrans	%	74	Kosovatrans Gjilan-Offices maintance premisses and buses LLC	€ 865,000.00
Gjilan	Hidroteknika	%	75		
Gjilan	Higjiena	%	76		
Gjilan	Bankos	%	77		
Gjilan	Veterinary Station	%	78		
Gjilan	City Cinema	Në Likuidim	79	Kinemaja Gjilan LLC	€ 274,500.00
Gjilan	Aviokosova Airport	%	80		
Gjilan	Barber Cooperative	%	81		
* Shitja me likuidim					

Lista e Ndërmarrjeve të privatizuara Ferizaj

Komuna	Emri i N.Sh-së	Statuti i N.Sh.	No	Emri i Nder.së Re	Cmimi i shitbl.
Ferizaj	Minex	Komercializuar	1	Minex Sh.P.K	€ 103,000.00
Ferizaj	Fabrika e Vajit	Tranzicion	2	Sunflower oil factory L.L.C.	€ 460,000.00
			3	Farmer Harvest L.L.C.	€ 422,000.00
Ferizaj	KB Ferizaj	Tranzicion	4	Domestic products L.L.C	€ 107,750.00
Ferizaj	KB Talinovci	Likuidim	5	Admin base	€ 102,000.00
			6	Land Bibaj LLC	€ 569,345.00
			7	Land Talinovci LLC	€ 335,009.00
			8	Warehouse LLC	€ 503,835.00
Ferizaj	Pasuria Bujqësore	Privatizim	9	Land Komogllava LLC	€ 701,000.00
			10	Land Varosh LLC	€ 1,104,000.00
			11	Land Prelez LLC	€ 265,000.00
			12	Land Elezaj LLC	€ 444,567.00
			13	Plantacioni L.L.C.	€ 362,500.00
			14	Plantacioni - Refrigeration plant LL	€ 211,250.00
Ferizaj	Plantacioni	Tranzicion	15	Plantacioni - agrobussines Shtime	€ 516,765.00
			16	Concrete base	€ 405,250.00
			17	Admin base	€ 1,555,555.00
Ferizaj	Mustafë Goga	Likuidim	18	Workers restaurant	€ 121,150.00
			19	IMK Shtime warehouse LLC	€ 630,000.00
Ferizaj	IMK Pipe factory	Likuidim	20	IMK Pipe factory LLC	€ 3,657,000.00
Ferizaj	Metalografika	Likuidim	21	Metalografika LLC	€ 131,999.00
Ferizaj	Tools & Apparatus	Likuidim	22	Tools & apparatus LLC	€ 1,355,555.00
			23	Eurometal LLC	€ 712,650.00
Ferizaj	Eurometali	Likuidim	24	Eurometal Warehouse & Offices L	€ 881,250.00
			25	Mustafë Rexhepi LLC	€ 710,100.00
Ferizaj	Mustafë Rexhepi	Likuidim	26	Car & track service center LLC	€ 1,300,001.00
Ferizaj	Semafori	Tranzicion	27	Semafori driving school LLC	€ 452,000.00
			28	Hotel Lybeten LLC	€ 1,635,000.00
			29	Admin base	€ 95,000.00
Ferizaj	Drita	Likuidim	30	Restaurant "Fitorja"	€ 303,303.00
			31	Shops LLC	€ 401,000.00
			32	Warehouse LLC	€ 757,427.00
			33	Offices & shopping centre LLC	€ 1,666,666.00
Ferizaj	17 Nëntori	Tranzicion	34	Central shops LLC	€ 1,030,000.00
			35	Shops Gjilan street LLC	€ 301,333.00
			36	Shops Dëshmorët e Kombit LLC	€ 942,346.00
			37	Shops Vilezërit Gërvalla LLC	€ 477,770.00
			38	Central square shops LLC	€ 1,256,250.00
			39	Town centre shops LLC	€ 1,476,077.00
			40	White house apartments LLC	€ 121,121.00
			41	Retail barracks LLC	€ 140,000.00
Ferizaj	17 Nëntori	Tranzicion	42	Shop in Lypjan	€ 72,199.00
			43	Shops in Prishtinë & Lypjan LLC	€ 384,750.00
			44	Shopping mall Shtime LLC	€ 401,000.00
			45	Shops lamela A&C LLC	€ 261,000.00
			46	Shops Ferizaj LLC	€ 460,700.00
			47	Admin base LLC	€ 188,750.00
Ferizaj	Tregtia	Privatizim	48	Shops LLC	€ 411,999.00
Ferizaj	Kosovatrans	Privatizim	49	Offices, maint. premises and buss	€ 1,221,000.00
Ferizaj	Fertrans	Likuidim	50	Fertrans LLC	€ 300,011.00
			51	Warehouse LLC	€ 2,162,250.00
Ferizaj	Tefik Çanga	Likuidim	52	Furniture LLC	€ 3,100,001.00
			53	Kinemaja e qytetit LLC	€ 432,000.00
Ferizaj	Universiteti punëtor.	Likuidim	54	Universiteti punëtorëve LLC	€ 806,750.00
			55	Factory premises	€ 415,000.00
Ferizaj	Brick factory	Likuidim	56	Land	€ 24,500.00
					€ 39,365,734.00
Totali i shitjeve: 56 Ndërmarrje të Reja/njësi					
	Shitjet me privatizim - 48 Ndërmarrje të Reja				
	Shitjet me likuidim - 08 njësi				

Lista e Ndërmarrjeve të privatizuara Viti

Komuna	Emri i N.Sh-së	Statuti i N.Sh.	Emri i Ndër.së Re	Cmimi i shitbl.
Viti	KB Vitia	Në tranzicion	Kooperativa Bujqësore e Vitisë Sh.P	€ 217,000.00
Viti	Agromorava	Në tranzicion	Agromorava Motel Sh.P.K.	€ 215,500.00
			Agromorava Ramian Sh.P.K.	€ 353,535.00
			Warehouse and Agro land in Gërmo	€ 309,990.00
			Agricultural Land in Nec LLC	€ 106,122.00
			Agricultural Land Pozharan-Stub LL	€ 51,500.00
			Agricultural Land Beli Dub LLC	€ 156,555.00
			Warehouse Pozharan LLC	€ 50,150.00
			Agromorava Electrical Mill LLC	€ 301,000.00
			Agromorava Goat Farm LLC	€ 41,111.00
			Agricultural Land in Nec 2 LLC	€ 107,000.00
Viti	FAM	%	%	%
Viti	Vinex	Në Likuidim	Vinex Screws and Bolts LLC	€ 730,000.00
Viti	Bentokos	Në Likuidim	Bentokos LLC	€ 310,000.00
Viti	Letnica	Në tranzicion	Letnica Textile Factory LLC	€ 185,000.00
			Letnica Viti Properties LLC	€ 266,666.00
Viti	Banja e Kllokotit	Në tranzicion	Banja e Kllokotit Mineral Water Plant	€ 1,680,000.00
			Banj a Kllokotit Land LLC	€ 401,250.00
Viti	Morava e Epërr	Në tranzicion	Morava e Eperme Margaritaret e Viti	€ 228,750.00
			Morava e Eperme Shoping Mall Viti l	€ 1,190,000.00
Viti	POE Univerzal	%	%	%
Viti	Ekonomia e py	%	%	%
Viti	Visoca - Sllatin	%	%	%
Viti	Xhafa - Sllatina	%	%	%
Viti	Vet station - Viti	Në tranzicion	Stacioni I Veterinarise Viti LLC	€ 79,861.00

Lista e Ndërmarrjeve të privatizuara Kamenicë

Komuna	Emri i N.Sh-së	Statuti i N.Sh.	Emri i Ndër.së Re	Cmimi i shitbl.
Kamenicë	KB Agroprodukti	Në tranzicion	Toka Bujqësore Kor	€ 45,555.00
Kamenicë	KB Bujku	Në tranzicion	Bujku Sh.P.K.	€ 450,000.00
Kamenicë	KBK Strezovci	%	%	%
Kamenicë	KB Perparimi -Hogosht	%	%	%
Kamenicë	ENG Beton	Në Likuidim	ENG Betoni Sh.P.K.	€ 425,235.00
Kamenicë	Tullara (Ciglana)	Në tranzicion	Tullara Sh.P.K.	€ 160,189.00
Kamenicë	XIQ Karaqeva	Në tranzicion	Karaqeva Sh.P.K.	€ 888,888.88
			Karaqeva fabrika e v	%
Kamenicë	Ekonomia e Pyjeve	%	%	%
Kamenicë	Imkos	Në Likuidim	Imkos Sh.P.K.	€ 207,000.00
Kamenicë	XIM Strezovci	Në tranzicion	XIM Strezoc miniera	€ 45,555.00
Kamenicë	Kosovarja	%	%	%
Kamenicë	Pionir	Në Likuidim	Pionir - Objektet dh	€ 316,666.00
Kamenicë	Hotel Mineral	Në tranzicion	Hotel Mineral Sh.P.	%
Kamenicë	Qëndresa	Në tranzicion	Qëndresa Shtëpia e	€ 430,000.00
Kamenicë	Kosovatrans	Në Likuidim	Kosovatrans Kamen	€ 111,111.00
Kamenicë	Stacioni i Veterinës	Në tranzicion	Stacioni i veterinaris	€ 39,083.00
Kamenicë	Jometalet Kaolini	Në tranzicion	Kaolini Sh.P.K.	€ 109,136.00

BIBLIOGRAFIA

Literatura e cituar dhe konsultuar

1. Afërdita Dervishi-Berisha , Pas Privatizimi dhe performancat e ndërmarrjeve në Kosovë, Prishtinë 2012, fq. 30
2. Aghion, P., Blanchard, O. and Burgess, R. (1994a), “The behaviour of state firms in EasternEurope, pre-privatisation”, European Economic Review, Vol. 38, pp.
3. Aghion, P., Blanchard, O. and Carlin, W. (1994b), “The economics of enterprise restructuring in Central and Eastern Europe”, CEPR Discussion Paper No. 1058, CEPR, London.
4. Aharoni, Y. (1986) The Evaluation of Management of state-owned Enterprises. Cambridge, MA; Melrose, MA: Pitman.
5. Aida Grgić, Zvonimir Mataga, Matija Longar i Ana Vilfan- Pravo na imovinu prema Evropskoj Konvenciji o ljudskim pravima- Savet Evrope, 2007 pg..4
6. Albu, Lucian-Liviu, Exploration of economic systems in the transition period,Munich Personal RePEc Archive, 1993
7. Ali Jakupi Metodologja e punës shkencore kërkimore, 2005, Ligjerata te autorizuar f.17
8. Alchian, A.A. (1977) Economic Forces at Work. Indianapolis: Liberty Press.Alchian, A.A. and H. Demsetz (1972) ‘Production Information Cost and Economic Organization’. American Economic Review 62(2):
9. Alchian, A.A. and Demsetz, H. (1972), “Production, information costs and economic organization”, American Economic Review, Vol. 62, December,
10. Alchian, A.A. and Woodward, S. (1987), “Reflections on the theory of the firm”, Journal ofInstitutional and Theoretical Economics, Vol. 143 No. 1,

11. Aleksandar Štulhofer, Povratak u budućnost?: Proces privatizacije i hrvatska javnost 1996. – 1998, Objavljeno 1999. godine u zborniku Privatizacija i javnost /ur. D. Čengić i I. Rogić/. Zagreb: Institut društvenih znanosti I. Pilar
12. Alexis, M. (1982), “The applied theory of regulation: political economy at the Interstate Commerce Commission”, Public Choice, Vol. 39,
13. Anders ÅSLUND, How Capitalism Was Built The Transformation of Central and Eastern Europe, Russia, and Central Asia, Cambridge University Press, 2007
14. Anderson, S., A. de Palma and J-F. Thisse (1997) ‘Privatization and Efficiency in a Differentiated Industry’. European Economic Review 41:
15. Anna Canning and Paul Hare, Political Economy of Privatization in Hungary: A Progress Report , Department of Economics, Heriot-Watt University, Riccarton, Edinburgh 1996 fq. 3
16. Anna Canning and Paul Hare, Political Economy of Privatization in Hungary: A Progress Report , Department of Economics, Heriot-Watt University, Riccarton, Edinburgh 1996
17. Aoki, M. (1990), “Toward an economic model of the Japanese firm”, Journal of Economic Literature, Vol. 28, March,
18. Ardian Civici, Kriza Financiare...apo Globale , UET Press 2010, fq. 125
19. Aslund, A. (1996), “Reform versus ‘rent-seeking’ in Russia’s economic transformation”, Voprosieconomiky, Vol. 68 No. 8,
20. Atkinson, S.E. and R. Halvorsen (1986) ‘The Relative Efficiency of Public and Private Firms in a Regulated Environment: The Case of U.S. Electric Utilities.’ Journal of Public Economics 29:
21. Augestad Knudsen, Privatization in Kosovo: The International Project 1999–2008 NUPI Report fq. 34

22. Awadalla Sfwat A, Privatization with Economic Development: Study on the Effect of Privatization of the Economic Efficiency in Developing Countries: Egyppt BRILL, Arab Law Quarterly, Vol 18, Nr. 1, 2003 pp 30
23. Backhaus, J.G. (1996) "Wirtschaften im Umbruch: Ordnung, Unternehmer und Stil", University of Limburg/Maastricht, METEOR Working Papers 17, Vol. 17,
24. Backhaus, J.G. (1997), "Subsidiarity and ecologically based taxation: a European constitutional perspective", Public Choice, Vol. 90,
25. Bailey, R.W. (1987) 'Uses and Misuses of Privatization'. In R.W. Bailey (ed.) Privatization and Development. New York: Academy of Political Science.
26. Bargeman, P. (1970) 'Heterogeneous Capital, the Production Function and the Theory of Distribution'. Review of Economic Studies 37:
27. Barzel, Y. (1982), "Measurement cost and the organization of markets", Journal of Law and Economics, Vol. XXV, April,
28. Barzel, Y. (1985), "Transaction costs: are they just costs?", Journal of Institutional and Theoretical Economics, Vol. 141 No. 1,
29. Blaine Harden, "Anti-Sprawl Laws, Property Rights Collide in Oregon," Washington Post, February 28, 2005.
30. Blanchard, O., Dornbusch, R., Krugman, P., Layard, R. and Summers, L. (1991), Reform in Eastern Europe, MIT Press, Cambridge, MA.
31. Blaszczyk B, Hashi I, Woodward R, Secondary Privatization In Transition Economies, The Evolution of Enterprise Ownership in Czech Republic, Poland and Slovenia, Polgrave, 2003 Czech Republic, Prague, Czech Republic pp. 281

32. Blommestein, H.J. and Marrese, M. (1991), "Developing competitive markets", in Marer, P. and Zeccini, S. (Eds), *The Transition to a Market Economy*, Special Issues II, Part 7.3, OECD, Paris,
33. Boardman, A.E. and A.R. Vining (1992) 'Ownership versus Competition – Efficiency in Public Enterprise'. *Public Choice* 73(2):
34. Bonn, M.J. (1931), "Economic policy", in, *Encyclopedia of the Social Sciences*, Brennan, G. and Buchanan, J.M. (1980), *The Power to Tax: Analytical Foundations of a Fiscal Constitution*, Cambridge University Press, Cambridge.
35. Borcharding, T., W. Bush and R. Spann (1977) 'The Effects of Public Spending on the Divisibility of Public Outputs in Consumption'. In T.E. Borcharding (ed.) *Budgets and Bureaucrats: The Sources of Government Growth*. Durham, NC: Duke University Press.
36. Borcharding, T.E., B.C. Bunaby, W.W. Pommerehne and F. Schneider (1982) 'Comparing the Efficiency of Private and Public Production: the Evidence from Five Countries'. *Zeitschrift flier Nationaloekonomie*, Supplement 2.
37. Bortolotti, B., M. Fantini, D. Siniscalco and S. Vitalini (1998) 'Privatization Processes in a Cross-section of Countries: An Empirical Analysis'. Working Paper. Italy: Universita di Torino.
38. Bos, D. (1991) *Privatization: A Theoretical Treatment*. Oxford: Clarendon Press.
39. Bothwell, J.L. (1980) 'Profitability, Risk, and the Separation of Ownership from Control'. *Journal of Industrial Economics* 28(3) (March): 303–11.
- Bowen, S. (1997) 'Bolivian Watchdog Proud of its Teeth'. *Financial Times*, 27 July: 7.

40. Boycko, M., A. Shleifer, and R.W. Vishny (1994) 'Voucher Privatization'.
Journal of Financial Economics 35:
41. Brom, K. and Orenstein, M. (1994), "The privatised sector in the Czech Republic: government and bank control in a transitional economy", East-Asia Studies, Vol. 46 No. 6,
42. Buble, M. Management. Split: Ekonomski fakultet, 2000.
43. Carlin, W. (1993), "Privatisation and de-industrialization in East Germany",
CEPR Discussion Paper 892, Centre for Economic Policy Research, London,
December.
44. Claessens, S., Djankov, S. and Pohl, G. (1997), "Ownership and corporate governance: evidence from the Czech Republic", Policy Research Working Paper No. 1737, The World Bank, Washington, DC.
45. Coffee, J. (1996), "Institutional investors in transition economies: lessons from the Czech experience", in Frydman, R., Gray, C.W. and Rapaczynski, A. (Eds), Corporate Governance in Central Europe and Russia, Vol. I, CEU Press, Budapest, London, New York, NY,
46. Corbett, J. and Mayer, C. (1991), "Financial reform in Eastern Europe: progress with the wrong model", Oxford Review of Economic Policy, Vol. 7 No. 4,
47. David Lipton- Jeffrey Sachs, Privatization in Eastern Europe: The Case of Poland ,Brookings Papers on Economic Activity,2/ 1990 fq 294
48. Davies, S.W. and Lyons, B.R. et al. (1996), The Organisation of Industry in the European Union,Oxford University Press, Oxford.
49. De Alessi, L. (1983), "Property rights, transaction costs, and X-efficiency: an essay in economic theory", American Economic Review, Vol. 73 No. 1

50. Demsetz, H. (1966), "Some aspects of property rights", Journal of Law and Economics, Vol. 22,
51. Demsetz, H. (1982), "Barriers to entry", American Economic Review, Vol. 72, March,
52. Demsetz, H. (1988), "The theory of the firm revisited", Journal of Law, Economics and Organization, Vol. 4 No. 1,
53. Dewatripont, M. and Roland, G. (1992), "On the preferences of gradualism and its justification in the transition to market economy", The Economic Journal, Vol. 102, March.
54. Doeringer, P.B. and Piore, M.J. (1971), Internal Labour Markets and Manpower Analysis, Lexington Books, Lexington, MA.
55. Dr Ismet Gusia , Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të KSA, Rilindja 1982, Prishtinë faqe 7
56. Draft, L. Richard. Management. Fifth edition. San Diego: The Dryden press, 2000
57. Dragica Pavovic: Social – psychological attitudes of citizens about privatization, Belgrade, April 2001.
58. Dušan Janjić, Nacionalni identitet, pokret i nacionalizam Srba i Albanaca, u: Sukob ili dijalog, fq. 113
59. E.S. Savas, Privatization and Public-Private Partnerships_(New York: CQ Press, 2000
60. Ellerman, David (ed.) 1993. Management & Employee Buy-Outs as a Technique of Privatization. Ljubljana: CEEP.N.
61. Enrico Colombatto: On the Concept of Transition, ICER, Working Paper Series, Torino, 2000.

62. Fama, E.F. and Jensen, M.C. (1983), "Separation of ownership and control",
Journal of Law and Economics, Vol. XXVI, June,
63. Fatmir Mema, Privatizimi dhe efekte e tij në Shqipëri, fq. 197
64. Felderer, B. (Ed.) (1989), The Political Economy of Progressive Taxation,
Springer Verlag, Berlin, New York, London,
65. Fine, B. and L. Harris (1985) The Peculiarities of the British Economy.
London: Lawrence & Wishart.
66. Finsinger, J. (1984) 'The Performance of Public Enterprises in Insurance
Markets'. In M. Marchand, P. Pestieau and H. Tulkens (eds) The Performance
of Public Enterprises: Concept and Measurement. Amsterdam: North Holland.
67. Fisher, F.M. (1971) 'The Existence of Aggregate Production Functions:
Reply'. Econometrica, Vol. XXXIX,
68. Foreman-Peck, J. and M. Waterson (1985) 'The Comparative Efficiency of
Public and Private Enterprise in Britain: Electricity Generation Between the
World Wars'. Economic Journal 95 (Supplement):
69. Forsyth, P. and R. Hocking (1980) Economic Efficiency and the Regulation of
Air Transport. Melbourne: Committee for Economic Development of
Australia.
70. Frey, B.S. (1979), "Economic policy by constitutional contract", Kyklos, No.
32,
71. Frydman, R., Rapaczynski, A. and Earle, J.S. (1994), The Privatisation
Process in Central Europe, Central European University Press, Budapest,
London, New York, NY.
72. Furubotn, E. and Pejovich, S. (1972), "Property rights and Landes, W.M. and
Posner, R.A. (1979), "Adjudication as a private good", Journal of Legal
Studies, Vol. 8.

73. Glassman, C.A. and S.A. Rhoades (1980) 'Owner vs. Manager Control Effects of Bank Performance'. *Review of Economics and Statistics* 2 (May):
74. Goldring, M. (1993) 'Private Lives of Really Useful Companies'. *Independent*, 25 March.
75. Goodman, J.B. and G.W. Loveman (1991) 'Does Privatization Serve the Public Interest?' *Harvard Business Review* 69(6) (November–December):
76. Goran Mitić,: *Regulatorna funkcija države u savremenim tržišnim privredama*, <http://www.link.elearning.com/linkdl/elearning/jedinica.php?IDJedinice=6184>
77. Gordon, R.J. (1990) *The Measurement of Durable Goods Prices*. Chicago, IL:University of Chicago Press.
78. Gould, John A. , 2007: 'Privatization and Political Institution Building in Kosovo and Bosnia & Herzegovina', IREX (International Research& Exchanges Board), Washington DC.
79. Government of Bulgaria and the World Bank (1993) "Mass privatisation in Bulgaria", general framework, joint memorandum of a working group of the Government of Bulgaria and the World Bank, draft, December, Sofia.
80. Gow, James, 1997: *Triumph of the lack of will: International Diplomacy and the Yugoslav War*. Hurst, London.
81. Groenewegen, J. (1997), "Institutions of capitalism: American, European, and Japanese systems compared", *Journal of Economic Issues*, Vol. 31 No. 2,
82. Grossmann, S.J. and Hart, O.D. (1986), "The costs and benefits of ownership: a theory of vertical and lateral integration", *Journal of Political Economy*, Vol. 94,
83. Hajko, I. (1995), "According to A.M. Huska main consequence of voucher privatization are insufficiently transparent owners", *Trend*, Vol. 3, May, p. 5B.

84. Hameiri, Shahr, 2009: 'Capacity and its Fallacies: International StateBuilding as State Transformation', *Millennium* 38 (1).
85. Hamidi, Lavdim, 2009: 'Elections pave way for Kosovo privatisations', *BIRN*, 26 Nëntor.
86. Hannum, Hurst, 1996: *Autonomy, sovereignty and self-determination: the accommodation of conflicting rights*. University of Pennsylvania Press, Philadelphia, PA.
87. Hanousek, J. and Kocenda, E. (1997), "Effects of the Czech voucher scheme on the corporate governance", *Economics Institute Discussion Paper 05/97*, Bulgarian Academy of Sciences, Sofia.
88. Harberger, A.C. (1954), "Monopoly and resource allocation", *American Economic Review*, Vol. 44
89. Hartley, K. and N. Hooper (1992) 'Industry and Policy.' In P. Curwen (ed.) *Understanding the U.K. Economy*. Basingstoke: Macmillan.
90. Hasani, Enver, 2005: *Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability: The Case of Yugoslavia*, National Defence Academy, Vienna.
91. Hayek, F.A. (1984) *The Essence of Hayek*. Edited by C. Nishiyama and K.R. Leubel. Foreword by W. Gienn Campbell. Stanford, CA: Hoover Institution Press, Stanford University.
92. Henry H Perrit, Jr. "Resolving claim when countries disintegrate: the challenge of Kosovo", *Chicago-Kent Law Review*, 80, 119, 2005, fq. 160
93. Herrera, G.P. (1996), "Economic and political obstacles to privatisation in Bulgaria", *Bericht des BIOst*, No. 51
94. Héthy, Lajos, 2002: 'Labour Law for Kosovo', *South East Europe Review*, 3.

95. Hirst, I. (1993), "Financial markets and public policy", in Hare, P.G. and Simpson, L. (Eds), British Economic Policy, Harvester Wheatsheaf, London.
96. Hoffmann, Florian and Mégret, Frédéric, 2005: 'Fostering Human Rights Accountability: An Ombudsperson for the United Nations?', Global Governance, 11.
97. Hoti, Avdullah, 2004: 'Human Capital and Unemployment in Transition: The Case of Kosova', RIINVEST, Prishtinë.
98. Hurl, B. (1988), Privatisation and the Public Sector, Heinemann Educational, Oxford.
99. Institut za Avancirane Studije- Opštinski izveštaj 2009 f. 2
100. Iraj Hashi: Privatisation Strategy for Kosovo: What can we learn from other transition countries?, Stanford University,. January 2001.
101. Isa Mulaj, Redefining Property Rights with Specific Reference to Social Ownership in Successor States of Former Yugoslavia: Did it Matter for Economic Efficiency? Central European University, Budapest, Hungary, 5 – 7 May 2006 pg. 5
102. Ismet Gusia , Burimet natyrore si faktor i zhvillimit ekonomik të KSA, Rilindja 1982, Prishtinë f. 7
103. Jan Hanousek and Evzen Kocenda, The impact of Czech mass privatization on corporate governance, Center for Economic Research and Graduate Education, Charles University, Economics Institute, Academy of Sciences of the
104. Jelena Manić, Jedan liberalni pogled: Hajekova kritika socijalizma, Zbornik Beogradske otvorene škole, 2007

105. Jensen, M.C. and Meckling, W.H. (1976), "Theory of the firm: managerial behavior, agency costs and ownership structure", *Journal of Financial Economics*.
106. John M. Meyer, Humboldt State University, Arcata, California The Concept of Private Property and the Limits of the Environmental Imagination, *Political Theory* Volume 37 Number February 2009
107. Joseph Henry Vogel, *genes for sale Privatization as a Conservation Policy*, New York Oxford, Oxford University press 1994
108. Joseph M. Dogget- *Privatization on Central and Eastern Europe*
109. Jurgen Backhaus, Frank H. Stephen and Plamen Tchipev, *Mass privatisation in Central and East European countries*, *Journal of Economic Studies*, Volume 30 Number 3/4 2003
110. Kikeri, Sunita, Nellis, Jon, Shirley, Marz, *Privatization the lessons of Experience*, A World Bank Publication, Washington DC, 1994
111. King, L. (1996), "The managerialization of the postcommunist economy in Hungary and the CzechRepublic: strategies on transition to East European capitalism", *Lessons from Transition*, Austrian Academy of Sciences, Vienna,
112. Kornai, J. (1988) 'Individual Freedom and Reform of the Socialist Economy'. *European Economic Review* 32(2-3) (March):
113. Kotrba, J. (1995), "Privatisation process in the Czech Republic: players and winners", in Svejnar, J.(Ed.), *The Czech Republic and Economic Transition in Eastern Europe*, Academic Press, San Diego, CA.
114. Laffont, J-J. and J. Tirole (1991) 'Privatization and Incentives'. *Journal of Law, Economics and Organization* 7:
115. Laštovieka, R., Marcinein, A. and Mejsstøik, M. (1995), "Corporate governance and share prices in voucher privatised companies", in Svejnar, J.

- (Ed.), *The Czech Republic and Economic Transition in Eastern Europe*, Academic Press, San Diego, CA.
116. Leibenstein, H. (1966), "Allocative efficiency vs X-efficiency", *American Economic Review*, Vol. 56No. 6,
 117. Lindahl, E. (1958), "Positive Lösung: Die Gerechtigkeit der Besteuerung. Lund 1919", in Musgrave, R.A. and Peacock, A.T. (Eds), *Classics in the Theory of Public Finance*, Macmillan, London.
 118. Linowes, D.F. (1990) 'Privatization and Deregulation in the United States'. In D.J. Gayle (ed.) *Privatization and Deregulation in Global Perspective*. London: Pinter.
 119. Littlechild, S.C. (1986a) *Economic Regulation of Privatised Water Authorities: A Report Submitted to the Department of the Environment*. London: HMSO.
 120. Lorna Štrbac , Prikaz knjige Zorana Vidojević, *Demokratija na zalasku – autoritarno – totalitarna pretnja*, Službeni glasnik i IDN, Beograd, 2010
 121. Lorna Štrbac , Prikaz knjige Zorana Vidojević, *Demokratija na zalasku – autoritarno – totalitarna pretnja*, Službeni glasnik i IDN, Beograd, 2010
 122. Marija Obradović , *ekonomska-politika/uloga-medjunarodnih-finansijskih-organizacija-i-agencija-stranih-vlada-u-privatizaciji-drustvenog-kapitala-u-srbiji-2002*
 123. Megginson, W.L. and J.M. Netter (1998) 'Equity to the People: The Record on Privatisation by Public Offers.' In *Privatisation Yearbook*. London: Privatisation International:
 124. Mema Fatmir, *Privatizimi në Shqipëri*, Universiteti i Tiranës , 1997
 125. Milanovic B. *Privatization Options and procedures in the Transitions from Socialism in Eastern Europe*, Washington DC 1992, fq.49

126. Miller, J. (1992), "Financial institutions, risk and resource allocation in Bulgaria", Bank Review (Journal of Bulgarian National Bank), Vol. 2, July,
127. Moritz, J.B. (1931), "Economic policy", in, Encyclopedia of the Social Sciences, Vol. 5,
128. Motasam Tatahi, Privatisation Performance in Major European Countries Since 1980, 175 Fifth Avenue, New York 2006
129. Muhamet Mustafa –Privatizimi në Kosovë, Riinvest 2004, fq. 11
130. Muhamet Mustafa –Privatizimi në Kosovë, Riinvest 2004, f. 11
131. Murati, Gjylbehare: 'The Independence of the Judiciary and its role in the Protection of Human Rights under UN Administration using the Case of Kosovo', European Society of International Law, Agora Paper, 2004, Florence.
132. Musa Limani, Makroekonomia Aplikativa , Aplikativna Makroekonomija, Prishtina 2003 fq 69,72,74
133. Musgrave, Thomas, 1997: Self-determination and National Minorities. Oxford University Press .Narten, Jens, 2009: 'Dilemmas of promoting 'local ownership': The case of postwar Kosovo' in Paris and Sisk (eds).
134. Newbery, D.M. and Kattuman, P. (1992), "Market concentration and competition in Eastern Europe", The World Economy, Vol. 15 No. 3,
135. North, D.C. (1981), Structure and Change in Economic History, New York. There is a long review in The Wall Street Review of Books, Vol. 11 No. 3, 1983.
136. Nuri Bashiota, Ekonomia Politike, Prishtinë, 1998 fq. 473
137. Nuri Bashota, Ekonomia e Tregut-detyrë prioritare në dokumentin "Standardet për Kosovën"-Publikim 2006

138. OSCE, 2008: 'Privatization in Kosovo: Judicial Review of Kosovo Trust Agency Matters by the Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo', Monitoring Department/Rule of Law Division, Maj, Prishtinë.
139. Palairer, Michael, for the LLA/ESI, 2002: 'Trepca 1965-2000', Prishtinë.
140. Pettifer, James, 2002: 'Kosovo Economy & Society after 1945 – Some Observations', Conflict Studies Research Centre, Royal Military Academy, Surrey, Janar.
141. Polona Domadenik, Lubomír Lízal, Marko Pahor effect of enterprise break-ups on performance: case of former yugoslav republic of macedonia Institute for South East Europe (ISEE) and University of Ljubljana
142. Radovan Kovacevic, Tranzicija zemalja Centralne i Istočne Evrope u tržišnu privredu, Institut za spoljnu trgovinu. Beograd. 2002
143. Ramiz Livoreka, Argumentet relevante për shfrytëzimin e mjeteve nga privatizimi i ekonomisë së Kosovës. "Economia" nr.1-2 2003, Instituti Ekonomik, Prishtinë
144. Ramiz Livoreka, Argumentet relevante për shfrytëzimin e mjeteve nga privatizimi i ekonomisë së Kosovës. "Economia" nr.1-2 ,2003, Instituti Ekonomik, Prishtinë
145. Rita Augestad Knudsen, Privatization in Kosovo: The International Project 1999–2008 NUPI Report
146. Romer, P.M. (1986) 'Increasing Returns and Long-run Growth'. Journal of Political Economy 94(5):
147. Rowthorn, B.E. (1974) 'Neo-classicism, Neo-Ricardianism and Marxism'. New Left Review 86:

148. Rybczynski, T. (1986), "Industrial finance system in Europe, US and Japan", in Day, R.H. and Eliasson, G. (Eds), *The Dynamics of Market Economies*, Elsevier Science Publishers, Amsterdam,
149. S. KUSIC: Institucionalni i evolucijski aspekti privatizacije u srednjoj i istočnoj Europi ekonomski pregled, 58 (1-2) (2007) fq. 91-105 .
150. Sachs, Jeffrey 1999. *Lessons of Transition: A reform architect looks at what worked -- and what didn't*. Central European Economic Review. October 25, 1999.
151. Schleifer, A. and Vishney, R.W. (1997), "A survey of corporate governance", *The Journal of Finance*, Vol. LII,
152. Schumpeter, J.A. (1949), "Science and ideology", *American Economic Review*, No. 39.
153. Scott, James C. 1998. *Seeing Like a State: How Certain Schemes to Improve the Human Condition Have Failed*. New Haven: Yale.
154. Selman Selmanaj – *Sistemet ekonomike bashkëkohore* , Prishtina 1996 fq 25-27
155. Selman Selmanaj – *Sistemet ekonomike bashkëkohore*, Prishtina 1996 fq. 33-34
156. Singer, M. and Svejnar, J. (1994), "Using vouchers to privatise and economy: the Czech and Slovak case", *Economics of Transition*, Vol. 2 No. 1.
157. Slaveski, Trajko. *Makedonskata ekonomija vo tranzicija: Propušteni mogućnosti, alternativni rešenija*. Skopje: NIP Ekopres, 1995.
158. Staehr, K. (2006): *Linkages between Political and Economic Reforms in Post-Communist Countries*, *Nordic Journal of Political Economy*, 32(2),
159. Staehr, Karsten, Tamazian, Artur and Vadlamannati, Krishna Chaitanya, *Political Determinants of Economic Reforms in the Post-Communist*

Transition Countries, University of Santiago de Compostela 01. May 2009 fq.

5

160. Staehr, Karsten, Tamazian, Artur and Vadlamannati, Krishna Chaitanya, University of Santiago de Compostela, May 2009 pg. 5
161. Stanlez Fischer 1991, Privatization in Eastern Europe, National Bureau of Economic Research Cambridge, 1991 fq,3
162. Shleifer, Andrei and Robert Vishny 1998. The Grabbing Hand: Government Pathologies and Their Cures. Cambridge: Harvard University Press.
163. Shyqri Laci- Jorida Tabaku, Qeverisja e Korporate, Tiranë : Albpaper, 2010 fq.238
164. Tchipev, P. (1994), "Development of the model for financial institutions: involvement in Bulgarian privatisation. Some lessons from UK experience", Department of Economics, Heriot-Watt University, Edinburgh, July.
165. V. Legal issues in Privatization, United Nation Commission on international Trade Law, Viena, 1993 fq.2
166. Valve, N. T. (2004): No Pain, No Gain: Market Reform, Unemployment and Politics in Bulgaria, Journal of Comparative Economics, 32(3),
167. Vining, A.R. and A.E. Boardman (1992) 'Ownership versus Competition: Efficiency in Public Enterprise'. Public Choice 73:
168. Vukotić V., Privatizacija, Institut društvenih nauka, Beograd, 1993, fq. 29
169. Walras, L. (1954) Elements of Pure Economics. Homewood, IL: Richard D. Irwin.
170. Wayland, K. (2002): The Political Fate of Market Reform in Latin America, Africa, and Eastern Europe, International Studies Quarterly, 42(4),

171. Wickens, M.R. (1970) 'A Theory of the Labour Market'. Discussion Papers in Economics, No. 36.
172. Williamson, O. (1970) Corporate Control and Business Behaviour. Englewood Cliffs,NJ: Prentice-Hall.
173. Williamson, O.E. (1975), Market and Hierarchies: Analysis and Antitrust Implications, Free Press,New York, NY.

Publikimet e cituara;

1. KIPRED (Kosovar Institute for Policy Research and Development), Pristina 2005, f.9
2. Forum 2015, Privatizimi në Kosovë,2004, f.35
3. Raport pune AKP për periudhën kohore 2009-2013,
4. KIPRED- Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Pasurisë Shoqërore, Prishtina 2005, f. 13
5. Jedinstvo, Priština, 02.mart.1997
6. Riinvest; Ndërmarrjet Shoqërore dhe Transformimi/ Privatizimi, Prishtina, 2001 f.4

Web Site:

1. <http://kta-kosovo.org>
2. www.unmikonline.org/constframework.htm
3. www.unmikonline.org/regulations/unmik
4. www.unosek.org/docref/report
5. [www, Wikipedia](http://www.Wikipedia), Kosova
6. www.pak-ks.org etj

Ligjet e cituara dhe konsultuara:

1. Gazeta Zyrtare e nr .77 Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë , 31 dhjetor 1988
2. Gazeta Zyrtare e nr. 40 Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë,7.korrik 1989
3. Gazeta Zyrtare e nr.77 Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, 31.dhjetorr 1988
4. Ligji nr.03/ L-109 mbi doganat dhe akcizën në Kosovë
5. Ligji i Agjencionit Kosovar të Privatizimit nr.03/L-067
6. Ligji nr. 02/L-123 mbi shoqëritë tregtare
7. Ligji nr. 03/L-113 mbi tatimin në qarkullim të korporatave
8. Ligji nr. 03/L-114 mbi tatimin në vlerën e shtuar
9. Ligji nr. 03/L-115 mbi tatimin në të ardhura personale
10. Ligji nr.02/ L-33 mbi investimet e jashtme
11. Ligji nr.03/ L-067 Mbi Agjencionin Kosovar të Privatizimit
12. Ligji nr.03/ L-071 21.11. mbi borxhin e Ndërmarrjeve Shoqërore
13. Rregullore UNMIK 2000/45 , neni 1
14. Rregullore br.2002/12 neni 17
15. Rregullore UNMIK 1999/24 neni 1
16. Rregullore UNMIK 2002/13 neni 1 i 4
17. Rregullore UNMIK 2005/18 neni; 2,3,5,6,8,9,10,13,14,15 i31
18. Rregullore UNMIK-a nr. 1999/01 od 25. korrik 1999.të ndryshuara dhe plotësuar me Rregulloren UNMIK-a nr. 2000/54
19. Rregulloren UNMIK-a nr. 2001/9, 15. maj 2001
20. Sluzbeni Glasnik Republike Srbije br.48, 5.avgust 1991